

Bordi Editorial

PROF. DR. ROMEO GURAKUQI, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

FATOS TARIFA PH.D., *Universiteti European i Tiranës (UET)*

PROF. DR. ERLETA MATO, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

DR. ENIS SULSTAROVA, *Universiteti i Tiranës*

BLENDI KAJSIU, DOKT., *Essex University, Britani e Madhe*

STEPHANIE SCHWANDNER-SIEVERS, *University of Roehampton, Britani e Madhe*

PROF. ASOC. ÇAPAJEV GJOKUTAJ, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

DR. NATHANIEL COPSEY, *Aston University, Britani e Madhe*

Kryeredaktore

ODETA BARBULLUSHI, PH.D.

Redaktorë

PROF. ASOC. DR. TONIN GJURAJ, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

PROF. DR. PËRPARIM FUGA, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

PROF. ASOC. DR. ALEKSANDËR DHIMA, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

Redaktore Gjuhësore

BASHKIM GJERGJI

BESA VILA

Arti grafik

BLERIM BYTYÇI

përmbajtja

Partitë Politike Shqiptare pas njëzet vitesh demokraci Odeta BARBULLUSHI, Ph.D.	5
Parti të reja por jo dhe aq: PDIU dhe LSI në qeverisje Dr. Klejd KËLLIÇI	7
Ndërveprimi midis partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile Dokt. Gentian ELEZI	31
Struktura dhe Organizimi i Partisë në Shqipërinë post-komuniste: Një studim mbi Partinë Demokratike të Shqipërisë Dokt. Anjeza XHAFERAJ	42
Televizioni në raportet Parti Politike: Publik Dokt. Roland LAMI	61
Progres Raporti i Bashkimit Evropian në Shtypin Shqiptar: Një analizë përmbajtësore Odeta BARBULLUSHI, Ph.D.	75
Yll i partisë, yll i mediave: Rasti i ngritjes mediatike të Edi Ramës Dokt. Belina BUDINI	85
Partitë politike shqiptare dhe tëhuajtësimi i qytetarëve ndaj politikës: Bilanc pas 20 vitesh pluralizëm partiak Gilman BAKALLI, Ph.D.	95
INTERVISTA/ Florian Beiber: Roli i Partive në Ballkanin Perëndimor Intervistoi: Dr. Klejd KËLLIÇI	115
Financimi i partive politike nga donatorët privatë: Aleancë e heshtur? Dr. Erjona CANAJ	119
Protesta si Fenomen Konservator Dokt. Klementin MILE	135

© UET Press

Të gjitha të drejtat për këtë botim janë të rezervuara.
Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet
përmes çdo mënyre ose mjete pa leje paraprake.

Punimet e paraqitura shprehin mendimet dhe qëndrimin personal të autorëve.
Redaksia nuk mban përgjegjësi për sa autorët kanë shprehur në shkrimet e tyre.

Sulltanizmi në Shqipëri Dokt. Lulzim HOXHA.....	149
Recencë Dr. Klejd KËLLIÇI.....	159
Mendimi Social Politik, Weberi dhe tradita weberiane në sociologjinë amerikane Fatos TARIFA, Ph.D.	163
Ekologjia humane dhe ndihmesa e Shkollës së Çikagos në zhvillimin e Antropologjisë Sociale Prof. Asoc. Dr. Aleksandër DHIMA.....	181

Partitë Politike Shqiptare pas njëzet vitesh demokraci

Odeta BARBULLUSHI, Ph.D.

KRYEREDAKTORE

Partitë politike janë aktorët kryesorë të politikës në Shqipërinë postkomuniste, përveçse janë dhe mbartëset kryesorë të identiteteve sociale. Identifikuesit “i majtë” apo “i djathtë” janë shënjes thelbësorë të individit shqiptar në post-komunizëm. Por ç’farë do të thonë në të vërtetë këta shënjes? Ç’farë kuptimi kanë në realitetin politik shqiptar dhe si përpiqen partitë shqiptare që të sigurojnë besnikërinë e ndjekësve dhe të shtojnë elektoratin e tyre? Po ashtu, cilat janë disa prej tipareve, sjelljeve dhe strukturave ideologjike dhe konjiktive të partive shqiptare në post-komunizëm?

Këto janë disa nga pyetjet që shtron ky numër i revistës *Polis*. Me anë të analizave, të bazuara në punën e mirëfilltë në terren, kjo përmbledhje artikujsh demonstroi si partitë politike përpiqen gjithnjë të ndryshojnë kushtet strukturore, institucionale dhe ligjore ku operojnë, me synim forcimin e pozitave të tyre dhe rritjen e numrit të votuesve. Kontributin më të rëndësishëm kjo përmbledhje artikujsh e jep në drejtim të hapjes së “kutisë së zezë” të partive shqiptare, duke hulumtuar me imtësi në brendësi të organizimit strukturor, aspekteve ideologjike, rolit të liderit, strategjive mediatike dhe komunikimit politik të partive shqiptare në këto dy dekada pas rënies së regjimit komunist dhe monopolit të Partisë së vetme, asaj të Punës. Nëpërmjet këtyre hulumtimeve empirike arrihet të nxirren specifikat e partive postkomuniste shqiptare në kuadrin e literaturës dhe të debateve mbi demokratizimin dhe evoluimin e partive politike gjetkë, në Europën Lindore dhe Qendrore.

Kontributet në këtë numër të revistës hulumtojnë ngritjen dhe suksesin e partive tradicionale, tashmë Partia Demokratike (shih artikullin e Anjeza Xhaferit), daljen në skenë të aktorëve të rinj partiakë si PDIU dhe LSI (shih artikullin e Klejdi

Këllicit) si dhe marrëdhënien e koklavitur mes partive politike dhe shoqërisë civile (artikulli i Gentian Elezit), demokracinë e brendshme të partive politike shqiptare (Ina Zhupa) dhe financimin e tyre (artikulli i Erjona Canajt). Po ashtu, pjesa e dytë e artikujve i dedikohet çështjeve që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e partive politike me median (si në rastin e shkrimeve të Roland Lamit e të Belina Budinit) si dhe me “trekëndëshin e Bermudës” të demokracisë shqiptare: Media-Partitë Politike-BE dhe Integrimi European (shkrimi i Odeta Barbullushit). Tri punime, me fokus konceptual, si ai i Gilman Bakallit, Klementin Miles dhe Lulzim Hoxhës hulumtojnë kuptimin dhe aplikueshmërinë në realitetin politik shqiptar të koncepteve “demokraci”, “protestë sociale” dhe “sulltanizëm”.

Të gjitha këto analiza bazohen te një punë e mirëfilltë në terren dhe shumica e këtyre artikujve kanë shfrytëzuar burime parësore krejtësisht të reja. Për më tepër, ato mbajnë një distancë kritike nga objekti i tyre i analizës, me gjithë faktin që shumica e çështjeve dhe e problematikave në shqyrtim janë ende në proces konsolidimi. Pikërisht për këto arsye këto analiza janë sa të freskëta, aq dhe rigorozë.

Parti të reja por jo dhe aq: PDIU dhe LSI në qeverisje

Dr. Klejd KËLLIÇI¹

Abstrakt. Ky studim ka si qëllim evidentimin dhe shqyrtimin e sistemit të partive politike në Shqipëri dhe kryesisht rolin që partitë e “reja” kanë në funksionimin e vetë sistemit. Si fillim do të shqyrtohen termat mbi të cilat ngrihet punimi, si për shembull përcaktimin e termit “parti të reja” si dhe mjedisin në të cilin ato zhvillojnë aktivitetin e tyre. Prania, ose domosdoshmëria parlamentare e partive të “reja” do të shihet në raport me rolin që ato kanë në aftësinë e “shtrëngimit”, ose të kushtëzimit të autonomisë në aksionin ekzekutiv të forcave tradicionale, ose të forcave më të mëdha në qeverisje. Punimi merr në shqyrtim efektin e prodhuar si pasojë e futjes në qeverisje të dy formacioneve të reja politike LSI dhe PDIU në vitin 2009.

Hyrje

Ky studim ka si qëllim evidentimin dhe shqyrtimin e sistemit të partive politike në Shqipëri dhe kryesisht rolin që partitë e “reja” kanë në funksionimin e vetë sistemit. Si fillim do të shqyrtohen termat mbi të cilat ngrihet punimi, si për shembull përcaktimin e termit “parti të reja” si dhe mjedisin në të cilin ato zhvillojnë aktivitetin e tyre. Mjedisi, është kryesisht ai i pranisë në parlament, frekuenca e shfaqjes, ose e rishfaqjes së këtyre partive në këtë institucion si dhe ushtrimin e aktivitetit parlamentar në funksion të marrjes pjesë në qeveri. Prania, ose domosdoshmëria parlamentare e partive të

¹ Klejd Këlliçi është titullar i lëndës Shkenca Politike dhe Politikë e Krahasuar pranë Universitetit European të Tiranës. Ai ka marrë titullin Doktor në Institucione dhe Politikë të Krahasuar nga Universiteti i Barit në Itali.

“reja” do të shihet në raport me rolin që ato kanë në aftësinë e “shtrëngimit”, ose të kushtëzimit të autonomisë në aksionin ekzekutiv të forcave tradicionale, ose të forcave më të mëdha në qeverisje. Punimi nisët nga dy elemente të debatuar gjerësisht në lëmin e shkencave politike, atë që ka të bëjë fillimisht me natyrën e sistemit të partive politike në Europën Lindore (Kitchelt 1992, Lewis 2001, Lindstrom 2001, Gryzmala-Busse 2007, Van Biezen 2003, Birch 2003) dhe shtjellimin e konceptit të partive të “reja” (Dalton dhe Wattenberg 2000, Luther dhe Müller-Rommel 2002, Mair 2002, Norris 2004, Schoefield dhe Sened 2006, Deschouëer 2008, Boyller 2008).

Natyra e sistemit të partive politike në Europën lindore do të shërbejë si mekanizëm krahasimi për të parë evolucionin dhe konsolidimin e partive politike në Shqipëri. Ky mekanizëm krahasimor është vecanërisht i nevojshëm në kushtet kur një analizë e tillë kritike mungon, jo vetëm në vëmendjen e studiuesve të huaj, por edhe të atyre vendas. Koncepti i partive të “reja” do të vihet kështu në funksion të analizës së sistemit të partive politike. Shpesh, dallimi që bëhet në konceptin e partive të “reja” si mekanizma ndryshimi cilësor në sistemin e partive politike lidhet në radhë të parë me përcaktimin e vetë sistemit të partive si dhe të arsyeve të konsolidimit të tij. Duke qenë se studiues të ndryshëm kanë shprehur shpesh rezervat e tyre në lidhje me konceptin e partive të reja në sistemet partiake të Europës Lindore, me ‘parti të reja’ do të nënkuptojmë ato parti të cilat nuk janë pasardhëse të asnjë partie parlamentare, që kanë një emër si dhe një strukturë të re dhe që nuk kanë brenda tyre ndonjë figurë të rëndësishme politike mes anëtarëve më të rëndësishëm të tyre (Sikk 2005). Nëse do t’i qëndronim besnik këtij cilësimi atëherë qëllimi i tezës së kësaj teme mund të binte të paktën në një rast, ndonëse jam munduar ta justifikoj me përfundimin që këto parti nuk mund të konsiderohen edhe aq të reja. Gjithsesi risia që ato sjellin në sistem lidhet me faktorët si: ndryshimi që ato sjellin në sistemin e partive (Sartori 1976) dhe suksesi i paprecedentë në raport me njëzet vjet demokraci.

Nëse i referohemi hipotezës më të debatueshme, pikërisht asaj të “frakturave shoqërore”(Lipset dhe Rokkan 1967) sistemet e partive politike në Europën Perëndimore janë konsoliduar në raport me një seri përplasjesh brenda konteksteve kombëtare, por me ndjeshmëri paneuropiane si konflikti mes “kishës dhe shtetit, qendrës dhe periferisë, apo kapitalit dhe punës”. Ky mekanizëm ka ndikuar të paktën deri në vitet 1970-1980 në ruajtjen e një stabiliteti të paprecedentë të sistemit të partive politike të reflektuar në atë që

Lipset dhe Rokkan e cilësojnë si “hipoteza ngrirëse”². Pa dashur të analizojmë kushtet socio-kulturore që i çuan autorët të dalin me një hipotezë të tillë, ajo çka është e rëndësishme për ne është reflektimi organizativo-sistemik në të cilin inkuadrohet ‘hipoteza ngrirëse’. Sipas Mair-it, elementi kryesor mbi të cilin ngrihet hipoteza “Lipset Rokkan” qëndron jo më në faktin se “frakturat” prodhuan mobilizim dhe si pasojë organizim politik, po në atë se paritë politike qenë të afta të stabilizojnë ekzistencën e tyre nëpërmjet adaptimit dhe organizimit (Mair 2001:24).

Nga kjo pikëpamje, koncepti i partive të reja zgjon interes për sa kohë që mbetet në dinamikën e dy elementeve të para e të shtjelluara më lart. Pra, partitë e reja bëhen më të konsiderueshme përsa kohë që ato prodhojnë ndryshime të qenësishme në strukturën e përfaqësimit, në sistemin e kanaleve përmes të cilave rregullohet përfaqësimi (pra në vetë sistemin e partive) si dhe në përcaktimin e aksionit të qeverisë. Logjika me të cilën analizohen partitë, dhe sidomos partitë e reja, lidhet me ndryshimet sistemike që ato sjellin (Mair 2001:52). Sipas cilësimit të Mair-it “*ndryshimet në sistemin e partive ndodhin atëherë kur sistemi i partive transformohet nganjë klasë, ose nga një tip partish në një tjetër*” (Mair 2001:52). Në këtë kuptim me ndryshim dhe parti të reja Mair nënkupton ndryshim jo vetëm elektoral, por edhe përmbajtësor në sistemin e partive. Në të njëjtën kohë, duke cituar Sartorin dhe mënyrën që ai përdor për të numëruar partitë politike, Mair lidh pra, praninë e partive të reja edhe me një dimension numerik i cili ndryshon jo vetëm strukturën e përfaqësimit, por edhe dimensionin e aksionit të qeverisë.

Sistemi i partive në Shqipëri

Dy rastet të cilat do të analizohen në këtë artikull, PDIU dhe LSI merren parasysh në radhë të parë si elemente të reja në sistemin e partive politike në Shqipëri. Ato ndoshta nuk i përshtaten skemës së Mair-it (të paktën me LSI-në) nga pikëpamja cilësore. Po kështu edhe në logjikën e Sartorit për numërimin e partive, sistemi i partive në Shqipëri hyn formalisht në kategorinë e multipartitizmit të moderuar, me dy koalicione me parti dominante. Termi

² ‘Hipoteza ‘ngrirëse’ hedh idenë se sistemet e partive politike kanë ‘ngrirë’ në evidentimin e disa frakturave sociale dominante që me futjen e sistemit universal të votës në vitet njëzet. Sipas Lipset dhe Rokkan, partitë politike të viteve gjashtëdhjetë përfaqësonin po ato interesa dhe kontradikta shoqërore që evidentohen me fillimin e analizës së tyre. Autorët shpjegojnë kështu stabilitetin e sistemeve partiake në Evropën Perëndimore. Kjo teori vlen të testohet edhe në Evropën Lindore për të kuptuar mënyrën se si votojnë qytetarët dhe atë se si formohen sistemet partiake në këtë zonë. Lipset, Seymour Martin, and Stein Rokkan. 1967. ‘Introduction’. In *Party Systems and Voter Alignments*, eds Seymour Martin Lipset and Stein Rokkan. New York:Free Press.

‘formalizëm’ në këtë rast shtyn dhe më tej analizën tonë duke hedhur hipotezën që të paktën deri në vitin 2001 sistemi i partive në Shqipëri ka anuar më tepër nga bipartitizmi sesa nga multipartitizmi i moderuar. Siç do të shihet edhe në vazhdim sistemi i partive në Shqipëri ka evoluar drejt multipartitizmit formal vetëm duke filluar me zgjedhjet e vitit 2001 dhe me efektet që pati kushtetuta e miratuar në vitin 1998. Duke filluar me analizën e sistemeve zgjedhore me pikënisje vitin 1991 (Lewis 2001, Biberaj, 2011) vërehet konfigurimi i një sistemi dypartiak, i përcaktuar jo vetëm nga formula zgjedhore, me mundësinë e raundit të dytë me qëllim arritjen e mazhorancës absolute, por edhe me natyrën e konfliktit të prodhuar në kalimin e një regjimi në një tjetër. Në një farë mase konfigurimi dypartiak në zgjedhjet e para u vu re edhe në një pjesë të mirë të vendeve lindore që ndodheshin në të njëjtën situatë politike si Shqipëria³. Nëse në këto vende sistemet e partive i janë nënshtruar ndryshimeve të mëdha në Shqipëri kjo nuk ka ndodhur, ose të paktën ka ndodhur me ngadalësi. Sipas Dechouëer (Dechouëer 2008) kriteret e identifikimit të partive të reja përcaktohen përmes tri dimensioneve: së pari, moshta e partisë; së dyti, idetë e reja dhe së treti, kapaciteti i ri organizativ. Dy rastet në fjalë ndoshta nuk i përmbushin plotësisht të tria kriteret e marra parasysh. Vetëm mosha e partive është elementi i përbashkët i dy forcave politike në fjalë, ndërkohë që vetëm PDIU-ja përmbush kriterin e dytë duke i dhënë një dimension të ri çështjes çame dhe asaj kombëtare në përgjithësi. Nga pikëpamja organizative të dyja partitë nuk paraqesin ndonjë ndryshim të madh. Kanalet e mobilizimit që ato përdorin janë po të njëjtat si ato të partive tashmë tradicionale në Shqipëri. Mospërmbushja e të tria kriterëve mund të sjellë problem në limitimin deri diku të tezës së parashtruar.

Përcaktimi i rolit të ‘partive të reja’ nuk vjen vetëm nga dimensionin e rrisë (Bolloyer 2008: 22), por dhe nga disa faktorë të tjerë si kapaciteti që ato kanë për të ripërsëritur suksesin elektoral, kushtëzimi në të cilin ato vendosin aktorët tradicionalë të sistemit në ndërtimin e koalicionit qeveritar (Mair 1997), ose ajo që Tsebelis përcakton si aftësia për të vendosur veton, *veto players* (Tsebelis 1995)⁴.

³ Në zgjedhjet e para parlamentare në një pjesë të mirë të vendeve lindore dolën fitues, në të shumtën e rasteve, koalicionet e mëdha të forcave që kontestonin partitë tashmë ish-komuniste (Çeki, Hungari, Poloni). Vetëm në Bullgari, apo edhe në Maqedoni sistemi politik u konfigurua në zgjedhjet e para dhe të dyta si dypartiak duke e humbur më pas, gjatë rrugës, këtë veti. Sot sistemet e partive të marra në konsideratë mund të quhen si relativisht më të fragmentarizuara po t’i krahasojmë me atë shqiptar.

⁴ Me konceptin “veto player”, ose aktor politik me fuqi vetoje Tsebelis ka parasysh si individë, ashtu edhe aktorë kolektivë, të cilët kanë mundësi në ndryshojnë një situatë të dhënë. Këta aktorë kanë fuqi të ndryshojnë një sistem i cili paramendohet si i qëndrueshëm. Tsebelis-i me këtë koncept ka parasysh si aktorët institucionale (parlamenti, ose presidenti për shembull), por edhe aktorët partizanë si partitë politike. G. Tsebelis “*Veto Players: How Political Institution Eork*” Princeton University Press, 2002.

Padyshim që numri i aktorëve me kapacitet vetoje në sistemin e partive në Shqipëri është rritur pas zgjedhjeve të vitit 2009, ndonëse zgjerimi cilësor i koalicionit qeveritar nuk ka pasur pasoja në vazhdimësinë e aksionit si legjislativ, ose ekzekutiv. Fuqia e vetos në këtë kuptim në Shqipëri mbetet më afër konceptimit të Sartorit (1976) mbi cilësimin, ose mbi peshën e partive politike. Sipas tij partitë politike “peshohen”, ose numërohen në sistem në raport me dy elemente: aftësinë për të bërë koalicion dhe kapacitetin e shantazhit (Sartori1994). Të dyja këto elemente lidhen me konceptin e rrisë që partitë e reja, në rastin tonë PDIU-ja dhe LSI-ja sjellin në raport me qeverisjen. Kapaciteti koalicion-formues i LSI-së lidhet me mundësimin e krijimit të qeverisë në vitin 2009 dhe kapaciteti i shantazhit lidhet me aftësinë për të marrë nga mazhoranca qeverisëse gati të njëjtin numër ministrash me atë të deputetëve, pa llogaritur këtu efektet anësore në administratën shtetërore. Rasti i PDIU-së është paksa më specifik pasi kjo parti paraqet çështje të debatuar gjatë në arenën politike shqiptare siç është ajo çame. Në dallim nga periudha e viteve 1991-2005, kur kjo çështje u përshpejtua në nivelin e shoqërisë civile dhe kryesisht të shoqatës “Çamëria”, me krijimin e PDIU-së ajo merr një dimension të ri, atë të përfaqësimit parlamentar.

Suksesi i partive të reja në sistemin politik shqiptar

Sistemi i partive në Shqipëri ka një histori tashmë të konsoliduar stabiliteti politik dhe të evidentuar në përballjen politike mes dy alternative mbizotëruese në diskurin politik, së pari nëpërmjet referencës tek e kaluara, si PS (si parti ish-komuniste), dhe së dyti nepermjet anti-komunizmit, si në rastin e PD-së, si partia më e madhe dhe gati hegjemoniste që doli nga radhët e opozitës në vitin 1991.

Arsyet mbi të cilat mbështetet dialektika antikomuniste lidhen disi me një set vlerash që marrin karakter politik dhe ideologjik, të cilat mund të jenë heterogjene, por të lidhura nga një fill logjik, ku mund të futen identitetet e veçanta kombëtare, lokale, ose ato fetare (Markus 1998:10).

Në fazën e parë të tranzicionit procesi i ndërtimit të identitetit politik ishte relativisht i thjeshtë, pasi ishte normale që partitë e reja të vinin në dukje dështimin e sistemit komunist përballë alternativës së ardhme liberale. Siç vë në dukje Markus, identifikimi negativ që i mvishej partive të majta në Europë si trashëgimtare të drejtpërdrejta të partive të vjetra të regjimit ka luajtur një rol të rëndësishëm në përcaktimin e karakterit të partive të reja (Markus 1998 :11). Në raport me Shqipërinë, antikomunizmi ka mbetur në karakterin e Partisë së parë politike të paskomunizmit, asaj Demokratike. Ajo ka ditur të monopolizojë këtë element,

duke eklipsuar dhe partitë tradicionale të djathta, që *përveçse* në raste sporadike⁵, nuk kanë arritur të tërheqin as vëmendjen e kategorive të identifikuar si të djathta (ish-pronarët, ose ish-të persekutuarit politikë në përgjithësi).

Elementi dhe retorika antikomuniste ka qenë dhe do të vazhdojë të mbetet tipar dallues i së djathtës në Shqipëri, për sa kohë shtresëzimi dhe prejardhja mbeten emëruesi i përbashkët i një elektorati relativisht heterogjen nga përbërja. Përkundër identiteteve klasike (klasore) të partive politike të Europës Perëndimore (Katz 2001:62) mbështetja që sot u jepet partive politike në vend është e vertikalizuar. Etiketat majtas, djathtas në Shqipëri vlejné pikërisht në raport me një rekuperim të elementit ideologjik, i cili është konsoliduar tashmë dhe i dallon palët nga njëra-tjetra. Partia Demokratike përpos trajektores së saj në pushtet ka një identifikim paradoksalisht më të qartë sesa e majta, duke e riprodhuar vazhdimisht atë. Ritualizimi dhe monopolizimi i datave historike si 11 Dhjetori, 21 Shkurti, përkujtimi i zellshëm i ngjarjeve të tranzicionit, apo dhe vetë përkujtimi i disa datave, si 28 Nëntori, lënia në hije e të tjerave, si 29 Nëntori, shërbejnë pikërisht për të forcuar ideologjikisht dhe për të identifikuar të djathtën mbi temën e antikomunizmit.

Fenomeni i PDR-së

Mbijetesa e dikotomisë e majtë/e djathtë nuk e ka përjashtuar gjithsesi daljen në skenë të aktorëve të rinj politikë. Ky fenomen ka prekur përgjithësisht partinë Demokratike prej të cilës janë larguar grupe individësh, të cilët megjithëse i kanë dhënë jetë subjekteve politike të re, janë pozicionuar tradicionalisht në spektrin majtas/djathtas. Vetëm pak prej tyre arritën të kishin një përfaqësim parlamentar të qenësishëm. Aleanca Demokratike arriti vetëm një rezultat minimal dhe thaujë të papërfillshëm në zgjedhjet e vitit 1997, vit kur mori pjesë për herë të parë në zgjedhje. Ky rezultat e ka shoqëruar këtë parti edhe në zgjedhjet e tjera parlamentare të mbajtura në vitet 2001-2005 deri në daljen e saj të plotë nga skena dhe bashkimin me Partinë Demokratike. Një trajektore paksa më të rëndësishme nga pikëpamja politike ka pasur forca tjetër politike e dalë nga shkëputja e disa eksponentëve të PD-së në vitin 1999 dhe krijimin e një force të re politike nën siglën PDR. Ky ka qenë ndoshta i vetmi rast në historinë e zgjedhjeve në Shqipëri kur një forcë e re politike, në zgjedhjet e vitit 2001, arrinte e vetme të futej në Kuvend për t'iu bashkuar më pas koalicionit fitues me PD-në në vitin 2005.

⁵ Politikisht, e djathta tradicionale në Shqipëri nuk ka arritur të afirmohet nga pikëpamja numerike. Këtë argument e mbështesin edhe rezultatet zgjedhore ku shpesh këto parti kanë mbetur jashtë parlamentit. Kjo mund të lidhet me “zënien” e hapësirës ideologjike nga Partia Demokratike, me ngushtimin e bazës shoqërore (ish-pronarët), si dhe me efektet që mund të prodhojnë në një kohë të gjatë sistemet elektorale. A. Krasniqi, “Zgjedhjet në Shqipëri”, Tiranë 2009, f. 333-334.

Suksesi elektoral i PDR-së ishte gjithsesi i brishtë dhe ndoshta i papërsëritshëm në kushtet kur strategjia elektorale e PD-së në vitin 2005 arriti të rikthente, në forma të ndryshme, brenda spektrit të djathtë eksponentë të ndryshëm të larguar prej saj në harkun kohor 92-97-të. Në këtë mënyrë mospërsëritja e partive të reja në Shqipëri deri në vitin 2005 lidhet jo vetëm me mungesën e risive programore dhe alternative, që ato parashtronë, sesa me tkurrjen e konfliktit politik prej të cilave ato janë gjeneruar. Koalicioni i PD-së me PDR-në nuk bëri gjë tjetër veç reduktoi arsyet dhe motivet e votuesve të kësaj partie për të ruajtur të paprekur identifikimin e tyre me partinë në fjalë. Në këtë kuptim fenomeni PDR nuk mund të asimilohet në skemën tonë pikërisht për arsye se ai nuk rievidentohet me të njëjtin sukses edhe në zgjedhjet e vitit 2005.

Sistemet elektorale, kryesisht ato proporcionale me barriera të ulëta në hyrje ndikojné pozitivisht futjen e partive të reja në parlament. Në rastin e Shqipërisë kjo nuk ka ndodhur. Sistemet elektorale të përdorura sidomos në harkun e viteve 1992-2005 nuk janë parë si të përshtatshme, apo janë përcaktuar deri diku (Zaloshnja, Zlataticanin: Tema 22. 11. 2011) si frenuese për hyrjen në lojë të subjekteve të reja politike. Mendohet se pikërisht në periudhën 1992-1997 sistemi i partive politike në Shqipëri ka shkuar drejt stabilizimit duke marrë parasysh disa kritere të përmendura edhe në hyrje si kohëzgjatja e sistemit të partive, ku nga viti 1992 e deri në vitin 2009 vendi është drejtuar nga dy koalicione me pak ndryshime të qenësishme në raport me peshën e aktorëve politikë. Po kështu edhe institucionalizimi i partive politike në Shqipëri është tashmë evident duke pasur parasysh stabilitetin e këmbimit të koalicioneve në qeverisje. Përkundër sistemeve të tjera partiake në Europën Qendrore dhe Lindore sistemi i partive në Shqipëri ka qenë relativisht më i stabilizuar në prirjet identifikuese të elektoratit. Sipas Innes (Innes 25:2001), paqëndrueshmëria e partive politike në Europën Qendrore dhe Lindore është pasojë e strategjisë elektorale të ndjekur nga vetë aktorët politikë në raport me objektivat afatshkurtër e afatmesëm të vetë partive në raport me pushtetin politik. Në Shqipëri ky fenomen nuk ka ndodhur pasi ndonëse dy partitë politike kryesore kanë pasur mundësinë të konsolidojné sistemet përkatëse klienteliste (Kajsiu 2008), partitë e reja, deri në vitin 2005, nuk kanë mundur t'i shpëtojnë logjikës paralizuese të konfliktit të përdorur nga dy aktorët e mëdhenj. Mungesa e suksesit të PDR-së, apo mospërsëritja e këtij suksesinë kohë nuk lidhet vetëm me sistemin elektoral të atëhershëm, me barrierën në hyrje prej 2.5% (barrierë kjo jo e konsideruar e lartë), por me efektin programatik kohëshkurtër që ajo pati në raport me alternativën që ajo i ofronte elektoratit të djathtë shqiptar. PDR-ja nuk arriti të mbledhte vota në basenin e madh të së djathtës shqiptare për sa kohë që projekti i saj politik kishte një natyrë tranzitore dhe lidhej më tepër me reformimin e Partisë Demokratike. Njëherë që ky reformim në dukje u arrit në vitin 2005 me hapjen e PD-së ndaj shoqërisë civile dhe me kooptimin e figurave të konsideruara historike për të djathtën, PDR humbi arsyen e të ekzistuarit. Në

këtë kuptim mundësitë e ruajtjes së paprekur të pozicionit të saj politik që me konsekuencë shkrirjen e saj në PD. Sistemi i partive në Shqipëri deri diku ka dekurajuar formimin, ose mbijetesën e partive të reja siç edhe e tregon edhe rasti i PDR-së, apo në një rast më pak domethënës si Partia Demokristiane, peshat e së cilave nuk kanë qenë asnjëherë aq të konsiderueshme sa të vinin në dyshim strukturimin e sistemit politik në Shqipëri. Për të gjitha këto arsye shkalla e futjes së partive të reja në sistem ka qenë e ulët edhe pas ndryshimit të sistemit elektoral në vitin 2006, efektet e të cilit u provuan në vitin 2009. Sistemi i përdorur në Shqipëri nga vitit 1992 deri në vitin 2005 hyn në familjen e sistemeve të përziera (Chiaromonte 2005) dhe tentohet të vihen bashkë dy prej parimeve kryesore të mekanizmit elektoral: atij mazhoritar dhe atij proporcional⁶.

Megjithë formulën e zgjedhur, PDR-ja mbijetoi vetëm një cikël zgjedhor në parlament, atë të vitit 2001, ndërsa në vitin 2005 përfshirja e saj në koalicion e ktheu këtë parti në një mekanizëm kompensues të PD-së. Rezultatet e saj në zgjedhje nuk mund të konsiderohen si reale në kuptimin e strategjisë dhe taktikës që u ndoq nga ky koalicion për të maksimizuar vendet në parlament. Sistemi i atëhershëm elektoral mundëson jo vetëm zgjedhësin të përdorë votën strategjike, pra ta ndajë partinë nga kandidati, por i jep mundësi partive edhe të pilotojnë votën e zgjedhësve për të maksimizuar rezultatin (Norris 2004). Numri i votave të marra nga PDR-ja në vitin 2005 dhe ndonëse më i madh sesa ai i vitit 2001 nuk e bën këtë parti të kalojë parakushtin e parë për të qenë një parti e re dhe e konsoliduar sa kohë e kasistemin e shpërndarjes së votave të përcaktuar nga PD-ja. Logjika përmes së cilës kaloi PDR-ja në rrugëtimin e saj gjatë viteve 2001-2005 shkoi nga radikalizimi, ose dallimi elektoral me PD-në, deri te gjetja e vijës së mesme për të arritur në koalicion me këtë parti në vitin 2001. “Rrugëtimi” i ndërprerë i PDR-së në viti 2009 bën të mendohet se kjo parti pati kostot e saja elektorale dhe politike gjatë katërvjeçarit të parë të futjes së saj në parlament. Suksesi në zgjedhjet e vitit 2001, me rreth 6 deputetë të zgjedhur dhe me 68 mijë vota të marra, u rrit në vitin

⁶ Chiaromonte numëron rreth 6 nënsisteme, apo forma sistemesh elektorale që hyjnë në familjen e sistemeve të përziera. Në thelb të tyre qëndron dyzimi i formulimit të sistemit me dy variable përzgjedhjeje për deputetët: një proporcionale dhe një mazhoritare. Nënsistemet më pas ndahen sipas mënyrës si e arrijnë qëllimin e tyre duke përdorur dy vota, dhe duke e ndarë vendin në dy zona të mëdha ku në njërin votohet mbi bazë zonale, me sistem mazhoritar dhe në tjetrën në mënyrë proporcionale. Po kështu në disa prej formulave të përdorura qëndron seleksionimi i kandidatëve me dy formula, por zgjedhësit kanë një votë. Në rastin e Shqipërisë zgjedhësit kishin në dispozicion dy vota një për partinë dhe një për kandidatin e zonës. Variabilet e tjera, që këto nënsisteme marrin në konsideratë, janë raportin mes deputetëve të seleksionuar në bazë zonash uninominale me ato të zgjedhura me votë proporcionale ku sa më e lartë është kuota propocionale aq më proporcional bëhet sistemi. Tjetër variabël i rëndësishëm është pragu legal elektoral i cili varion prej 2 % deri në 4 %. A. Chiaromonte ‘Tra il maggioritario e proporzionale: l’universo dei sistemi misti’, Il Mulino 2005

2005 ku kjo parti arriti të merrte rreth 100 mijë vota. Rritja e numrit të votave nuk përbën ndonjë tregues të qartë suksesi dhe konsolidimi elektoral sa kohë që futja e saj në koalicion u var nga përfshirja në qeverisje.

LSI si simbol vazhdimësie

Tradita e themelimit të partive politike në Shqipëri ka pasur disa prirje të mëdha. Prej tyre, mund të veçojmë së pari traditën e formimit të tyre rishtas që përkon kryesisht me vitet 1991-1993 që përkon me fillimin e pluralizmit politik dhe formimin e ofertës politike në funksion të 3 proceseve zgjedhore të mbajtura në atë periudhë (Biberaj, 2011). Bëhet këtu fjalë për një fenomen logjik dhe të njëtrajtshëm pjesën më të madhe të vendeve të Europës Lindore të dala nga regjimet autoritare, apo totalitare (Kitchelt 1993, Linz, Stepan 1994: Leëis 2001, , Buse 2001-2002). Në një qasje tjetër analitike Leëis përcakton një set të mundshëm hipotezash mbi të cilat mund të ndërtohet logjika e frakturave e mobilizimit dhe për rrjedhojë e formimit të partive politike : “Në një vështrim të Europës Lindore postkomuniste, nga tri nga frakturat kryesore, Qendër-Periferi, Kapital-Punë, Kishë-Shtet, që kanë kontribuar në krijimin e sistemit të partive politike të Europës Perendimore, vetëm ajo e cila prodhon parti politike secesioniste, të mbështetura nga minoritete etnike, kishte gjasa të shfaqej me të njëjtin intensitet në Lindje” (Leëis, 2000;143-144). Për sa i përket frakturës me karakter ekonomik, ajo u minimizua në raport me politikën imediate pas rënies së regjimeve komuniste. Ishte logjike që pas rënies së murit të Berlinit të adoptoheshin nga qeveritë e vendeve lindore politika ekonomike thellësisht liberale.

Studiues lokalë kanë insistuar duke rindërtuar në mjedisin e tyre lokal problematikën e frakturave. Në një pjesë të mirë ata i referohen evolucionit historik të realiteteve lokale duke rekuperuar dhe transferuar në ditët e sotme problematikën e trashëgimisë politike të para Luftës së Dytë Botërore, periudhës së komunizmit dhe asaj të tranzicionit (Markus 1998, 2000; Olimid, 2009) pa harruar të vënë në dukje problemet e konsolidimit dhe të identifikimit të frakturave sociale si elemente përreth të cilëve ndërtohen identitetet politike. Dalja në pah dhe ndërtimi i këtyre frakturave natyrisht mund të prekë vetëm disa elemente tipike të shoqërive të Europës Lindore, ku vlen të theksohen probleme si ato mes qendrës e periferisë apo kolapsi dhe diferencat ekonomike, në të cilën këto shoqëri u ndodhen. Po ashtu, forca centrifugale me karakter etnokulturor të theksuar, të tulatura dhe të “ngrira” përgjatë regjimeve komuniste, si në rastin e vendeve si Polonia, shprehen me intensitet. Mekanizma të ngjashëm funksionojnë dhe në formimin e ofertës politike në Shqipëri në raport me problemet imediate me të cilat u përballedhe shoqëria shqiptare.

Prirja e dyte është ajo e ripërcaktimit të natyrës së angazhimit politik të partive, kryesisht të spektrit të qendrës së djathtë të cilat arritën të konfirmoheshin në zgjedhjet e para apo të dyta parlamentare. Kështu partitë apo koalicionet e qendrës së djathtë ju nënshtruan një procesi “hemorragjie”, apo copëzimi i cili vinte si

pasojë e forcave centrifugale të gjendura brenda tyre, natyrës së beftë dhe të shpejtë të formimit, ose edhe mosrealizimit të objektivave me natyrë ekonomike sociale. Kështu në periudhën 1993-2000 Partia Demokratike iu nënshtrua një valë largimesh (Zogaj 2010) që rezultoi më pas në riformatimin e spektrit të djathtë në disa parti politike me pesha të ndryshme elektorale.

Prirja e tretë dhe trasversale ka qenë ajo e krijimit të partive me pikënisje jo më shoqërinë civile por kryesisht arenën parlamentare ku si pasojë e divergjencave politike në legjislaturat 1992-1996, 1996-1997, 1997-2001, 2001-2005 u krijuan një serë grupimesh parlamentare autonome të cilat shërbyen si referencë për krijimin e partive politike të reja. Ky fenomen ka qenë endemik në politikën shqiptare ndonëse duket në shterim e sipër. LSI-ja është pikërisht produkt i kësaj logjike ndonëse krijimi i saj lindi si pasojë e divergjencave politike brenda Partisë Socialiste. Për herë të parë në vitin 2004 partia e majtë më e madhe në vend u bë subjekt i një ndarje politike pa precedent në historinë politike të kësaj force politike e cila kishte mëshuar fort tek kapaciteti për të ruajtur të paprekur trashëgiminë elektorale dhe politike që i vinte nga ish - Partia e Punës.

Në kuadrin të majtës, historia e Partisë Socialiste është ndofta e paprecedentë dhe për vetë të majtën post -komuniste në vendet e Europës Lindore. Në dallim nga partitë e tjera ish- komuniste ajo ruajti të paprekur jo vetëm vazhdimësinë organizative, por edhe kapacitetin për tu gjykuar si alternativë e vlefshme ndaj të djathtës në pushtet në periudhën (1992-1996). Në kuadrin ideologjik kjo parti ju me vonesë stilit të socialdemokracisë perëndimore (Fuga 1998), gjë që vërehet edhe në raste të tjera në Europën qendrore, ose lindore (Curry, Urban 2003:7). Procesi relativisht i gjatë i qëndrimit në opozitë ruajti të paprekur forcën elektorale e cila më pas i dha mundësinë për të ardhur në qeverisje në vitin 1997. Në dallim nga e djathta, Partia Socialiste arriti të ruante një farë dialektike konfliktualiteti dhe demokracie të brendshme gjë që i lejoi të mos ishte pre e largimeve, apo ndarjeve ashtu si në rastin e PD-së. Vetëm në fund të vitit 2005 logjika pluraliste që kishte ruajtur një farë dualiteti mes rolit të kryetarit të partisë, F. Nano, dhe njërit prej ish-kryeministrave dhe ministrave më të suksesshëm të kësaj partie, u thye për të rezultuar më pas në një ndarje të pakthyeshme. Ish- kryeministri, dhe njëkohësisht njeri prej njerëzve më në zë në politikën shqiptare, Ilir Meta, shpalli ndarjen nga Partia Socialiste dhe krijimin e një force të re politike si LSI-ja. Arsyet e ndarjes së të majtës nuk ishin ideologjike më tepër sesa mbi konceptin dhe natyrën e pushtetit brenda Partisë Socialiste.

Ndarja ishte kështu e një natyre jo-përmbajtësore dhe jo-ideologjike. Ne te kundert, ajo ishte një ndarje që në thelb nisej nga konflikti i pastër për kontrollin e forcës më të madhe politike në spektrin e majtë. Diskuri politik që kjo ndarje prodhoi lidhej më tepër me aspekte strukturore në menaxhimin e partisë pa vënë në diskutim asnjëherë mekanizma përmbajtësorë, apo ideologjikë për të cilët nuk ka pasur ndonjëherë debat të qenësishëm mes palëve (Kajsiu 2008). Ideologjia kështu nuk ka qenë logjika mbi të cilën u krye kjo ndarje. Historia e LSI-së respekton pak a shumë paradigmen e krijuar

dhe të konsoliduar të ndarjeve politike, subjekt i të cilave kanë qenë partitë në Shqipëri. Në thelb mbetet dhe mbetet aftësia dhe kontrolli që tashmë liderët historikë ushtrojnë brenda organizatave respektive. Nëse ky ka qenë përcaktori kryesor dhe cilësor i cili ka diferencuar PD-në nga PS-ja (Krasniqi 2009), me daljen në skenë të LSI-së ky dallim u zhduk. Paradigma e formimit që LSI-ja ndjek pra mbetet pak a shumë ajo e PDR-së, veçse e amplifikuar në pasoja dhe konsolidim. Nga pikëpamja përmbajtësore pra LSI-ja nuk sjell ndonjë risi në të majtën shqiptare përveçse rikuperon në një farë mënyre një prej arsyeve më madhore të ndarjes së partive politike në Shqipëri, atë të demokracisë së brendshme. Mair i konsideron dhe i fut partitë e reja në dy kategori të mëdha *sfiduese* dhe *mobilizuese* (Mair 2002). Në këtë kuadër, partitë e reja politike në Shqipëri si LSI-ja është e vështirë të futen kategorinë e partive të reja, sa kohë sfida e tyre nuk është më ndaj sistemit të vlerave, por në mënyrën sesi operon vetë sistemi i partive. Padyshim që përpjekjet e LSI-së për të ruajtur të paprekur sistemin elektorale dhe ndryshimet kushtetuese të vitit 2006 hyjnë në këtë skemë, por qëllimi i tyre ishte thjesht mbijetesa dhe adaptimi i partisë më tepër sesa ndryshimi i paradigmes dominante politike në vend. Në radhë të parë, sfida këtu vjen në raportin e diferencimit dhe konfrontimit me partinë mëmë dhe ku mungesa e një koherence ideologjike çon domosdoshmërisht në një retorikë konfrontimi të vazhdueshëm, qëllimi i të cilit është krijimi i një profili në “tregun politik” aq vital për partitë e vogla (Pedersen 1982). Në aspektin e mobilizimit politik (Deschouëer) dallon aftësinë e partive të vogla për t’u përballur me sistemin duke mobilizuar dhe duke u mobilizuar mbi të njëjtat çështje të cilat shqetësojnë elektoratin. LSI-ja mund të futet me pak vështirësi në këtë kategori sa kohë që nuk ka prodhuar ndonjë diskur politik ideologjik të aftë ta diferencojë atë nga Partia Socialiste. Në këtë kuptim diskuri ideor ka qenë i vakët dhe pa ndonjë dallim të madh përmbajtësor. Që prej viteve 2000, PS-ja ka adoptuar politika me qasje liberale duke ndjekur në një farë mase edhe prirjet politike të simotrave të saj në perëndim. Në këtë kuptim LSI-ja nuk është shtyrë përtej riprodhimit dhe artikulimit të një diskuri politik të ndryshëm nga ai i PS-së, bile as është munduar ta bëjë atë.

Faktorët e themelimit të LSI-së

Literatura mbi partitë e reja është munduar të përcaktojë mekanizmat që ndikojnë në formimin dhe daljen e tyre në skenë duke u përqendruar kryesisht në faktorë (Benich-Bjorkman 2006) me karakter:

- a. institucional
 1. sistemi elektorale
 2. akses regjistrimi i partive
- b. strukturor
 1. zhvillimi ekonomik
 2. ekzistenca e çështjeve madhore, të mbetura të pa konsumuara nga partitë e mëdha

Në përgjithësi paritet e reja politike eksperimentojnë dhe hasin vështirësi jo vetëm të karakterit politik por edhe strukturor. Shpesh mundësia për t'u përkrahur si forca ndeshet me probleme të koordinimit dhe barrierave që sistemi legal vë për partitë e reja. Në Shqipëri, por edhe në Europën lindore, ndryshimi i regjimeve politike ka ndikuar për këtë arsye në dy drejtime: Së pari, në lehtësimin e procedurave për regjistrimin e partive politike, aspekte pra procedurale të cilat nuk kanë krijuar ndonjëherë probleme relevante përveç kur krijimi i partive politike bie ndesh me qëllimet kushtetuese. Në përgjithësi legjislativi mbi partitë në Europën Qendrore ruan një fleksibilitet i cili i përgjigjet në periudhën që u hartua nevojës për të kanalizuar përfaqësimin politik brenda kuadrit të demokracive parlamentare të mbështetura te partitë politike (Leëis 2000). Së dyti, në krijimin e partive të reja janë edhe aspekte të sistemit elektoral. Në përgjithësi mekanizmat e një sistemi elektoral janë një prej përcaktorëve kryesorë të suksesit të partive (Lijphart1984;Taagepera, Shugart1989;Sartori 2005). Sistemet mikse, ose ato proporcionale janë më të prirura që të lejojnë futjen në sistem të partive të reja se ato mazhoritare. Gjetjet në këtë fushë gjithësesi konfirmojnë pjesërisht këtë pohim. Në Europën lindore, sukcesi i partive të reja kryesisht ato me orientimi në kah të ekstremit të djathtë, apo ato të gjelbra kanë qenë fenomene të kudo ndodhura (Inganzi 2003, Norris 2004) dhe të pavarura nga mekanizmat elektoralë. Kjo afirmohet edhe nga Benich-Bjorkman (Benich-Bjorkman 2006) kur pohon se i njëjti fenomen ka ndodhur edhe në vendet e Evropës lindore, ashtu si edhe në rastin e Shqipërisë.

Nëse për Evropën Lindore ky fenomen është i pritshëm pasi presupozohet një shkallë e lartë fluiditeti në sistem, në Shqipëri lëvizshmëria elektorale ka qenë relativisht e ulët. Dy partitë e mëdha dhe koalicionet pre-electorale respektive kanë dominuar skenën politike për një periudhë relativisht të gjatë. Dalja në skenë e partive të reja me prani në parlament si PDR, apo PDI (PDIU) ka qenë i vetmi fenomen i cili e ka cenuar këtë rregull, por pa e ndryshuar në mënyrë të qenësishme atë. Në disa studime të zhvilluar kryesisht në zonën e Tiranës në kuadrin e zgjedhjeve vihet re një shkallë tejet e lartë besnikërie ndaj partive politike nga ana e votuesve. Studimi i Institutit Eunacal nxjerr pikërisht në pah se tri partitë më të mëdha në vend PS, PD dhe LSI-ja ruajnë shkallën më të lartë të besnikërisë përpara votuesve me shifra që shkojnë nga 90% -80%⁷.

Shkaqet stukturore që kanë ndikuar në themelimin e partive të reja në Shqipëri lidhen më tepër me probleme të brendshme shpërndarje pushteti brenda partisë sesa me mospërputhje substanciale në raport me çështje madhore të zhvillimit ekonomik. Në këtë kuptim krijimi i LSI-së ndjek pak a shumë të njëjtën formulë, tashmë të kolauduar (AD, PDD, ose PDR) nga ikjet, apo rrjedhjet e vazhdueshme

⁷ 'Sjellja Votuesit në Zgjedhjet Lokale 2011' Eunacal, <http://eunacal.org/vota2011/raportet-paraprake-mbi-zgjedhjet-e-8-majit/>

që ka pasur Partia Demokratike ndër vite (Zogaj 2010; Biberaj2011). Zhvillimi ekonomik, ose dhe vetë platforma politike e LSI-së nuk ka risi apo ndarje të pakthyeshme në raport me Partinë Socialiste. Ajo mbështetet kryesisht dhe ndoshta qëllimisht në një përcaktim të vagullt ideologjik, mbështetur mbi filozofinë e integritit në BE, gjë që tashmë nuk kontestohet dhe nuk artikullohet nga asnjë prej partive politike (Kajsiu 2008). Referencat politike të LSI-së në raport me zhvillimin mbeten të përgjithshme dhe në linjë me partitë e tjera. Në logjikën programatike bile vihen re jo vetëm pandryshueshmëritë me PS-në, por edhe perspektiva e mbivendosjes programatike⁸ të palëve. Problemet, ose çështjet madhore, që kanë të bëjnë me modele zhvillimi të vendit, nuk janë pjesë e debatit politik mes palëve. Në këtë kuptim betejat kryesore të LSI-së në harkun kohor 2005-2009, vit në të cilin ajo erdhi në pushtet kanë pasur kryesisht karakter organizativ dhe "mbijetese" politike. Debatit organizativ ka qenë ai i strukturave dhe i përpjekjeve të ndërsjellta brenda së majtës për të përfituar /marrë strukturat ekzistuese, ose të reja të njëjës, a tjetrës. Ndërkohë që ai për mbijetesën ka qenë elementi kryesor për të cilin kjo parti është përpjekur të ruajë të paprekur sistemin e vjetër elektoral të vitit 2005 e më pas të rikonceptojë qëndrimin e saj në raport me koalicionin me PD-në në vitin 2009.

Profili elektoral dhe organizativ i LSI-së

Në një libër të rëndësishëm mbi partitë politike "Party System Change Approaches and Interpretations", Peter Mair i dedikon një kapitull të veçantë sistemeve partike në Europën Lindore. Thelbi i kapitullit rreh kryesisht në tezën e përjashtueshmërisë së fenomenit duke mbajtur si (Mair 1997) etalon krahasimor sistemet e partive në perëndim. Pa dashur të analizojmë thellë perspektivën e Mair ajo që del qartë janë kushtet specifike në të cilat partitë politike dalin në pah në Lindje çka më pas tenton të shpjegojë edhe fenomene si copëzimi endemik i sistemit të partive (Boeschler, Beizen), ose edhe nivelin e besimit që ato gëzojnë (Leëis 2000). Përkundër zhvillimit dhe evolucionit politik të partive në këtë zonë, Shqipëria paraqet një shkallë të lartë stabilizimi sistematik e cila vihet re edhe në raport me emetimin në sistem të partive të reja që deh suksesin e tyre elektoral. Mair afirmon se elektorati dhe partitë në këto vende janë të ndryshme, ndërkohë që në Shqipëri shkalla e besnikërisë dhe e historisë së votës është e vogël. Për Mair-

⁸ Në një artikull në të përditshmen "Panorama", 6 shkurt 2009 me titull *Frika nga vjedhja e programit* Blendi Kajsiu shtjellon debatin mbi "vjedhjen" e programit të PS-së mbi bujqësinë nga LSI-ja, ai vë re pikërisht mbivendosjen mes dy partive politike të majta, debati i të cilave kufizohet më shumë mbi çështje që kanë të bëjnë me probleme dytësore në raport me logjikën e dy partive që pretendojnë të përfaqësojnë të majtën. Në asnjë debat politik LSI-ja dhe PS-ja nuk kanë debatuar mbi çështje, probleme, apo mbi modele që kanë të bëjnë me zhvillimin politik të vendit.

in logjika e shtresëzimit social të konsoliduar në kohë është faktori kryesor që shpjegon koherencën më të madhe dhe për pasojë stabilitetin e partive në vendet e Europës perëndimore, ndërkohë që ato të Europës Lindore kanë një shkallë shumë të lartë lëvizshmërie si organizative ashtu edhe përfaqësimi.

Të gjitha këto fenomene janë më relative në Shqipëri ku shkalla e soliditetit, të paktën e dy partive më të mëdha, mbetet e lartë. Në këtë kuptim edhe LSI-ja nuk bën përjashtim. Një njëfarë mase ajo ka replikuar të njëjtin profil organizativ klasik të importuar nga eksperiencia brenda PS-së dhe të diktuar nga sistemi elektoral miks i vitit 2005. Po ashtu, ky lloj sistemi ka mundësuar deri diku edhe fenomenin e institucionalizimit⁹ të partive politike në Shqipëri, ose shtrirjen/pasjen e organizatave në pjesën më të madhe të vendit. Kjo lloj strukture ka bërë të mundur ruajtjen jo vetëm të pranisë elektorale, por edhe të asaj organizative brenda konteksteve sociale lokale. Afirmimi se LSI-ja është parti e re në moshë, por e vjetër (apo tradicionale në raport me sistemin politik shqiptar) për sa i përket aspekteve të tjera si profili elektoral, ai programatik, ose organizativ del në pah me mënyrën e organizimit të partive të reja politike në Shqipëri. Origjina e tyre është kryesisht parlamentare në kuptimin e asaj që inputi organizativ është “bottom doën” më shumë sesa “bottom up”. Katz dhe Mair (Katz dhe Mair 1993) përdorin termin “party në detyrë” dhe “parti në terren”. Teza e partive të reja në fakt e mbështet risinë në dy aspekte në atë të artikulimit politik dhe pjesëmarrjen në qeverisje duke marrë të mirëqenë faktin se partitë e reja janë manifestim i jashtë sistemit të partive tradicionale (Bollyer 2008). Në rastin e Shqipërisë partitë e reja kanë pasur kryesisht origjinë parlamentare, pra hyjnë në kategorinë e cilësuar nga Katz dhe Mair si ‘parti në detyrë’. Kjo origjinë presupozon jo vetëm një qasje më elitare, por njëkohësisht më kontrolluese ndaj elektoratit. Ky lloj tipi partie ruan një organizimi të lehtë dhe fleksibël duke u munduar të përdorë më shumë mjetet e komunikimit sesa të investojë në krijimin/mbulimin e territorit me strukturë permanente. LSI-ja, në këtë kuptim, devijon nga teoria të paktën në pjesën e dytë. Ajo është me të vërtetë një parti e cila formohet në kuadrin e pasjes së një organizimi parlamentar paraprak, por ruan të njëjtin kapacitet dhe aftësi organizative si partia nga e cila shkëputet grupi nismëtar.

Në vetvete kjo e dhënë mund të duket jo e vlefshme, por nëse raportohet për votuesit e kësaj partie (në vitin 2005 -115 000 vota) dhe në vitin 2009 -73 676) vihet re një ruajtje e konsiderueshme e kapacitetit organizativ të LSI-së në raport me ruajtjen e elektoratit dhe me angazhimin e tij. Në periudhën që LSI-ja futet në koalicionin qeveritar në zgjedhjet lokale do të shënojë si subjekt politik një rezultat

pozitiv me 108. 000 vota. Roli politik i LSI-së si parti e re në skenën politike shqiptare mbetet gjithsesi për t’u verifikuar në periudhën afatgjatë. Nga pikëpamja teorike LSI-ja është një subjekt i konsoliduar politikisht. Mbetet për t’u verifikuar pozita e saj politike në raport me performancën qeveritare në vitin 2009 e në vazhdim, ndonësenë zgjedhjet e fundit lokale ajo ishte një faktor përcaktues në të paktën dy momente: 1. fitoren e koalicionit “Aleanca për Qytetarin” në Tiranë dhe 2. ruajtjen e epërsisë në terma votash në raportin mes koalicionit qeveritar “Aleanca për Qytetarin” dhe atij opozitar “Aleanca për të Ardhmen.”

Rezistenca ndaj efektit të “përdorimit”, ose të konsumimit në raport me pjesëmarrjen e një partie të re në qeverisje është një element tejet i debatueshëm në studimet mbi partitë. Futja në qeveri, osenë koalicione e partive të reja shpesh është kosto e madhe dhe çon në një konsum më të shpejtë sesa kostoja e partive të mëdha (Rose dhe Mackie1993:Mueller dhe Strom 2000). Në rastin tonë ky afirmim është pjesërisht i vërtetë sidomos për sa i përket LSI-së, e cila përkundrazi e ka shtuar numrin e votuesve që nga viti 2009. Buelens dhe Hino (Buelens, Hino 2008) kanë konceptuar kështu dy indikatorë për sa i përket peshës së partive të reja, duke pasur parasysh se ato janë më të ndjeshme sesa partitë qeverisëse në raport me votën dhe për rrjedhojë me mbijetesën e tyre. Treguesi i parë është ai i fatit elektoral të cilësuar ELECFATE (EF), T_1 nëzgjedhjet që e çuan partinë në pushtet dhe T_2 ato pas eksperiencës qeveritare. Treguesi formalisht përftohet si më poshtë:

$$\text{ELECFATE (EF)} = \frac{T_2(\text{votimi i dytë})}{T_1} - 1$$

T_1 (votimi i parë)

Si bazë për këtë mund të merren zgjedhjet e vitit 2009 dhe ato lokale të vitit 2011, duke marrë parasysh edhe faktin se qeverisja e LSI-së u shoqërua edhe nga skandale me karakter korruptiv si ai i denoncuar nga ish –ministri, D. Prifti, dhe që përfshiu kryetarin e kësaj partie, zotin I. Meta. Çdo shifër negative do të rezultonte negativisht në vlerën e EF-së dhe anasjelltas. Nisur nga rezultatet mund të themi se LSI-ja ka një rezultat pozitiv prej 0. 46. Padyshim që këto vlera mbeten pozitive pavarësisht faktit se të dhënat e pamatshme këtu varen nga faktori i shfrytëzimit të kapaciteteve administrative dhe prej efektit të saj në elektoratin e LSI-së.

PDI/PDIU: Parti e re, çështje historike

Pavarësisht faktit se një pjesë e mirë e literaturës mbi partitë politike në Europën Lindore e vë theksin te mungesa e shoqërisë civile në fillimet e tranzicionit dhe tek impakti i saj në sistemin e partive (Mair, Lewis, Van Beizen), arena civile ka pasur një rol të rëndësishëm dhe lidhje të pashmangshme me partitë. Historia

⁹ Me institucionalizim të partive politike nënkuptohet ‘procesi përmes të cilit organizatat dhe proceset përftojnë vlera dhe stabilitet’. Procesi i institucionalizimit të partive shihet si një element i rëndësishëm në zhvillimin demokratik të një vendi. Huntington, S. (1968): *Political Order in Changing Societies*. Në Haven: Yale University Press

politike shqiptare ka pasur shpesh shembuj të tillë kalimi kryesisht në titull personal të individëve nga shoqëria civile në politikë (Budini) dhe në disa raste vetë transformimin e grupeve, osetë organizatave brenda saj në parti. Rasti më i prekshëm është ai i shoqatës Çamëria e cila në vitin 2005 u transformua në Partia për Drejtësi dhe Integrim¹⁰. Ky fenomen ishte një risi në skenën politike shqiptare, ndonëse siç thotë Pedersen (Pedersen 1982) “Linja e demarkacionit mes partive politike dhe organizatave shoqërore (parapolitike) nuk është e ndarë plotësisht”. Kjo vjen për pasojë e ambiguitetit dhe e kompleksitetit të jetës politike si dhe të mënyrës së organizimit/qëllimeve të vetë organizatës në fjalë (Della Porta 2009). Po ashtu, Pedersen pohon se ekziston gjithmonë një “zonë gri” shkëmbimi mes partive politike dhe shoqërisë civile. Nëse këto kushte kanë qenë të pranishme në Shqipëri në harkun kohor 1997- 2005, themelimi i PDI-së i shton një tjetër dimension; atë të transformimit të një organizate nga shoqëria civile në parti politike. Historia e PDI-së fillon me themelimin e shoqatës Çamëria dhe me mobilizimin e anëtarëve të këtij komuniteti të dëbuar nga Greqia përgjatë viteve 1920-1945. Kërkesat e kësaj shoqate ishin njohja e “genocidit të ushtruar ndaj popullsisë shqiptare në Çamëri” dhe rikthimi i pronave të anëtarëve të këtij komuniteti. Problemi çam ka mbetur kështu endemik në kuadrin e diskurit politik shqiptar duke gjetur mbështetje, por jo ndonjë zgjidhje efektive. Gjatë viteve 90-të dhe fillimit të viteve 2000-jë, shoqata Çamëria mund të thuhet se është e vetmja me një farë lidhje publike dhe me një organizim i cili i përafrohet atij të partisë politike në shtrirjen e saj territoriale dhe në kapacitetin për të mobilizuar anëtarët e komunitetit të cilit ajo i referohet. Ky komunitet ka pasur edhe karakterin e tij të veçantë në kuptimin e ruajtjes, krijimit, ose rikrijimit të identitetit, ¹¹ gjë që e bëri lehtësisht atë të transmetueshëm në një identitet politik. Shpesh partitë e reja mobilizohen rreth çështjeve të vjetra, ose rreth çështjeve nga të cilat tërhiqen partitë e mëdha (Mair 1997). Si e tillë PDI-ja arriti të kapitalizonte në dy drejtime aftësinë organizative të krijuar ndër vite; komunitetin të cilit i apelohej dhe paafësisë për të marrë përgjigje nga qeveritë e ndryshme nga vitet 1992-2005. Në vitin 2009 PDI-ja përfundoi një fazë krize politike, kur deputeti i saj, zoti Shpëtim Idrizi, u largua nga radhët e Partisë për t’iu bashkuar një deputeti tjetër, që u largua nga grupi parlamentar¹² i PS-së, për të themeluar një subjekt të ri, PDU-në. Krijimi i një

¹⁰ Nga pikëpamja praktike një fenomen i tillë ka ndodhur edhe në organizatën Mjaft ku një pjesë e mirë e anëtarëve të saj krijuan një subjekt të ri politik G99-ën. Mjafti si organizatë nuk pushoi së ekzistuari dhe përkundrazi drejtuesit e rinj të saj u kthyen në polemistët më aktivë ndaj lidërshpit të G99-ës, sidomos pas “emigrimit” të drejtuesit të saj, z. Erion Velia, në Partinë Socialiste.

¹¹ SHOqata Çamëria ka mbajtur thujse çdo vit në Sarandë një festival të traditës çame dhe një rrugëtim për në Qaf Bot nga ku erdhën edhe valët e para të të dëbuarve çamë në vitet 1944-45.

¹² SH. Idrizi: “Pse ika nga PS-ja dhe themelua PDU-në çame”, Koha Jonë 1. tetor. 2009

subjekti të ri elektoral sidoqoftë nuk cenoi kapacitetet integruese dhe mobilizuese në kuadrin e komunitetit për sa kohë që brenda një kohe të shkurtër këto dy parti u bashkuan në një të vetme.

Tipologjia e Partisë

Rasti PDI/PDU do të trajtohet si një i vetëm duke pasur parasysh vazhdimësinë organizative të partive, kohëzgjatjen e shkurtër të subjektit PDU dhe komunitetin të cilit kjo Parti i referohet. Kësisoj tipologjia e Partisë do të kërkojë integrimin e tri momenteve:

- a. kalimin nga shoqata, apo shoqëria civile në parti;
- b. bashkimin/rorientimin e profilit ideologjiko -programatik në vitet 2009 e në vazhdim;
- c. pjesëmarrjen në koalicionin qeveritar.

Kalimi nga një organizatë në një parti politike është natyrisht një proces i ndërlikuar për më tepër kur ai kryhet në kuadrin e një organizate në terren (Kats Mair). Si e tillë PDI-ja projektohet si një parti e themeluar dhe e organizuar nga poshtë dhe hyn në atë që Mair e konsideron si parti me një axhendë mobilizimi aktiv të anëtarëve, me një projektim masiv të konsiderueshëm. Në krahasim me LSI-në si rast studimor tranzicioni, shoqata Çamëria /PDI (1992-2005) bën një dallim themeltar në raport jo vetëm me llojin e partisë (parti në pushtet/parti në terren), por edhe si rast përmbajtësor ku mbi të gjitha e përshtatshme është çështja. Pedersen, që ofron në këtë kuptim disa kategori analitike për studimin e partive të reja, gjë që na lejon t’i përmbahemi edhe tezës kryesore të këtij artikulli: stabilitetit të sistemit të partive në Shqipëri /emetimit të rrallë të partive të reja e të suksesshme në sistem. Teza e tij dallon katër faza të ekzistencës së një partie -Deklarimin – Autorizimin- Përfaqësimin- Përshtatjen, faza këto që do të integrohen në raport me tri kategoritë e mësipërme:

- a- Faza e parë, ajo e maturimit është klasike për një parti të re e cila si PDI-ja lindi si pasojë e një çështje të lënë në margjinën e diskurit politik, ose të mbetur pa përgjigje konkrete. Faza deklarative kalon pikërisht në atë që po Pedersen-i e cilëson si “kufirin e errët” mes shoqërisë civile (shoqatës) dhe partisë. Kjo fazë për PDI-në gjithsesi mbetet ajo më e gjata dhe më delikatja në raport me konfigurimin e saj brenda një konteksti politik aspak “mikpritis”. Siç u shtjellua edhe më lart vetëm pak parti të vogla në sistemin shqiptar kanë arritur të mbijetojnë në një kontekst politik të polarizuar dhe me zbrazëti ideologjike të theksuar (Kajsiu 2008).
- b- Faza e dytë, ajo e autorizimit, është një fazë formale në të cilën partia e sapoformuar autorizohet të ushtrojë funksionin e saj, gjë që legjislacioni shqiptar e lejon pa pengesa të mëdha.
- c- Përfaqësimi mbetet elementi i parë delikat për një parti, pasi tranzicioni

nga shoqëria civile në politikën partiake implikon numrin (Graziano 2001) dhe matjen e forcës në raport me elektoratin. Në këtë kuptim kjo fazë për subjektin në fjalë mund të riorganizohet në dy pjesë, në atë të periudhës 2005-2009 dhe në atë të viteve 2009-2011, në të cilën PDI-ja ruan karakterizimin si parti e cila i drejtohet një komuniteti të caktuar me një bllok çështjesh dhe me atë të vitit 2009 me bashkimin me subjektin tjetër PDU, një parti e cila lindi në kuadrin e mekanizmave parlamentarë. Në fazën e parë të ekzistencës 2004-2009, PDI-ja nuk konsiderohet në kuadrin e dinamikave qeveriformuese. Ajo nuk është konsideruar sa kohë që koalicioni që mori pushtetin në vitin 2005 kishte forcën dhe realisht numrin e e mjaftueshëm të deputetëve sa për të mos futur në gjirin e tij edhe parti të reja të cilat do të kushtëzonin ekzistencën e tij.

d- Natyrisht ajo që në na intereson është përshtatja e partisë në raport jo vetëm me logjikën e të qëndruarit në parlament, por edhe me kapacitetin/aftësinë për t'u bërë pjesë e qeverisjes. Në këtë kuptim strategjia e PDI-PDIU pati dy qasje interesante. Në fazën e parë të qeverisjes së djathtë ajo nuk u përfshi në koalicionin qeveritar duke ruajtur autonominë e aksionit politik në raport me qëllimin e saj kryesor, atë të të qenit zë i çështjes çame.

Një pjesë e sistemeve partiake në Europën lindore ka krijuar tashmë një profil pak a shumë të qartë dhe si të tillë të klasifikueshëm në raport edhe me sistemet partiake në Europën perëndimore. Një klasifikim i tillë bëhet, të paktën nominalisht edhe duke iu referuar anëtarësisë së tyre në familjet e mëdha të partive të krijuara në kuadrin e organizimit të tyre ndërkombëtar si Partia Popullore Europiane, ose ajo Socialiste Europiane. Në të njëjtën kohë, anëtarësimi i shumë prej vendeve të Europës Lindore ka bërë të mundur inkuadrimin e partive politike të këtyre vendeve në grupet parlamentare me orientim nga qendra e djathtë tek ajo e majtë e deri në ekstremet e harkut parlamentare (Ignazi 2003), dhe si të tilla të klasifikueshme brenda skemës së propozuar nga Von Beyme (1985) në sistemin e asaj që ai quan familje “shpirtërore” të partive politike¹³. Në bazë të kësaj skeme, klasifikimii PDI/PDIU bëhet paksa i vështirë sepse evolucioni politik i kësaj partie kalon nëpër disa faza dhe është i lidhur ngushtë me veçantinë e profilit të saj politik pasi ajo

¹³ Duke rimarrë skemën Lipset/Rokkan, Klaus Von Beyme përdor konceptin e familjeve shpirtërore të partive politike për të treguar atë tërësi partish politike të cilat bashkohen nga një vizion i përbashkët mbi botën. Klasifikimi i Von Beymes i përshtatet më së shumti sistemit të partive politike në Europën Perëndimore, por me anëtarësimin e shumë prej partive politike në organizatat transnacionale si PPE-ja, ose PSE-ja, ose edhe inkuadrimin e një pjese të tyre brenda grupeve parlamentare në Parlamentin Europian, bën të mundur studimin e tyre në përputhje me skemat e mësipërme. Von Beyme i ndan familjet e partive në Parti Liberale/Radikale, Socialiste/Social Demokrate, Demokristiane, Komuniste, Agrare, Etnorajonaliste, e Djathta Radikale dhe Ekokologjiste. f 47-49. K. Von Beyme cit. D. D. Porta “Partiti Politici” Il Mulino 2001.

i drejtohet një teme të caktuar siç është respektimi dhe riintegrimi i të drejtave të popullsisë çame të dëbuar nga Greqia. Së dyti komuniteti çam është e vështirë që të konsiderohet si një komunitet kulturor (dhe aq më pak etnik) i ndryshëm nga pjesa tjetër e shqiptarëve. Për këtë arsye klasifikimi i Vone Beymes e bën përcaktimin e natyrës së partisë të vështirë përse i përket fazës së parë të jetës së saj, pasi kemi të bëjmë me një rast gati sui generis për natyrën e interesit në lojë, komponentin identitet-kulturor dhe perspektivën që kjo forcë politike sjell në arenën politike shqiptare. Gjithsesi për evolucionin e saj gjatë viteve 1991-2004-9 dhe 2009-ës e tutje PDI/PDIU është transformuar në një parti politike nacionaliste me një axhendë politike (Idrizi) e cila e tejkalon profilin e ngushtë dhe të mirëpërcaktuar të identifikimit me grupin e referencës. Tranzicioni politik i PDI/PDIU-së kalon kryesisht fazën e artikullimit të çështjes çame duke rritur kështu mundësinë dhe duke zgjeruar hapësirën elektorale që mund të zërë çështja kombëtare në sistemin politik. Ndryshimi në artikullim vihet re qartazi përgjatë viteve 2006-2009 me zgjerimin e axhendës politike dhe me gjysmëpërfshirjen e PDIU-së në koalicionin qeveritar dhe riartikullimin e një programi politik, i cili e rivendos çështjen çame në një kuadër më të gjerë dhe më të orientuar drejt një angazhimi që thyen skemat e artikullimit nacionalist të gjithë viteve të tranzicionit. Në këtë kuptim tranzicioni i PDI/PDIU-së, nga një grup interesi në një parti me axhendë nacionaliste, respekton në kohë edhe mekanizmat përmes të cilëve kanë kaluar partitë nacionaliste në Europën lindore. Zhvillimi i partive nacionaliste ka¹⁴ qenë i mangët në Europën Lindore, të paktën në fazën e parë të tranzicionit dhe kjo mendohet të ketë qenë si pasojë e “okupimit” të këtij tregu politik nga partitë kryesore (Mudde 2002, Boschler 2007). Një nga problematikat kryesore në konsolidimin e demokracisë në Europën Lindore mendohet të ketë qenë edhe problemi i identitetit kombëtar, ose ai i shtetformimit (Linz dhe Stepan 1996). Kjo natyrisht mund të shihet qartë në rastin e ish –Jugosllavisë, ose në ndarjen e Bashkimit Sovjetik, ku nacionalizmi u artikulua njëkohësisht me kërkesat për ndryshimin e regjimit. Në pjesën tjetër të Europës Lindore artikullimi i nacionalizmit u përjetua i brendashkruar në dy dimensione, në atë të emancipimit dhe të shpëputjes nga Bashkimi Sovjetik (rifitimi i sovranitetit kombëtar) dhe atë të realizimit të tij brenda kuadrin të integritetit Euro-Atlantik. Në Shqipërinë postkomuniste ligjërimi nacionalist u reduktua po ashtu në një linjë si në Lindje në kuadrin e integritetit Euro-Atlantik dhe atë të aspiratave për bashkim kombëtar me territoret ish-jugosllave brenda kuadrin të BE-së. Çështja çame nuk

¹⁴ Një nga problematikat kryesore në konsolidimin e demokracisë në Europën Lindore mendohet të ketë qenë edhe problemi i identitetit kombëtar, apo ai i shtetformimitit (Linz Stepan 1996). Kjo natyrisht mund të shihet qartë në rastin e ish –Jugosllavisë, ose në ndarjen e Bashkimit Sovjetik ku artikullimi i nacionalizmit u bë krahas atij mbi ndryshimin e regjimit. Në pjesën tjetër të Europës Lindore artikullimi i nacionalizmit u përjetua i brendashkruar në dy dimensione; në atë të emancipimit dhe të shpëputjes nga Bashkimi Sovjetik (rifitimi i sovranitetit kombëtar).

ishte kështu veçse një pjesë e debatit politik mbi nacionalizmin i cili mbeti në kuadrin e kërimit të realizimit të tij, kryesisht brenda të djathtës, apo edhe brenda vetë projektit mbretëror, të pretendentit për fronin shqiptar Leka Zogut, në vitin 1997 (Biberaj 2011).

Në këtë kontekst, mund të vihet re njëfarë tranzicioni politik i identitetit të PDI-së¹⁵ si parti me një çështje të caktuar, drejt një axhende më të theksuar inovative dhe proaktive nacionaliste. ¹⁶Në vitet e fundit problemi çam ka qenë vetëm një prej artikuleve politike mbi çështjen kombëtare të konceptuar si një projekt unitar i cili nuk përfshin vetëm hapësirën shqiptare ballkanike, por prek edhe shqiptarët me banim jashtë atdheut. Gjithsesi ky projekt mbetet në kuadrin e një partie politike të institucionalizuar pa ndërmarrje ose iniciativa, ¹⁷ të cilat shkojnë jashtë kuadrin kushtetues (iniciativa referendare, ose protesta). Vetëdeklarimi i PDIU-së si parti e djathtë nacionaliste dhe konservatore justifikon kësaj edhe zgjedhjen për të qenë në krah të koalicionit qeveritar. Në një farë mënyre PDIU-ja po sillet si “alter ego” moralizuese e së djathtës shqiptare, sa kohë që kjo parti justifikon në njëfarë mase pozicionet më të buta të qeverisë në raport me çështjet që qendrojnë në themel të projektit të saj politik ¹⁸. Vetë pozicioni i kësaj partie, si mbështetje parlamentare e koalicionit dhe jo pjesë e ekipit qeveritar, sugjeron këtë ruajtje, a në një farë mase garancinë formale të mbajtjes së një profili nacionalist të qeverisë, ndonëse në pozita konservatore dhe jo aq proaktive¹⁹.

¹⁵ Njohja e “monopolit” të ligjëritimit nacionalist vetë njëres prej partive të mëdha, asaj Demokratike duket qartë edhe në një intervistë të ish -kryetarit të PDI-së. Në vitin 2009 del qartë impenjimi i kësaj force për zgjidhjen vetëm të çështjes çame duke e ndarë atë nga problemi i Kosovës, i cili tashmë konsiderohet i zgjidhur. Gazeta Shqip 8. 01. 2009

¹⁶ Intervistë me zotin Shpëtim Idrizi, marrë nga Koha Jonë, 1. 10. 2009.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ “Zakonisht dy partitë e mëdha e kanë të vështirë të marrin pozicione mbrojtëse për elemente të caktuara të çështjes kombëtare prandajle të themi se maxhoranca e ka të vështirë të marrë pozicione të tilla mbrojtëse për këto elemente sepse për shkak të çështjeve integruese në BE, ose në NATO, duket sikur nuk i mëshon fort një çështjeje të caktuar”, po aty.

¹⁹ Një nga iniciativat më të rëndësishme të qeverisë ishte projekti i censusit me vetëdeklarimin e kombësisë me amendimet e propozuara, të cilat do të penalizonin personat që deklarorin një kombësi të cilën nuk mund ta provonin me anë të dokumentacionit “Censusi: Idrizi, të mbrojmë identitetin shqiptar” http://ëëë.balkanëeb.com/bë_lajme2.php?IDNotizia=72398&IDCategoria=1

Përfundime

Zgjedhjet e qershorit të vitit 2009 dhe formimi i koalicionit qeveritar në shtator të po atij vitindoshta revolucionarizuan panoramën e formimit të koalicioneve në Shqipëri. Nëse gjatë viteve 1990-2005-së koalicionet qeveritare, ose edhe opozitare kanë respektuar në mënyrë të qëndrueshme modele me karakter ideologjik, të ngjashme me ato në Perëndim, pas 2009-ës, shënuan një ndryshim thelbësor dhe cilësor në panoramën e sistemit të partive në Shqipëri. Nga një sistem multipartiak i moderuar (Sartori, Boeschler) përgjatë periudhës 1991-2009, ai u transformua në një sistem multipartiak i cili dalëngadalë po shkon drejt multipartitizmi të segmentuar (Sartori) me një shkallë polarizimi ideologjik të ulët. Fakt për këtë është edhe kalimi gradual i partive politike nga një koalicion në tjetrin, gjë që filloi pas zgjedhjeve parlamentare me kalimin e Partisë Agrare në koalicionin e qendrës së djathtë në vitin 2005. . Po kështu, panorama e partive politike ndryshon cilësisht me daljen në skenë të dy forcave të reja politike në vitin 2004, LSI-së, dhe garimin e tyre të vetëm në zgjedhjet e vitit 2005 dhe eventualisht praninë e tyre në parlament. Kjo do të ishte hera e dytë në historinë e sistemit të partive politike në Shqipëri kur forca të reja politike arrinin të kalonin pragun prej 2. 5 përqind, të imponuar nga ligji elektoral. Risia që këto parti sollën qëndronte në afirmimin e tyre në dy zgjedhje kombëtare për LSI-në dhe në një kombëtare dhe një lokale për PDI-PDIU-në. Për herë të parë një koalicion qeveritar ishte post-elektoral gjë që bëri të mundur edhe afirmimin politik, por edhe atë që Sartori e cilëson si potenciali i koalicion -formimit dhe i shantazhit që këto parti kanë në raport me partinë drejtuese të koalicionit, atë Demokratike. Përtej këtij konstatimi sistemi i partive në Shqipëri po shkon drejt një dobësimi të dikotomisë PD-PS, gjë që po vjen në raport me dy tendenca të përfaqësuara nga dy partitë e analizuar në këtë punim:

1. Afirmimin e alternativave politike të pambuluara, ose të lëna në periferi të artikulimit politik si çështja kombëtare (PDIU)
2. Krijimin e subjekteve të reja politike të stabilizuara të cilat kanë gjasa të kushtëzojnë cilësinë e koalicion -formimit në të ardhmen në Shqipëri (LSI)

Përtej kushtëzimit që këto parti sjellin në sistem, vlen për t’u përmendur një tjetër faktor i cili bie në fakt ndesh me gjetjet, ose me teorinë e partive të reja në raport me performacën e tyre në koalicionin qeveritar ku supozohen dy përfundime:

1. Ndjeshmëria e partive të reja nga zgjedhja në zgjedhje me “migrimin” e votave drejt partive të mëdha.
2. Ndjeshmëria e performancës në raport me pjesëmarrjen e tyre në koalicionet qeveritare.

Këto dy hipoteza duket se bien ndesh me rastin e Shqipërisë kur si LSI-ja, ose PDIU-ja kanë pësuar rritje të votave në raport me periudhën përpara hyrjes në koalicionin qeveritar.²⁰ Ndonëse ky rezultat mund të duket pak a shumë kontradiktor kur mendohet se futja e partive të reja në koalicione qeveritare shënon një “zbutje” të axhendave respektive politike në raport me programin qeveritar, ka shumë gjasa që pikërisht pjesëmarrja në qeverisje i hap mundësi partive të vogla të shfrytëzojnë levën e pranisë administrative në thithjen e votave. Suksesi elektoral i partive të vogla duhet të lidhet me mundësinë e tyre për të mos ndierë presionin e partive të mëdha gjatë zgjedhjeve, ose atë të pasjes së një aksesit më të zgjeruar në “shpërblimin” e elektoratit. Jetëgjatësia e tyre pra nuk lidhet me projektin politik më shumë sesa me mundësinë që ata i krijojnë një pjese të elektoratit për akses në të mirat publike. Në këtë kuptim projekti i tyre politik është afatshkurtër dhe i destinuar për t’u riorientuar drejt partive të mëdha njëherësh që dalja në skenë e partive të vogla përmbush funksionin e mjedisit, ose të situatës në të cilën ajo është krijuar.

Bibliografia

- Bartolini, S. ‘*The Macro-constellation of Political Party Rise, Consolidation and Decline in the European Experience*’, No. 6 (2002/12), Taiwan Political Science Review, pp. 6-52
- Bennich-Bjorkman, Li ‘*New Political Parties in Central and Eastern Europe: A study of the determinants of immediate electoral success and its consequences*’ Statsvetenskaplig Tidskrift 2006, Vol. 108 nr 2
- Boschler, D ‘*The puzzles of party systems in Central-East Europe: Is Party Nationalisation the key variable?*’ ECPR 3rd General Conference, Budapest, 8-10 September 2005 Panel: 31-11 Nationalisation of parties and party systems
- Budini, B. ‘*Edi Rama, Politikani Pop(ulist)-Star*’ 2009, Polis, no. 8, 3-19
- Dalton, J. R, and Wattenberg, P. M. , Edited by ‘*Parties Without Partisans Political Change in Advanced Industrial Democracies*’ Oxford University Press, 2000
- Deschouwer, K. ‘eds’ ‘*New Parties in Government: In power for the first time*’ Routledge, 2008
- Della Porta, D. ‘*Partiti politici*’. Collana “Universale Paperbacks il Mulino”. 2009.

²⁰ Nga zgjedhjet e kaluara politike të vitit 2009 në ato lokale të vitit 2011 PDIU-ja pati një rritje nga 14477 në 63024 vota. I njëjti fenomen ndodhi dhe me LSI-në respektivisht në vitin 2009 me 73, 678 në 121. 172 në 2011 vota. http://www.cec.org.al/index.php?option=com_content&view=category&id=123&Itemid=147&lang=en Nëse do të përdornim formulën e Buelens dhe Hinos në raport me fatin elektoral të PDIU-së ajo do të shënonte një rezultat edhe më spektakolar +3. 55 për qind gjë që do ta çonte PDIU-në, apo edhe LSI-në në krye të indeksit të elaboruar nga këta studiues.

- Graziano, L. ‘*Lobbying, Pluralism and Democracy*’ Palgrave Macmillan, 2001
- Grzymala-Busse, A ‘*Rebuilding Leviathan: Party Competition and State Exploitation in Post Communist Democracies*’ Cambridge University Press, 2007
- Hanley, S. Szczerbiak, A. Haughton, T. dhe Fowler, B. “*Sticking together: Explaining comparative centre-right party success in post-communist Central and Eastern Europe*” Party Politics 2007
- Ignazi, P. ‘*Extreme Right Parties in Western Europe*’, Oxford University Press 2003
- Innes, A. Party ‘*Competition in Post-Communist Europe: The Great Electoral Lottery*’ Center for European Studies Central and Eastern Europe Working Paper Series 54 (June 2001)
- Kajsiu, B. ‘*Vdekje Politikës, Liri Popullit!-Krizë e Përfaqësimit në Përgjithësi*’, Polis 2008, 5-25.
- Kitchelt, H ‘*The Formation of Party Systems in East Central Europe*’ Politics & Society Vol. 20, No. 1, March 1992 7-50
- Krasniqi, A. “Zgjedhjet ne Shqiperi”, Tirane 2009
- Leftwich Curry, J. , Barth Urban, J. ‘*The Left Transformed in Post-Communist Societies: The Cases of East-Central Europe, Russia and Ukraine*’ Littlefield Publishers, Lanham, Boulder, Oxford-New York, 2003
- Lewis, P. G. “*Political Parties in Post-Communist Eastern Europe*” Routledge 2000
- Linz, J. J. Stepan, A. “*Problems of Democratic Transition and Consolidation*” Baltimore, MD: Johns Hopkins University Press. 1996
- Lindstrom, U. “*From post-communism to neo-communism? The reconstitution of the party systems of East-Central Europe*”
- Lipset, S. M. Rokkan, S. “*Cleavage Structures, Party Systems and Voter Alignments: Crossnational Perspectives*”, New York 1967
- Lijphart, A. ‘*Democracies: Patterns of Majoritarian & Consensus Government in Twenty-one Countries*. New Haven: Yale University Press, 1984.
- Luther, K. R. and Müller-Rommel, F. ‘*Political Parties in a Changing Europe*’ Keele European Parties Research Unit, Working Paper 14, 2002
- Mair, P “*Party System Change: Approaches and Interpretations*” Oxford University Press 1997
- Norris, P. ‘*Electoral Engineering: Voting Rules and Political Behavior*’ Cambridge Studies in Comparative Politics, 2004
- Pacek, A. C. , Pop-Eleches, ‘*G. Disenchanted or Discerning: Voter Turnout in Post-Communist Countries*’, The Journal of Politics, Vol. 71, No. 2, April 2009, Pp. 473-491
- Peterson D. A. M. , Djupe P. A. ‘*When Primary Campaigns Go Negative: The Determinants of Campaign Negativity*’, Political Research Quarterly, Vol. 58, No. 1 (Mar. , 2005), pp. 45-54.
- Pedersen, M. N. ‘*Towards a New Typology of Party Lifespans and Minor Parties*’ Scandinavian Political Studies, Bind 5 (New Series) (1982).

- Porta, D. D. "I partiti politici". Mulino 2001
- Rose, R. "Mobilizing demobilized voters in post-communist societies", Party Politics 1: 549-63. 1995
- Rommele, A. Lawson, K. Karasimenov, G. (edited) "Cleavage parties and voters: Studies from Bulgaria, Czech Repp., Hungary, Romania", Greenwood 1999.
- Sartori, G. 'Parties and Party Systems: A framework for analysis' (1976; reprint in 2005), ECPR Press, 2005
- Sikk, A "How Unstable? Volatility and the Genuinely New Parties in Eastern Europe," *European Journal of Political Research*, 44(1): 391-412, 2005
- Taagepera, R. Shugart, M. S. 'Seats and Votes: The Effects and Determinants of Electoral Systems', Yale University Press, 1989
- Tsebelis, G. "Decision Making in Political Systems: Veto Players in Presidentialism, Parliamentarism, Multicameralism and Multipartyism" *British Journal of Political Science*, Vol. 25, No. 3 (Jul. , 1995), pp. 289-325
- Olimid, A. P. "Political cleavages in Romania. A theoretical overview of the post-communist parties and party systems", MPRA Paper No. 14957, <http://mpra.ub.uni-muenchen.de/14957/>
- Van Biezen, I. 'Political Parties in New Democracies: Party Organization in Southern and East-Central Europe' Palgrave MacMillan, 2003
- Zaloshnja, E. **Zlaticanin A.** 'Një defekt i rëndësishëm i sistemit elektoral "Islami"' Tema, 22. 11. 2011
- Zogaj, P. 'Intuicionet e tranzicionit': UET Press, 2010

Ndërveprimi midis partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile¹

Dokt. Gentian ELEZI

Abstrakt. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë dhe të shpjegojë raportin që partitë politike ndërtojnë me një tjetër element të demokracisë, me shoqërinë civile dhe organizatat e saj. Studimi argumenton se kjo e fundit është përdorur nga partitë politike, për të legjitimuar aksionin dhe performancën e tyre përballë elektoratit dhe publikut të gjerë. Organizatat e ndryshme joqeveritare në momente të caktuara kanë "furnizuar" me kandidatë partitë politike duke i ndihmuar ato në ripërtëritjen dhe "pastrimin" e personelit politik. Në periudhën afatmesme, kjo tendencë ka sjellë edhe një delegjitimim gradual të organizatave të shoqërisë civile dhe produkteve të saj studimore si dhe aksioneve komunitare. Studimi bazohet në disa punime teorike të autorëve të fushës, duke i aplikuar ato në terrenin shqiptar, si dhe në analizën e ngjarjeve të zgjedhjeve të fundit politike të vitit 2009.

Hyrje

Rënia e sistemit komunist dhe vendosja e pluralizmit shënuan edhe fillimin e tranzicionit demokratik në Shqipëri. Skena politike përjetoi një gjallërim dhe një entuziazëm të munguar për dekada në shoqërinë shqiptare. Krijimi i partive të tjera politike ishte konkretizimi i sistemit të ri, por dhe fryt i parë i demokracisë së shumëpritur. Vitet 90-të u karakterizuan nga centrizmi i rolit të partive si njësitë e vetme të organizuara në arenën politike, duke treguar se ishte ende herët për forma të tjera aktivizmi dhe pjesëmarrjeje. Fundi i dekadës së fundit të shekullit dhe fillimi i dekadës së re shënuan lindjen dhe përhapjen e shpejtë të organizatave të shoqërisë civile.

¹ Studim i prezantuar në Konferencën "Partitë politike shqiptare 20 vjet pas ligjërimit të pluralizmit politik", Universiteti European i Tiranës, 15 nëntor 2011.

Kryesisht të mbështetura financiarisht nga organizata dhe nga donatorë të huaj, ato zgjeruan aktivitetin e tyre përgjatë viteve në vijim duke zënë një rol gjithmonë e më të rëndësishëm në jetën publike të vendit. Sipas përkufizimit të White (1994), shoqëria civile është një arenë e ndërmjetme midis shtetit dhe familjes, e përbërë nga organizata që gëzojnë autonomi në lidhje me shtetin dhe që formohen në mënyrë vullnetare nga individët, për të mbrojtur apo për të zgjeruar interesat dhe vlerat e tyre. Këto organizata, përveç që japin një kontribut të rëndësishëm në fushat e ndryshme ku operojnë, kanë edhe një funksion edukues për shoqërinë dhe qytetarët, sidomos nga pikëpamja e pjesëmarrjes. Në vendet e sapodala nga regjimet totalitare, shoqëria civile paraqitet e dobët dhe organizatat kishin probleme në terma anëtarësie dhe aktivizmi. Ishin të rralla rastet kur menjëherë pas rënies së komunizmit të krijoheshin hapësira të tilla të përbashkëta. Në shumicën e rasteve, pas komunitarizmit të detyruar për disa dekada, tranzicioni filloi me një garë të shfrenuar individualizmi duke mos lënë mundësi për rindërtimin e lidhjeve strukturore të shoqërisë. Megjithatë, pas “dehjes” së parë dhe pas konsolidimit të sistemit partiak, edhe Shqipëria filloi të përjetonte procesin e ndërtimit të shoqërisë civile dhe të organizmave të saj. Ky ka qenë një fakt tepër i rëndësishëm për forcimin e demokracisë dhe për nxitjen e qytetarëve për pjesëmarrje. Organizatat e shoqërisë civile janë mjeti më i mirë për të ushtruar presion dhe për të vënë para përgjegjësisë partitë politike në një sistem demokratik. Ato monitorojnë veprimtarinë e institucioneve shtetërore dhe të partive politike. Duke ushtruar influencën e tyre, ato shndërrohen *de facto* në kontrollues të mbarëvajtjes së çështjeve publike dhe kujdesen për ruajtjen e interesave të përbashkët, ose specifikë të grupit që përfaqësojnë (Bartolini & Mair, 2001). Pjesëmarrja e tyre në debatet dhe në diskutimet publike, angazhimi në forumet e ndryshme mbi tema të caktuara, kontributi në bashkëpunimet me institucionet e ndryshme, janë elemente që ndihmojnë në zhvillimin e vendit, në përmirësimin e politikave dhe për garantimin e një cilësie më të mirë të demokracisë. Ashtu siç ka theksuar edhe Diamond (1994), politika është tepër e rëndësishme që t’i lihet në dorë vetëm të partive politike.

Megjithatë, disa probleme kanë lindur nga bashkëpunimi i ngushtë midis partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri. Hipoteza e këtij studimi është se *ndërveprimi midis partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri, sjell disa avantazhe për partitë, por dëmton në disa mënyra të dytat.*

Partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile: pikat e takimit

Partitë politike kanë ndryshime thelbësore krahasuar me organizatat e shoqërisë civile. Këto ndryshime kanë të bëjnë me strukturimin, funksionimin, por sidomos edhe me objektivat. Qëllimi i këtyre dy strukturave është i

ndryshëm. Ndërkohë që partia politike synon marrjen e pushtetit, organizata e shoqërisë civile nuk e ka këtë aspiratë dhe nuk konkurren në zgjedhje. Strukturimi dhe përfaqësimi i interesave për të marrë pushtetin i përket partive politike (Diamond, 2001; Lipset & Rokkan, 1967; Dahl, 1993). Megjithatë, ka disa funksione që mbivendosen. Për shembull, përfaqësimi, mobilizimi, madje ndonjëherë edhe duke prezantuar kandidatë të pavarur në zgjedhje. Por cilat janë aktivitetet që vënë në kontakt dhe ndërthurin veprimtarinë e partive politike me atë të organizatave të shoqërisë civile?

Ndërveprimi midis këtyre strukturave merr formën e lobimit, advokimit, dhënies së informacionit dhe të analizave, organizimit të forumeve, trajnimit të kandidatëve dhe stafit, mbështetjes, furnizimit me material, mobilizimit të votuesve, monitorimit, etj (Jankowski, 1988). Të gjitha këto aktivitete kanë bashkuar partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile edhe në Shqipëri. Ashtu siç ndodh edhe në vende të tjera, një parti kërkon mbështetje dhe në këmbim përfaqëson interesat e organizatave në arenën e vendimmarrjes dhe bërjen e politikave publike, duke ofruar edhe mbështetje financiare, ose materiale (Ware, 1997). Disa autorë mbështetin tezën që thotë se kahu i ndërveprimit dhe i influencës mund të jetë i dyanshëm, ose mund të mbizotërojë në njërin drejtim. Kjo varet nga konteksti dhe nga madhësia dhe kapacitetet e subjekteve. Gjithashtu, ndërveprimi i tyre varet edhe nga elemente të tjera rrethanore si për shembull, natyra e sistemit dhe qëndrimet ndaj partive politike dhe shoqërisë civile në tërësi; ligje që mund të kushtëzojnë lidhjet midis tyre; niveli i besueshmërisë së publikut, historia dhe trashëgimia e vendit nga pikëpamja e organizatave dhe roli i tyre social dhe ekonomik, etj. Në shumë vende ndërveprimi është aq i ngushtë sa që është e vështirë të dallosh vijën e ndarjes midis partive politike dhe organizatave. Kjo ndodh sidomos në vende ku ligji krijon me lehtësi këto hapësira (p.sh. në Filipine dhe në Tajlandë). Pastaj ka raste të tjera ku polarizimi dhe politizimi është shumë i lartë dhe të gjithë janë të angazhuar në debatin politik. Megjithatë, në shumicën e vendeve ruhet një balancë e qëndrueshme midis partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile. Organizatat shpesh i ofrojnë qytetarëve hapësira dhe instrumenta alternativë për pjesëmarrjen politike. Janë të shumtë shembujt dhe rastet e suksesit të organizatave në përfshirjen e qytetarëve dhe në ndikimin e drejtpërdrejtë në marrjen e vendimeve nëpër institucione. Atje ku ndodh kjo, legjitimohet më tej edhe vetë procesi i ruajtjes së distancave nga partitë politike. Organizatat e shoqërisë civile arrijnë të mobilizojnë qytetarë për çështje të caktuara, duke përdorur instrumenta dhe metoda që nuk i përkasin partive. Në këtë mënyrë organizatat theksojnë vetë diferencat me partitë politike: ato janë më të reja, më pjesëmarrëse, më programatike, më pak të korruptuara, etj. Edhe sipas teorive dhe traditës liberale, partitë politike dhe organizatat janë të dallueshme qartë dhe janë të dyja shumë të nevojshme për një demokraci të shëndetshme. Mënyra se si partitë mund të

grupojnë, përfaqësojnë dhe negociojnë interesat e gjera, nuk mund ta bëjë dot asnjë strukturë tjetër. Organizatat përfaqësojnë interesa shumë më të ngushtë dhe, mbi të gjitha, ato mund të kërkojnë apo kritikojnë, por nuk zbatojnë dot kërkesat e tyre. Këtë mund ta bëjnë vetëm në mënyrë të tërthortë duke kërkuar llogari te shteti dhe partitë politike.

Në vendet në zhvillim, është vënë re një tendencë e thellimit të bashkëpunimit midis këtyre dy sferave, në katër drejtime të ndryshme: *së pari*, partitë politike duket se po thellojnë gjithmonë e më shumë bashkëpunimin për trajnimet që ofrojnë organizatat e shoqërisë civile. Siç, u tha më lart, kjo është një nga funksionet e këtyre organizatave që përdoret gjerësisht nga partitë politike. Tendencat në rritje e këtij lloji bashkëpunimi tregojnë edhe specializimin e mëtejshëm të organizatave dhe faktin që gjithmonë e më shumë ato po vihen në qendër të aktiviteteve politike. *Së dyti*, është rritur numri i partive që heqin dorë nga strukturat think-tank të brendshme dhe mbështeten kryesisht në organizatat e shoqërisë civile, gjatë procesit të hartimit dhe zhvillimit të platformës së tyre programore. Kjo ka ndodhur si duke punësuar drejtpërdrejt organizatat dhe think-tanks për të prodhuar një produkt të tillë, ose duke mbledhur së bashku copëza idesh dhe produktesh nga organizatat të ndryshme dhe duke i bashkuar në një program. *Së treti*, partitë politike tashmë publikojnë dhe debatojnë çështjet e ndryshme në forume dhe në tryeza të organizuara nga shoqëria civile. Kjo praktikë shërben jo vetëm në drejtimin e përmirësimit të cilësisë së produktit përfundimtar, por edhe për të nxitur pjesëmarrjen dhe për të legjitimuar procesin në prani të elektoratit dhe të publikut të gjerë. *Së katërti*, makineria e partive politike, që operojnë në terren për sondazhe gjatë fushatave, po zëvendësohet pikërisht nga stafi i organizatave, ose nga struktura të tjera të specializuara, duke qenë se garantojnë një punë më të pavarur dhe profesionale. Por ka ndodhur edhe fenomeni i anasjelltë. Shpesh është “politika që dikton termat organizatave duke përcaktuar madje edhe personat që përfshihen në projekte të ndryshme” (Sampson, 1996, f. 135).

Megjithatë, studimet tregojnë se shumica e organizatave të shoqërisë civile në botë, nuk janë të përfshira në bashkëpunime me partitë politike. Prirja e shumicës së organizatave është të shmangin sa më shumë kontaktet me partitë. Kjo ndodh sepse imazhi i tyre si struktura të paanshme mund të cenohet. Në varësi të profilit dhe qëllimeve të misionit të tyre, ato mundohen të qëndrojnë sa më larg partive dhe të mos shfaqin mbështetje për asnjë prej tyre, ose të tregojnë të njëjtën mbështetje për të gjitha. Kjo bën që perceptimi për paanshmërinë e aktiviteteve dhe produkteve të tyre të mbetet i njëjtë.

Por cili do të ishte raporti më i mirë dhe i frytshëm midis këtyre dy arenave, në mënyrë që demokracia të funksiononte sa më mirë? Debati teorik mbi këtë pikë është i hershëm dhe është projektuar ndjeshëm në fushën e studimeve mbi shoqërinë civile. Ertman (1998) ka qenë një nga autorët që më shumë ka

studiuar ekuilibrin midis partive politike dhe shoqërisë civile në demokraci. Duke studiuar sidomos periudhën midis dy luftërave në Europën Perëndimore, Ertman mbështet idenë se të vetmet demokraci që mbijetuan kanë qenë ato që kanë patur një zhvillim të mirë dhe të efektshëm të të dy grupaktorëve, si parti politike, ashtu edhe organizatat e shoqërisë civile. Ai thekson se këto lidhje “midis grupimeve shoqërore dhe partive politike kanë patur efekte shumë pozitive në trajektoren politike afatgjatë të kombeve. Nga njëra anë, kjo lejon individët, që kanë pikëpamje të ndryshme mbi disa çështje, të organizohen dhe të bëjnë fushata reformimi që prekin partitë dhe shtresat e ndryshme. Nga ana tjetër, kjo forcon partitë që të qëndrojnë pragmatiste dhe fleksibël në pozicionet e tyre në mënyrë që të fitojnë mbështetjen e një game të gjerë grupesh interesi dhe të reagojnë ndaj rrymave të reja brenda shoqërisë civile.” (Ertman, 1998, f. 501). Pra, si partitë politike, ashtu edhe organizatat e shoqërisë civile, luajnë të dyja një rol të rëndësishëm dhe thelbësor në demokraci, duke artikuluar qartë interesat, duke formësuar dhe duke ofruar zgjedhje dhe alternativa, duke mundësuar dhe nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve. Për rrjedhojë, një formë ideale e sistemit politik do të përfshinte skenarin ku të dy sektorët janë mjaft të zhvilluar dhe aktivë. Kjo verifikohet me lehtësi, në rastin e demokracive të zhvilluara perëndimore, ku edhe pse bashkëveprimi është intensiv, asnjë nga dy sektorët nuk dëmtohet nga tjetri (Sabatini, 2003). Çfarë ndodh në rastin e shoqërive me demokraci të brishtë? Si ndërveprojnë këto dy fusha në shoqëritë postkomuniste? Dhe më specifikisht, në rastin e Shqipërisë, cila është situata e dinamikës së bashkëveprimit?

Rasti i Shqipërisë: ndërveprim apo shfrytëzim

Fillimi i tranzicionit demokratik në Shqipëri u shoqërua me krijimin e disa partive të reja politike. Krijimi i Partisë Demokratike, si parti e parë opozitare, i hapi rrugën themelimit të partive të tjera të vogla, duke filluar një proces të mbushjes së hapësirës ideologjike, e lënë bosh për dekada me radhë. Skena politike dhe sistemi partiak i dy dekadave të para të regjimit të ri përjetoi disa ndryshime strukturore, si nga pikëpamja institucionale, ashtu edhe nga ajo e legjislacionit. Pavarësisht luhatjeve dhe trazirave, sistemi partiak arriti të gjejë një trajektore të vetën drejt një stabilizimi relativ. Kështu, gjatë 20 viteve kanë dominuar kryesisht të njëjtat parti dhe e njëjta qasje në ndërtimin e qeverisjes duke u bazuar në koalicionet (Krasniqi, 2008). Fillimi i krijimit të një hapësire publike jopolitike ka qenë pak më i vonuar. Fundi i viteve 90-të dhe fillimi i dekadës së re, shënoi edhe përhapjen e organizatave të ndryshme jofitimprurëse, kryesisht të financuara nga donatorët. Qëllimi i donatorëve ka qenë zhvillimi i hapësirës në dispozicion të shoqërisë civile dhe nxitja e

pjesëmarrjes së qytetarëve dhe grupeve të ndryshme sociale. Ky është menduar të jetë si element bazë për të mbështetur krijimin e një kulture politike demokratike.

Në literaturë, shoqëria civile njihet si e ndarë në dy nivele. Niveli i parë ka të bëjë me mundësinë e njerëzve për t'u bashkuar, me vullnet të lirë, në shoqata për interesa dhe qëllime të veçanta. Ata llojnë dhe tentojnë të influencojnë institucionet vendimmarrëse në favor të kërkesave që kanë si grupime. Ndërsa niveli i dytë lidhet me gatishmërinë e qytetarëve (individë apo grupe) për të kritikuar në mënyrë të pavarur ushtrimin e pushtetit të institucioneve, partive, biznesit, etj. si dhe të shprehin opinionet e tyre të pavarura mbi politikën e ndërmarrë. Në këtë kuadër, kuptohet lehtë pse shoqëria civile është e rëndësishme, pasi është e domosdoshme në funksionimin e një shoqërie të lirë e demokratike (Clunies-Ross & Sudar, 1998). Tashmë shoqëria civile në Shqipëri karakterizohet nga një shtrirje relativisht e gjerë në fusha të ndryshme dhe nga një strukturim i ngjashëm me vendet e tjera postkomuniste.

Megjithatë, sipas studimeve të ndryshme që paraqesin treguesit e aktivizmit dhe të influencës së tyre, organizatat e shoqërisë civile ende nuk kanë arritur atë stad zhvillimi dhe bashkëveprimi me arenat e tjera të jetës publike. Kjo ka të bëjë me vetë strukturimin dhe funksionalitetin e tyre, por edhe me mjedisin ku ato veprojnë, me hapësirat që lejon politika dhe institucionet e tjera, me predispozitën dhe kulturën politike qytetare që mbizotëron në Shqipëri, me presionin që ushtrojnë partitë politike. Kjo evidentohet edhe nga fakti që shumë pak OJF janë shprehur haptas publikisht mbi qëndrimin e tyre ndaj zbatimit të planeve të qeverisë. Rrallëherë gjërat kanë shkuar përtej artikujve të gazetave dhe protestave me numër të kufizuar njerëzish (Picari, 2008). Por cila është natyra e bashkëpunimit dhe e ndërveprimit midis partive politike dhe organizatave të shoqërisë politike në Shqipëri? Edhe pse influenza është e ndërsjelltë, kahu i presionit është në favor të partive politike. Përveç një periudhe fillestare, organizatat e shoqërisë civile nuk kanë mundur dot të krijojnë atë masë kritike dhe atë fuqi lobuese për të influencuar ndjeshëm aktivitetin e institucioneve dhe të partive politike. Rastet që dëshmojnë të kundërtën janë të pakta. Duke aplikuar edhe modelet teorike të përshkruara më lart, mund të vëzhgojmë se më së shumti janë partitë që përdorin organizatat dhe kryesisht në 4 drejtime (Jankowski, 1988):

Së pari, partitë politike shfrytëzojnë organizatat e shoqërisë civile për të legjitimuar aktivitetet e tyre. Ndodh shpesh që në prag të nismave dhe reformave të rëndësishme, partitë politike përfshijnë formalisht në bisedime grupe të ndryshme nga shoqëria civile. Me këtë lloj strategjie synohet pikërisht legjitimimi i një aktiviteti, ose aksioni të caktuar, si të pranuar nga grupet e interesuara në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo është një metodë që përdoret sidomos në prag të fushatave zgjedhore.

Së dyti, partitë politike kanë përdorur shoqërinë civile për të rinovuar imazhin e tyre. Gjatë vitit zgjedhor, partitë rekrutojnë profesionistë rinj nga organizatat dhe i përfshijnë në strukturat e partisë dhe të stafit elektoral. Kjo praktikë filloi gjerësisht në vitin 2005 dhe pikërisht me krijimin e strukturës së quajtur KOP nga Partia Demokratike. Shumë individë të rinj iu afruan politikës dhe bënë kalimin nga shoqëria civile drejtpërdrejt në zgjedhjet parlamentare. Ky ishte një shfrytëzim i ndërsjelltë, pasi nga një anë partitë politike mund të rinovoheshin përballë elektoratit me praninë e individëve të rinj, me formim akademik dhe profesional të përshtatshëm, por nga ana tjetër edhe këta individë e përdornin këtë mundësi si trampolinë për t'u lançuar në politikë. Kjo dinamikë u përsërit edhe në vitin 2009, ku një sërë figurash të njohura të shoqërisë civile iu bashkuan dy partive të mëdha politike, kryesisht duke u bërë pjesë e listave të kandidatëve për deputetë. Kjo lëvizje shkaktoi një zbrastje të disa organizatave nga pikëpamja e liderimit dhe, nga ana tjetër, pasuroi radhët e partive politike me individë të kualifikuar dhe me eksperiencë profesionale të konsiderueshme. Krahas personave që iu afruan partive politike, ka pasur edhe raste kur organizata të mirëfillta të shoqërisë civile janë shndërruar në parti politike dhe kanë marrë pjesë në zgjedhje (Mjaft, Ora, FER, etj.). Edhe pse rastet e përmendura nuk rezultuan të suksesshme në terma elektoralë, duket se kjo tendencë vazhdon të përsëritet dhe mund të ketë përsëri kalime të tilla, duke shfrytëzuar dimensionin publik që ofron shoqëria civile, për të akumuluar kapital politik, i cili mund të shpenzohet gjatë zgjedhjeve.

Thithja e stafit nga njëra sferë në tjetrën, ka ndodhur edhe në kahun e kundërt. Disa politikanë, ose një pjesë e stafit të partive politike, kalojnë shpesh të punësuar në organizata të shoqërisë civile. Kjo koincidon sidomos me rastet e dështimeve zgjedhore. Në këtë mënyrë, disa organizata shndërrohen në "strehëza" të përkohshme, duke ofruar punë për personelin e partive politike, në pritje të revanshit të radhës zgjedhor.

Së treti, partitë politike përdorin individë dhe grupime të caktuara të shoqërisë civile për ekspertizën e tyre. Ky lloj bashkëpunimi, i përhapur në shumë vende të zhvilluara, ka gjetur terren edhe në realitetin shqiptar në vitet e fundit. Duke qenë se organizata të caktuara kanë kapacitetet dhe mundësitë për të bërë studime dhe analiza të thelluara më mirë sesa mund të bëjnë vetë partitë politike, natyrshëm ka lindur një ndërveprim i tillë. Raportet dhe studimet e ofruara i shërbejnë partive për të ndërtuar platformën, programin, qëndrimet dhe reagimet politike në fusha të caktuara. Vlera e këtij lloj shërbimi dhe bashkëpunimi është nxitur gjithmonë e më shumë, sidomos në prag të zgjedhjeve.

Dhe, *së katërti*, pikërisht zgjedhjet përbëjnë edhe boshtin e këtij bashkëpunimi. Siç u përshkrua edhe më lart, pothuaj të gjitha aktivitetet që përfshinin ndërveprimin midis partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile ishin të orientuara drejt

rritjes së potencialit politik për përmirësimin e rezultatit elektoral. Kjo ka sjellë që partitë politike të kërkojnë angazhimin e grupimeve të caktuara edhe në fushatën zgjedhore. Mënyrat dhe llojet e aktiviteteve janë të ndryshme nga përgatitja e materialeve vizuale e deri te shpërndarja e tyre, nga bërja e sondazheve e deri tek organizimi i eventeve. Në këto raste bëhet fjalë për një bashkëpunim tejet të ngushtë midis partisë dhe organizatës, ku vija ndarëse midis të dyjave bëhet shumë e hollë.

Secila nga katër situatat e përshkruara më lart ka specifikat dhe pasojat e veta në funksionimin e këtyre dy sferave të rëndësishme të demokracisë. Përdorimi dhe ndërveprimi i shpeshtë, sipas pikëpamjeve teorike, mund të dëmtojë njërin, ose të dyja palët. Në rastin shqiptar, e humbura e madhe është shoqëria civile - prej dëmeve të shkaktuara nga partitë politike.

Në vend të përfundimeve

Pse janë fituese partitë politike? Në radhë të parë, partitë shqiptare kanë mundur të rinovojnë imazhin e tyre, falë shfrytëzimit që i kanë bërë burimeve të organizatave të shoqërisë civile. Ky përforsim i stafit të tyre ka pasur impakt në performancën e tyre zgjedhore, në qeverisje, ose edhe në aktivitetet e ndryshme politike. Duke dominuar bindshëm raportin midis dy sferave të lartpërmendura, partitë kanë ditur të përdorin në të gjitha mënyrat e shpjeguara organizatat dhe imazhin e tyre, për të përmirësuar rezultatin zgjedhor. Si nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja, partitë politike kanë zbratur copëza të shoqërisë civile në favor të mbijetesës dhe zhvillimit të tyre.

Nga ana tjetër, ky ndërveprim ka sjellë një dobësim të ndjeshëm të shoqërisë civile. Së pari, zbrazja nga potenciali, ekspertiza, profesionalizmi, lidhshipi, kanë reflektuar menjëherë pasojat të ndjeshme në performancën dhe në aktivitetet e organizatave që janë prekur nga kjo rrjedhje. Natyrisht, në periudhën afatmesëm dhe në atë afatgjatë gjasat janë që ky dëm të riparohet gradualisht, duke krijuar hapësirën për prurje të reja cilësore. Por në periudhën afatshkurtër impakti ka qenë i konsiderueshëm. Graviteti dhe tërheqja që ushtron politika duket se ka dobësuar edhe përgjegjshmërinë e individëve në disa raste, duke mos kuptuar rëndësinë e misionit të rolit të tyre në shoqërinë civile dhe në ruajtjen e balancave me politikën. Përveç zbrazjes nga pikëpamja e burimeve njerëzore, ka edhe një efekt tjetër negativ që ky ndërveprim ka sjellë në Shqipëri: zbehja e imazhit dhe cenimi i reputacionit dhe besueshmërisë. Natyrisht, jo të gjitha organizatat e shoqërisë civile duhet të jenë të paanshme. Është normale që disa prej tyre të kenë një mbështetje transparente për njërin apo tjetrin kah politik, në varësi të bindjeve dhe interesave përkatës. Por në shoqëritë demokratike, është e rëndësishme që të ketë gjithsesi edhe organizma të paanshëm dhe të distancuar në mënyrë të

barabartë nga partitë politike. Funksionin që ato luajnë e shpjeguam më lart. Në këtë kuadër, ikja e burimeve të tyre njerëzore drejt politikës apo transformimi i tyre në parti politike, dëmton imazhin e tyre dhe për rrjedhojë të imazhin e shoqërisë civile në tërësi. Duke shfaqur këto qëllime “dytësore”, ato krijojnë te qytetarët paragjykime edhe për organizatat e tjera. Ky efekt dytësor ka ndikuar ndjeshëm në dobësimin e aftësisë mobilizuese të shoqërisë civile, në mungesën e besueshmërisë së aktiviteteve, studimeve dhe analizave që ato ofrojnë, si dhe në rritjen e dyshimeve dhe të perceptimeve negative të tyre, jo si kundërpalë e partive, por si palë me to.

Bibliografia

- Bartolini, S. and Mair, P. 2001. “Challenges to Contemporary Political Parties,” in Larry Diamond and Richard Gunther, eds., *Political Parties and Democracy*, pp. 327-343. Baltimore: The Johns Hopkins University Press.
- Clunies-Ross, A. & Sudar, P. ed. 1998. *Albania's Economy in Transition and Turmoil 1990-1997*, U.K.: The Book Company.
- Dahl, Robert A. 1993. “Pluralism,” in Joel Krieger, ed., *Oxford Companion to Politics of the World*. New York: Oxford University Press.
- Diamond, Larry. 1994. “Rethinking Civil Society: Toward Democratic Consolidation.” *Journal of Democracy*, 5:3 (July), pp. 4-17.
- Diamond, Larry, and Richard Gunther. 2001. “Introduction,” in Larry Diamond and Richard Gunther, eds., *Political Parties and Democracy*, pp. ix-xxxiv. Baltimore: The Johns Hopkins University Press.
- Ertman, Thomas. 1998. “Democracy and Dictatorship in Interwar Western Europe Revisited.” *World Politics*, 50(3):475ff.
- Jankowski, Richard. 1988. “Preference Aggregation in Political Parties and Interest Groups: A Synthesis of Corporatist and Encompassing Political Theory.” *American Journal of Political Science*, 32:105-125.
- Lipset, Seymour Martin, and Stein Rokkan. 1967. “Cleavage Structures, Party Systems, and Voter Alignment: An Introduction,” in Seymour Martin Lipset and Stein Rokkan, eds., *Party Systems and Voter Alignments*, pp. 1-64. New York: Free Press.
- Krasniqi, A. (2008) *Partitë politike dhe sistemet politike: historia, roli, organizimi, modelet dhe tiparet e partive dhe sistemeve politike*, Tiranë.
- Picari, B. (2008) Ndikimi i ndërkombëtarëve nëpërmjet organizatave jofitimprurëse në procesin e zhvillimit, *Revista Polis*, UET Press.
- Sabatini, Christopher. 2003. “Lost Illusions: Decentralization and Political Parties.” *Journal of Democracy*, April.
- Ware, Alan. 1997. *Political Parties and Party Systems*. New York: Oxford University Press.

Sampson, S. (Hann, C. & Dunn, E. ed.) 1996. *Civil Society: Challenging Western Models*, London: Routledge, 121-142.

White, Gordon. 1994. "Civil Society, Democratization and Development (I): Clearing the Analytical Ground." *Democratization*, 1:3 (Autumn 1994), pp. 375-390.

Struktura dhe Organizimi i Partisë në Shqipërinë post-komuniste: Një studim mbi Partinë Demokratike të Shqipërisë

Dokt. Anjeza XHAFERAJ

Abstrakt. Synimi i këtij punimi është të analizojë faktorët që kanë çuar në suksesin e Partisë Demokratike të Shqipërisë. Punimi synon të sjellë parametra të rinj në matjen e suksesit të një partie politike. Këto parametra përjashtojnë elemente të tilla si marrja e posteve në qeveri, ose performanca, dhe duke e konsideruar partinë si një organizatë që është kthyer në qëllim në vetvete, vlerëson si të suksesshme çdo parti që ka jetëgjatësi dhe shtrirje permanente në elektorat. Po kështu punimi synon t'i "çlirojë" partitë politike prej së shkuarës e cila shpesh fajësohet për dështimet e perceptuara të politikës në Shqipëri, si edhe prej faktorëve makro-institucionalë që shihen si strukturues të procesit politik. Qasja e punimit është e tillë që i shikon partitë politike si strukturuese të institucioneve, si aktoret e vërteta politike, dhe që si të tilla duhet të marrin mbi vete përgjegjësinë për dështimet e perceptuara, që shpesh i faturohen të shkuarës. As mungesa e kulturës politike, ose sistemi komunist dhe as sistemi elektoral nuk janë faktorët kryesorë të zhvillimit të partive politike shqiptare. Suksesi, ose mossauesi i tyre është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimeve që vetë partitë politike kanë marrë. Në analizën bërë Partisë Demokratike u pa se partia ka qenë në gjendje të jetë e suksesshme pikërisht atëherë kur ka qenë e aftë të artikulojë ideologji integruese dhe të ndërtojë programe politike të kristalizuara rreth vijave ideologjike. Gjithashtu Partia Demokratike e ka ruajtur besnikërinë e elektoratit të saj të gjerë, tek i cili depërton falë strukturës së saj si parti masash, në sajë të patronazhit, duke bërë kështu të mundur një mosfraksionim të tij edhe kur elita e saj politike i është nënshtruar përçarjes.

This study is an attempt to analyze the factors that have contributed towards the success of the Democratic Party of Albania. It seeks to introduce new dimensions in measuring the success of a political party. The study rejects the elements of office-holding and policy – or performance-based measures of success, because they are determined by a complex array of economic, political, social and institutional factors. The concept of party success is defined in terms of: breadth and durability. At the same time the study aims at emancipating the political parties from the past and macro-institutional factors, to which very often are ascribed the reasons for the perceived failure of politics in Albania. The approach used in this study has regarded the political parties as the real political actors that as such should assume the responsibility for the perceived failures. Neither the lack of political culture, nor the communist system, are the main factors to shape the activity and development of political parties in Albania. Both macro-institutional and historical structural approach has limited explanatory power for the success of the Democratic Party. Its success is a direct consequence of the decisions that the political parties themselves, including Democratic Party as one of the key actors, have taken. The research showed that the Democratic Party of Albania has been successful because and when its elite have been able to craft inclusive ideological programs and because of its extensive penetration in the country, which it owes to its structure as a mass party. The party has established patronage linkages with its sympathizers, the rank and file and militants and consequently has ensured their loyalty and maintained an extensive electoral penetration in country.

Hyrje

Rënia e komunizmit në Europë u shoqërua me një sërë fenomenesh, ku ndër më të rëndësishmet, pa dyshim, mund të përmendet shfaqja e partive politike që nuk mëtojnë të unifikojnë trupin politik të popullit rreth një të vërtete universale, karakteristikë intrinsike kjo e partive komuniste, por përkundrazi krijojnë, ose së paku tentojnë të krijojnë një ndarje të shoqërisë në vija ideologjike, në përkatësi shoqërore, në identitete etnike dhe kombëtare. Shfaqja e partive politike në vendet postkomuniste ndodhi në një kohë kur simotrat e tyre në përfundim kishin krijuar tashmë një të shkuar të pasur, me ndryshime radikale në strukturën dhe organizimin e tyre, ndryshime këto që reflektuan revolucionin politik, ekonomik dhe shoqërorë që përfshiu Përfundimin në fundshekullin e 19-të dhe shekullin e 20-të.

Ndërsa, ka një literaturë të pasur mbi zhvillimin e partive politike në vendet postkomuniste, një e tillë në Shqipëri, dhe sidomos për partitë e djathta, mbetet megjithatë e paktë. Andaj edhe ky punim tenton të plotësojë disi vakuumin që ekziston në këtë fushë. Objekt i analizës është Partia Demokratike si partia politike më e madhe e krahut të djathtë. Studimi përfshin periudhën 1990-2009, pra që

nga krijimi i Partisë Demokratike dhe deri në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2009 ku Partia Demokratike, në krye të një koalicioni, arriti të marrë pushtetin dhe të krijojë qeverinë.

Studimi nis me premisën se partia demokratike është e suksesshme dhe synon të zbulojë faktorët që kanë çuar në këtë sukses. Elementet që përcaktojnë suksesin, ose mosesuksesin e një partie nuk janë marrja e posteve zyrtare dhe performanca, sepse këto varen nga një kompleks faktorësh ekonomikë, politikë, shoqërorë dhe institucionalë (Hanley et.al, 2007, f.5-6); Hanley et.al, 2008, f.408-409). Kështu, performanca e partive në vendet postkomuniste shpesh është kushtëzuar nga politikat e kondicionalitetit të institucioneve ndërkombëtare si edhe nga marrëveshjet mes partive në rastet e qeverive me koalicion. Për më tepër kohëzgjatja e shkurtër e sistemit politik shumëpartiak në këto vende e bën të vështirë identifikimin dhe agregimin e cikleve elektorale. Perspektiva e integritimit në Bashkimin Europian, gjithashtu ka imponuar zgjedhje të kufizuara politikash duke ndikuar kështu në platformën dhe performancën e partive. Në këtë studim, sukcesi përcaktohet në terma të shtrirjes dhe kohëzgjatjes. Me “shtrirje [kuptohet] aftësia për të ndërtuar një entitet elektoral të gjerë që përfshin votues dhe nëngrupe, që i përkasin një shtrirjeje të gjerë sociale dhe ideologjike” dhe me “kohëzgjatje [kuptohet] aftësia e entiteteve të tilla për të qëndruar të bashkuara dhe kohezive dhe që zgjasin për një periudhë kohe” (Hanley et.al, 2007, 6). Sot, 20 vjet pas themelimit të saj, Partia Demokratike ka shtrirjen më të madhe në elektoratin e djathtë. Kjo shtrirje është aq e madhe sa niveli i fragmentizimit të votës së djathtë është zero (Xhaferaj, 2010;16). Po kështu ajo vazhdon të ekzistojë. Andaj mund të thuhet se Partia Demokratike i plotëson të dyja kriteret që indikojnë që një formacion politik të jetë i suksesshëm.

Për të analizuar Partinë Demokratike janë përdorur një sërë qasjesh teorike siç janë ato makro-institucionale, historiko-strukturore si edhe qasja e kohezionit të elitave dhe e thurjes ideologjike, në përfundim të analizës së të cilave u arrit në konkluzionin se Partia Demokratike e Shqipërisë është e suksesshme kur elita e saj është në gjendje të prodhojë një ideologji përfshirëse dhe sepse ajo duke qenë një parti masash depërton thellë në elektorat dhe ka lidhje të forta me anëtarësinë e shumtë, lidhje të cilat i krijojnë dhe i ruan përmes patronazhit.

Qasjet ekzistuese gjatë analizimit të Partive Politike në vendet postkomuniste

Ndër qasjet analitike ekzistuese mbi partitë politike dhe në përgjithësi mbi zhvillimet politike në vendet postkomuniste, ka një lloj tensioni mes agjencisë dhe strukturës ku herë i jepet përparësi njëres dhe herë tjetrës. Ndër qasjet që

i japin rëndësi strukturës janë ato Makro-institucionale (Sistemi Elektoral) dhe Historiko-strukture (Trashëgimia Komuniste dhe Rruga e Varësisë). Ndërsa qasja që i jep përparësi agjencisë është ajo e Kohezionit të elitave dhe e Thurjes ideologjike.

Roli i sistemit elektoral mbi Partinë Demokratike

Ka pasur një prirje deri më tani për ta parë sistemin dypartiak në Shqipëri si produkt të sistemit elektoral me prirje mazhoritare (Kajsiu, 2004, f.18-21; Çili, 2002, f.9-10) i cili sipas ligjit të Duverger-it çon në dypartizëm dhe minon krijimin e një udhëheqjeje alternative brenda partisë (Duverger, 1954, f.207-22). E megjithatë në një vijë me Sartorin (1966, f.175) mund të thuhet se një sistem dypartiak vështirë se mund të imponohet nga lart vetëm me ndihmën e sistemit elektoral. Ka një sërë faktorësh që tregojnë se sistemi më shumë sesa formësues i partive politike është formësuar prej tyre në përpjekje për të maksimizuar sa më shumë përfitimet elektorale. Sistemi elektoral në Shqipëri ka ndryshuar disa herë, madje vështirë të gjenden dy palë zgjedhje rresht që të jenë organizuar me të njëjtin sistem. Në vitin 1991 sistemi ishte mazhoritar (Krasniqi, 2008, f.31). Në vitin 1992 sistemi ishte një miks i mazhoritarit me dy raunde me proporcional korrigjues (Edgeworth and Soares, 1992, f.39). Ndërsa në vitin 1996 dhe 1997 sistemi ishte një miks i mazhoritarit me dy raunde me proporcional, por kësaj radhe pa aspektin korrigjues të proporcionalit (De Gregorio et.al, 1996, 4; Kaplan dhe Knapp, 1997, f.30). Sistemi ndryshoi sërish në 2001-in dhe 2005-ën. Ishte rishtas një miks i mazhoritarit me proporcional, por në vitin 2001 ai mbeti mazhoritar me dy raunde duke rimarrë aspektin korrigjues të proporcionalit dhe në vitin 2005 sistemi u bë më i thjeshtë duke e kthyer mazhoritarin vetëm me një raund (OSCE, 2001, 4; OSCE, 2005, 4). Së fundmi, sistemi ndryshoi rishtas në vitin 2009, në proporcional rajonal (OSCE, 2009, 6). Siç mund të vërehet sistemi ka qenë subjekt i ndryshimeve të njëpasnjëshme, andaj edhe mund të thuhet se më shumë sesa një konturues i sistemit partiak ai u konturua nga partitë politike.

Studimet mbi sistemin elektoral në Shqipëri e kanë neglizhuar aspektin e dy raundeve në mazhoritar në zgjedhjet e viteve 1992, 1996, 1997 dhe 2001. Sartori komenton se sistemi me dy raunde i jep mundësi votuesit të votojë lirshëm për preferencën e tij/saj në raundin e parë dhe në këtë mënyrë të angazhohet në një “votim të sinqertë” pa u influencuar nga faktorët psikologjikë të përshkruar nga Duverger-i (Duverger, 1954, f.224, 226; Sartori, 2001, f.98-99). Prej kësaj rrjedh se gjasat, që një parti e tretë të identifikohet dhe të fitojë terren në një sistem mazhoritar me dy raunde, janë të mëdha. E megjithatë, në Shqipëri sistemi nuk arriti të prodhojë një parti të tretë, e cila u shfaq vetëm në vitin 2005, pikërisht kur sistemi nuk zhvillohej me dy raunde dhe ku teorikisht do të ishte e pamundur dalja e saj.

Rregullat zgjedhore, gjithashtu, janë përdorur nga partitë politike për të maksimizuar përfitimet e tyre. Është i njohur tashmë fenomeni i Dushkut, në vitin 2001, ku Partia Socialiste i instrukttoi mbështetësit e saj që të votonin për Partinë e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut, Partinë Aleanca Demokratike dhe për Partinë Agrare, në raundin e dytë të zgjedhjeve në fshatin Dushk ku zgjedhjet, për shkak të parregullsisë, u shtynë dy javë. Tashmë, proporcionali korrigjues nuk do t'i jepte asnjë vend Partisë Socialiste për shkak të përqindjes së lartë të deputetëve që kishte siguruar prej mazhoritarit, andaj edhe simpatizantët e partisë votuan për partitë aleate duke iu bërë atyre të mundur që jo vetëm të futeshin në Parlament, por edhe të merrnin një numër të konsiderueshëm deputetësh (ODHIR, 2001, f.16-17). E njëjta strategji, por në një shkallë më të lartë, u përdor në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2005, ku të dyja partitë instruktuan simpatizantët dhe militantët e tyre të votonin për aleatët në proporcional. Kështu ndërsa PD-ja arriti të fitonte 56 mandate nga mazhoritari, ose 40% të numrit të përgjithshëm të vendeve në Parlament, dhe PS-ja mori 42 mandate, ose 30% të vendeve dhe në proporcional ato fituan respektivisht nga 7.67% dhe 8.89%. Asnjëra prej partive nuk fitoi vende shtesë nga proporcionali, vende këto që u ndanë nga partitë e koalicionit (ODIHR, 2005, f.30). Si rezultat i votimit taktik në Parlament arritën të futen 12 parti politike (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 2005) megjithëse sistemi elektoral ishte kryesisht mazhoritar.

Situata shfaqet e ndryshme në vitin 2009. Sistemi elektoral me të cilin u zhvilluan zgjedhjet e vitit 2009 ishte proporcional rajonal e megjithatë numri i partive në Parlament u reduktua nga 12 parti në vitin 2005 në gjashtë parti në vitin 2009. Duke krahasuar rezultatet e vitit 2009 me ato të vitit 2001 dhe ato të 2005-ës del se dy partitë e mëdha politike (Partia Demokratike dhe Partia Socialiste) morën më shumë vende në vitin 2009 sesa në vitet pararendëse. Kështu në vitin 2001, Partia Demokratike dhe Partia Socialiste morën së bashku përkatësisht 119 dhe në 2005-ën morën 98 vende në Parlament, ndërsa në vitin 2009 ato morën së bashku 133 vende (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 2001, 2005, 2009). Pra, përkundër asaj çka teoria parashikon, sistemi proporcional rriti peshën e partive të mëdha dhe uli atë të partive të vogla. I shumëlëvduari sistem proporcional, jo domosdoshmërisht rezultoi në një sistem multipartiak, sepse në praktikë zbatohen strategji të ndryshme për të ulur proporcionalitetin e tij. Sipas Sartor-it, sa më e vogël të jetë zona zgjedhore, aq më i vogël është proporcionaliteti dhe sa më i madh të jetë pragu elektoral aq më i vogël është proporcionaliteti. Për më tepër sistemi proporcional eliminon gjithashtu partitë e vogla, që nuk kanë elektorat të përqendruar në një, ose në disa zona, por e kanë të shpërndarë në të gjithë vendin, aq sa shpërndarja të ndikojë në mosarritjen e pragut natyror elektoral (2001, p. 93- 94).

Pra sistemi elektoral *per se* nuk e influencon sistemin partiak. Partitë politike dizenuan kufijtë e zonave zgjedhore, numrin e mandateve për zonë zgjedhore,

pragun elektoral, numrin e vendeve në Parlament dhe formulën elektorale. Andaj mund të thuhet se sistemi elektoral në vetvete nuk mund të shpjegojë suksesin e Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Aplikimi i Qasjes Historiko – Strukturore mbi Partinë Demokratike

Shpjegimet historiko – strukturore i japin rëndësi të shkuarës dhe e shikojnë atë si një determinant të eventeve postkomuniste. Teoria e trashëgimisë komuniste argumenton se natyra e regjimit ekzistues, para atij komunist, ushtron faktor shtrengues në procesin e tranzicionit të vendeve postkomuniste. Vendet ish-komuniste janë të karakterizuara nga diversiteti për sa i përket zhvillimit të demokracisë dhe formimit të sistemit partiak. Shkaku i këtij diversiteti qëndron në trashëgimitë e ndryshme historike të këtyre vendeve (Kitschelt, 1999, f.19; 2001, f.299, 307).

Trashëgimia komuniste është fajësuar shpesh për problemet që demokracia e re shqiptare ka hasur në vitet e postkomunizmit. Ajo ka zënë një vend tepër të rëndësishëm në diskurin shqiptar (Biberaj, 1995;1998; Krasniqi 2009). Po kështu, të gjitha raportet e OSCE/ODIHR kanë nga një seksion dedikuar trashëgimisë komuniste në Shqipëri. Sipas Kitschelt et.al. Shqipëria i përket llojit të komunizmit patrimonial, që u shfaq në shoqëritë që nuk e kishin përjetuar modernizmin në periudhën midis dy luftërave (1999, f.24, 42). Për shkak të mungesës së modernizmit në periudhën parakomuniste, represionit të madh, korrupsionit dhe mungesës së disidencës gjatë regjimit komunist, partitë postkomuniste “nuk kishin se ç’të ndërtonin përveçse retorikës antikomuniste” dhe “e patën të vështirë të thurnin programe efektive për liberalizimin e tregjeve, dhe ca më pak t’i zbatonin ato” (Kitschelt et.al, 1999, f.74, 75). E megjithatë, sipas raportit të Freedom House, qeveria e Partisë Demokratike në Shqipëri “ndërmori reforma radikale, dhe shkalla e privatizimit të Shqipërisë dhe e progresit të Shqipërisë drejt ekonomisë së tregut ishte më e lartë se ajo e fqinjëve të saj” (2006, 5). Gjatë periudhës 1992-1996 sektori privat u rrit shumë. Shqipëria u konsiderua si një rast suksesi për sa i përket reformave të liberalizimit. Sipas Clunies-Ross dhe Petar Sudar-it “Shqipëria përjetoi një rritje me të njëjtën shpejtësi si ajo e vendeve të Azisë Lindore për katër vjet. Avokatët e terapisë së shokut mund të përdornin bindshëm rastin e Shqipërisë për të mbështetur terapinë e shokut si recetën më të mirë për të realizuar tranzicionin në tregun e lirë” (në Kajsiu, 2010, f.239). Pra Partia Demokratike e Shqipërisë ndërmori reforma liberale të cilat ishin aq masive dhe me pasojë në infrastrukturën ekonomike saqë afektuan interesat e grupeve të ndryshme në shoqëri duke ndikuar madje edhe në erozionin e mbështetjes së masave për partinë (Biberaj, 1998, f. 296-297).

Gjithmonë në vazhdim të tezës së Kitschelt et.al, është imperative të analizohet edhe koncepti i retorikës antikomuniste. Nga analizimi i të dhënave del se retorika antikomuniste e Partisë Demokratike ka kaluar në dy faza. Faza e parë përfshin periudhën 1991-1993, ndërsa faza e dytë përfshin periudhën 1993-2005, fazë që do të diskutohet në pjesën mbi ideologjinë. Gjatë fazës së parë retorika antikomuniste u fokusua në koncepte të tilla si të drejtat e njeriut, individualizmi, tregu i lirë, sipërmarrja dhe liberalizimi. Për pasojë retorika antikomuniste është më tepër një përplasje me ideologjinë komuniste, me principet e saj sipas të cilave shteti kontrollonte gjithçka, ndalonte iniciativën e lirë, lirinë e shprehjes dhe të mendimit. Më 6 shkurt të 1991-it, një prej themeluesve të Partisë Demokratike shkroi në gazetën *Rilindja Demokratike* artikullin me titull “Platforma Elektorale e Partisë Demokratike dhe disa alternative për transformimin e vendit”. Artikulli promovonte të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes, të drejtën për pronë dhe sipërmarrje (f.1,5). Në një vështrim të gazetave të këtij viti mund të shihet se natyra e artikujve të botuar në faqet e gazetës *Rilindja Demokratike* është e ngjashme me të sipërpërmendurën. Disa nga këta artikuj janë “Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut” (RD, 1991, f.6), “Privatizimi i tokës bujqësore, një nevojë reale që duhet adresuar” (Gjermani, 1991, 5), “Socializmi i Decentralizuar dhe Privatizimi” (Pashko, 1991, f.5,6), “Dështimi i kooperativave socialiste” (Ruli, 1991, f.3), “Terapia e Shokut” (RD, 1991, f.5) etj. Për pasojë, diskuri antikomunist u bazua mbi vlera ideologjike dhe si i tillë nuk ishte aspak bosh, ose thjesht retorikë. Ky diskur shërbeu për të hedhur koncepte të reja në hapësirën shqiptare, koncepte që kishin munguar gjatë periudhës së komunizmit. Pra, si reformat në ekonomi, ashtu edhe retorika në vija ideologjike ndodhën përkundër asaj çka Kitschelt et.al argumenton, pikërisht pas rënies së komunizmit.

Modeli i trashëgimisë komuniste paraqet edhe një sërë problemesh të tjera. Ai është përdorur rëndom për të shpjeguar dështimet e politikës shqiptare postkomuniste, duke injoruar kështu “procesin politik” (Kajsiu, 2010, f.230). Për më tepër kjo qasje nuk tregon megjithatë se “...cilat blloqe do të shfaqen si aktorë të fortë dhe të qëndrueshëm në sistemin politik kombëtar” dhe nuk merr parasysh mjedisin e jashtëm, kufizimet dhe kushtëzimet që aktorë ndërkombëtarë si BE-ja, FMN-ja, ose Banka Botërore ushtrojnë mbi vendimet dhe veprimtarinë e partive politike (Hanley et.al, 2007, f.24-25).

Aplikimi i Qasjes së Rrugës së Varësisë mbi Partinë Demokratike

Në qasje tjetër, që i jep përparësi strukturës, është ajo e rrugës së varësisë. Sipas Mahoney “...rruga e varësisë ndodh kur një ngjarje historike aktivizon një sekuencë pasuese që ndjek një model relativisht determinist” (2000, f.535). Kjo ngjarje historike influencën rezultatet e ngjarjeve që do të ndodhin në të ardhmen,

sepse ajo "...vë në lëvizje modele institucionale, ose ngjarje-zinxhir që kanë cilësi determinuese" (f.508-509). Koncept intrinsik i teorisë së varësisë është ai i "momentit kritik". Pierson-i argumenton se momentet janë "kritike" sepse ata i vendosin rregullimet institucionale në rrugë dhe në trajektore që më pas janë shumë të vështira për t'u ndryshuar (2004, f.114), sepse institucionet janë entitete afatgjata të karakterizuara nga stabiliteti dhe vështirësia për t'u ndryshuar. Pra vendimet që aktorët marrin në momente kritike kanë ndikim mbi modelet institucionale që pasojnë ngjarjen, por edhe kushtëzojnë zgjedhjet që të tjerë aktorë do të duan të marrin, kushtëzim ky që vazhdon deri në shfaqjen e një tjetër momenti kritik ku modeli institucional ndryshon sërish.

Grzymala-Busse adoptoi teorinë e Rrugës së Varësisë dhe momentit kritik për të shpjeguar mbijetesën dhe suksesin e partive trashëgimtare të partive komuniste (2002, f.2). Por, në rast se e aplikojmë teorinë e Rrugës së Varësisë për të analizuar Partinë Demokratike, atëherë shfaqet një problem. Përkufizimi i konceptit të Rrugës së Varësisë nënkupton ekzistencën e një të shkuare, ndërsa koncepti i momentit kritik nënkupton një thyerje me këtë të shkuar, thyerje kjo që sjell ndryshime radikale (Mahoney, 2000, f.513; Mahoney, 2001, f.112). Ngjarjet që sollën ndryshime radikale në vendet postkomuniste janë pikërisht revolucionet që sollën ndryshimin e regjimit nga ai komunist në atë demokratik, revolucione këto që i përkasin vitit 1989. Pra momenti kritik shfaqet në vitin 1989. Nëse ndjekim të njëjtën logjikë për të analizuar rastin e Shqipërisë ky moment kyç shfaqet në vitin 1990, vit në të cilin ndodhën revoltat që çuan në ndryshimin e regjimit dhe po kështu vit në të cilin u krijua Partia Demokratike Shqiptare, me ç'rast shohim se momenti kritik dhe momenti i krijimit të partisë ndodhën në të njëjtën kohë. Pikërisht këtu qëndron problemi. Origjina dhe momenti kritik nuk mund të ndodhin në të njëjtën kohë. Koncepti i origjinës, për nga përkufizimi, nënkupton se nuk ka një të shkuar. Por, sikurse u përmend edhe më sipër, koncepti i së shkuarës është intrinsik për atë të momentit kritik. Që të ndodh një thyerje, duhet të ekzistojë një e shkuar nga e cila ndodh ndarja, ose shkëputja radikale. Mes kushteve që i paraprijnë momentit kritik dhe vetë atij, ka një distancë kohore. Ndërsa origjina dhe kushti paraprak mund të jenë e njëjta gjë e për pasojë ndajnë të njëjtën hapësirë kohore, ata nuk mund të ndodhin njëkohshëm me momentin kritik. Për pasojë, ndërsa përmbysja e regjimit komunist në vitin 1990 mund të jetë një moment kritik për Shqipërinë, ai nuk mund të jetë si i tillë për Partinë Demokratike, e cila në vitin 1990 nuk kishte një të shkuar me të cilën të bënte një thyerje.

Në një analizë kronologjike të Partisë Demokratike mund të vihet re se ajo ka përjetuar ngritjen, rënien dhe sërish ngritjen. Moment i ngritjes së parë përputhet me atë të origjinës. Ndërsa ai i ngritjes së dytë ndodh në vitin 2005, moment ky në të cilin Partia Demokratike fiton zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. A mund të konsiderohet si kritik ky moment? Nëse i referohemi rishitas konceptualizimit të

"momentit kritik", atëherë viti 2005 mund të konsiderohej si i tillë vetëm nëse do të kishte mekanizma bllokues (lock in mechanisms) që do ta bënin të vështirë, ose të pamundur një kthim prapa në rrugën e përshkruar (Pierson, 2004, f.114). Ndërkaq, i vetmi rregullim institucional në vitin 2005 ishte ai i sistemit elektoral, i cili megjithatë ndryshoi sërish në vitin 2009 dhe për pasojë nuk mund të konsiderohet si një mekanizëm bllokues.

Pra edhe teoria e Rrugës së Varësisë nuk mund ta shpjegojë suksesin e Partisë Demokratike. Mungesa e një të shkuare para 1990-ës dhe mungesa e mekanizmit bllokues e bëjnë të paaplikueshme këtë teori.

Aplikimi i Qasjes së Kohezionit të Elitave dhe Thurjes Ideologjike mbi Partinë Demokratike

Qasja e Kohezionit të Elitave dhe e Thurjes Ideologjike i jep më shumë përparësi agjencisë sesa strukturës. Me kohezion elitash kuptohet "aftësia e një grupi elitash që me kalimin e kohës arrin të ruajë konsensusin në lidhje me çështjet kyçe të strategjisë dhe politikave" (Hanley et.al, 2008, 425). Në analizën e tyre për Hungarinë, Republikën Çeke dhe Poloninë, ata mbikëqyrën pozicionimin e elitave të suksesshme të qendrës së djathtë si "elita të besueshme të rangut dytësor, që sfiduan elitat opozitare të cilat fillimisht e morën pushtetin pas vitit 1989 kur uniteti i grupeve të gjera opozitare u thye në fillim të viteve 1990" (2008, f.426, 427).

Aplikimi i kësaj teorie në rastin e Shqipërisë kërkon fillimisht identifikimin e elitave, vlerësimin e kohezionit të tyre dhe më pas identifikimin e elitave të besueshme, dhe sfidues të rangut të dytë. Gjatë jetës së saj Partia Demokratike ka përjetuar një sërë krizash dhe përçarjesh të brendshme të cilat u shfaqën edhe më parë sesa ajo të merrte pushtetin në vitin 1992. Komiteti Drejtues fillestar, në shkurt të vitit 1991, kishte 12 anëtarë, ndërsa në vitin 1996 vetëm 3 prej tyre vazhdonin të ishin në radhët e Partisë Demokratike (Biberaj, 1998, f.220, 275, 423; RD, 1991). Ata ishin Sali Berisha, Aleksandër Mexhi dhe Azem Hajdari, i cili para se të vdiste në mënyrë të mistershme në shtator të vitit 1998, ishte përjashtuar nga grupi parlamentar i Partisë Demokratike. Megjithëse një pjesë e të përjashtuarve, ose e të larguarve krijuan parti politike të reja si Aleanca Demokratike ose Partia Demokratike e Re, ata nuk arritën të formonin atë çka Hanley et. al, i konsiderojnë si elita të rangut të dytë që sfiduan elitat fillestare opozitare. Kur Neritan Ceka, Gramoz Pashko, Preç Zogaj dhe Arben Imami u përjashtuan nga partia në gusht të 1992-it, ata krijuan Partinë Aleanca Demokratike e cila nuk arriti asnjëherë ta fragmentizonte votën e djathtë. Partia qëndroi në pushtet dhe arriti të siguronte vende në Parlament kryesisht në sajë të marrëveshjeve me Partinë Socialiste sesa në sajë të mbështetjes elektorale të djathtë. Një tjetër përjashtim ishte ai i Genc Rulit

nga Partia Demokratike në 1996-ën. Ai më vonë iu bashkëngjiti Partisë Demokratike të Re. E megjithatë ai nuk fitoi në zgjedhjet e vitit 2001, që ishin zgjedhjet e para në të cilat kjo parti merrte pjesë. Po kështu, kur Gramoz Pashko (një ndër figurat themeltare të Partisë Demokratike) u rikthye në Partinë Demokratike, nuk arriti të fitonte në zgjedhjet e vitit 2005. Neritan Ceka gjithashtu nuk arrinte të fitonte në votimin në mazhoritar dhe hyrjen në Parlament e ka siguruar gjithmonë në sajë të votave në proporcional. Kjo tregon se përçarja e elitave nuk e fragmentizonte votën e djathtë siç kishte ndodhur në Poloni, në Hungari dhe në Sllovaki. Kryetari i Partisë Demokratike dhe drejtuesi i koalicionit të djathtë sot, vazhdon të mbetet Sali Berisha, dhe promovimi i elitave është bërë gjithmonë përmes karrierës brenda partisë dhe jo jashtë saj. Kështu që mund të konkludohet se teoria e Kohezionit të Elitave nuk arrin të shpjegojë suksesin e Partisë Demokratike.

Ndërkaq duket se aftësia për të thurur programe ideologjike integruese ka qenë përcaktuese në suksesin ose jo të Partisë Demokratike. Sipas Hanley et.al, "Ideologjitë luajnë një rol kyç në formësimin e aksionit politik, duke i dhënë kohezion dhe identitet organizimeve politike dhe duke socializuar elitat e ardhshme" (2008, f.427). Një parti me diskur ideologjik integrues është në gjendje të kthehet në një "sipërmarrëse ideologjike" e aftë të "zhvillojë një narrative ideologjike integruese që mund të ofrojë baza të qëndrueshme për të zhvilluar një formacion politik të gjerë dhe të qëndrueshëm" (2008, f.427).

Në një analizim të diskurit të Partisë Demokratike mund të vihen re tri faza të ndryshme. Kur diskuri i Partisë Demokratike ka qenë integrues, partia ka qenë e suksesshme, ndërsa kur ky diskur ka qenë përjashtues partia nuk ka performuar suksesshëm.

Faza e parë i përket periudhës 1990 – 1992. Kjo periudhë i korrespondon ngjarjeve të themelimit të partisë dhe fitores së zgjedhjeve të vitit 1992. Në këtë periudhë, diskuri i Partisë Demokratike karakterizohet nga një filozofi gjithë-përfshirëse. Slogane të tilla si "E duam Shqipërinë si gjithë Europa" (Rilindja Demokratike, 1991, f.4), "Të gjithë vuajtës – të gjithë bashkëfajtorë" ose "Opozitar por vëllezër" (Sali Berisha, 1996, f.8) formësuan strategjinë elektorale të Partisë Demokratike, strategji e cila çoi në fitoren e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të vitit 1992. Më 16 mars të 1991-it, vetëm pak ditë përpara zgjedhjeve të 31 marsit, një prej liderëve të Partisë Demokratike, Pjetër Arbnori, shkroi në gazetën "Rilindja Demokratike" artikullin me titull "A do të votojnë komunistët për Partinë Demokratike?" Autori e mbyllte artikullin e tij duke komentuar se pjesa më e madhe e komunistëve ishin njerëz të ndershëm, të mashtruar nga regjimi komunist dhe që do ta hidhnin votën e tyre për Partinë Demokratike. Përmes diskurit të saj politik, Partia Demokratike mëtonte të përfaqësonte të gjithë popullin, pavarësisht kategorive të ndryshme sociale që e përbënin atë dhe që po formoheshin me shpejtësi.

Faza e dytë i korrespondon periudhës 1993-2005. Kjo periudhë u karakterizua nga diskuri antikomunist me natyrë dikotomike. Partia Socialiste u identifikua

si armiku që ndahej nga Partia Demokratike prej një hendeku të thellë dhe të pakapërcyeshëm. Kështu në fjalimin e mbajtur me rastin e 5-vjetorit të Partisë Demokratike, Presidenti i vendit dhe ish-kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, duke iu referuar Partisë Socialiste, komentoi se fitorja e Partisë Demokratike ishte "fitorja e Davidit kundër Goliathit" (1996, f.6). Gjatë periudhës 1993-2003, me përjashtim të zgjedhjeve lokale të vitit 1996 të cilat nuk u kontestuan dhe u fituan nga Partia Demokratike, ajo humbi në të gjitha zgjedhjet pas 1997-ës, andaj edhe kjo periudhë nuk mund të konsiderohet si e suksesshme për të. Kjo periudhë i korrespondon pikërisht atij diskuri i cili e projektonte armikun të Partia Socialiste. Ky lloj diskuri ishte bosh sepse në vend që të përfaqësonte kategoritë e ndryshme sociale, që përbënin popullin, ai e quajti popullin si një të tërë kundër komunizmit të mishëruar - sipas Partisë Demokratike - të Partia Socialiste.

Ndryshimi i madh ndodhi në vitin 2005, kur Partia Demokratike fitoi zgjedhjet parlamentare të vitit 2005. Është e qartë që ciklet elektorale kanë luajtur rolin e tyre në këtë fitore. Megjithatë, edhe ndryshimi në diskur i Partisë Demokratike ndihmoi në këtë fitore të saj. Partia Demokratike arriti të tërhiqte profesionistë të cilët i ofruan partisë fizionomi të re dhe risollën ideologjinë në diskur. Ajo krijoi Komitetin për Orientimin e Politikave (KOP) i cili hartoi platformën politike të partisë. Komiteti pasoi Kolokiumin Liberal që u mbajt në shkurt të 2005-ës, vetëm pak muaj para zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare. Tematika e Kolokiumit ishte: "Teza për një Qeverisje të Djathtë Liberale". Aktiviteti u organizua nga një grup liberalësh pa përkatësi partiake, ku megjithatë u ftua edhe kryetari i Partisë Demokratike. Pothuaj të gjithë ata që ishin të pranishëm në aktivitet u ftuan më vonë nga Partia Demokratike për të formuar Komitetin e Orientimit të Politikave. Kështu, mbas shumë vitesh, më në fund Partia Demokratike kishte një program i cili ishte më shumë i orientuar drejt të ardhmes sesa drejt "armikut". Në 5-vjetorin e Partisë Demokratike në vitin 1995, Sali Berisha foli për Partinë Demokratike sikur ajo të ishte një projekt mesianik: "Partia Demokratike u themelua si kërkesë imperative e mendimit përparimtar shqiptar, ideve të mëdha të Bogdanit e Budit dhe Rilindësve tanë që kishin përcaktuar në Perëndim vendin e Shqipërisë, e mendimit kundërshtar shqiptar ndaj absolutizmit e monizmit absolut të qindra dhe mijëra intelektualëve, punëtorëve dhe fshatarëve shqiptarë që për fjalën e lirë, për Zotin e madh, për Krishtin mbret, për dinjitetin e tyre dhe Shqipërinë e lirë u martirizuan për së gjalli" (Sali Berisha, 1996, f.6-7). Ndërkaq në vitin 2005, në Kolokiumin Liberal, Sali Berisha përfshiu në diskurin e tij koncepte të tilla liberale si "shteti i vogël", "liberalizim çmimesh", "privatizim", "zgjidhje të çështjes së pronësisë", "liberalizim të tregut të punës" dhe "zvogëlim të administratës shtetërore" (2005:19-20).

Pra aftësia për të thurur një ideologji integruese ishte kyçe në suksesin e Partisë Demokratike. Vetëm kur arriti të hartojë një platformë të qartë politike, të mbështetur në ideologji, Partia Demokratike ia doli të sigurojë sukses elektorale.

Suksesi i Partisë Demokratike në kuadër të organizimit të Partisë

Ideologjia integruese ndonëse shpjegon suksesin, ose mossuksesin e Partisë Demokratike, nuk është megjithatë e aftë të japë një shpjegim të plotë për të. Është teza ime se organizimi i partisë si parti masash (Kajsiu, 2005, f.143; Democracy International, 2006, f.19) ndikon në suksesin e saj elektoral.

Qëllimi i një partie politike është të maksimizojë anëtarësinë dhe të depërtojë thellë në shoqëri dhe Partia Demokratike nuk bën përjashtim. Gjithmonë, në momente vështirësie, partia i është kthyer anëtarësisë për të maksimizuar mbështetjen prej saj. Në 5-vjetorin e Partisë Demokratike u artikulua shumë qartë se duhet të kishte një “kthim në bazë” (12 Dhjetor 1995) dhe kjo kishte për qëllim të tregonte sesa e rëndësishme ishte anëtarësia për partinë. Në këtë periudhë u bënë përpjekje të konsiderueshme për të rritur anëtarësinë në të gjithë vendin. Në dhjetor të 1995-ës ajo kishte 2407 seksione në të gjitha rrethet e vendit. Në fund të vitit 1995 ajo ishte kthyer në qëllim në vetvete. Kështu në 5-vjetorin e partisë, sekretari organizativ deklaroi se “Konsolidimi i strukturës së partisë ishte aktiviteti organizativ më i rëndësishëm i Partisë Demokratike” (Fletore Politike 3, 1995, f.26). “Strategjia për të fituar zgjedhjet parlamentare konsistonte në rigjenerimin e partisë dhe në depërtimin e saj në shoqëri” (Fletore Politike 3, 1995, f.24-34). “Që në fillimet e saj degët dhe nëndegët e partisë u vendosën afër qendrave të votimit dhe distrikteve zgjedhore në mënyrë që ajo të ishte në gjendje ta dizenjonte strategjinë në bazë të distrikteve zgjedhore për të arritur rezultate më të mira”. (Kajsiu, 2005, f.143)

Megjithatë ajo ç’ka u tha më sipër flet për fillimet e Partisë Demokratike. Mund të mendohet se trashëgimia komuniste, si e vetmja përvojë në organizimin e një partie politike ka ndikuar për këtë. Po kështu ndikim mund të ketë pasur edhe mungesa e një teknologjie moderne të masmedias që ndërkohë në Perëndim kishte ristrukturuar tërësisht organizimin dhe komunikimin politik të partive politike (Panebianco, 1988). Natyrshëm mund të lind pyetja nëse Partia Demokratike vazhdoi ta ruante karakterin e partisë së masave edhe në vitet e mëvonshme, ku përvoja komuniste kishte filluar të distancohej në kohë dhe masmedia fitoi të njëjtat tipare si edhe në Perëndim. Për të kuptuar këtë është e rëndësishme t’i kthehemi zgjedhjeve të vitit 2005 ku Partia Demokratike përdori votimin strategjik për të fituar zgjedhjet. Kur Partia Demokratike i bëri thirrje elektoratit për të votuar në proporcional për partitë në koalicion me të, thirrja rezultoi se ishte e suksesshme. Si rezultat i votimit strategjik, Partia Demokratike arriti të fitonte zgjedhjet. Megjithatë kyçi i suksesit nuk qëndron thjesht te strategjia e përdorur. Strategjia do të duhej të vihej në zbatim që të funksiononte. Në realitet anëtarët e partisë, të organizuar në degë dhe në nëndegë, arritën të depërtonin në të gjithë vendin për të përçarur dhe për të sqaruar votimin strategjik. Ishin anëtarët e partisë ata që bënë të mundur zbatimin e suksesshëm të skemës. Kështu që mund të konkludojmë se

anëtarët e partisë dhe aftësia e saj për të hartuar një platformë ideologjike politike, kontribuan në suksesin e partisë.

Është ndoshta me vend të eksplorohej arsytet e shfaqjes së partisë së masave në Shqipëri. Ka një sërë autorësh që argumentojnë se partisë së masave tashmë i ka kaluar koha, është *passé* dhe modele të tjera si partia “catch-all”, profesional-elektorale ose kartel mund të jenë më të përshtatshme në demokracitë e reja (Lewis, 1996, f.10; Van Biezen, 2003, f.218-219).

Megjithatë, mendoj se teza e Van Biezen dhe Lewis nuk mund të aplikohet në rastin e Shqipërisë. Sipas Duverger-it, shfaqja e partisë së masave është e lidhur me votën universale (1954, p. 65). Vota universale bëri të mundur futjen e masave në sferën politike, e drejtë që deri në atë moment u ishte mohuar. Me kolapsin e komunizmit dhe me ardhjen e demokracisë, njerëzit përjetuan të njëjtin fenomen: të drejtën për të votuar. Është e vërtetë se gjatë sistemit komunist, qytetarët kishin të drejtë të votonin, por ajo nuk ishte një votë e lirë. Votimi dhe rezultati i tij ishte i komanduar nga Partia (e Punës) dhe për pasojë votimi ishte zbratur prej kuptimit të tij. Me kolapsin e komunizmit, procesi i votimit mori kuptim. Votimi tashmë mund të kishte ndikimin mbi sferën politike. Ka megjithatë një ndryshim me modelin e Duverger-it. Sipas Duverger-it, partia e masave përfaqëson klasën punëtore dhe i përket krahut të majtë të spektrit politik (1954, f.67). Në rastin e Shqipërisë, masat u karakterizuan nga heterogjeniteti dhe klasa punëtore, e cila historikisht në Perëndim ka qenë kontingjent i partive të majta, në rastin e Shqipërisë, u bë kontingjent i një partie të djathtë, i Partisë Demokratike.

Sipas modelit gjenetik dhe të institucionalizimit të Panebianco, krijimi dhe zhvillimi i një partie është në varësi të depërtimit territorial, *territorial penetration* dhe në varësi të shpërndarjes territoriale, *territorial diffusion* (1988, 49-51). Në rastin e parë, partia në qendër ka një depërtim territorial, të cilin e siguron përmes organizimit të degëve lokale. Ndërsa në rastin e dytë, partia që lind në periferi tenton të integrohet në një organizim kombëtar. Sipas Panebianco-s, “Zhvillimi përmes depërtimit prodhon institucione të forta, ndërsa zhvillimi përmes shpërndarjes tenton të prodhojë institucione të dobëta” (1988, f.63). Partia Demokratike e Shqipërisë i përket grupit të parë. Ajo u krijua në qendër dhe më pas ia doli të depërtonte në të gjithë territorin. Procesi u lehtësua në sajë të mobilizimit të masave për të hedhur poshtë regjimin komunist. Masat e mobilizuara u integruan te Partia Demokratike, me të cilën ndanin të njëjtin synim. Mbetet megjithatë, për të eksploruar sesi arriti Partia Demokratike të ruante besnikërinë e elektoratit të saj. Me përjashtim të zgjedhjeve të vitit 2001, ku Partia Demokratike e Re mori 5.3% të votave të përgjithshme, duke fragmentizuar kështu elektoratin e djathtë, Partia Demokratike ka pasur gjithmonë një elektorat besnik dhe të pafragmentizuar (Xhaferaj, 2010, f.16-19).

Ka një tezë që argumenton se besnikëria e elektoratit të djathtë është ruajtur përmes patronazhit dhe lidhjeve klienteliste që Partia Demokratike ka ndërtuar

me mbështetësit e saj (Kajsiu, 2008, f.53-54). Patronazhi dhe klientelizmi janë të vështira për t'u vërtetuar. Për ekzistencën e tyre mund të flitet, por dokumentimi është i vështirë. E megjithatë ka dokumente dhe strategji të Partisë Demokratike që në mos e provojnë të paktën sugjerojnë se gjasat që patronazhi dhe klientelizmi të ekzistojnë janë të mëdha. Në një material për shtypin, përgatitur nga anëtarët e Presidencës së Partisë Demokratike më 27 mars 1995, kemi një udhëzim sipas të cilit qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike duhet të mbështesë shtypin proqeveritar me kredi të lehta, zyra pune dhe shtëpi për punonjësit (1995, f.3-4). Materiali për Shtypin është një dokument i brendshëm i Partisë Demokratike që tregon sesi partia dhe qeveria ishin një dhe sesi kjo e fundit ishte vënë në shërbim të partisë. Kjo mund të vihet re edhe në zgjedhjet e vitit 1996. Partia Demokratike, asokohe në pushtet përdori qeverinë qendrore dhe vendore për të organizuar fushatën paraelektorale dhe atë elektorale (Fletore Politike 3, 1995, f.28, 34), duke mjegulluar kështu kufijtë mes partisë dhe shtetit. Në fakt, emërimet politike në administratën publike ishin të dukshme gjatë periudhës 1992-1996. Sipas Human Rights watch, 60% e personelit të gjyqësorit u zëvendësua me akuzën për korrupsion, por sërish sipas Human Rights Watch ishte e vështirë të përcaktohej sesa vetë u zëvendësuan për motive politike (1996, f.16). Situata u përsërit kur Partia Demokratike erdhi në pushtet në vitin 2005. Punonjësve në administratën shtetërore u ndërpritej kontrata në mënyrë arbitrare dhe emërimet e reja ishin me natyrë politike. Ka një seri raportesh nga organizatat ndërkombëtare, të cilat kanë vërejtur si shqetësues faktin e emërimeve politike në administratën shtetërore (Freedom House, 2006, f.6-7; Commission of the European Communities, 2007, f.8; 2009, f.9; EU Enlargement, 2006, rreshti 15). Vetëm gjatë periudhës 2005-2007, 27.8% e Administratës Publike ishin emërimet të reja (Kajsiu, 2008, f.52). Pra me të ardhur në pushtet, Partia Demokratike zbatoi një sistem shpërblimi për mbështetësit e saj, duke iu ofruar atyre punë në administratën shtetërore. Sipas Kajsiut, politika e patronazhit është e vetmja rrugë përmes së cilës partitë mund të mobilizojnë mbështetësit dhe të sigurojnë besnikërinë e tyre (2008, f.52). Kur partia e masave u shfaq fillimisht, ajo premtonte incentiva për mbështetësit e saj në mënyrë të tërthortë. Mbështetësit e saj vinin nga klasa punëtore dhe si të tillë interesat e tyre pasqyroheshin në programin politik të partisë. Ndërkaq natyra e partisë së masave ka ndryshuar në varësi të kontekstit social në të cilin shfaqet. Tashmë nuk kemi ndarje të qarta klasore. Grupet që formojnë shoqërinë janë të ndryshme dhe partia e sotme është në të njëjtën kohë edhe "catch-all". Ajo kërkon të kapë sa më shumë grupe të shoqërisë, qofshin këto edhe me interesa kundërshtues. Për pasojë, mbështetësit ndihmohen jo përmes programit politik, por në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes afrimit të posteve të punës dhe nëpërmjet favoreve të ndryshme.

Pra mund të thuhet se struktura dhe mënyra e organizimit është e rëndësishme në suksesin, ose dështimin e një partie. Të qenit një parti masash ka ndikuar që

Partia Demokratike të depërtojë thellë në shoqëri dhe të ketë kontakte të shumta me elektoratin, besnikërinë e të cilit e siguron përmes patronazhit dhe klientelizmit.

Përfundime

Nisa ta shkruaj këtë punim me qëllimin për të shpjeguar suksesin e Partisë Demokratike të Shqipërisë. Studimi filloi me presupozimin që Partia Demokratike është një parti e suksesshme, presupozim ky i bazuar mbi dy parametra: kohëzgjatja, ose jetëgjatësia e partisë dhe shtrirja e saj në elektoratin e djathtë. Edhe sot mbas 20 vitesh të themelimit të saj, Partia Demokratike vazhdon ende të jetë forca kryesore e spektrit të djathtë dhe të marrë pjesën më të madhe të elektoratit të djathtë duke e çuar nivelin e fragmentizimit të së djathtës në zero.

Kuadri teorik u mbështet në modelet e strukturës dhe të organizimit të partive politike si edhe mbi teoritë që mëtojnë të shpjegojnë transformimin e tyre. Ai është mbështetur gjithashtu edhe mbi teoritë ekzistuese që tentojnë të shpjegojnë suksesin, ose dështimin e partive politike të Europës Qendrore dhe Lindore. Aplikimi i modeleve që studiojnë dhe shpjegojnë strukturën dhe organizimin e partisë në Europën Perëndimore riskonte të limitizonte kuptueshmërinë e proceseve që çuan në zhvillimin aktual të partive politike në demokracitë e reja. E megjithatë modelet janë të vetmit "konstrukcione teorike që kemi për të analizuar organizimin e partisë, dhe do të ishte e padëshirueshme t'i mohonim tërësisht ato" (van Biezen, 2003, f.7). Katz-i dhe Mair-i vërejnë gjithashtu se "zhvillimi i partive në demokracitë perëndimore ka reflektuar një proces dialektik sipas të cilit çdo tip i ri partie gjeneron një reaksion që stimulon zhvillime të mëtejshme, duke çuar kështu në formimin e një tipi të ri partie" (1995, f.6). Kjo do të thotë se nuk ka vetëm një model, por janë disa modele të tilla dhe secili, ose dhe një kombinim i tyre mund të shpjegojë strukturën dhe funksionimin e Partisë Demokratike. Për pasojë studimi ka bërë një rrugëtim nëpër shkallët kryesore të mendimit, të cilat janë marrë me studimin e partive politike në Europën Perëndimore, në demokracitë e reja në Europën Juglindore si edhe në demokracitë postkomuniste të Europës Qendrore dhe Lindore.

Qasjet e marra në shqyrtim janë ato makro-institucionale, historiko-strukturore dhe ajo e kohezionit të elitave dhe thurjes ideologjike. Ka një tension të brendshëm mes këtyre qasjeve, tension që ushtrohet mes strukturës dhe agjencisë. A është Partia Demokratike produkt i historisë dhe institucioneve, ose ajo vetë është aktor në këtë histori dhe formësuere e institucioneve.

Qasjet me prirje drejt strukturës ofrojnë shpjegime limitizuese. Ato nuk marrin parasysh rolin që luajnë aktorët politikë në formimin e institucioneve, sepse institucionet mund t'i formojnë aktorët politikë po aq sa ç'mund të formohen prej tyre. Po kështu qasja e trashëgimisë komuniste nuk arrin të shpjegojë qasjen

tërësisht liberale që pati Partia Demokratike si në diskur, ashtu edhe në ekonomi, qasje që sipas Kitschelt et.al, do të ishte e pamundur për një parti të dalë nga një shtet që i përket komunizmit patrimonial. Rruga e varësisë gjithashtu dështon kur duhet të tregojë se cilat janë momentet kritike dhe mekanizmat bllokues që ndikojnë në trajektoren që ka ndjekur Partia Demokratike. Po kështu, edhe kohezioni i elitave nuk ofron ndonjë kuadër shpjegues për suksesin e Partisë Demokratike. Pavarësisht se partia ka pësuar fraksionime të shumta, elektorati i saj ka mbetur besnik i asaj që mund të quhet partia mëmë dhe nuk ka rrjedhje për në partitë e reja të djathta, që u krijuan si pasojë e këtyre fraksionimeve.

Ajo çka përbën edhe konkluzionin e punimit është pikërisht aftësia e Partisë Demokratike për të thurur ideologji integruese në të cilën ka bazuar programin e saj politik, të kristalizuar rreth linjave ideologjike si edhe organizimi i saj si parti masash, që e ruan besnikërinë ndaj simpatizantëve, anëtarësisë dhe militantëve përmes lidhjeve të patronazhit: këto janë dy faktorët që e kanë çuar në suksesin e saj.

Bibliografia

- Arbnori, Pjetër (1991) "A ka ndonjë komunist që do të votojë për PD?" "Will communists vote for the Democratic Party?", Rilindja Demokratike (Democratic Renaissance), No.21, pp.1.
- Berisha, Sali (2006) "Partia Demokratike, Parti e të ardhmes së Shqiptareve, Fletore Politike 3, No.3, 1-26.
- Biberaj, Elez (1998) *The Rocky Road to Democracy*, Westview Press: Boulder, Colorado.
- Caplan, Constance and Alexander Knapp (1997) Technical Assistant Mission to the OSCE/ODHIR, Republic of Albania, May-July 1997, International Foundation for Electoral System: Washington.D.C., Available at: <http://www.ifes.org/~media/Files/Publications/VRC/Reports/1997/R01506/R01506.p>
- Central Elections Commission (2001) *Rezultati Përfundimtar i Zgjedhjeve 2001*, Available at: <http://cec.org.al/2004/eng/Zgjedhejekuvendfiles/rezultat2004.htm>
- Central Elections Commission (2005) *Rezultati i zgjedhjeve parlamentare sipas zonave, 2005*, Available at: <http://cec.org.al/2004/Zgjedhejekuvendfiles/Rez-zgjedhje2005/rezultatet%20100%20zona/buletini.htm>
- Central Elections Commission (2005) *Rezultati Përfundimtar i Zgjedhjeve Parlamentare, 2005*. Available at: <http://cec.org.al/2004/Zgjedhejekuvendfiles/Rez-zgjedhje2005/rezultatet%20vendore/linke/parti%20rang%20vendi.pdf>
- Central Election Commission (2005) *Përbërja e kuvendit sipas subjekteve që e mbeshesin*. Available at: http://cec.org.al/2004/Zgjedhejekuvendfiles/Rez-zgjedhje2005/rezultatet%20vendore/linke/perberja%20e%20kuvendit_grafiku.pdf

- Çili, Henri (2002) *Shumica që na mund*, Institute of National Studies: Tiranë.
- Collier, Ruth Berins and David Collier (1991) *Shaping the Political Arena. Critical Junctures, the Labor Movement, and Regime Dynamics in Latin America*, Princeton: Princeton University Press
- De Gregorio, Paul, Kimberly Ross, Jonas Rolett, Alicia Allison and Gerald Mitchell (1996) Albania Pre-Election Technical Assessment – March 20-28, 1996 International Foundation for Electoral System: Washington.D.C. Available at: <http://www.ifes.org/~media/Files/Publications/VRC/Reports/1996/R01504/R01504.pdf>
- Duverger, Maurice (1964) *Political Parties. Their Organization and Activity in the Modern State*. 3rd eds. London: Methuen & Co Ltd.
- Edgeworth, Linda and Fabricio Soares (1992) "Republic of Albania: A Technical Assistance of the People's Assembly- March 09 – April 2", International Foundation for Electoral System: Washington.D.C. Available at: <http://www.ifes.org/~media/Files/Publications/VRC/Reports/1992/R01505/R01505.pdf>
- Grzymala-Busse, Anna.M (2002) *Redeeming the Communist Past. The Regeneration of Communist Parties in East Central Europe*, Cambridge: Cambridge University Press.
- Hanley, Seán (2006) "Getting the Right Right: Redefining the Centre – Right in Post-Communist Europe", pp.9-27 in Aleks Szczerbiak and Seán Hanley (eds.) *Centre-Right Parties in Post-Communist East-Central Europe*, UK:Routledge.
- Hanley, Seán, Aleks Szczerbiak, Tim Haughton and Brigid Fowler (2007) "Explaining the Success of Centre-Right Parties in Post-Communist East Central Europe: A Comparative Analysis", Sussex European Institute Working Paper No 94, [available at <http://www.sussex.ac.uk/sei/1-4-10-1.html>].
- Hanley, Seán, Aleks Szczerbiak, Tim Haughton and Brigid Fowler (2008) "Sticking Together: Explaining Comparative Centre-Right Party Success in Post-Communist Central and Eastern Europe", *Party Politics*, 14: 407-434
- Kajsiu, Blendi (2004) "Albanian Political Parties", pp.9-38 in Georgi Karasimeonov (eds.) *Political Parties and the Consolidation of Democracy in South Eastern Europe*, Gorex Press Publishing House: Sofia.
- Kajsiu, Blendi (2005) "Organizational Structure and Internal Party Democracy in Albania", pp.142-165 in Georgi Krasimeonov (eds.) *Organizational Structures and Internal Party Democracy in South Eastern Europe*, Gorex Press Publishing House: Sofia.
- Kajsiu, Blendi (2008) "Në rrënojat e një utopie: Pse dështoi Anti-Korrupsioni Shqiptar?", *Polis* 6, No.6 (Vjeshtë 2008): 42-57.
- Katz, Richard S., Mair, Peter (1995) "Changing Models of Party Organizations and Party Democracy – The Emergence of the Cartel Party", *Party Politics*, 1 (1): 5 – 28.

- Kitschelt, Herbert, Mansfeldova, Zdenka, Markowski, Radoslaw, Tóka, Gábor (1999) *Post-Communist Party Systems – Competition, Representation and Inter-Party Cooperation*, Cambridge University Press.
- Kitschelt, Herbert (2001) “Divergent Path of Postcommunist Democracies”, pp.299 – 323 in Diamond, Larry and Gunther, Richard (eds.) *Political Parties and Democracy*, Baltimore and London: The Johns Hopkins University Press.
- Krasniqi, Afrim (2009) *Zgjedhjet në Shqipëri (1991-2008). Historia, Proceset Zgjedhore, Partitë, Kandidatët, Fushatat Elektorale (Elections in Albania 1991-2008. History, Election Processes, Parties, Candidates, Electoral Campaigns)*, Tiranë: Konica Kolor.
- Lewis, Paul G. (1996) “Introduction and Theoretical Overview”, pp.1-19 in Lewis, Paul G. (eds.) *Party Structure and Organization in East – Central Europe*, Cheltenham: Edward Elgar.
- Mahoney, James (2000) “Path Dependence in Historical Sociology,” *Theory and Society*, 29: 507-548.
- Mati, Mirush (1995) “Konsolidimi i mëtejshëm i strukturave të partisë, Aksioni më i rëndësishëm organizativ i PDSH”, *Fletore Politike* 3, No.2, 27-34.
- OSCE/Office for Democratic Institutions and Human Rights (1996) Observation of the Parliamentary Elections Held in the Republic of Albania, May 26 and June 2, 1996, Available at: http://www.osce.org/documents/odihr/1996/07/1176_en.pdf
- OSCE/Office for Democratic Institutions and Human Rights (2000) Republic of Albania. Local Government Elections, 1 and 15 October 2000, Warsaw, 11 December 2000, Available at: http://www.osce.org/documents/odihr/2000/12/1174_en.pdf
- OSCE/Office for Democratic Institutions and Human Rights (2001) *Republic of Albania. Parliamentary Elections: OSCE/ODHIR Election Observation Mission Final Report – 24 June-19 August 2001*. Warsaw, 11 October 2001. Available at: http://www.osce.org/documents/html/pdftohtml/1170_en.pdf.html
- OSCE/Office for Democratic Institutions and Human Rights (ODIHR). *Needs Assessment Mission Report, 12-16 April*, Warsaw, April 2005, Available at: <http://www.osce.org/odihr-elections/14376.html>.
- OSCE/Office for Democratic Institutions and Human Rights (ODIHR). *Republic of Albania: Parliamentary Elections, 3 July 2005*. Warsaw, November 2005. Available at: <http://www.osce.org/odihr-elections/14376.html>
- OSCE/Office for Democratic Institutions and Human Rights (ODIHR) (2009) *Republic of Albania. Parliamentary Elections – 28 June 2009. OSCE/ODHIR Election Observation Mission Final Report*, 22 October 2009. Available at: http://www.osce.org/documents/html/pdftohtml/39545_en.pdf.html
- Panebianco, Angelo (1988) *Political Parties – Organization and Power*, Cambridge: Cambridge University Press.
- Pashko, Gramoz (1991) “*Platforma Elektorale e PD dhe disa alternative për transformimin e Shqipërisë*”, Rilindja Demokratike, No.10, f.1-5.
- Pierson, Paul (2004) *Politics in Time*, Princeton: Princeton University Press.
- Rilindja Demokratike (1991) “*E duam Shqipërinë si Gjithë Europa*”, Rilindja Demokratike (Democratic Renaissance), No.2, p.4.
- Sartori, Giovanni (1968) “Political Development and Political Engineering”, p.261-298 in J.D. Montgomer and A.O.Hirschman (eds) *Public Policy* 17.
- Sartori, Giovanni (2001) “The Party Effects of Electoral Systems”, pp.90-105 in Diamond, Larry and Gunther, Richard (eds.) *Political Parties and Democracy*, Baltimore and London: The Johns Hopkins University Press.
- Szcerbiak, Alkes and Hanley, Seán (2006) “Introduction: Understanding the Politics of the Right in Contemporary East-Central Europe”, pp. 1-8 in Szcerbiak, Alkes and Hanley, Seán (eds.) *Centre-Right Parties in Post-Communist East-Central Europe*, UK: Routledge.
- Van Biezen, Ingrid (2003) *Political Parties in New Democracies – Party organization in Southern and East-Central Europe*. Hampshire: Palgrave MacMillan.
- Zaloshnja, Eduart (1991) “Çfarë u propozohet fshatareve”, Rilindja Demokratike, No.11, f.5.

Televizioni në raportet Parti Politike: Publik

Dokt. Roland LAMI

Abstrakt. *Shumë studiues pohojnë se në kushtet e shoqërisë së informacionit vetë demokracia përjeton një transformim të thellë funksional. Në gjykimin e Habermas-it, Meyer-it dhe Hinchman-it, Merkel, Lew, demokracia, jo vetëm që është transformuar në nivelin e paraqitjes dhe të portretizimit të politikës, por vetë procesi politik ndryshon për sa i përket çdo aspekti. Thelbi i saj riformatohet si rezultat i bashkëveprimit të kodit mediatik dhe kodit politik.*

Studiuesit sugjerojnë që aktorët politikë i nënshtrohen këtij procesi si rezultat i zgjerimit dhe komercializimit të sistemeve mediatike. Në këtë konfigurim të skenës publike, mediat e informacionit qëndrojnë ndërmjet politikanëve dhe ndjekësve të tyre. Politikanët iu flasin mediave, ndërsa mediat iu flasin votuesve. Ky transformim i ofron një rol të rëndësishëm medias, teksa politika dhe politikanët detyrohen t'i kushtojnë gjithnjë e më tepër rëndësi imazhit dhe formës, sesa përmbajtjes dhe realitetit dhe kështu i gjithë transformimi etiketohet si mediatizim¹ politikës.

Në këtë epokë të re, është përfshirë edhe politika shqiptare, ku televizioni shikohet si instrument i domosdoshëm në ndikimin e publikut. Pikërisht, analiza e ndërveprimit televizion – politikë – publik përbën fokusin kryesor në këtë punim. Më konkretisht, synohet të evidentohen disa nga implikimet e mundshme që shkakton televizioni te politika dhe ajo që është më e rëndësishmja te publiku. E gjitha, analizohet duke u mbështetur në prespektivën teorike të disa autorëve të njohur në fushën e sociologjisë së komunikimit.

¹ Shënim: Termi Mediatizim shpjegon ndërfitjen e mediave në domenin politik.

Hyrje

Kur flitet për partitë politike si “produkt” i demokracisë, çështja nuk shtrohet për të ditur nëse partitë i shërbejnë ose jo demokracisë, por se çfarë marrëdhënie krijojnë ato me elektoratin e tyre. Studiuesi Peter Merkel, Thomas & Lew, (2002) i qëndron idesë se për të analizuar një marrëdhënie të tillë, në radhë të parë duhet të përqendrohemi te natyra e shërbimeve që ato kryejnë. Në këtë propozim, unanimiteti i autorëve dhe studiuesve është i vështirë.

Për disa, natyra e shërbimeve në ndikimin e medias dhe veçanërisht të televizionit, ka marrë një dimension ndryshe nga ai mëparshmi. Mediatizimi i politikës është sot, një nga fenomenet më të përhapura në arenën politike të shumicës së vendeve me demokraci të konsoliduar. Media për shkak të masivizimit dhe influencës, “josh” gjithnjë e më shumë politikën që ta përdorë atë. Kësisoj, politika në kushtet e përdorimit të saj merr dimensione të reja.

Teoricienë si Habermas, Meyer dhe Hinchman (2002) e vënë theksin në varësinë e politikës nga media. Sipas tyre, njëri domen shoqëror arrin të imponojë rregullat e veta specifike në mënyrën e funksionimit të domenit tjetër. Politika mesa duket ka rënë në ndikimin e sistemit mediatik, duke i'u dorëzuar logjikës së saj. Si rezultat i këtij nënshtrimi politika humbet shumë nga vetja në këmbim të përfitimeve që rrjedhin nga media.

Në këtë logjikë, « thelbi i procesit politik riformatohet si rezultat i bashkëveprimit të kodit mediatik dhe kodit politik » (Thomas & Lew, 2002 : 57). Kjo do të thotë që, nga njëra anë mediat dhe televizioni në veçanti e paraqesin politikën në përputhje me rregullat e tyre specifike ndërsa, natyra e politikës transformohet si rezultat i dëshirës së pareshtur për t’iu nënshtruar pushtetit të këtyre rregullave. Falë televizionit politikanët iu flasin mediave, ndërsa mediat iu flasin votuesve. Trinomi, politik – televizion - elektorat apo televizion – politik - elektorat merr një përmasë të re.

Urat e komunikimit midis elektoratit të gjerë dhe përfaqësuesve të partive të ndryshme politike, realizohen me anë të mesazheve televizive, që jepen nga politikanët dhe konsumohen nga audienca televizive, sidomos gjatë periudhës së fushatës elektorale. Televizioni u jep mundësi kandidatëve, që për një periudhë të shkurtër kohore, të arrijnë të bëhen të njohur në nivel kombëtar dhe të kenë mundësi të depërtojnë e të fitojnë simpati tek të gjithë shtresat (Axford & Hugins, 2001). Personazhet politike janë të ndergjegjshme për rëndësinë e vizibilitetit të tyre në kanalet televizive si dhe për ndikimin e mesazheve që ata përcojnë tek audienca. Kështu, roli i televizionit në sferën politike bëhet tejet i rëndësishëm dhe nevoja për t’iu përshtatur kërkesave të saj kthehet në domosdoshmëri për këto të fundit.

Ky aspekt kushtëzues i medias dhe i televizionit, në veçanti, kthen me kokë

poshtë deri diku idenë e konsoliduar rreth viteve 70-të mbi influencën e politikës në media. (Chomsky, 1997) Sot, nuk mund të themi se ky ndikim nuk ekziston, por ekspansioni i shpejtë i televizionit në këto dy dekada si dhe shkalla e influencës te publiku i ka dhënë një status shumë më “arrogant” sesa më parë televizionit. “Për shumë specialistë të komunikimit mbrohet teza se sot nuk është media që i nënshtrohet politikës, por e kundërta”. (Louw, 2005: 57)

Në këtë realitet komunikativ aktiviteti politik humbet paprekshmërinë e tij me hyrjen e televizionit dhe sot asnjë politikan nuk mund të komunikojë pa kaluar më parë në filtrin e tij. “Fakti i thjeshtë që politikanët, duke filluar nga niveli kryetar bashkie e deri te Presidenti, duhet të kalojnë patjetër nëpërmjet televizionit për të shkuar te qytetari me qëllim që të transmetohet oferta politike dhe për të marr miratimin e tyre, dëshmon pikërisht, rolin e përcaktues të medias vizive.” (Kallciu, 2010:93). Kjo e fundit imponon një mënyrë të caktuar për t’u prezantuar e për të vendosur për problemet që shqetësojnë qytetarët. (Axford & Hugins, 2001)

Në këtë dimension të ri komunikimi, partitë politike nga një palë zgjedhje në tjetrën kanë rritur ndjeshëm shpenzimet në drejtim të sigurimit të kohës televizive. Po t’i referohemi kontekstit shqiptar do të vërejmë shuma marramendëse në adresë të sigurimit të askesit në televizion. Sipas OPEN Data Albania “zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2009 janë administruar nëpërmjet një fondi prej 600 milionë lekësh dhe po kaq janë parashikuar për zgjedhjet lokale të vitit 2011. Këto shifra janë 25 herë më të larta krahasuar me ato të vitit 2005”. Njëkohësisht, referuar monitorimit të kryer nga KQZ-ja vihet re se zërin kryesor të shpenzimeve e zënë shumat e akorduara për reklamë televizive.

Subjektet	Rezultati i monitorimit
Partia Demokratike	119,692,768
Partia Socialiste	70,067,390
LSI	35,932,580
Partia Republikane	12,637,000
Lëvizja G99	8,43,660

Shënim: Raport i KQZ-së – (Në kolonën e dytë pasqyrohen shpenzimet sipas monitorimit të bërë (për reklamat në pesë televizione, shtu shpenzimet e hapjes dhe të mbylljes së fushatës së secilës parti në tetë qytetet kryesore të vendit, <http://www.cec.org.al>

Nga monitorimi rezulton se PR-ja ka shpenzuar vetëm për reklamat politike, në pesë televizione dhe fushata hapëse e mbyllëse në tete qytete kryesore, 96%

të shpenzimeve të deklaruar, PS-ja, 68.8 % dhe PD-ja 76,2% . Pra shihet qart që pjesa më e madhe e shpenzimeve adresohen për te reklama televizive. Ky investim ka influencuar në sigurimin e kohës televizive. Pavarësisht se ekziston një ligj për balancimin e kohës televizive, parti të ashtuquajtura të vogla në mungesë të financave të mjaftueshme si dhe të mosrespektimin të ligjit nga ana e operatorëve mediatikë për balancimin e kohës. Ky fakt del fare qartë nga monitorimi i kryer nga KKRT-ja.

SUBJEKTET POLITIKE	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL
PARTIA DEMOKRATIKE (PD)	68.23	56.77	14.85
PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRIË (PS)	52.23	54.77	64.90
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM (LSI)	17.23	12.08	9.80
PARTIA REPUBLIKANE (PR)	13.42	9.37	6.05
PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ)	0.72	1.30	0.90
PARTIA DEMOKRACI DHE UNITET (PDU)	5.13	0.52	2.02
PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE (PDSSH)	4.73	1.00	2.37
PARTIA DEMOKRISTIANE (LDK)	2.00	0.22	1.97
PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD)	6.73	0.50	5.03
PARTIA TË TJERA	10.47	3.49	13.58

Shënim: Raport i Drejtorisë së Pogrameve për edicionet informative. (Koha Sinkron për Subjektet Politike) Prill 2009, <http://www.kkrt.gov.al>

Në këto kushte, gara bëhet e pabarabartë të paktën vizualisht dhe prirja për të qenë prezent në media, pavarësisht kostove, kthehet në domosdoshmëri. Më këtë logjikë politika dorëzohet pa kushte te kriteret që dikton televizioni duke pësuar transformime rrënjësore qoftë në përmbajtje, qoftë dhe në formë. I vetmi shqetësim i saj është sigurimi i fondeve për të përballuar kostot e kripura të televizioneve.

Rimodelimi estetik i politikanit

Standardet estetike të konsoliduara nga televizioni përgjatë një kohe realtivisht të gjatë kthehen në modele për t'u imituar nga politikanët. Pikërisht, kjo nevojë e detyron atë të njohë ligjësitë e funksionimit të medias dhe në veçanti të teknikave që e prodhojnë këtë imazh. Siç shprehet Fuga: "...i duhet të njohë lojën televizive po aq sa i duhet ta bëjë këtë spikeri i lajmeve televizive. Politikani përpara kamerave duhet të flasë, të vishet, të marrë ato pozicione trupore, të bëjë të njëjtat gjestikulacione sikurse e kërkon teknika televizive."(2005: 138). Në këtë rast, simbolizmi televiziv si gjetje estetike i jep më shumë përparësi sjelljes së dukshme sesa asaj të fshehur po të flisim me gjuhën e përfaqësuesit të ndërveprimit simbolik, George H. Mead. (Ritzer, 2009: 371)

Për të nxjerrë në pah këtë transformim Pozzato (1997) ndalet te veshja si simbol që ndikon në ndërtimin, ose ripërcaktimin e identitetit të politikanit. Më tepër sesa t'u përshtatet kodeve shoqërore të paracaktuara (konformisti, transgresivi, shtëpiakja etj), ose të simbolizojë ideologji të dukshme falë aksesoreve stereotipikë (bereta ala franceze, kefyah- ja palestineze, çizmet si Che Guevara etj) veshja bëhet standarde. Për pasojë, imazhi në sytë e publikut standardizohet, bëhet njësh pavarësisht diferencave profesionale, kulturore, ekonomike apo ideologjike që mbartin kandidatët.

Larmia e simbolikës së komunikimit joverbal si shikimi, qëndrimi, gjestikulacioni, shprehjet në fytyrë, përdorimi i hapësirës si dhe intonacioni i zërit, i nënshtrohen simbolikës "tip" të fabrikuar nga televizioni. Ky i fundit e fabrikon dhe e shpërndan atë për konsum tek audiencia. Të keqen në këtë rast e pëson telespektatori, i cili e ka të vështirë të dallojë ngjyresat politike dhe personalitet njerëzore të ndryshme përballë një numri të kufizuar simbolesh virtuale të standardizuara që i serviren për deshifrim.

Të njëjtin fat pëson edhe simbolika verbale. Koha e kufizuar në televizion në njërin anë dhe fuqia e shpërdarjes së mesazhit nga ana tjetër e detyron politikanin të vendosë një marrëdhënie sa më gjithëpërfshirëse mes përmbajtjes së mesazhit dhe interesit të audiencës për ta dekoduar atë. Ndërveprimi ndërmjet tyre përcakton formën e adresimit dhe masivizimin në mënyrën e interpretimit.(Hall, 1980) Pikërisht, shkalla e njohjes së kërkesave dhe preferencave të audiencës përcakton cilësinë dhe suksesin e transmetimit të mesazhit.

Janë pikërisht, kompanitë e marketingut që preokupohen për këtë aspekt. Ata realizojnë në terren studime të thelluara si dhe anketime periodike për të njohur shkallën e perceptimit të audiencës, me qëllimin final; formulimin e saktë të mesazhit ndaj tyre dhe përcaktimin e mundësive për maksimalizimin e deshifrimit të mesazhit politik. Kjo është edhe arsyeja e kostove të "kripura" që qëndrojnë pas kontraktimit të tyre, pasi ata nuk shqetësohen vetëm për "trukimin" dhe transmetimin e mesazhit verbal dhe joverbal, por edhe për masën

e audiencës që do ta konsumojë këtë mesazh. Për ta tregu njihet si instancë legjitime e legjitimitetit.

Në këtë logjikë, “idetë e përgjithshme”, që luajnë një rol të madh në komunikimin e përditshëm, tentohet të përfshihen në pjesën dominante të ligjërimit me justifikimin që gjithkush të mund t’i receiptojë dhe në mënyrë të atypëratyshme. Kjo kërkesë stimulohet nga televizioni, i cili dikton “tipologjinë” e komunikimit mediatik. Sikurse nënvizon specialisti shumë i njohur i shkencave të komunikimit, francezi Jacques Ellul (1973), politika, nën ndikimin e televizionit, kërkohet të jetë disi sipërfaqësore, në kuptimin se, nuk i sugjerohet të shtjellojë analiza shkencore për të ardhmen e vendit. Më shumë asaj i këshillohet të marrë tiparet e një telerealiteti, sesa të një shkence, sikurse ajo konceptohej në shekullin e nëntëmbëdhjetë, ku politikanët ishin edhe ligjvënës me një barrë dijesh juridike, ekonomike dhe institucionale. Ndërsa sot, stili i ligjërimit merr më shumë rëndësi sesa përmbajtja, retorika bëhet më e preferuar sesa logjika, teknikat e bindjes mbivendoset mbi arsyen. Mirëpo, duke qenë se të gjithë e synojnë këtë gjë, në finale, ligjërimit i tyre pavarësisht diferencave profesionale, akademike, ideologjike që ata përfaqësojnë, reduktohet në një numër të kufizuar kodesh. Mund të themi se kodet gjeneralizuese i mbivendosen kodeve specifike që ata kanë trashëguar nga e kaluara.

Ky transformim sipas Fugës (2001) presupozon uniformitet dhe jo varacion, ngjashmëri dhe jo ndryshim. Përmbajtja nuk i adresohet shtresave, grupeve sociale apo niveleve ekonomike, kulturore të ndryshme por, përkundrazi tenton t’i përfaqësojë të gjithë. Publiku vihet përballë dëgjimit të të njëjtin zhargon politik, të bazuar në fjalët nëse do t’i referohemi kontekstin shqiptar “korrupsion”, “integrit”, “drejtësi”, “krizë ekonomike”, “demokraci”, europianizim, etj.

Për të nxjerrë më në pah ndikimin e televizionit në përzgjedhjen e kodeve, studiuesi, Fabbri (1971), analizon terminologjinë e përdorur në mitingje, në sheshe, në takime me simpatizantët si dhe deklaratat e bëra në televizion. Në rastin e parë, politikanët duke iu drejtuar një auditori të ngushtë dhe për më tepër homogjen nga pikëpamja ideologjike, synojnë të forcojnë dallimet ideologjike me kundërshtarit duke përdorur një simbolikë qartësisht të dallueshme. Ata/ato e dinë se kujt i adresohen dhe kanë mundësi të ndërveprojnë me ta. Në rastin e televizionit duke qenë përballë marrësisht heterogjenë nga pikëpamja ideologjike dhe duke mos pasur mundësi të shikojnë se kujt konkretisht i adresohen, këto dallime bëhen shumë më të zbutura. Tendencia për t’iu druajtur reagimeve të një publiku të papërcaktuar, i bën kandidatët që të preferojnë të mbajnë një qëndrim më të zbutur në televizion dhe kështu ata shfaqin një uniformitet përmbajtësor. Televizioni në këtë rast dikton përmbajtjen e ligjërimit dhe në krahun tjetër zeron diferencat e kandidatëve.

Një komponent me shumë ndikim në përmbajtjen e ligjërimit është edhe presioni i kohës televizive. Programacioni dhe spotet publicitare presin, ndaj s’ka

shumë kohë në dispozicion për të folur. Ndikimi i kohës, në cilësinë e arsytimit, është një temë e vjetër e diskutit filozofik: është dallimi që bën Platoni ndërmjet filozofit që ka kohë dhe njerëzve që janë në *agora* (sheshi publik) të cilët e kanë me nxitim. Ai thotë, pak a shumë, se në kushte urgjence nuk mund të arrish të mendosh. Dhe një nga problemet më të mëdha që krijon televizioni është çështja e raporteve ndërmjet të menduarit dhe shpejtësisë. A mund të mendohet në kushte shpejtësie? Duke u dhënë mundësi për të folur vetëm njerëzve që arrijnë të mendojnë me ritëm të përshpejtuar, a nuk e dënon veten televizioni që të ketë në gjirin e vet vetëm mendime të shpejta, njerëz, mendimet e të cilëve janë më të shpejta sesa hija e tyre? Kjo bën të mundur që disa politikanë t’i përshtaten këtij kriteri me koston e cilësisë së mesazhit dhe nevojës për t’u shfaqur, ndërsa disa të tjerë jo. Mirëpo pyetja që ngrihet në këtë rast është se përse disa individë janë në gjendje t’u përshtaten kushteve krejtësisht të veçanta, përse ata arrijnë të mendojnë në kushte kur askush nuk mendon dot? Përgjigja sipas Bourdieu-s (2009:91) është se ata mendojnë me “ide të gatshme”, të cilat janë të përgjithshme, të zakonshme, të kudogjendura dhe për të cilat nuk shtrohet aspak problemi i receiptimit të tyre. Për gazetarin në këtë rast, shqetesimi është nëse janë përmbushur kushtet e receiptimit; a e ka dëgjuesi kodin për të ç’koduar atë që është duke iu thënë? Sipas Bourdieu kur përcillet një “ide e gatshme”, problemi është zgjidhur. Komunikimi në këtë rast është i atypëratyshëm, sepse, në një farë kuptimi, ai nuk ekziston aspak, ose ekziston vetëm në dukje.

Shumë studiues të tjerë mbrojnë mendimin se shkëmbimi i ideve të përgjithshme, është një komunikim pa përmbajtje tjetër, përveç formës së komunikimit. Idetë e përgjithshme, që luajnë një rol të madh në komunikimin e përditshëm, kanë lehtësinë që gjithkush mund t’i receiptojë për shkak të banalitetit të tyre. Ato janë të njohura si për transmetuesin, ashtu dhe për marrësin. Krejt e kundërta ndodh me mendimin që është “antagonist” nga natyra: ai duhet të fillojë demontimin e “ideve të gatshme” dhe mandej të ndërtojë për të demonstruar. Mirëpo, shpalosja e mendimit “reflektiv” është e lidhur ngushtë me kohën.

Raportet asimetrike gazetar – politikan

Televizioni i ofron gazetarit një rol të rëndësishëm, . Ai zëvendëson rendimentin e mijëra specialistëve të aparateve organizative të partive. Roli i tij për shkak të efektit tek elektorati bëhet përcaktues. Postulati i famshëm i Berkeley-t “Të jesh, do të thotë të shihesh” materializon më së miri rëndësinë që i atribuohet kohës televizive që administron gazetari. Sot, “shumë politikanë kanë bindjen se të jesh politikan do të thotë të shfaqesh në televizion, pra më konkretisht, të jesh i dukshëm për gazetarët, të shihesh me sy të mirë prej tyre, gjë që nënkupton bërjen e kompromiseve dhe komprometim reciprok në shkëmbim të kohës televizive.” (Louw, 2005: 123)

Audienca e emisionit të tij, shikohet si mundësi e mirë për t'u transformuar nesër në kapital elektoral dhe anasjelltas, popullariteti i politikanit shikohet si një rast i volitshëm për të rritur audiencën e emisionit. “ Në këtë raport reciprociteti nuk kuptohet mirë se kush është në varësi të kujt. Është politikanin që përdor gazetarin? Apo është gazetari që përdor politikanin? Në fakt, kemi një strukturë ku nuk gjenden dot fillimi dhe fundi. Është një univers rrethor, pa fund e pa fillim, pa pasoja e pa shkak. Politikani u kërkon gazetarëve imazh, kohë, minutazh, privilegj televiziv, fjalë të mira, ndërsa gazetari kërkon audiencë, reklamë, sponsor dhe favore nga ky i fundit. Brenda kësaj strukture të pashmangshme ngjizet imazhi i politikaneve dhe suksesi i gazetarit.”(Fuga, 2007: 71)

Kjo dialektikë orienton politikanin në përzgjedhjen e emisioneve televizive dhe gazetarin në seleksionimin e politikanit. Mirëpo, nuk mungojë zëra si Bourdieu që shprehen se në emër të kredos liberale, në jo pak raste, konkurrenca bëhet homogjenizuese. “Sigurisht nuk kam asgjë kundër konkurrencës, por vërej, që kur ajo vepron ndërmjet gazetarëve, ose gazetave që u nënshtrohen të njëjtave rregulla, të njëjtave sondazheve, të njëjtave njoftime edhe konkurrenca bëhet homogjenizuese” (2009:72). Tendenca për të përzgjedhur të ftuarin më të rëndësishëm nga pikëpamja e statusit dhe me popullaritetin i shtyn gazetarët që në finale t'u adresohen personave të njëjtë. Në këto kushte kufizohet ndjeshëm hapësira televizive për politikanë të tjerë që nuk i zotërojnë këto kritere. Le ta konkretizojmë këtë gjë në kontekstin shqiptar duke iu referuar disa të dhënave të publikuar nga monitorimi i KKRT-së.

Aktorët Politikë	TVSH	TV KLAN	TOPCHANNEL
Bamir Topi	5.30	4.10	5.02
Sali Berisha	76.88	46.95	22.33
Josefina Topalli	9.28	3.60	0.65
Edi Rama	10.10	11.02	31.53
Ilir Meta	21.23	21.08	7.62
Lulzim Basha	19.87	11.65	
Genti Strazimiri	12.32		
Taulant Balla		4.92	
Aktorë të tjerë	136.57	63.33	64.88

Shënim: Raport monitorimi KKRT, Shkurt 2011, <http://www.kkrt.gov.al>

Pa qëllim krijohet një rreth vicioz ku statusi apo popullariteti tërheq interesin e gazetarit dhe ky i fundit riprodhon statusin dhe popullaritetin e politikanit. Giovani Sartori jo pa arsye pohon se ekrani për hir të besueshmërisë që gëzon imazhi mbi fjalën është pilotuesi kryesor i opinionëve dhe në shumicën e vendeve publiku mendon sidomos në funksion të asaj që televizioni e shtyn të mendojë. Në rastin tonë televizioni e shtyn të mendojë vetëm për një numër të kufizuar kandidatësh, ose subjekte politike, të tjerët që nuk e kanë këtë akses për publikun nuk ekzistojnë. Pra, ndodh ajo që ka theksuar Bernard Cohen, mediat nuk na thonë se ç'duhet të mendojmë, por për çfarë duhet të mendojmë. Të ngjashëm me këtë argument, Elisabeth Noelle Neuman (1993) mbron idenë se media ndërhyt në hapësirën sociale duke e kufizuar larminë e zgjedhjeve.

Nevoja për të siguruar akses në televizion dhe hapësirat e kufizuara në krahun tjetër e bëjnë shumë të rëndësishëm rolin e gazetarit. Është politikanin ai që ka më shumë nevojë për gazetarin dhe jo ky i fundit. Në këtë raport asimetrik, shijet e gazetarit kthehen në sfidë përshtatje për politikanin, njëkohësisht përmbushja e interesave të ngushta të gazetarit kthehen në detyrim për politikanin. Nuk është gazetari që i servilozet politikanit, por ndodh e kundërta. Nuk është politikanin që dikton agjendën e gazetarit, por është ky i fundit që përcakton agjendën e politikanit. Mirëpo, jo radhë herë ndodh që gazetari i udhëhequr nga parimet e brendshme të mjeshhtërisë së tij, nga vizioni për botën, formimi kulturor, karakteristikat individuale, logjika e profesionit, por edhe nga interesat e ngushta, të përzgjedh në tregun politik, ato politikan që u përshtaten kategorive të tij të perceptimit dhe të interesit. Gara ndërmjet politikanëve zhvillohet në shkallën e përshtatjes dhe të përmbushjes së interesave të gazetarit.

Me kalimin e kohës gazetari nuk ka nevojë të riskojë tek persona të tjerë. Ata janë të disponueshëm dhe të gatshëm në çdo moment, qoftë për të dhënë ndonjë intervistë apo për të qenë të pranishëm në emision. Mjafton t'i referohemi të ftuarve në disa nga emisionet politike më të ndjekura në televizionet shqiptare për ta spikatur këtë gjë.

Ky kufizim, nuk manifestohet vetëm tek të ftuarit, por edhe në përzgjedhjen e temave për diskutim. Gazetari përthith si informacion nga jashtë vetëm ato lajme dhe mesazhe që përputhen me strukturat e tij të brendshme ideologjike dhe kulturore, si dhe interesin e ngushtë personal. Ai vepron si një sistem që transmeton informacion vetëm pasi ka filtruar atë që është në përputhje me strukturën dhe idealin e vet të brendshëm. Pjesa tjetër e informacionit përjashtohet. Puna nuk është se ky mënjanim ndodh në mënyrë të qëllimshme në rastin më të mirë, por gazetari apo drejtuesi duke e parë nga perspektiva e tij personale, beson se këto lajme janë pa kurrfarë rëndësie. Injorohet faktin se “syzet” e gazetarit, jo në pak raste nuk janë të ngjashme me “syzet” e publikut dhe anasjelltas. Në këtë mënyrë gazetari e analizon realitetin duke e parë nga lart – poshtë dhe asnjëherë nga poshtë – lart. Janë temat e përcaktuara nga vetë gazetari ato që përcaktojnë agjendën e medias.

Në këtë rast krijohet një hendek ndërmjet pritshmërive të publikut dhe interesit të gazetarit. Kufizimi i shijeve të tij implikon larminë e tematikave për t'u diskutuar. Jo radhë herë ndodh që tematika e debatit është larg problemeve dhe kërkesave të audiencës. Ky është një fenomen i zakonshëm në formatet e emisioneve si "Opinion" në TV Klan, "Top story" dhe "Shqip" në Top Channel, "Fakt" në UTV. "Logo" TVSH etj, "Studio 24" në News 24 etj, ku sipas monitorimit të kryer nga KKRT-ja, për vitin 2009, bie në sy mungesa e diversitetit të problematikave dhe numri i kufizuar i të ftuarve.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është ndërtimi i paneleve të debateve televizive, i cili është vendimtar për cilësinë e performancës së politikanit apo subjektit politik. Gazetari për shkak të eksperiencës zotëron një listë të personave që nuk e refuzojnë ftesën, që e kushtëzojnë ardhjen e tyre në varësi të të ftuarve apo në varësi të tematikës, ose të personave që e kanë refuzuar ftesën më parë. Kompozimi i panelit në shumë raste ideohet në funksion të qëllimit të gazetarit, por nuk mungojnë edhe rastet kur paneli kompozohet në interes të një force politike apo evidentimit të një kandidati të caktuar. Kjo e fundit arrihet duke e dominuar panelin me të ftuar nga njëri krah politik, ose duke ftuar persona që dihet që janë nën nivelin e të ftuarit të preferuar. Në këtë rast publiku krijon një ide për më të mirin në bazë të asaj që i ofrohet nga televizioni dhe jo asaj që është në të vërtetë.

Ekspozimi i aspekteve intime tek audienca

Personalizimi i politikës është një tjetër dimension, të cilin e mundëson televizioni. "Përhapja e kulturës së individit dhe e marketingut politik, që e shesin politikanin si një produkt, çojnë në një kërkim të shfrenuar të famës dhe ekspozimit të intimes në kuadrin e një konkurrence të re të kanaleve televizive." (Maigret, 2010:260) Jeta private bëhet publike dhe jeta publike bëhet private. Politikani, siç e përshkruan me shumë realizëm specialisti i komunikimit Bakalli, "...vendos të mos e çojë kohën dem. I udhëhequr nga dëshira për të qenë njeriu më i lakmueshëm mediatisht vendos në çdo lëvizje të tij, në rrugë, shtëpi, në mal, a det, të ketë një kamer mbrapa. Mijëra njerëz nëpër largësira anonime qëndrojnë pranë ekraneve televizive dhe shohin nga afër veprimet rutinore të tij. Mijëra njerëz marrin pjesë në jetën private të tij; një jetë, të cilën vetëm me një farë naiviteti mund ta quash jetë private." (2011:10) Kjo formë komunikimi raporton atë që Chaffey (2009) e quante shpërndarja e përmbajtjes individuale te konsumatori.

Televizioni e zgjeron hapësirën publike të diskutimit duke shuar mjaft dallime midis hapësirave politike dhe hapësirave familjare. Kandidatët më të favorshëm bëhen subjekt i çështjes dhe pjesë edhe pse raportimi rreth tyre ka tendencë për të qenë i orientuar rreth një tematike të caktuar dhe kërkon të provokojë interes publik dhe pjesëmarrje publike. "Ata ndërmarrin fushata, strategjitë e të cilave ngrihen

mbi çimentimin e statusit dhe figurës së kandidatit favorit, apo të kompensimit, në rast se një status i tillë mungon." (Patterson, Wilkins, 2010:202). Vëmendja e medias përqendrohet te karakteri i kandidatit.

Sigurisht, ky koncept ka ndryshuar në mënyrë të dukshme që nga themelimi i republikës kur karakteri përcaktohej në terma aristoteliane – një bashkësi e vëzhgueshme zakonesh dhe vesesh. Psikologjia frojdiane e ka ndryshuar përkufizimin, për të përfshirë edhe motivimin, subkoshiençën dhe marrëdhëniet që ndihmojnë për të na formuar të gjithë si njerëz. Gazetarët, në shkrimet apo komentet e tyre merren me çështje që lidhen me të ashtuquajturin "karakter politik", ku ndërthuren personaliteti me performancën publike, brenda një konteksti të caktuar kulturor e politik. Kjo prirje manifestohet edhe në realitetin tonë. Kujtojmë, përmbajtjen e fushatave të fundit për ta faktuar këtë gjë. Më konkretisht, fushata e personalizuar e PD-së kundrejt kandidatit për Bashkinë e Tiranës, Edi Ramës, në 2007-ën dhe fushata e PS-së kundrejt kryeministrit Berisha në zgjedhjet e fundit të 2011-ës (Budini, 2010).

E gjitha fushata u përqendrua në etiketimin dhe nxjerrjen në pah të karakterit të këtyre personave. Strategjia e marketingut politik u përqendrua në evidentimin e cilësive të figurave politike dhe shumë pak në aspekte programore apo doktrinare. Në një farë mënyre jeta politike, personazhi politik duke shkuar "live" në mjediset familjare u kthye në objekt komentesh. Ishin pikërisht, konvencionet sociale që shërbyen si kriter vlerësimi për komponentë të tillë psikosociale dhe në fund bënë diferencën.

Përfundime

Në këtë studim kemi shtjelluar fenomenin e mediatizimit të politikës në kontekstin shqiptar. Në këtë kuadër, evidentuam prirjen në rritje të politikës për të përdorur televizionin dhe ndikimin e politikës nga televizioni. Argumentuam se politika në dekadën e fundit jo vetëm që është transformuar në nivelin e paraqitjes dhe të portretizimit të politikës, por vetë procesi politik ka ndryshuar në çdo aspekt të tij, falë ndikimit të televizionit.

Thelbi i procesit politik është riformatuar si rezultat i bashkëveprimit të kodit mediatik dhe atij politik. Politikanëve u flasin televizionet, ndërsa këto të fundit u flasin votuesve. Në këtë realitet komunikativ, asnjë politikan nuk mund të komunikojë pa kaluar më parë në filtrin e saj. Në këtë kontekst, politika dorëzohet pa kushte te kriteret që dikton televizioni duke pësuar transformime rrënjësore qoftë në përmbajtje, qoftë dhe në formë. Diversitetet doktrinare, profesionale, kulturore dhe ekonomike, si pasojë e televizionit dhe e kompanive marketuese, homogjenizohen pasi i nënshtrohen teknikave standarde të komunikimit verbal dhe joverbal, të sugjeruar nga televizioni dhe kompanitë marketuese me qëllim

perfeksionimin e estetikës dhe të masivizimit të deshifrimit të mesazhit. Mirëpo, në finale publiku e ka të vështirë të bëjë diferencën.

Njëkohësisht, televizioni i rezervon një rol të rëndësishëm gazetarit. Audiencia e emisionit të tij, shikohet si mundësi e mirë për t'u transformuar nesër në kapital elektoral dhe asnašnjelltas. Kjo marrëdhënie e ndërsjellët, pa qëllim krijon një rreth vicioz, ku statusi apo popullariteti tërheq interesin e gazetarit dhe ky i fundit riprodhon statusin dhe popullaritetin e politikanit. Për publikun ofertat politike reduktohen ndjeshëm. Në një farë mënyre, gazetari duke besuar verbërisht te kriteret e tij profesionale pa qëllim largohet nga shqetësimet e përditshme të publikut. Ky i fundit duke qenë se shqetësimet nuk bëhen objekt i debateve e ka të vështirë të përzgjedh kandidatin apo subjektin politik që do ta përfaqësojë më së miri atë.

U ndalëm në këtë artikull edhe në përhapjen paralelisht të kulturës së individit dhe të marketingut politik, që e shesin politikanin si produkt duke çuar në një kërkim të shfrenuar të famës dhe ekspozimit të intimes në kuadrin e një konkurrence të re të kanaleve televizive. Mirëpo, e gjitha kjo, në një shoqëri të karakterizuar nga presioni i publikut dhe nga kompleksiteti i sfidave për të zgjedhurit, që duhet të zgjidhin problemet dhe të përfaqësojnë në të njëjtën kohë popullatën heterogjene, me interesa të ndryshme, personalizimi mund të duket para publikut si një mjet për të vlerësuar dhe për të gjykuar përfaqësuesit. Ky dimension i ri i politikës e vendos shoqërinë në një pozicion të ri për të gjykuar.

Shqisa e publikut lipset të jetë e stërvitur për të bërë dallimin ndërmjet politikës reale dhe asaj virtuale. Pikërisht, këtu qëndron problemi, pasi gjykimet kërkojnë kohë të përshtatën me ndryshimet e shpejta teknologjike dhe në një realitet si i yni fenomeni sapo ka filluar të shfaqet. Në këtë kuadër, çdo studim që evidenton të tilla aspekte rrit edhe më shumë vetëdijen publike dhe atë politike për pozitivitetet dhe negativitetet që mundëson televizioni.

Bibliografia

- Axford, B. & Huggins, R. (2001) *New Media and Politics*, London: SAGE Publication.
- Bakalli, G. (2011) *Recetë për përjetësinë*, Mapo, Tiranë: UET PRESS.
- Bourdieu, P. (2009) *Mbi televizionin*, Polis, Tirane: UET Press (përkth. Belina Budini)
- Budini, B. (2009) *Edi Rama, Politikani Pop (ulist) – Star*, Tirane: UET PRESS.
- Chomsky, H. (1997) *Propaganda and Control of the Public Mind*. Cambridge – MA: Crambridge University Press.
- David, M. (1980) *Television, Audiences and Cultural Studies*, London, Rout

ledge.

- Hall, S. (1980) *Encoding/decoding*. In *Centre for Contemporary Cultural Studies*, London: Hutchinson
- John, M. (2010) *Bourdieu, Language and the Media*, Palgrave Macmillan Patterson.
- Kallciu, Nada (2009) *Media dhe komunikimi politik*, Tiranë: albPAPER.
- Kajsiu, B. (2008) *Mediatizimi i Politikës, ose rreziku i politikës mediatike*, Polis Nr.8, Tirane: UET PRESS.
- Jacques Ellul (1973) *Propaganda: And the Formation of Man's Attitudes*, New York: Vintage Books
- Fuga, A. (2005) *Lexime në Komunikim*, Tiranë: Ora.
- <http://open.data.al> (parë për herë të fundit më 3 dhjetor 2011)
- <http://www.cec.org.al> (parë për herë të fundit më 12 nëntor 2010)
- <http://www.kkrt.gov.al> (parë për herë të fundit më 12 nëntor 2010)
- Louw, E. (2005) *The Media and Political Process*, London: SAGE Publication.
- Neumann, N. E. (1993) *The Spiral of Silence A Theory of Public Opinion*, University of Chicago Press
- Marrone, G. (2008) *Trupat Shoqëror: Proceset komunikuese dhe semiotika e tekstit*, Tiranë: Dudaj.
- Migret, E. (2010) *Sociologjia e Komunikimit dhe e Mediave*, Tiranë: UET PRESS.
- Meunier, J. & Peraya, D. (2009) *Hyrje në Teoritë e Komunikimit*, Tiranë: QSSHE.
- Monitorim i KKRT (2009) *Koha sinkron për subjektet politike*, Prill.
- Monitorim i KKRT (2011) *Koha sinkron për Aktoret Politik, Shkurt*.
- Patterson, Ph. Wilkins, L. (2010) *Etika në Media: Çështje dhe Raste*, Tiranë: UFO PRESS
- Pozzato, M. (2008) *Semiotika e tekstit*, Tiranë: UET PRESS.
- Raport i KKRT (2009) *Monitorimi i mediave*.
- Ritzer, G. (2009) *Teoria Sociologjike*, Tiranë: UFO PRESS.
- Thomas, M. Lew, H. (2002) *Media democracy: How the Media Colonize Politics*: Polity Press

Progres Raporti i Bashkimit Europian në Shtypin Shqiptar: Një analizë përmbajtësore

*Odeta BARBULLUSHI, Ph.D.*¹

Abstrakt. *Raport-Progresset e Bashkimit Evropian shkaktojnë debat mediatik dhe bëhen biseda e ditës. Për më tepër, ata shërbejnë dhe si armë apo terren lufte mes mazhorancës dhe opozitës. Kjo luftë ka për synim përvetësimin e procesit të integritetit dhe sigurimit të monopolit të kuptimit të këtij procesi. Në këtë punim cilësor, fokusi bie mbi rolin e shtypit të shkruar shqiptar në krijimin e identiteteve sociale dhe politike nëpërmjet pasqyrimin të Raport-Progressive të Komisionit Evropian të tetorit 2011. Duke u bazuar në Analizën Kritike të Ligjërimit, ky artikull hulumton sesi shtypi kontribuon në krijimin dhe konsolidimin e identiteteve partiake, por dhe atij kombëtar në raport me atë evropian e rajonal (ballkanik).*

I. Hyrje

Më datë 12 tetor 2011, Bashkimi Evropian publikoi raport-progresin mbi vendet e Ballkanit Perëndimor. Sipas këtij raporti, Shqipëria nuk ishte akoma gati të merrte statusin e vendit kandidat dhe kishte ende shumë rrugë për të bërë. Raport-progresi ia atribuoi refuzimin e statusit kandidat kryesisht mungesës së dialogut institucional, tensionit politik mes mazhorancës dhe opozitës, por edhe mosplotësimin të kushteve të BE-së nga aktorë të tjerë, si Parlamenti dhe Gjyqësori. Mëgjithëse raporti u paraqit para Parlamentit Shqiptar më datë 13 tetori,

¹ Odeta Barbullushi ka fituar gradën PhD në Universitetin e Birminghamit, Britani e Madhe. Është Zv.Rektore për Kërkimin Shkencor dhe Metodologjinë në Universitetin Evropian të Tiranës. Ky punim është përgatitur fillimisht për Institutin Shqiptar të Medias dhe financiar nga Friedrich Erbert Stiftung në nëntor 2011.

shtypi shqiptar i parapriu rezultatit negativ të Raport-Progressit me një numër të madh komentesh dhe kryetitujsht pesimistë që nga datat 11 dhe 12 tetor.

Publikimi i raport-progresit të BE-së është një rutinë e përvitshme. Në të shkuarën, çdo publikim i raport-progresit është përcjellë me akuza dhe kundërakuza ndërmjet mazhorancës dhe opozitës; ku secila palë ia hidhte përgjegjësinë tjetrës për kritikën e BE-së. Në këto raste, shtypi shqiptar ka marrë anën e njëjës apo tjetrës palë politike. Pasqyrimi i raport-progresit të BE-së nga shtypi nuk ka ndryshuar shumë dhe këtë vit nga vitet e tjera, përse i përket interpretimit të rezultateve të raportit sipas njërës pozicion politik apo tjetrit. Megjithatë, këtë vit pasqyrimi në shtyp i raport-progresit të BE-së karakterizohet nga një konsensus më i gjerë ndërmjet gjithë gazetave të pavarura, në lidhje me përgjegjësinë që e gjithë klasa politike duhet të mbajë për vonesat e integritimit evropian të Shqipërisë. Pasqyrimi në shtyp i raport-progresit të BE-së ndryshon këtë vit nga vitet e mëparshme për shkak të disa faktorëve:

Së pari, liberalizimi i vizave Schengen për qytetarët shqiptarë në shkurt të 2011-ës. Liberalizimi i vizave është interpretuar rëndom në debatin publik dhe në median shqiptare si objektivi kryesor i integritimit evropian të shqiptarëve. Kështu, me liberalizimin e vizave, mund të mendohej që shtypi shqiptar nuk do të ishte shumë kritik në lidhje me kriteret e paplotësuar nga Shqipëria për të marrë statusin e vendit kandidat. Po kjo mund të ishte e vertetë vetëm nëse do mungonin dy faktorë të tjerë: situata e brendshme politike dhe kryesisht tensionimi politik që pasoi protestat e 21 janarit si dhe faktori 'rajonat'. Ngjarja e 21 janarit, bashke me ngërcin institucional dhe bojkotin e Parlamentit pritej të ishte një pengesë për progresin e Shqipërisë drejt BE-së. Duke pasur parasysh krizën politike që pas zgjedhjeve të përgjithshme të 2009-së, ky raport i BE-së pritej të jepte njëfarë 'verdikti' për sjelljen e elitës politike gjatë vitit të fundit.

Një tjetër faktor lidhet me progresin pozitiv të vendeve të rajonit të Ballkanit drejt BE-së dhe diferencën e krijuar mes këtyre vendeve dhe Shqipërisë në dy vitet e fundit. Duke marrë parasysh këtë faktor, pritej që shtypi të kishte tone më të forta kritike për qeverinë, klasën politike ose Bashkimin Evropian, si dhe t'i mëshonte fort 'interetit kombëtar' dhe 'interetit civil të qytetarëve'. Duke marrë në konsideratë këto aspekte specifike të publikimit të sivjetshëm të raport-progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, pyetjet që kjo analizë shtron janë: Si e interpreton shtypi shqiptar marrëdhënien Shqipëri-BE? Po pozicionin e Shqipërisë në lidhje me vendet e tjera në rajon dhe më gjerë? Si e pasqyron shtypi marrëdhënien mes elitës, klasës politike ose qeverisë nga njëra anë, dhe qytetarëve, popullit dhe kombit nga ana tjetër? Një pyetje tjetër e analizës është sesa i pavarur, neutral apo akuzues dhe partizan është shtypi në këtë raportim të raport-progresit të BE. Dhe së fundmi, sa arrin shtypi të krijojë dhe të mbajë të hapur një debat publik në lidhje me BE-në dhe integritimin?

II. Metodologjia e Punimit

Kjo analizë është një rast i vetëm studimor (*case study*). Kjo do të thotë që analiza bazohet në një ngjarje të vetme: publikimin e raport-progresit të BE-së së vitit 2011, në ditët që i paraprijnë (deri para ditës së publikimit në shtyp më 13 tetor) si dhe në muajin që pason (nëntor). Në këtë analizë, 'shtypi shqiptar' shihet si mjet informimi, si arenë diskutimi por dhe si aktor i mëvetësishëm. Përse i përket të kuptuarit të shtypit si 'aktor', përballemi me një numër pyetjesh të vështira: A e përbëjnë 'shtypin' reporterët e medias, të cilët shkruajnë përditë në faqet e gazetave apo redaktorët, opinionistët, dhe komentatorët? Sic shihet nga këto pyetje, është e vështirë ta identifikojmë shtypin si një aktor të vetëm dhe të njëjësuar. Për këtë arsye, analiza do të bazohet kryesisht në pesë kriteret e analizës së teksteve të shtypit. Këto kriteret janë zhanri, konteksti më i gjerë mediatik dhe politik i një ngjarjeje/lajmi, gazeta në të cilën botohet, autorësia e shkrimit, si dhe mjetet/strategjitë linguistike dhe stilistikore. Këto kriteret i kam huazuar nga Metoda e Analizës Kritike të Ligjërimit mediatik, të themeluar nga Norman Fairclough dhe Ruth Ęodak (1992; 1996). Sipas këtij modeli, asnjë tekst nuk na paraqitet i izoluar, por sjell në vetvete dhe jehonën e shkrimeve të mëparshme mbi një çështje të caktuar, duke vendosur kështu një lloj vazhdimësie mes teksteve. Po ashtu, gjuha e shtypit është tejet heterogjene, sepse përfshin elemente nga ligjërime të fushave të ndryshme, si politike, kulturore, ekonomike etj.

Zhanri ka rëndësi themelore, sepse zhanre të ndryshme formojnë në mënyra të ndryshme autoritetin e folësit: autoriteti i reporterit është i ndryshëm nga ai i një opinionisti. Editoriali i një gazete ka më shumë peshë dhe autoritet sesa komentet dhe opinionet, sepse përmbledh politikën e gazetës. Kështu, rëndësia dhe autoriteti i shkrimeve në shtyp përcaktohet dhe nga zhanri i tyre. Mund të themi se kur ka një fokusim si të lajmeve dhe të zhanreve raportuese, ashtu dhe të editorialeve dhe të komenteve mbi të njëjtën ngjarje ose çështje, atëherë çështja është kthyer në prioritet të axhendës së shtypit. Zhanri dhe autorësia e shkrimit janë kriteret të lidhura ngushtë me njëra tjetrën. Psh, kemi shumë raste kur politikanë, ministra integrimi, ambasadorë të BE-së dhe të vendeve anëtarë në Shqipëri etj. shkruajnë si komentatorë në rubrikën e komenteve ose të analizave. Në këto raste, komenti apo analiza ka impakt për shkak të statusit dhe profesionit të autorit. Në datat mes 12 dhe 14 tetorit, disa gazeta përdorën komentet apo intervistat e përfaqësuesve të BE-së apo të vendeve anëtare në Shqipëri (si psh. Tema), për të kritikuar klasën politike shqiptare në lidhje me rezultatin negativ të progres-raportit. Megjithatë, zhanret e lajmeve dhe të editorialeve/komenteve nuk ndjekin të njëjtin ritëm në mbulimin e ngjarjeve dhe çështjeve.

Në rastin e analizës sonë, vihet re se lajmi i botimit të raport-progresit të BE-së asqyrohet intensivisht nga data 12 tetor deri më datën 15/16 tetor në faqet e para, pra faqet e lajmeve të ditës. Pas këtyre datave, lajmi i raportit të BE-së

zevëndësohet me replikën Topi-Topalli mbi gegnishten, me lajmin e formimit të koalicionit kundër importimit të plehrave në Shqipëri nga Italia, etj. Ndërkohë, opinionet dhe editorialet mbi raport-progresin e BE-së vazhdojnë deri në fund të tetorit. Por, në këtë rast mund të themi se megjithëse vazhdon të jetë pjesë e debatit publik, çështja e integritit ka kaluar më poshtë në axhendën e shtypit. Po ashtu, mjetet stilistikore dhe gjuhësore luajnë rol të rëndësishëm në mënyrën sesi shtypi kontribuon në krijimin e identiteteve sociale/politike dhe kolektive, si dhe të marrëdhënies mes aktorëve të ndryshëm, si psh mes BE-së dhe Shqipërisë, klasës politike dhe qytetarëve, Shqipërisë dhe rajonit etj. Fairclough argumenton që variacionet linguistike në gjuhën e medias krijohen dhe kushtëzohen nga shumë lloje ligjërimesh dhe praktikash të ndryshme sociale. (1995a: 41). Kështu, disa nga metaforat si psh ‘kapja e trenit të integritit’, ose ‘tangoja mes opozitës dhe mazhorancës’ më synim përmbushjen e kriterëve të BE-së, apo metafora e ‘izolimit’ të përsëritur të Shqipërisë nga BE-ja janë marrë nga ligjërimet politike të elitës shqiptare ose asaj evropiane. Me kontekst të teksteve të shtypit kam parasysh pozicionimin e deritanishëm të gazetave (pro ose kundër politikave të mazhorancës, ose në një pozicion neutral dhe të qendrës), si dhe debate më të mëparshme, ngjarje apo momente të caktuara politike të paqyruara në gazetatat e analizuara.

Kampionimi

Me synim analizën e pasqyrimit në shtyp të raport-progresit të BE-së kam zgjedhur vetëm të përditshme të pavarura (jo partiake), të pozicionuara si afër qendrës në spektrin politik-ideologjik, ashtu dhe më afër skajeve ekstreme të majtë dhe të djathtë. Gazetat janë: Gazeta Shqiptare, Shqip, Mapo, Tema, Panorama, Shekulli. Periudha e analizës përfshin muajin tetor, i cili përkon dhe me periudhën e publikimit të raport-progresit, si dhe muajin nëntor. Përfshirja e muajit nëntor është vendosur me qëllim të vëzhgohej kohëzgjatja e debatit mbi raport-progresin, dhe jehonën e këtij debati në lidhje me debate të tjera publike.

III. Pasqyrimi i Raport-Progresit në Shtyp

Megjithëse ky studim nuk është analizë krahasimore, mund të themi se në krahasim me vitet e kaluara, shtypi shqiptar jep këtë vit një tablo më të plotë dhe më informuese të raport-progresit të BE-se. Të 12 kërkesat ose kriteret e BE-së janë shtjelluar gjerësisht, dhe shpesh kanë mbuluar njërën deri në dy faqet e para të gazetës (në shumicën e rasteve faqet 2 dhe 3). Po ashtu, në shumicën e gazetave, aktorët të cilët kanë zënë kryetitujt në ditët e publikimit të raportit në Parlament dhe në shtyp (12-13 tetor) janë aktorët evropianë, dmth përfaqësues

të BE-së në Shqipëri ose komisioneri për zgjerimin. Kjo do të thotë, që aktorët kryesorë të politikës së brendshme shqiptare nuk kanë zënë kryetitujt në faqet e para të faqeve të para. Kjo është pozitive, pasi shtypi nuk ka përsëritur fjalë për fjalë aktorët politikë dhe akuzat e tyrë të ndërsjellta në lidhje me ngadalësimin e procesit të integritit.

3.1. Roli i BE-se dhe e ardhmja e marrëdhënies Shqipëri-BE

Në këtë moment ‘krize’, roli i BE-së është kritikuar pak ose aspak nga shtypi shqiptar. Është e rëndësishme të përmendim se publikimi i raportit të BE-së pasoi daljen në media të një numri analistësh të cilët u vetë-cilësuan si ‘Euro-skeptikë’. Këto analistë, si psh Blendi Kajsiu, Arbër Zajmi, Blendi Sala etj. kanë shkruar dhe përpara në lidhje me koston më të lartë të integritit për bizneset, tregun e brendshëm etj. si dhe për mungesën e informimit të publikut shqiptar në lidhje me këto kosto. Pra mund të argumentohet se raport-progresi i BE-së u botua në një moment të shkurtër lindjeje të një lloji ‘Euro-skepticizmi’ shqiptar. Megjithatë, vihet re se me publikimin e raport-progresit të BE-së, ka shumë pak zëra në shtyp të cilët kritikojnë qasjen e BE-së, kriteret e përzgjedhjes së BE-së për dhënien e statusit kandidat të vendeve të tjera të rajonit, ose rolin që BE-ja ka luajtur në dy vitet e fundit në Shqipëri. Janë të pakta analizat (si psh. Nano, Shqip, 14 tetor, fq. 9; Stefani, Shqip, 19 tetor 2011, fq. 9; Kajsiu, Panorama, 22 tetor, fq. 23), të cilat kritikojnë direkt BE-në dhe përfaqësuesit e saj në Shqipëri.

Megjithatë, dhe këto artikuj kundërpeshohen të paktën me dy shkrime analitike në këtë periudhë: Alfred Lela ‘Euro-skeptiket dhe pse idete e tyre nuk duhen kthyer në ligjërime politik’, (Mapo, 12 tetor 2011, fq. 11) dhe Igli Totozani ‘Euro-Skeptikët made in Albania janë qesharakë: Europa është fati ynë’ (Shekulli, 12 tetor 2011, fq. 5) Sic e shohim, të dy shkrimet janë botuar pikërisht në ditën e daljes së raport-progresit të Komisionit të BE-së, dhe të dyja ndodhen në pozicione të ndryshme—në mos të kundërta— në spektrin ideologjik të shtypit. Duhet theksuar se ekziston një konsensus i gjerë në shtypin shqiptar në lidhje me mbështetjen e paluhatur të Bashkimit Evropian për integritin e Shqipërisë, packa vonesave të procesit të integritit. Këtë e ilustron kryetitujt e faqeve të para të gazetave, të cilët citojnë fjalë inkurajuese të përfaqësuesve të Bashkimit Evropian. Janë të shpeshta citimet nga ambasadori i BE-së në Shqipëri, si psh. “rruga drejt Bashkimit Evropian është e gjatë, por ne ju mbështesim”, (Shqip, 18 nëntor 2011) ose ‘Sanino: Statusi mund të zhblllokohet shpejt nëse jepen prova reale për krizën’ (psh Mapo, 13 tetor, fq. 5). Po ashtu, edhe në debatet që pasuan publikimin e raport-progresit të BE-së, roli i i BE-së dhe i ndërkombëtarëve shihet si i pazëvendësueshem për zbutjen e klimës së brendshme politike (shih psh. Mapo, 15 nëntor, fq. 3).

Në ditët që pasuan publikimin e progresi-raportit mbi Shqipërinë, BE-ja u kthye në burim të rëndësishëm legjitimimi për aktorët shoqërore dhe politikë. Kështu psh, disa nga çështjet më të 'nxehta' pas 13 tetorit ishin konflikti mes Presidentit Bamir Topi dhe Kryetares së Parlamentit Jozefina Topalli; debati rreth importimit të plehrave në Shqipëri nga Italia si dhe programi i publikuar të Partisë Socialiste. Në të gjithë këto debate publike, 'integrimi evropian' përdoret nga palët si armë e fortë për argumentet dhe pozicionet e tyre. Ky përdorim i BE-së si burim legjitimimi është shumë më i fortë në krahasim me momentet e 'politikës normale'. Kjo demonstron me prezencën e BE-së dhe përfaqësuesve evropiane në titujt dhe kryetitujt e lajmeve të faqeve të para mbi çështjet e përmendura më lart.

Për ta përfunduar këtë pjesë, mund të themi se shtypi është vendosur plotësisht në anën e politikës së kushtëzimit ose kondicionalitetit të BE-së, duke interpretuar integrimin evropian si çështje të 'interetit kombëtar'.

3.2. Raporti me fqinjët dhe pozicionimi në rajon

Është mëse e pranuar tashmë që qasja rajonale e BE-së për integrimin e krejt rajonit ka dështuar. Në shumicën e shkrimeve gjatë 12 dhe 14 tetorit, Shqipëria krahasohet me vendet e tjera të rajonit, Serbinë, Kroacinë dhe Malin e Zi të cilët morën statusin e vendeve kandidatë. Kështu, si në shkrimet raportuese (lajme), ashtu dhe në zhanret e komenteve dhe editorialeve, Shqipëria krahasohet me të gjithë rajonin, 'i cili merr lajme pozitive, përveç nesh dhe Bosnjës'. Po ashtu, një prej temave që përmendet në disa gazeta është fakti që vendet e rajonit që kanë kaluar luftra etnike ose kanë qënë përgjegjëse direkte për ta, kanë përparuar shumë më tepër se Shqipëria në procesin drejt integritit evropian.

Megjithëkëtë, dy aspekte vihen re: së pari, kjo 'mbetje mbrapa' fqinjëve në progresin drejt BE-së nuk nxit komente nacionaliste ose akuzuese për Serbinë apo vendet e tjera të rajonit. Po ashtu, nuk nxit kundërshti ose antagonizëm ndaj Bashkimit Evropian. Ajo cka disa analiza dhe komente parashikojnë është se kjo pabarazi po con në një integrim me dy shpejtësi dhe ndarje *de facto* të rajonit: 'Ndarja e rajonit në dy pjesë (rastësisht apo jo, ndarja reflekton dhe ndarjen fetare sipas shteteve), do të pikturonte një skenar tepër të vështirë e të rrezikshëm për stabilitetin e vetë Evropës' (Elezi, Mapo, 13 tetor, fq. 11; shih gjithashtu Murati, Gazeta Shqiptare, 14 nëntor, fr. 22). Krijimi i një Ballkani të ndarë sipas ritmeve të ndryshme të integritit—dhe rrjedhimisht dhe zhvillimit—është një temë e cila del për herë të parë kaq fort në shtypin shqiptar pas publikimit të nje raport-progresi të BE-së. Mbetet për t'u parë në muajt në vazhdim sesi do të ndryshojë ligjërimi politik në lidhje me këtë ri-pozicionim të Shqipërisë në kuadrin rajonal, dhe sesi kjo të pasqyrohet në shtyp.

3.3. Rëndësia e integritit dhe Evropës për Shqiptarët

Duke pasur parasysh rezultatet jo pozitive të raport-progresit BE-së Shqipërisë, pyetja mbetet se çfarë kuptimi dhe rëndësie kanë Evropa dhe integrimi evropian për Shqipërinë dhe shqiptarët, sipas shtypit shqiptar. Ose thënë më thjesht, çfarë kanë humbur shqiptarët me refuzimin e statusit kandidat?

Disa gazeta si Shekulli, Shqip dhe Gazeta Shqiptare e kanë vënë më shumë theksin te humbja ekonomike që do të kalojë Shqipëria si pasojë të humbjes së statusit të vendit kandidat. Sipas gazetave, kjo humbje ekonomike do të vijë si pasojë e humbjes së kredibilitetit dhe cënimit të imazhit të vendit; të gjitha këto përkthehen në humbje të investimeve të huaja në Shqipëri (shih Shqip, 11 tetor, fq. 3; Shekulli, 12 tetor, fq. 4; Gazeta Shqiptare, 13 tetor, fq. 3). 'Humbja financiare e shqiptarëve' për shkak të ngadalësimit të integritit evropian nënvizohet jo vetëm në komentet dhe analizat, por dhe në kryetitujt e faqeve të para të këtyre gazetave. Po ashtu, në shumicën e kryetitujve, BE identifikohet si aktori i vetëm që do të ulë në tavolinë mazhorancën dhe opozitën shqiptare. Kështu, BE-së i atribuohet një rol prej 'arbritri' ose 'gjyqtari' të drejtë. Sipas të gjithë gazetave, përgjegjësia për ngadalësimin e procesit të integritit bie vetëm mbi klasën politike shqiptare. Mënyra sesi interpretohet kjo përgjegjësi ndryshon nga rasti në rast, në varësi edhe të pozicionimit të gazetave në spektrin politik (shih më poshtë).

Për shumë editorialistë, integrimi evropian do të ofronte zgjidhjen e vetme për drejtësi sociale dhe për ndëshkim të korrupsionit në nivelet më të larta të pushtetit. Kjo është një nga temat më të rrahura, sidomos nga media e pozicionuar në të majtë të spektrit politik. Në këtë kontekst, përmenden dhe raste të tjera nga Evropa Qendrore dhe Lindore, kur BE ka shërbyer si forcë kryesore e demokratizimit të brenshëm: 'në aspektin politik, nëse do të ishim anëtarë, arroganca apo lajthitjet e pushtetarëve do të thyenin keq hundët prej Brukselit sikurse ndodhi me Mecarin në Sllovaki dhe Hajderin në Austri, të cilëve iu vu bërri prej trysninsë së BE-së' (Nurellari, Shqip, 17 tetor 2011: 8) Editoriali vazhdon mbi marrëdhënien mes shoqërisë dhe shtetit, duke ia atribuar BE-se rolin kryesor për rregullimin e kësaj marrëdhënieje: 'Mbi 70% e legjislacionit dhe rregullave që prekin jetën e qytetarit të BE-së vendosen në Parlamentin Evropian dhe kjo do të thoshte për kastën politike shqiptare që s'do të kenë mundësi të bëjnë ligje apo rregulla që favorizojnë kompanitë e tyre apo të partnerëve të tyre dhe që penalizojnë në mënyrë abuzive e arbitrarë rivalët' (Shqip, 17 tetor 2011: 8).

Në këtë kontekst, liberalizimi i vizave konsiderohet të jetë një histori e të kaluarës dhe jo provë për suksesin e Shqipërisë në rrugën drejt integritit. Në shumicën e gazetave, çështja e liberalizimit të vizave ose lihet krejtësisht në harresë, ose kujtohet si një 'fitore e paplotë', pra që nuk është parakusht apo kriter i mjaftueshëm i integritit. Interpretimi i dytë gjendet më shumë në gazetatat më kritike ndaj mazhorancës aktuale, si Shekulli apo Shqip. Psh. një ditë para publikimit

të raport-progresit të BE-së, gazeta Shekulli boton në një okiello në faqen 4 një koment mbi 'qytetarinë evropiane' dhe mbi atë çfarë do të fitonin shqiptarët nëse do të kishin qytetari të plotë evropiane. Imazhi ilustrues për këtë është një poster me imazhin e Pasaportës Biometrike i vendosur me rastin e liberalizimit të vizave në shkurt 2011 në Bulevardin Dëshmorët e Kombit, por që tani është i dëmtuar (Shekulli, 12 tetor, fq. 2).

IV. Përdorimi i mjeteve stilistike dhe strategjive linguistike

Ligjërimi i shtypit kombinon mjete të ndryshme stilistike dhe linguistike. Nëpërmjet tyre mjeteve krijohen identitetet politike/sociale dhe bëhet dallimi mes 'nesh' dhe 'atyre', kushdo qofshin këto palë. Në rastin e kësaj analize, na intereson të shohim sesi shtypi, sidomos nëpërmjet zhanreve raportuese—pra të atyre rubrikave që pretendojnë objektivitet—krijon përgjigjësi dhe marrëdhënie mes qytetarëve, klasës politike, BE-së, elitës etj.

4.1. Krijimi i 'përgjigjësive' për integrimin e ngadaltë të BE-së

Në gazetat të cilat janë më afër mazhorancës qeverisëse, lajmi i refuzimit të statusit kandidat është përcjellë me tone më neutrale. Si 'fajtores' për këtë refuzim shihet 'klasa politike' ose 'skena politike'. Në këto raste, 'bojkotit të opozitës' i vihet e njëjta peshë faji—ose më shumë—sesa 21 janarit dhe zgjedhjeve të majit 2011. psh: Kryetitull: 'KE: Skena Politike, një vit pezull/ Nëntitull: 'Bojkoti, 21 janari dhe zgjedhjet rriten polarizimin' (Panorama, 13 tetor 2011, fq. 3) ose Kryetitull: Berisha: Rama bllokoi, por shqiptarët janë të mencur/ Nëntitull: 'Qeveria do të bëjë reforma, por opozitën s'e udhëheq dot' (Panorama, 13 tetor, fq. 4). Ndërkohë, që ky rend i përgjigjësive përmbysen në titujt e gazetave të cilat mund të rreshtohen në krahun e majtë politik. Psh, kryetitull: 'BE: Parlamenti i njëanshëm, administrata e politizuar, media, kontroll nga qeveria' ose kryetitull i faqes së brendshme '21 janari dhe zgjedhjet e 8 majit, shkaqet kryesore të rrëzimit' (Shqip, 13 tetor, fq. 2 & 3).

Duke përdorur një gjuhë më të ashpër, gazeta Tema vë si kryetitull me 14 tetor një citim nga përfaqësuesi i Komisionit Evropian në Tiranë, Ettore Sequi: '21 janari ishte ngjarja më e trishtuar që më kanë parë sytë' (Tema, 14 tetor; po ashtu Shqip, 14 tetor, fq. 4). Po kështu, gazeta Tema botoi në fund të tetorit, një koment të ambasadorit së Mbretërisë së Danimarkës së Shqipëri, të titulluar 'Dështimi i qeverisë në çdo fushë, dhe jo ngërçi politik, ju penguan të merrnit ftesën për BE' (Tema, 28 tetor). Kështu, termi 'ngërc politik' hidhet poshtë si një term neutral dhe zevëndësohet me terma më të fortë si 'faj' dhe 'dështim'.

Në gazetat që janë më kritike ndaj qeverisë aktuale, reporterët—dmth, jo ne faqet e komenteve dhe editorialeve, por në faqet e para të brendshme të gazetave—

përdorin imazhe të shoqëruara me disa rreshta koment, të cilat kujtojnë 21 janarin e deri dhe Gërdecin në një rast (psh Gazeta Shqiptare, 13 tetor 2011, fq. 2). Këto imazhe përdoren për të kujtuar publikun dhe lexuesit shqiptarë se te kush qëndron faji për mosmarrjen e statusit 'kandidat' nga BE. Është e rëndësishme të përmendet këtu dhe dallimi mes titujve të lajmeve, pra të zhanrit raportues, dhe titujve të komenteve dhe analizave. Ndërsa komentet dhe editorialet nga vetë natyra e tyre e tregojnë menjëherë pozicionin e autorit në lidhje me përgjigjësitë për projekt-raportin, shkrimet e reporterëve shpesh fajësojnë klasën politike shqiptare nëpërmjet fjalëve të përfaqësuesve të BE-së. Në kontrast me editorialet dhe komentet, në shkrimet raportuese mungon argumenti dhe duket shumëherë sikur zëri i reporterit fshihet tërësisht nga zërat e politikanëve të cituar.

4.2. Ndarja politikë-qytetarë

Në shumë prej kryetitujve të faqeve të para, theksi vihet te fakti që 'ne e kemi fajin', ose 'e merituar', ose 'elita politike na lë jashtë BE'-së'. Kështu, p.sh në të gjithë shkrimet e analizuara krijohet një ndarje e qartë mes qytetarëve, dhe 'klasës politike'. Kësaj të fundit i atribuohet faji për ngadalësimin e procesit të integrimit. Kështu, 'politika' dhe jo 'opinionin publik' ose 'qytetarët' interpretohen si përgjigjesi i vetëm i ngadalësimit të progresit të Shqipërisë drejt BE-së. Është interesante të vihet re se shtypi nuk tregohet në asnjë rast reflektiv mbi rolin që ka luajtur vetë në procesin e përmbushjes së kriterëve të BE-së nga pala shqiptare.

Pavarësisht pozicionimit politik të secilës gazete, të gjitha vënë gishtin të mungesa e dialogut dhe konsensusit mes mazhorancës dhe opozitës, duke përforcuar kështu fjalët e raport-progresit dhe të përfaqësuesve të BE-së. Ky fokus në temat ose fjalët kyce të Bashkimit Evropian shihet dhe në pasqyrimin e zgjeruar që shtypi i bën marrëveshjes së nëntorit për reformën zgjedhore mes mazhorancës dhe opozitës. Mund të argumentohet se megjithë pozicionin kritik ndaj politikës në ditët e para të publikimit të raport-progresit, shtypi ndjek axhendën e lajmeve dhe temave të elitës së brendshme politike ose përfaqësuesve të BE-së.

Përfundime: Pavarësia e Shtypit Shqiptar dhe Interesi Kombëtar'

Qëllimi i punimit ishte të hulumtonte nëpërmjet analizës përmbajtësore interpretimin që shtypi shqiptar i bën marrëdhënies mes Shqipërisë dhe BE-së, marrëdhënies mes klasës politike dhe qytetarëve, si dhe pozicionit të Shqipërisë vis-a-vis fqinjëve. Po ashtu, u vëzhgua dhe pozicionimi i gazetave të ndryshme në lidhje me aktorët përgjigjës për rezultatin negativ të raport-progresit. Nga analiza jonë mund të nxirren disa konkluzione: Së pari, megjithë rezultatin negativ të

raport-progresit të BE-së, shtypi nuk ka tone kritike për BE-në. Për më tepër, mund të thuhet se shtypi shqiptar nuk reflekton aspak atë që sipas Institutit Shqiptar të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, mund të shihet si një rritje e skepticizmit të qytetarëve shqiptarë në lidhje me integrimin (AIIS, The Prospect of EU Integration of Albania. Perspectives and Perceptions, 2011). Së dyti, megjithëse krahasimet e Shqipërisë me vendet e tjera të Ballkanit nuk mungojnë,

shtypi në asnjë rast nuk shpreh paragjykim ose antagonizëm ndaj vendeve të tjera të rajonit ose ndaj BE-së. Së treti, në pasqyrimin e këtij raport-progresi, BE-ja shihet si një forcë normative dhe demokratizuese, e cila mund të disiplinojë dhe të neutralizojë klasën politike shqiptare. Kështu, BE del si përfaqësuese e interesit të të gjithë shqiptarëve.

Megjithë këto të përbashkëta, mund të themi se nga analiza na rezultojnë gjithashtu se shtypi i përditshëm është i ndarë sipas disa pozicioneve pro dhe kundër mazhorancës qeveritare. Në bazë të këtyre pozicioneve, shtypi përdor dhe mjete stilistike dhe figurative, vizuale si dhe strategji të renditjes së lajmeve dhe të titujve, me synim përcimin e një mesazhi politik tek lexuesi. Po ashtu, axhenda politike dhe konflikti politik zënë vendin kryesor në pasqyrimin e shtypit shqiptar. Kjo mund të ilustruhet nga lehtësia me të cilën debati disa ditësh mbi raport-progresin e BE-së u zëvendësua brenda 24 orëve me debatin mbi gegërishten mes Presidentit Topi dhe Kryetares së Kuvendit Topalli. Në fund, mund të themi se këtë herë publikimi i Raport-Progresit të BE-së mbi Shqipërinë dhe Ballkanin Perëndimor është pasqyruar më gjerësisht dhe në mënyrë më kritike nga shtypi shqiptar sesa në të kaluarën. Kjo do të thotë se ka një konsensus mes të gjithë gazetave—pavarësisht pozicionit të tyre politik dhe ideologjik—në lidhje me nevojën e kapërcimit të ngërcit politik si dhe hapjes së dialogut politik për kapërcimin e pengesave në rrugën e integritit. Megjithatë, shtypi vazhdon të ndjekë në shkallën më të madhe axhendën politike dhe jo të hapë çështje dhe tema të rejanë debatin publik, gjë të cilën po e bën shumë më fort media vizive.

Yll i partisë, yll i mediave: Rasti i ngritjes mediatike të Edi Ramës

Dokt. Belina BUDINI¹

Abstrakt. Ky artikull merr në analizë rastin e ngritjes në krye të Partisë Socialiste të Shqipërisë, të një politikani që përkon me modelin mediatik po t'i referohemi literaturës së komunikimit politik bashkëkohor. Rasti studimor i politikanit mediatik na shërben këtu për të nxjerrë në pah pikërisht pasojat e dukurisë së mediatizimit dhe personalizimit të politikës për partitë politike në kontekstin shqiptar të pluralizmit të ligjëruar politik, pas rënies së regjimit monist.

Hyrje: Shfaqja e populistit mediatik

Shqetësimi më i madh i shprehur nga studjuesit e politikës është cënimi i qëndrueshmërisë së institucioneve partiake dhe demokratike nën ndikimin e dukurive të tilla si mediatizimi² dhe personalizimi i politikës. Studiuesit sugjerojnë gjithashtu se në kontekstin e një vendi me demokraci të re, implikimet mund të jenë edhe më problematike sesa në vendet me demokraci të zhvilluara, ku institucioni i partisë politike është më i konsoliduar. Sipas Sëanson dhe Mancini-it, 'personalizimi politik është sidomos i papërshtatshëm për demokracitë e reja, sepse mund t'i pengojë partitë politike *per se* që të fitojnë besimin në sytë e publikut si

¹ Ky artikull i përgatitur për konferencën "Partitë politike shqiptare: 20 vjet pas ligjërimit të pluralizmit politik". Ai është version i rishkruar i një pjese të monografisë së publikuar nën titullin "Edi Rama, politikani pop(ulist)-star" nga UET Press.

² Termi 'Mediatizim' shpjegon ndërfitjen e mediave në domenin politik sipas Mazzolenit dhe Schulz. Një fenomen i tillë është domethënës në sfondin e perspektivave teorike të shqyrtuara deri tani në këtë studim, pasi ndërthën procese dhe zhvillime bashkëkohore të kompleksit të media-politikës. Mund të rezultojë kësajsoj i nevojshëm për vlerësimin e magnitudës së depërtimit të mediave në domenin politik, pa tentuar të sugjerojmë domosdoshmërisht një rol primar të mediave në kontekstin post-komunist.

përfaqësuese të vërteta, duke mbetur thjesht platforma të një lideri populist' (1996, f.272).

Mirëpo, media dhe lidhshiptari populist konsiderohen si magnetë në raport me njëri-tjetrin, sepse 'liderët populistë u përshtaten më së miri kornizave rrëfyese të mediave' (Kellner 1990, 112). Vetë masmediat, dhe veçanërisht televizioni, krijojnë madje kushte për lindjen e formave të reja të populizmit ose neo-populizmit³ (Street, 1997). Këto marrëdhënie të dyanshme dashurie ndërmjet mediave dhe politikanëve populistë shihen gjithashtu me shqetësim nga studjuesit e politikës. Sipas tyre, duke u ofruar vizibilitet të gjerë liderëve populistë, media si 'video-politikë' – për të përdorur një term të Giovani Sartorit (1998) – mund të shndërrohet në një mjet të shkëlqyer për të shmangur kanalet institucionale si partitë politike (Gilbert, 2007).

Me pak fjalë, frika nga mediatizimi dhe personalizimi i politikës apo populizmi mediatik lidhet pikërisht me pasojat e mundshme të këtyre dukurive për strukturat organizative të partive politike, duke sjellë jo thjeshtë dhe vetëm rënien e këtyre të fundit nën pushtetin e mediave, por edhe dobësimin e shturjen e vetë partive politike. Megjithatë politika e partive nuk konsiderohet asesi e varrosur, ekziston konsensusi ndërmjet studjuesve se qendrën e politikës tani e dominojnë politikanët e orientuar kah mediat (Mazzoleni, 2003). Në kushtet e kësaj influence mediatike, partitë politike sipas Sëanson dhe Mancinit (1996) kanë marrë atributet e konfederatave 'gjithëpërfshirëse' pa programe të definuara, duke adoptuar teknika elektorale të orientuara kah mediat, që mjegullojnë diferencat pragmatike ndërmjet partive politike (Weyland, 1999)⁴. Kështu, ndërsa strukturat organizative të partive politike po bëhen gjithnjë e më të dobëta, mungesa e lidhjeve të forta ideologjike me votuesit po u krijon kësaj mundësinë politikanëve individualë që ta personalizojnë politikën, duke reflektuar kështu një atomizim të pushtetit⁵. Kjo do të thotë se pushteti individual i disa politikanëve mund të jetë rritur, por

³ *Neo-populizmi* është një kombinacion i neo-liberalizmit me populizmin, përshkruar si paradoksi i ri. Kemi të bëjmë pra me një lidhje ndërmjet dy opsionesh politike që duken krejt të papajtueshme. Me pak fjalë, neo-populizmi është strategji politike dhe ekonomike e dirigjuar nga lart dhe që ka për qëllim të forcojë njëherësh shtetin dhe tregun. Për ta arritur këtë, liderët neo-populistë duhet të perceptohen nga populli si 'reformues të sinqertë', aksioni i të cilëve pasqyron vullnetin popullor. Ky hibrid i retorikës populiste si strategji politike dhe i ekonomisë së tregut të lirë është identifikuar veçanërisht në vendet e Amerikës Latine dhe të Evropës Lindore.

⁴ I pajtueshem me një sërë polesh ideologjike, studjuesit shpjegojnë se populizmi mund të levizë me lehtësi nga linjat partiake të majta tek ato të djathta (Legler, 2006; Torres, 2006; Knight, 1998).

⁵ Sipas Sëanson and Mancini 'Ndryshimet janë pjesë e një procesi ciklik ku pushteti rrjedh nga struktura partiake që përbën ndërmjetësen tradicionale të konsensusit politik tek politikanët individualë duke sjellë një rënie të aftësive të partive politike për të menaxhuar institucionet politike dhe për pasojë, rënien e aftësisë institucionale për të vepruar efektivisht'.

pushteti institucional i partive politike është në rënie. Punët kanë shkuar deri aty sa ndodh që vetë partitë politike ta shohin me nderim dhe magjepsje kandidatin e vet që fiton simpatinë e mediave. 'Partive nuk u mbetet pra veçse të vënë vulën e aprovimit për atë që media në të vërtetë ka zgjedhur' (Meyer, 2002: p.102).

Duke iu kthyer rastit tonë studimor, është pikërisht konfirmimi si protagonist dhe aktor efikas të politikës nga ana e mediave, që e ka bërë Edi Ramën të pranueshëm edhe brenda vetë strukturave politike të Partisë Socialiste. Kjo e fundit madje e ka duruar në heshtje vijimin konstant të një ligjërimi anti-politik nga ana e tij. Edhe pse ligjërimi i Ramës përtej të Majtës dhe të Djathtës, që shënon edhe momentin e tij hyrës në Partinë Socialiste, vijon një konstante mediatike të tij që nga koha kur bënte publicistin pa ideologji, ky ligjërim në vetvete përbën një linjë ideologjike të mirëfilltë, që rezonon pikërisht me atë të populizmit. Është e njohur tashmë sentenca e tezës së tij se 'për mua njerëzit e këtij vendi janë në radhë të parë shqiptarë me të njëjtat ëndrra dhe halle përpara se të jenë socialistë apo demokratë' (Panorama, 12 korrik 2008; f5).

Në terma pragmatistë, pretendimi i tij *Përtej të Majtës dhe të Djathtës* ka patur për qëllim që të mbledhë rreth projektit të *Politikës së Re* elektoratin gri ose siç i quan ai 'të zhgënjyerit nga 'politika e vjetër'. I rreshtuar edhe vetë në kampin e 'qytetarëve të zhgënjyer' nga politika shqiptare në përgjithësi, me anë të këtij ligjërimi përgjithësues, pa bosht ideologjik, Rama ka synuar sigurisht të zgjerojë spektrin e mbështetësve të tij me votues edhe nga zonat rurale dhe të marxhinalizuara. Mirëpo, prej këtyre zgjedhjeve praktike dhe instrumentalizuese, burojnë edhe shqetësimet teorike rreth politikanit populist, që bën të veten gjuhën jo-politike dhe gjithëpërfshirëse, përkundër logjikës së përfaqësimit, asaj të alternativës dhe të mundësisë së zgjedhjes politike, në mënyrë që të mund të themi nëse është i mirëqenë apo jo pluralizmi politik në Shqipëri.

Më tej në këtë punim do të vështrijmë shkurtimisht si është injektuar në politikën e qendrës përmes mediave kryetari i Partisë Socialiste të Shqipërisë, Edi Rama. Do të përpiqemi të shpjegojmë nëpërmjet këtij ilustrimi se çfarë do të thotë kjo ndërfitje për mediat dhe partitë politike në vendin tonë. Së fundi, do të përvijojmë prirjen dhe perspektivën e marrëdhënies së politikanit me mediat nën dritën e zhvillimeve të reja në të dyja hemisferat.

Ardhja e politikanit mediatik

Në hapësirën publike shqiptare Edi Rama ofroi fillimisht modelin e politikanit të ri për t'i shpërfaqur më vonë ngjyrimet neo-populiste. Ndërsa sot një pjesë shohin tek ai demagogun ekstravagant, në krye të herës perceptimet pajtoheshin në tepër në lidhje me profilin e një politikani modern. Ai u vëzhgua si 'specie e re' që sillte kontributin e stilit në kulturën politike shqiptare që pas rënies së

regjimit diktatorial. Kjo risi iu njoh pa vonesë nga mediat të cilat i ofruan vizibilitet maksimal që në fillim. Në kohën kur gama e televizioneve private nuk ekzistonte ende në tregun mediatik në Shqipëri, shtypi meriton të konsiderohet me më tepër vëmendje, pasi kishte rol të rëndësishëm në fabrikimin e imazhit të aktorëve politikë. Në këto rrethana, revistat dhe të përditshmet e kohës i dedikuan Ramës tituj sensacionalë dhe kopertina provokuese (shih Klan, Spekter, Koha Jone, Gazeta Shqiptare). Shtypi i shkruar nisi kësaj procesin e fabrikimit të tij si politikan jashtë kornizave partiake, duke e veçuar nga politikanët tradicionalë.

Edi Rama e niste udhëtimin e tij të pazakontë në arenën politike shqiptare i stilizuar si intelektual modern, duke tërhequr kësaj vëmendje të veçantë. Gazetarët e njohur të kohës e cilësuan 'simbol të një intelektualit të pavarur dhe ekstravagant në vendin më të varfër të Evropës' duke nënvizuar se përfshirja e tij në politikë si Ministër Kulture ishte një befasi për faktin se 'për një kohë të gjatë ai ishte konsideruar rebeli, anti-konformisti dhe provokuesi i pushtet-mbajtësve' (Bejtja: Klan 07.06 1998). Gazetarë të tjerë e quajtën një Don Kishot në politikë apo Njeri të Shpresës (Xhunga: 'Koha Jone', 23.04.1998). Ata madje anonçuan në titujt e artikujve kushtuar Ramës parabola të tilla si 'Fenomeni Rama' apo 'Casus Rama' (Bejtja, Xhunga: po aty). Edhe spektri i intelektualëve dhe njerëzve të shoqërisë civile e simpatizoi aktorin më të ri të politikës shqiptare. Megjithatë nuk munguan zërat skeptikë dhe kritikët e hapur, mbështetësit e dominuan opinionin mediatik, ndërsa superlativat nuk u kursyen: 'E konsideroj emërimin e Edi Ramës si shenjë emancimi për politikën shqiptare' (Isaku, Koha Jone, 23.04.1998). 'E konsideroj emërimin e tij një ngjarje të rëndësishme e cila duhet përshëndetur dhe duartrokitur, sepse Edi Rama nuk është vetëm një artist i jashtëzakonshëm, por edhe një politikan profesionist' (Xhafferri, po aty.).

Duke imituar modele të tjera të suksesshme të politikanëve mediatikë në arenën ndërkombëtare, por duke investuar edhe një farë origjinaliteti dhe karizme personale, Edi Rama diti të tërhiqte vëmendjen e mediave dhe ta ushqente vazhdimisht atë. Profili i parafabrikuar i stilistit të ri të politikës u servirej me lehtësi mediave dhe gazetarëve të cilët, nga ana e tyre, e panë si novator dhe autentik. Ai do të bëhej shumë shpejt trazovaçi i dashur i mediave për performancat e tij shpesh të pacipa, duke fituar qendrën e vëmendjes dhe të debatit. Gjestet dhe performancat simbolike përbënin kapitalin e tij primar politik⁶. Duke u vendosur në qendër të vëmendjes, do të kritikohesh gjithnjë e më shpesh, por sërish kjo shihej pozitivisht nga mediat: 'Edi Rama, hipi për kundërshtarët, aleat vetëm me veten: Ky është njeriu i ri i kulturës' komentohej ai në 'Klan' (Balla, 19 prill 1999).

⁶ Rama i thirrur në interpelancë plenare nga Deputetët e Parlamentit shfaqet një hop dhe largohet brenda pesë minutash duke deklaruar se nuk kishte kohë për të humbur pasi deputetët ishin me vonesë. Sjellje të tilla provokonin debate dhe kritika për sjellje arrogante por i siguronin atij simpatinë e 'rebelit' (Spekter, 1999).

Një lexim i performancës së Ramës në termat e mësipërm, estetikë dhe stil personal, ka për qëllim të hedhë dritë pikërisht në terrenin e nëndheshëm të politikës së tij, që është ajo e përpunimit të emocioneve më tepër sesa arsyes, që ka të bëjë pra jo me kërkimin e racionalitetin njerëzor në gjykimin ndaj tij dhe të politikave të tij, por me kërkimin dhe përpunimin e emocioneve me qëllim përfshirjen emocionale dhe subjektive të elektoratit në projektin e tij politiko-mediatik. Kjo do të thotë që, nëpërmjet akteve estetike, Rama kërkon të fitojë vëmendjen emocionale të publikut në një kohë kur 'politikat e reja të emocionit dhe përfaqësimit estetik janë mjaft të përhapura në botën e sotme' (Ankersmit, 2002).

Të servirësh mediat, të bëhesh vetë media ?

Edhe në fazën e konsolidimit të figurës së vet si politikan nga Ministria e Kulturës në krye të Bashkisë së Tiranës dhe së fundi në krye të Partisë Socialiste, ka shumë për të thënë dhe analizuar në aspektin e marrëdhënies politikan-media. Në mënyrë që të bindë për cilësinë dhe substancën e performancës së tij, Rama ka përdorur me efikasitet metodat e marketingut dhe marrëdhënive publike. Për këtë qëllim i kanë shërbyer edhe më mirë se gazetaret televizionet, në kohën kur po mbërrinte bumi i ofertës televizive në tregun mediatik shqiptar. Megjithatë profili i Ramës u stilizua së pari nga mediat e shkruara, i ndihmuar nga aftësitë e tij imazh-projektuese deri diku intuitive, Rama e shndërroi veten në politikanin pop-star që aspironte përmes përdorimit koshient të mediumit televiziv.

Ky proces do të evoluonte deri në pikën e shndërrimit të Ramës në një 'agjenci publicitare' të vetvetes. Ka ditur ta servirë median ditë pas dite, duke siguruar një mbulim të plotë të aktiviteteve të tij dhe ndërtuar një tablo narrative më të gjerë që e paraqet si të suksesshëm. Marketingu i vetvetes përbën pra strategjinë e tij kryesore të pushtetit. Në të vërtetë, askush tjetër përpara tij nuk e kishte performuar politikën në arenën mediatike të post-komunizmit si Edi Rama. Jo thjesht në aspektin e personalizimit, por edhe të profesionalizimit, duke huazuar teknikat e marketingut dhe eksploruar strategjitë e marrëdhënive publike.

Për tre mandate rresht në krye të Bashkisë së Tiranës, Rama nuk e ndali kurrë fushatën e tij personale politike nëpërmjet mediave. Ekspert në marketimin e punës së tij, Rama ia ka dalë për një kohë të gjatë të sigurojë mbulim të efektshëm për çdo aktivitet të tij si kryetar bashkie, duke i ftuar kamerat të ndjekin çdo detaj të shfaqjes së tij. Për shumë kohë asnjë edicioni lajmesh në kanalet më të rëndësishme televizive në vend nuk i mungonte kronika për punën e Kryetarit të Bashkisë. Axhenda e tij e punëve ka patur vizibilitet publik të jashtëzakonshëm, pikërisht në sja të paraqitjeve mediatike bujare.

Shfaqja e politikanit-media

Ndërkohë mjedisi mediatik shqiptar ka njohur së fundmi edhe një zhvillim të ri, shfaqjen e politikanit-media. Nuk është rastësi që ky zhvillim lidhet me emrin e Edi Ramës, që ka mishëruar në Shqipëri edhe prototipin invers, atë të politikanit produkt të mediave, i cili nuk doli në politikë nga mjedisi partiak, por nga “oxhaku” i mediave. Kjo risi përkon me një prototip të ri komunikuesi politik, atë të politikanit që bëhet media. Edhe pse kjo nuk është tentativa e tij e parë si politikan për të marrë funksione mediatike, për herë të parë kemi daljen e tij me një media të institucionalizuar si e tillë, siç është faqja në internet eëë.edirama.al. Për kreativitetin me të cilin po e menaxhon vetveten online dhe për formën e zgjedhur, që është ajo e përdorur fillimisht nga industria hollivudiane për të menaxhuar imazhet e yjeve të saj, që po dilnin jashtë kontrollit, ky riformatim mediatik i Ramës duket sikur i rikthen atij shkëlqimin e humbur prej artisti dhe ylli mediatik si edhe hap shtigjet e dëshiruara prej tij në mënyrën se si të tjerët do ta referojnë, në përpjekje për të disiplinuar ose përmbajtur klimën kritike ndaj tij.

Mirëpo, kjo dalje e politikanit Rama me një paketë mediatike të vetën, që shkon nga mesazhet e shkurtra në të titter, tek shkëmbimet e natyrës dialoguese në blog, e deri tek rrëfimet e gjata monologuese në një libër, përmban edhe rreziqet e preokupimet e veta për mjedisin mediatik dhe atë politik në Shqipëri, pa përjashtuar efektet kundërtënëse për vetë Ramën. Duke i vendosur në kontekstin e zhvillimeve shqiptare në lidhje me mediat, politikën dhe së fundi rrugëtimin politik të Edi Ramës, këto taktika dhe korigjime komunikative të një protagonistit të politikës dhe të mediave paraqesin në radhë të parë vështirësi dhe sfida të reja për mediat në Shqipëri.

Është e qartë se Media-Rama nuk përbën thjesht një media më shumë, në shërbim të pluralitetit të zërave mediatikë në këtë vend. Madje, do të ishte qesharake po të shihej thjeshtë nga kjo perspektivë, pasi zëri i tij është ai i pothuajse gjysmës së shqiptarëve dhe dëgjohet ngado lirisht në këtë vend, sipas cilësisë së performancës së tij. Pra, në mos qoftë e tepërt si media, është sëpaku jo domosdoshmëri për demokracinë, fjalën e lirë dhe komunikimin politik në Shqipëri. Një arsye tjetër për ta konsideruar me shqetësim median-Rama është anashkalimi dhe sfida e qëllimshme që u bën mediave tradicionale si shtypit të shkruar dhe televizionit tani që nuk arrin t'i përballojë më ato me optikat e tyre të lira. Gjetja për t'i penetruar gazetat dhe ekranin e vogël në mënyrë indirekte, përmes joshjes virtuale, cicërimave në të titter dhe fragmenteve nga libri i vet të cilat i përzgjidhte vetë përpara publikimit të tij, është një hile ose taktikë që fillimisht funksionon, por që duhet lexuar qartë si një përpjekje për të nxjerrë jashtë loje aparatit përzgjedhës dhe interpretues të vetë mediave, duke marrë vetë rolin e tyre si “gate-keep-ers” si edhe duke përcaktuar vetë axhendën e tyre.

Edhe pse mund të duket e dëshiruar si formë e komunikimit politik nga vetë politikanët, një media virtuale si ajo e Edi Ramës nuk ka asnjë lidhje me pjesën dërrmuese të elektoratit të një subjekti partiak në Shqipëri dhe si e tillë është një ushtrim snobizmi dhe ekstravagance politike. Është gjithashtu një ushtrim *personalizimi* i skajshëm, që përbën një sfidë të hapur ndaj partisë politike si *forum* dhe *kolektivitet*. Është fiks në stilin e yjeve të Hollivudit dhe nuk është çudi që edhe politikanët botërorë që e përdorin më me zell kanë ose statusin e yjeve nacionale ose atë të ekstremistëve politikë, duke filluar që nga Obama të cilit nuk i mungon një eëë.barackobama.com e deri tek Hugo Chavez me eëë.chavez.org.ve. Mirëpo, në Shqipëri Rama është ende politikan i vetëm që e merr seriozisht veten si media online, edhe pse brenda opozitës disa politikanë përdorin me një lloj efikasiteti facebook-in si media për të komunikuar mesazhet e tyre. Si e tillë, dalja e politikanit Rama si media krijon pabarazi brenda llojit të vet, ashtu si edhe në raport me kundërshtarët politikë, që duket qartë se i ka lënë pak mbrapa në përdorimin më të ri teknologjik. Efekti më afatgjatë i medias Rama do të jetë sigurisht edhe përfshirja e politikanëve të tjerë në garën virtuale me “të titter” e blogje, gjë që nuk mund të themi se do ta bëjë politikën më të mirë, në mos e bëftë më të keqe.

Përfundime

Në peisazhin e mediave dhe politikës në vendet me demokraci të re ose pluralizëm politik të vonuar si Shqipëria, një nga dinamikat më të përhapura ka të bëjë pikërisht me Mediatizimin dhe Modernizmin e komunikimit politik. *Mediatizimi i politikës* sipas studjuesve është tanimë një fenomen që po përhapet në arena politike nga më të ndryshmet rreth botës si një model i ri ndryshimi. Ai ka të bëjë në thelb me ndërfitjen e mediave në domenin e politikës. Zhvillime të ngjashme janë në proces në kontekste kombëtare nga më të ndryshmet (Mazzoleni dhe Schulz, 1999). ‘Mediatizimi është në fakt një fenomen i përbashkët për sistemet politike të shumicës së vendeve demokratike ku varion në proporcione dhe po zhvillohet me ritme të ndryshme’ (po aty: f.249). Kësisoj, studjuesit sugjerojnë që aktorët e sotëm politikë i nënshtrohen procesit të *mediatizimit* që po fiton terren me shpejtësi si rezultat i ekspansionit dhe komercializimit të sistemeve mediatike.

Në kushtet bashkëkohore të mediatizimit, marrëdhëniet publike dhe teknikat e marketingut kanë fituar gjithashtu rol parësor brenda partive politike, qeverive dhe në kupolën e lidhshme të liderit modern (Franklin, 2004; Davis, 2002; Blumler dhe Kavanagh, 1999; Scammell, 1995). Sipas ekspertëve të komunikimit politik, praktika të tilla si përzgjedhja e kandidatëve për shkak të imazhit tërheqës që ata projektojnë në TV, ose mbështetja tek ekspertët e PR që këshillojnë kandidatët në lidhje me strategjitë mediatike, përbëjnë tanimë karakteristika të përbashkëta

anekënd globit (Negrine dhe Papathanassopoulos, 1996). Modernizimi dhe i ashtuquajtur *Amerikanizim i procesit politik*, sidomos në periudha zgjedhjesh elektorale, shihet gjithashtu si një trend i ri i komunikimit politik edhe për vendet ish-komuniste. Këto vende 'janë shndërruar në tregje konkurruese për këshilltarët dhe ekspertët amerikanë të komunikimit për shkak të përhapjes së teknikave amerikane me orientim tregun për organizimin e fushatave elektorale' (Plassers, 2000).

Për pasojë, në sajë të dukurisë së mediatizimit, në shumë demokraci të reja, politikanët më të spikatur kanë fituar statusin e yjeve. Kjo ka ndodhur edhe me ndihmën e gazetarëve, të cilët janë të etur për të paraqitur transgresionet e politikanëve. Personaliteti dhe karakteri shihen gjithashtu si komponentë qendrorë të figurës së politikanit në kulturën politike moderne dhe vlerësohen veçanërisht nga mediat (Negrine dhe Stanyer, 2007: 238). Kësisoj, mediat kanë një kontribut të konsiderueshëm në ndërtimin e imazheve 'mitike', duke u dhënë disa aktorëve të politikës atributet e heronjve që frymëzojnë shpresë dhe besim (Parry-Giles 2002: f 24-26). Studjuesit vënë re një evoluim të vetë statusit të politikanit në kushtet e politikës së orientuar kah media, pasi politikanët tanimë propozohen si modele shoqërore për t'u simpatizuar dhe imituar (Ëest and Orman, 2003). Reporterët preferojnë gjithnjë e më tepër t'i ndërtojnë historitë e tyre rreth këtyre figurave rrezëllitëse të kinemasë politike. Përgjithësisht masmediat luajnë pra një rol shumë të rëndësishëm në inkurajimin e procesit të personalizimit të politikës (Mancini dhe Swanson, 1996).

Mirëpo, kur zhvillime të tilla shihen nga perspektiva e vendeve me demokraci të re, një pjesë e akademikëve vënë syzet kritike duke sugjeruar se 'komunikimi politik modern në kontekstin e një sistemi mediatik të parregulluar ende mirë, i cili karakterizon vendet me demokraci të brishtë, mund të rezultojë më tepër i dëmshëm sesa produktiv për formimin e institucioneve të qëndrueshme dhe angazhimin qytetar' (Bennett, 1998). Sipas Bennett, procesi i Amerikanizimit dhe trendet e Modernizimit të komunikimit politik nuk i kanë shërbyer stabilitetit demokratik të vendeve post-komuniste si për shembull Polonisë apo Rusisë. Ai pohon se demokracia kërkon *rrjete sociale dhe organizata politike filtruese* (parti, unione dhe institucione të tjera sociale) për të ankoruar dhe orientuar komunikimin politik që vjen befasisht nga kanale të jashtme dhe të zhurmshme. Në tërësi, ai parashikon që komunikimi i lirë politik mund të prodhojë shpesh efekte dekurajuese për stadin e ardhshëm të ndërtimit të institucioneve demokratike.

Në analizë të fundit të rastit tonë studimor, mund të jetë e vështirë të ndërtohet një tablo të implikimeve të mëtejshme të projektit të Edi Ramës për fashitjen e dallimeve ndërmjet linjave partiake në Shqipëri, por evidenca në lidhje me strategjinë homogjenizuese për të fituar pushtet, është mëse e qartë në projektin e tij fillestar në krye të Partisë Socialiste, ashtu sic po bëhet evidente strategjia e tij e re me theksin sërish tek mediat dhe jo forumin politik. Edhe pse në Shqipërinë

post-komuniste partitë kryesore të të dyja kampeve janë zhvendosur njëlloj drejt qendrës, rasti i Edi Ramës mbetet unik për nga niveli i përgjithësimit dhe refuzimi i të gjitha ideologjive ekzistuese si të pamjaftueshme për shoqërinë shqiptare. Për pasojë, në përputhje të plotë me pritshmëritë nga liderët dhe platformat populiste, rruga e re apo rruga e vetme janë propozuar prej tij si e vetmja zgjedhje. Duke huazuar deri edhe nga e djathta radikale, Edi Rama pretendon që *Politika e tij* është zëri i 'demokracisë së vërtetë' dhe u përgjigjet 'nevojave popullore të injoruara nga partitë politike shqiptare', ndërsa kërkon rregullisht sa herë ka zgjedhje jo ndryshimin e ngjyrave politike, por 'transformim të natyrës së pushtetit' (Rama: Panorama, 12 korrik 2008).

Bibliografi

- Ankersmit, Frank (2002), *Political Representation*, Stanford: Stanford University Press
- Balla, Sokol, 'Edi Rama, hipi për kundërshtarët, aleat vetëm me vetveten. Ky është njeriu i ri i kulturës', *Klan*, 19 prill 1999, p.16-18
- Bejtja, Andi, 'Fenomeni Edi Rama' (Edi Rama Phenomenon) *Klan* No:61, 7 June 1998. p26.
- Belina Budini (2009), *Edi Rama, politikani pop(ulist)-star*. Tirane: UET Press
- Bennett, Lance Ë. and Entman, M. Robert (eds.) (2001), *Mediated Politics: Communication in the Future of Democracy*. Cambridge University Press
- Bennett, Lance.Ë (1998) *The Media and Democratic Development: The Social Basis of Political Communication* in O'Neil, Patrick ed, *Communicating Democracy*: Lynne Rienner Publishers
- Blumler, Jay G. and Kavanagh, Dennis (1999) 'The third age of Political Communication: Influences and Features' in *Political Communication*, vol. 16, no 3, pp.209-225
- Corner, John and Pels, Dick (eds) (2003), *Media and the Restyling of Politics: Consumerism, Celebrity and Cynism*, London: Sage
- Franklin, Bob (2004), *Packaging politics. Political Communications in Britain's Media Democracy*, London: Arnold
- Kellner, D. (1990), *Television and the crisis of democracy*. Boulder, Colo: Ëestvieë Press
- Mazzoleni, Gianpietro and Schulz, Winfried (1999), *Mediatization of politics: a challenge for democracy?* in *Political Communication*, 16: p.247-261, Taylor and Francis.
- Mazzoleni, Gianpietro, Julianne Steëart and Bruce Horsfield (2003), *The Media and Neo-Populism, a Contemporary Comparative Analysis*, Ëestport: Praeger Publishers

- Meyer, Thomas and Hinchman, Leë (2002), *Media Democracy: How the Media Colonize Politics*: Polity Press
- Negrine, Ralph; Stanyer, Jay. (ed) (2007) *The Political Communication Reader*, London: Routledge
- Negrine, Ralph and Papathanassopoulos, Stylianos (1996), 'The Americanization of Political Communication, a Critique' in Harvard Journal of Press and Politics, Vol.1 No.2, pp.45-61
- O'Neil, Patrick (1998), (ed) *Communicating Democracy: The Media and Political Transition*: Lynne Rienner Publishers
- Rama, Edi 'Opozita jone e ka fuqine te forca e arsyes' *Panorama*, 12 July 2008, p.4-5 ,
- Plasser, Fwith Plasser, G (2000), *Global Political Campaigning. A eoldëide analysis of campaigning professionals and their practices*, Eëstport, CT: Praeger
- Sartori, Giovanni (1998), *Homo Videns: the Telly-led Society (Spanish edition)* Homo Videns - La Sociedad Teledirigida): Aguilar
- Street, John (2003), 'The celebrity politician. Political style and popular culture' in Corner, John and Pels, Dick eds (2003), *Media and the Restyling of Politics: Consumerism, Celebrity and Cynism*, London: Sage. p85-98
- Street, John (2001), *Mass media, politics and democracy*; London: Macmillan
- Street, John (1997), *Politics and Popular Culture*; Cambridge: Polity Press
- Swanson, David, L., Mancini, Paolo (1996) *Politics, Media and Modern Democracy: An International Study*; Westport: Praeger
- Xhunga, Rudina, 'Edi Rama, Një Don Kishot në Politikë', *Koha Jonë*, 23 prill 1998. f.32.
- West. M. Darell and Orman, John (2003), 'The Evolution of Celebrityhood'in *Celebrity Politics: Upper Saddle River*, Neë York: Prentice Hall, pp1-16.
- Weyland, Kurt (1999) "Neoliberal populism in Latin America and Eastern Europe". *Comparative Political Studies*, Vol. 31, No 4

Partitë politike shqiptare dhe tëhuajtësimi i qytetarëve ndaj politikës: Bilanc pas 20 vitesh pluralizëm partiak

Gilman BAKALLI, Ph.D.

Abstrakt. *Tëhuajtësimi i shqiptarëve ndaj ndaj demokracisë dhe partive politike në përgjithësi ka njohur veçse rritje gjatë këtyre dy dekadave të pluralizmit politik në Shqipëri. Partitë politike shqiptare kanë punuar sistematikisht për inkurajimin e këtij fenomeni të tëhuajtësimi, duke mos toleruar asnjë referendum popullor, asnjë zgjedhje direkte në postet e larta shtetërore si dhe duke mbështetur një sistem zgjedhor, i cili nuk inkurajon më zgjedhjen e deputetëve direkt nga zgjedhësit, por paraprakisht nga partia. Artikulli i mëposhtëm reflekton në lidhje me mundësitë konkrete për ta nxjerrë demokracinë shqiptare nga statusi i saj teatral e autoreferencial dhe për ta transformuar atë në një sistem që lejon përfaqësim direkt dhe i përgjigjet problemeve afatgjata të shoqërisë.*

Hyrje

Imagjinoni një traget të madh pasagjerësh duke lundruar nëpër Mesdhe. Në kuvertën e tragetit ka disa shezlongje. Herë pas here janë të gjitha të zëna, ndonjëherë, me pak fat, arrin ta kapësh ndonjë shezlong të lirë. Për javë të tëra i njëjti skenar përsëritet në të njëjtën formë. Derisa një ditë gjithçka ndryshon. Diku, në një qytet port në traget ngjitet një grup i madh njerëzish, që e njohin njëri-tjetrin. Ato zaptojnë të gjitha shezlongjet dhe, sa herë që ndonjërit prej tyre i duhet të largohet nga kuverta, shokët ia ruajnë vendin duke vendosur një peshqir. Disa pasagjerë nervozohen për situatën e krijuar. Anëtarët e grupit-klan reagojnë ndaj këtij zemërimi në forma të ndryshme: disa duke ia kthyer me të njëjtën monedhë, kurse disa të tjerë duke u ofruar të pakënaqurve një marrëveshje. Sipas kësaj marrëveshjeje, disa nga të përjashtuarit nga përdorimi i shezlongjeve mund

të ndihmojnë në monitorimin e tyre. Si shpërblim, atyre u lejohet t'i përdorin shezlongjet kur këto nuk janë në përdorim nga anëtarët e grupit-klan. Disa nga të përjashtuarit e pranojnë këtë marrëveshje.

Ndërsa pak më parë kishim një grup me të drejta të barabarta sa i takon përdorimit të shezlongjeve, tani në kuvertë kemi tre grupe: pronarët e shezlongjeve, shërbëtorët e tyre me përfitime minimale, dhe të përjashtuarit nga përdorimi i shezlongjeve. Një revolucion që do ta përmbyste këtë rend duket se është i pamundur. Jo vetëm pronarët e shezlongjeve, por edhe shërbëtorët e tyre dinë ta pengojnë atë po qe nevoja.

Kjo histori tregohet rreth viteve '80 nga sociologu gjerman Heinrich Popitz në librin e tij "Fenomene të pushtetit" (Popitz, 2004). Ideja që ajo përcjell është e qartë: nëse askush nuk e monitoron një rend demokratik, herët a vonë do të krijohen struktura pushteti që do ta nxjerrin demokracinë nga menteshat e saj. Dhe aty ku më përpara sundonte barazia e të drejtave, do të sundojë rendi oligarkik.

A ka të bëjë me ne shembulli i mësipërm? Në thelbin e saj, demokracia supozohet të vërë në funksion vullnetin e popullit. Ajo funksionon mbi bazën e interesit që ka populli tek e mira e përgjithshme. E formuluar në mënyrë më patetike, demokracia është versioni politik i asaj etike që buron që nga koha e Aristotelit: krijimi i shanseve për një jetë të mirë për një numër sa më të madh njerëzish. A është përmbushur ky premtim në vendin tonë gjatë këtyre 20 viteve që nga rënia e komunizmit? Më saktë: a e kanë përmbushur këtë premtim ato instanca që presupozohet ta pasqyrojnë vullnetin e popullit, a e kanë përmbushur partitë politike premtimin për një jetë më të mirë për një numër sa më të madh njerëzish? Kam frikë se më duhet t'i përgjigjem negativisht kësaj pyetjeje.

Ka një përshpejtim të theksuar të tëhuajtësimi të popullit ndaj demokracisë dhe partive politike në përgjithësi. Partitë kanë punuar sistematikisht për inkurajimin e këtij fenomeni. Ndoshta edhe për shkak të një përvoje historike negative të popullit shqiptar, ato nuk kanë toleruar asnjë referendum popullor, asnjë zgjedhje direkte në postet e larta shtetërore, dhe tani së fundi, që nga 2009, kemi edhe deputetë që nuk varen më direkt nga zgjedhësit, por nga partia.

Problemi i mosbesimit të qytetarëve shqiptarë ndaj partive politike nuk është thjesht çështje e mohimit që politika i bën pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje. Është mbi të gjitha edhe një protestë kundër përpjekjes kokëfortë për të ruajtur status quo-në e pushtetit të tyre. Partitë politike në Shqipëri sot nuk punojnë më për reformimin e shoqërisë, por për të fituar në zgjedhjet e radhës. Prandaj nuk të habit fakti se partitë shqiptare po bëhen gjithnjë e më njësoj, ato nuk janë më vendi ku njerëz me ide e botëkuptime të njëjta apo të përafërta mblidhen për ta reformuar shoqërinë mbi bazën e një ideologjie. Zhargoni, përmes të cilit partitë përpiqen të diferencohen nga njëra-tjetra, është bërë tejet vulgar dhe banal dhe nuk i shërben më ruajtjes së identitetit të partisë, por thjesht përforcimit të skemës mik-armik.

Po pse vazhdon populli ta luajë këtë lojë edhe sot, pas 20 vitesh? Sepse askush prej nesh nuk e fut veten tek ajo masa anonime njerëzish që quhet "populli", ose, e thënë ndryshe, secili prej nesh është thjesht një teleshikues, i cili pas çdo debati politik apo talkshoë betohet me vete se nuk do të marrë më pjesë në këtë lojë pafund premtimesh të pambajtura. Në zgjedhje nuk shkon më, sepse nuk ndjehet më i përfaqësuar, duke e rritur kësajsoj partinë e abstenuesve. Politikanëve nuk u bën përshtypje kjo, kurse për demokracinë kjo është goditje e rëndë. Partitë nuk merren më me "popullin", sepse nuk u duhet më të merren me të; në rastin më të mirë ato merren me variantin e kondensuar të popullit nëpër sondazhe demografësh. Në agjendën e partive nuk ekziston më populli, me përjashtim të ndonjë fushate zgjedhore. Teatri politik nuk ka më nevojë për spektatorë. Partitë, politikanët, këshilltarët e marrëdhënies me publikun dhe institutet e sondazheve – të gjithë së bashku dhe kundrejt njëri-tjetrit lëshojnë prozhektorët e tyre dhe ndotin dritën e dijes morale. Ashtu si metropolet e mëdha, ato krijojnë atë fashën e dritës, e cila të pengon ta shohësh qiellin me yje. Një teatër të tillë, ku partitë dhe aktorët politikë luajnë me njëri-tjetrin pa praninë e audiencës, politologu britanik Colin Crouch e quan "postdemokraci". Ky term, sipas Crouch,

"nënkupton një bashkësi sociale, në të cilën mbahen zgjedhje periodikisht, të cilat mund të çojnë edhe në ndërrim qeverish. Por e veçanta është se gjatë fushatave elektorale debati publik kontrollohet aq fort nga kompanitë e MP apo mediat, saqë e gjitha kthehet në një spektakël të mirëfilltë, në të cilin paraqiten ato probleme, të cilat janë zgjedhur paraprakisht nga ekspertët. Shumica e qytetarëve luan thjesht një rol pasiv dhe apatik, thjesht si reagues ndaj sinjaleve që merren mediatikisht. Nën hijen e një inskenimi të tillë politik, real-politika zhvillohet pas dyerve të mbyllura: nga qeveritarët dhe elitat, të cilat para së gjithash përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat ekonomike"(Crouch 2004).

Si është e mundur atëherë që këto rituale dhe zakone vazhdojnë të ruhen të pandryshueshme? Nobelisti amerikan, ekonomisti Douglass North ka futur në fillim të viteve '90 konceptin "varësia nga shtegu" (Pathdependence). Në zanafillë, ky term përshkruan mënyrën se si teknologji të reja diktojnë edhe procedura të reja. Ka një diskrepancë ama midis asaj që dikton teknologjia dhe gatishmërisë sonë për ta pranuar atë. Shembulli që e ilustron këtë raport midis teknologjisë dhe inercisë së individit është tastiera klasike e makinës së shkrimit apo kompjuterit, tastiera QWERTY. Mënyra e renditjes së germave në tastierën klasike nuk i nënshtrohet aspak ndonjë logjike të caktuar. Shpikësi i saj, amerikani Christopher Latham Sholes, i renditi tastet në atë mënyrë që germat, që në përdorim ndodheshin më shpesh pranë njëra-tjetrës, të fiksoheshin sa më pranë njëra-tjetrës në tastierë. Me gjithë rrezikun që kjo afërsi sillte shpesh edhe

bllokimin e tyre. Ky problem pushoi së ekzistuari me avancimin e teknologjisë. Fakti që miliona njerëz në mbarë botën ishin mësuar tashmë me këtë lloj tastiere, bëri që specialistët ta respektonin prirjen njerëzore për t'iu përmbajtur së zakonshmes. Pra ndoqën të njëjtin “shteg”, në të cilin njerëzit qenë mësuar të ecnin për vite e vite. Edhe pse një shteg aspak logjik apo i argumentueshëm në aspektin ergonomik. North e aplikoi konceptin “pathdependance” në ekonomi, duke konstatuar se institucionet, duke ndjekur të njëjtat shtigje të rrahura ndër vite, krijojnë “një matricë institucionale”, e cila sa vjen e fuqizon vetveten. Pra, prioritet nuk kanë problemet e mirëfillta, por mënyra e perceptimit dhe e përpunimit të tyre nga institucionet.

E njëjta gjë vlen edhe për politikën. Partitë politike shqiptare kapin tema diskutimi jo për shkak të relevancës së tyre, por sepse këto tema premtojnë avantazhe politike. Kemi dy realitete paralele që ecin me shpejtësi diametralisht të kundërta brenda kësaj shoqërie të vogël: përballë realitetit politik të procedurave të tepërta e të ngurta, përballë një realiteti politik që operon me tema të stërdala mode, qëndron realiteti i një popullsie, e cila është gjithnjë e më moderne, liberale, më e arsimuar e me vetëdije më të lartë politike se para 20 vitesh. Kjo nuk mund të mohohet! Nëse politikanët mendojnë se populli është akoma në fazën e pubertetit, atyre u duhet kujtuar se nuk mund dhe nuk duhet t'i trajtosh fëmijët e rritur si të ishin fëmijë të vegjël, edhe pse ndonjë sjellje e tyre aty këtu mund të jetë e papjekur apo naive.

Ka edhe një mënyrë tjetër për ta shpjeguar faktin se pse populli vazhdon ta luajë të njëjtën lojë edhe sot, pas 20 vitesh pluralizëm politik: “shifting baselines”. *Shifting baselines* është një term që përdoret në psikologjinë sociale për fenomene, tek të cilat kufiri ndryshon gradualisht pa u vënë re prej nesh. I përkthyer lirisht, ky term nënkupton ndryshim gradual dhe të pakuptueshëm të atyre pikave të referimit që na kanë shërbyer deri tani për të vlerësuar diçka. *Shifting baselines* është produkt i aftësisë sonë të jashtëzakonshme për t'u përshtatur. Zhvendosja e vazhdueshëm e kufirit të normalitetit na ruan nga dëshpërimi. Nuk besoj se, në një moshë të thyer, vazhdojmë të kemi pikë referimi për të gjykuar gjendjen tonë trupore moshën 20 vjeçare, por vijmë gradualisht, duke i shtyrë kufinj të “normales”, duke u mësuar me brishtësinë tonë fizike.

Aq sa na ndihmon për ta ruajtur normalitetin tonë psikik, aq është e dëmshme si dukuri në raportin e individit me pushtetin apo me natyrën. Në raport me pushtetin *shifting baselines* prodhon qytetarë të bindur ndaj çdo abuzimi të pushtetit, ndaj çdo korrupsioni qeveritar. Kështu ka ndodhur edhe përjashtimin e qytetarit nga vendimmarrja për çështje të rëndësishme publike. Nëse duam të bëjmë diçka për të ikur sindroma e lodhjes prej partive dhe politikës së tyre duhet të zbatojmë atë çka thoshte Willy Brandt: mehr Demokratie äagen! (Të guxojmë për më shumë demokraci!)

Problemi është se për cilën demokraci duhet të guxojmë më shumë? Cilin

model demokracie duhet të mbrojmë? Modelin e shumicës, të cilin e kemi marrë si model nga vende të Europës Perëndimore, ndryshe e quajtur si demokraci e shumicës? Apo modelin e demokracisë konsensuale, siç ekziston në Zvicër, ku qeveria formohet mbi bazën e përqindjeve të votave të marra nga secila parti? Ideja e demokracisë së shumicës buron nga një kohë, kur partitë dalloheshin qartë nga njëra tjetra përmes ideologjish dhe botëkuptimesh, mbi të cilat ndërtonin programet e tyre. Ku janë sot këta ato diferenca ideologjike, të cilat mund ta justifikonin qeverisjen e njëres parti me pak më shumë vota duke lënë jashtë partinë me më pak vota? Në Zvicër, që nga viti 1959, qeveria përbëhet nga 7 anëtarë, duke u bazuar në numrin e votave të marra nga partitë. Avantazhi i këtij modeli është i dukshëm: në vend që të shpenzojnë energji nga mëngjesi në darkë për të bllokuar apo për ta dëmtuar njëra-tjetrën, partitë detyrohen të bashkëpunojnë dhe të bien dakord mes tyre. Kur për çështje delikate nuk bien dakord, partitë i drejtohen popullit për referendum. Politologu i shquar amerikano-holandez Arend Lijphart i Universitetit të Kalifornisë në San Diego i ka analizuar imtësisht gjatë tri dekadave dy modelet e mësipërme të demokracisë, atë të shumicës dhe atë konsensual, duke e konsideruar këtë të fundit, nga shumë këndvështrime, si më superior:

Modeli i shumicës e përqendron pushtetin politik në duart e një shumice të thjeshtë [...], ndërsa modeli konsensual synon të shpërndajë dhe ta kufizojë pushtetin në mënyra të ndryshme. [...] modeli maxhoritar i demokracisë është përjashtues, konkurrencial dhe gjeneron konflikte, kurse modeli konsensual karakterizohet nga përfshirja, negociimi dhe kompromisi. Kjo është arsyeja pse modeli konsensual është quajtur edhe “demokracia e negociimit”(Lipjhart 1997).

Meqë sistemi ynë politik nuk funksionon në mënyrë intrinzike, nga brenda, atëherë duhet parë për një zgjidhje nga jashtë. Një mundësi të tillë mund ta ofronte zgjedhja e një presidenti jopartiak, direkt nga populli. Natyrisht, qeveria shqetësohet me të drejtë se i vetmi autoritet shtetëror i zgjedhur direkt nga populli mund të fitojë rëndësi dhe domethënie të jashtëzakonshme. E në fakt pikërisht kjo është ajo për të cilën kemi nevojë: një figurë drejtuese jopartiake, e cila e lufton status quo-në me ide dhe reforma të reja. Jo thjesht një figurë që qetëson gjakrat e ndezur partiake, por që merr seriozisht shqetësimet e qytetarëve. Kështu p.sh. një president i tillë mund të krijonte një komision ekspertësh të fushave të ndryshme. Së bashku ata mund të propozonin ndryshime strukturore në sistemin tonë politik, të cilat partitë, për arsye që njihen, nuk mund t'i propozojnë apo aplikojnë vetë. Sigurisht që propozimet nuk do të kishin fuqi legislative, por do të duheshin argumente të forta nga ana e partive për t'i kundërshtuar ato, apo për të bllokuar zbatimin e tyre.

Duket se frika nga eksperimentimi, “varësia nga shtegu” (“shifting baselines”) e bëjnë të pamundur ndryshimin e kursit. Demokracia shqiptare, me sa duket është e dënuar të pranojë gjithçka – bllokimin, lodhjen nga politika, zgjedhje pafundësisht të diskutueshme – me përjashtim të ndryshimeve rrënjësore.

Bibliografia

Crouch, Colin: Post-democracy. Polity Press, 2004.

Lijphart, Arend. Patterns of Democracy: government forms and performance in thirty-six countries. Yale University Press, 1999.

Popitz, Heinrich: Phaenomene der Macht. Mohr Siebeck, Botimi i 2. 2004.

Ligji i hekurt i oligarkisë. Vështrim mbi demokracinë e brendshme të partive shqiptare

Dokt. Ina K. ZHUPA

Abstrakt. Ky punim jep një vështrim kritik mbi demokracinë e brendshme të partive politike shqiptare në këta 20 vjet. Punimi tenton të jepë kontribut për të treguar indikatorët matës të demokracisë së brendshme, pse është e domosdoshme dhe çfarë tregon mbi partitë dhe shtetin pasja apo mospasja e demokracisë së brendshme partiake. Studiohen statutet e partive kryesore deri sot në skenën shqiptare duke nxjerr në pah të gjitha modalitetet që ato përcaktojnë mbi demokracinë e brendshme. Ajo që vihet re është që “de juro” këto parti janë demokratike. Ndërsa nga ana tjetër është parë praktika e derisotme e trajtimit të mendimit ndryshe, përjashtimet dhe krijimit të partive të reja nga fraksione dhe “de facto” na rezultojnë që nuk janë demokratike. Për këtë arsye sugjerohen disa zgjedhje afatgjata që mund të çojnë në zbatimin de facto të demokracisë së brendshme partiake në Shqipëri.

Fjalë kyçe: demokraci, zgjedhje të brendshme, fraksion, mendim ndryshe, 1 anëtar-1 votë, parti politike.

Hyrje

S hfaqja e partive politike bëri të mundur kalimin nga kontrolli oligarkik-borgjez i pushtetit te demokracia konstitucionaliste moderne. Me të drejtë thuhet se demokracia aktuale është demokracia e partive dhe shpikja më e madhe në fushën e organizimit politik (Zampetti, 1973, f. 19). Pa ekzistencën e partive nuk mund të ketë demokraci autentike që do të thotë demokraci pluraliste.

Pa disa parti politike të qëndrueshme, duke marrë për bazë mbështetjen e tyre sociale dhe një organizim me kohezion dhe me disiplinë brendshme, një sistem demokratik, është e vështirë që të ketë vlera të vërteta. Në këtë kuptim, për shembull, sipas Kelsen demokracia është thelbësisht çështje procedurale (Kelsen, 1988, f. 210), dhe kjo shënjon atë që demokracia nuk është e konceptueshme pa ekzistencën e partive politike; me fjalët e tij “demokracia moderne mbështetet mbi partitë politike, rëndësia e të cilave rritet me forcimin progresiv të principeve demokratike” (Kelsen, 1992, f. 35-36).

Bile edhe sistemet me qeverisje autokratike, ashtu si edhe ne për 50 vjet në komunizëm, organizimi partiak (thënë më saktë monopartiak) luan një rol vendimtar. Ashtu siç thoshte Laski, në këto vende zgjedhjet janë si garat me kuaj ku merr pjesë vetëm një kalë. Pavarësisht kësaj, partia përbën qendrën e pushtetit politik brenda shtetit. Është e qartë pra që partitë politike bashkëpunojnë për formimin, shprehjen e vullnetit politik dhe drejtimin e shtetit.

Për këtë janë përcaktuar si “organizime qytetarësh që me ndihmën e organizatës së tyre aspirojnë të ndikojnë në një drejtim të caktuar mbi formimin e vullnetit të shtetit” (Friederich, 1975, f. 357- 358). Për sa më sipër deduktohet që partitë kanë një bazë bashkëpunimi, pra janë më të ndërtuara nga qytetarë që janë duke ushtruar të drejtën e tyre kushtetuese për t’u organizuar lirisht. Normalisht janë edhe mbartëse të një ideologjie të caktuar, ose të paktën një bashkim idesh dhe idealesh që lidhen me aspekte të ndryshme të jetës politike, sociale dhe ekonomike.

Partitë politike kërkojnë të forcohen, në radhë të parë, për të pasur më shumë votues/zgjedhës, në mënyrë që të kenë më shumë mundësi për të ndikuar, qeverisur apo drejtuar aktivitetin e shtetit. Le të kujtojmë që Heller-i me të drejtë thoshte: “Çdo pushtet politik, nga natyra e vet dhe nga prirja e tij ekzistenciale aspiron të shndërrohet në pushtet shtetëror” (Heller, 1955, f. 499). Pikërisht ky fakt na bën ne studiuesve edhe më të interesuar për jetën partiake sepse ajo në çdo moment mund të shndërrohet si model për jetën shtetërore të vendit; pas fitimit të zgjedhjeve nga partia. Gjithashtu demokracia e brendshme në një optikë tjetër mund të shikohet si mënyra e vetme për të parë tendencën demokratike, ose jo demokratike që mund të ketë partia pas marrjes së pushtetit dhe qeverisjes së vendit.

Kuptime dhe konceptime mbi demokracinë e brendshme partiake

Kur vjen puna për të folur dhe për të trajtuar demokracinë e brendshme, vështirësitë e para lidhen me përkufizimin e saj. Deri më sot nuk ka një mënyrë për ta përcaktuar dhe çdo herë varet nga qasja me të cilën pozicionohet studiuesi, ose edhe politikani. Demokracia e brendshme në një parti supozon adoptimin e parimeve të sistemit politik demokratik brenda këtij organizmi. Nga një perspektivë pluraliste kjo do të thotë që të përfshihet, brenda partive, kriteri

i konkurrueshmërisë, adoptimi i vlerave demokratike si liria e shprehjes, liria e zgjedhjes për anëtarët e vet dhe përdorimi i mekanizmave të ndershëm dhe të hapur në procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrjen e anëtarëve, ndjekësve dhe vullnetarëve të partisë dhe ekzistenca e disa kushteve që lejojnë ushtrimin efektiv të pushtetit politik.

Mirëpo lind pyetja: cilët mund të jenë disa nga indikatorët që mund t’i përdorim në një gjykim mbi demokracinë e brendshme partiake? Gjëja e duhur do të ishte adoptimi i atyre indikatorëve që përdoren edhe për të gjykuar mbi demokracinë e një vendi, por duke i përshtatur brënda në një sfond partiak. Të tillë mund të jenë:

Garantimi i barazisë mes anëtarëve dhe mbrojtja e të drejtave themelore për ushtrimin e lirisë së shprehjes; Mekanizmat përzgjedhës të kandidatëve që marrin pjesë në zgjedhjet (e jashtme dhe të brendshme) të jenë konkurruese; Pjesëmarrja e anëtarëve në organet e qeverisjes, të jetë pa asnjë lloj diskriminimi për grupet e ndryshme që përfaqësohen brenda organizatës; Ndikimi aktiv i grupeve të ndryshme, në diskutimin dhe formimin e propozimeve programatike dhe përpunimin e propozimeve partiake dhe vendimeve të përbashkëta që merren; Respektimi i parimit të shumicës, që bën që vendimet të merren si rezultat i bashkimit të shumicës së vullneteve individuale dhe të respektohet dhe të garantohet mendimi i pakicës; Kontrolli efektiv i anëtarëve mbi drejtuesit e tyre nëpërmjet një procesi “ndëshkimi”, ose procesi “shpërblimi” për vendimet e marra.

Rëndësia e demokracisë së brendshme partiake

“Nevoja për demokraci të brendshme, përbën themelin e një partie solide, konkurruese, demokratike dhe moderne. Përmes demokracisë së brendshme partia krijon struktura efektive, ngjall besim tek elektorati dhe bën më të preکشëm premtimin për shndërrimin e demokracisë dhe vlerave të saj në parim udhëheqës edhe gjatë qeverisjes në pushtet. Mungesa e demokracisë jep rezultate negative në prezantimin e partisë në elektorat, largon qytetarët e pavendosur, rrit burokracinë dhe familjaritetin, vë në dyshim aftësinë qeverisëse dhe ul nivelin e debatit politik” (Krasniqi, 2008, f. 105). Shumë e rëndësishme është të kuptojmë që partitë janë replika të shtetit, dhe në një mënyrë ato përfaqësojnë mënyrën sesi do të ndërtohet qeverisja kur ato të jenë në pushtet.

Nuk mund të mohojmë që demokracia në përgjithësi dhe partitë politike sot janë në një krizë legjitimiteti për shkak të tërheqjes së qytetarëve nga votimet dhe nga pjesëmarrja nëpër aktivitete partiake dhe politike. Pikërisht lidhur me këtë ka mundësi që dalja nga kriza e legjitimitetit, që sot ka prekur partitë politike, të varet nga një pjesë e mirë prej asaj që na paralajmëron edhe Manuel Aragon-i: aftësinë e këtyre partive për të pasur një demokraci të brendshme të arsyeshme (Aragon, 1999, f. 139-142).

Po ashtu demokracia e brendshme është e rëndësishme brenda partisë sepse çdo patologji e partive ndikon në funksionimin e organeve të pushtetit. Për këtë arsyeje, partitë në rregulloret e tyre duhet të jenë të gatshme që jo vetëm të ndërpusin, por dhe të zbatojmë norma që garantojnë demokracinë e brendshme. Guillermo O'Donnell shkruan: ... "deficiti më i rrezikshëm i ligjshmërisë gjendet në ekzistencën e pushteteve faktike që qëndrojnë mbi ligjin dhe që duhen patjetër të futen brenda ligjit" (Valades, 1998, f. 65)

Organizimi i brendshëm i partive sipas bazave ligjore dhe statutore

Gjykimin mbi partitë politike shqiptare duhet vetvetiu ta nisim nga pjesa formale dhe ajo që parashikohet nëpër gjithë pjesën dokumentare të shtetit shqiptar dhe më pas të vetë partive. Për sa i përket pjesës shtetërore, dokumenti më i rëndësishëm juridik për shtetin është kushtetuta ku në nenin 9, pika 1 të saj përcaktohet: "Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike" (Kushtetuta e Shqipërisë, neni 9).

Kjo është e vetmja pikë në kushtetutë ku citohet organizimi i partive politike dhe cilësohet si domosdoshmëri që duhet të përputhet me parimet demokratike. Por çfarë duhet të kuptojmë ne me organizim demokratik, kjo është lënë e papërcaktuar, por dhe në vullnetin e partive politike për të vendosur mekanizmat e duhur që çojnë në plotësimin e këtij kriteri. Diçka në lidhje me atë çfarë kuptohet me parimet demokratike brenda partisë e gjejmë te ligji mbi partitë politike.

Pikërisht dokumenti tjetër që marrim në shqyrtim është ligji "Mbi partitë politike" i cili në nenin 7 të tij përmend në pikën (a) që ndalohet regjistrimi i një partie në rastet kur:

Organizimi i saj i brendshëm është në kundërshtim me parimet demokratike dhe, veçanërisht, me parimet vijuese.

Ndërtimi nga poshtë lart i partisë, zgjedhjet e brendshme demokratike për forumet e partisë, e drejta e shprehjes së mendimit nga çdo anëtar, liria e hyrjes dhe e daljes së tyre nga partia, e drejta e çdo anëtari për të zgjedhur e për t'u zgjedhur (Ligji 8580, neni 7). Kjo do të thotë se ekziston një kuadër legal që sanksionon nevojën për demokraci të brendshme brenda partive politike. Fakti që nuk mund të regjistrohesh si parti nëse nuk ke demokraci të brendshme është një tjetër tregues që më bind se demokracia e brendshme është e nevojshme dhe për shtetin dhe për shoqërinë sepse ndryshe nuk do të përmendej.

Partitë politike zotërojnë, në ndryshim nga organizimet pararendëse të tyre, një organizim juridik të cilin e emërtojnë përgjithësisht statut. Ky i fundit saktëson parimet e mëdha që strukturojnë jetën e partisë, orientimin e saj ideologjik, objektivat që ajo do të ndjekë. Por statuti përkufizon sidomos, në terma abstraktë,

funksionet e drejtimit dhe përcakton rregullat sipas së cilave do të funksionojë zgjedhja, ose zëvendësimi i drejtuesve.

Pikërisht statuti i partive do të jetë dokumenti tjetër të cilin ne duhet të shqyrtojmë për të parë se ç'përcakton mbi demokracinë e brendshme dhe sa nga kriteret e shpërmendura gjenden në reflektuara në statutet përkatëse.

Partia Demokratike e Shqipërisë

Aktualisht partia kryesore në pushtet sanksionon në statut demokracinë e brendshme si bazë të funksionimit të saj dhe zbatimin e saj e shpreh edhe me zgjedhjen e kandidaturave elektorale sipas nenit 8 ku përcaktohet "Funksionimi i PD-së bazohet në demokracinë e brendshme, e shprehur përmes votës së anëtarëve të saj...Demokracia zbatohet edhe në nxjerrjen e kandidaturave elektorale të partisë" (statuti i PD) Gjithashtu në nenin 14 përcaktohet barazia mes anëtarëve të saj për të marrë pjesë në zgjedhje dhe në veprimtaritë e partisë si edhe të shprehë lirisht aty mendimin e tij, por edhe të propozojë të gjitha organet legjislative e ekzekutive që përfaqësojnë partinë.

Në nenin 34 të statutit pika 1 sanksionohet që: "kandidaturat për zgjedhjet në pushtetin lokal dhe Kuvendin e Shqipërisë konsultohen nga e gjithë anëtarësia e PD-së" Në nenin 58 garantohet shprehja e lirë për çdo anëtar të partisë: "Çdokush nga anëtarët ka të drejtë të shprehë lirshëm mendimin e tij në strukturat dhe organet e PDSH-së. Kufizimi në kohë dhe në numër i diskutimeve në një mbledhje është i mundshëm kur nuk është diskriminues dhe kur këtë e kërkon shumica e anëtarëve me të drejtë vote. Në çdo rast duhet respektuar dhe garantuar shprehja e mendimit ndryshe. Për këtë, kur diskutohen çështje për të cilat ka mendime "pro" dhe "kundra", të garantohet shprehja e mendimit të pakicës". Ndërsa në nenin 60 përcaktohen shumica e kërkuar për vendimmarrje brenda partisë: "Vendimet quhen të miratuara nëse votat "pro" përbëjnë mbi 50% të votave të vlefshme të pjesëmarrësve në votim me përjashtim të rasteve kur në Statut parashikohet ndryshe. Kur votat janë të barabarta propozimi i votuar konsiderohet i refuzuar. Abstenimet merren në konsideratë për llogaritjen e korumit. Për ndryshime statutore nevojitet shumica absolute e anëtarëve me të drejtë vote. Për miratimin e vendimit për shpërndarjen, ose bashkimin e PDSH-së me një parti tjetër, duhet një shumicë prej ³/₄.

Këto janë nenet kryesore që flasin dhe kanë lidhje me konceptin e demokracisë së brendshme në statutin e Partisë Demokratike. Në vija të përgjithshme mund të përcaktohet si në përputhje me parimet e demokracisë së brendshme, sepse sanksionon vendime të marrë me shumicë votash, shprehje të lirë të mendimit, lirinë për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, mundësi përfaqësimi për të gjithë anëtarët nëpër strukturat drejtuese të partisë.

Partia Socialiste e Shqipërisë

Që në nenin 1 të statutit sqarohen disa koncepte organizative bazë që lidhen me demokracinë e brendshme. Në këtë nen përcaktohet që: “Demokracia e brendshme në parti është kusht politik, organizativ dhe moral i ekzistencës dhe i zhvillimit të saj. Personaliteti dhe dinjiteti i anëtarit të partisë është i pacenueshëm. Organet drejtuese të partisë përfaqësojnë dhe shërbejnë vullnetin e anëtarëve dhe përkrahësve të saj. Anëtari i partisë shpreh vullnetin drejtpërdrejt, ose me delegim. Delegatët zgjedhës në të gjitha nivelet e zgjedhjeve, si rregull, kanë mandat me kohëzgjatje të njëjtë me të zgjedhurit e tyre. PSSH-ja garanton shanse të barabarta në përfaqësim midis grave dhe burrave. Disiplina në parti bazohet në konvergencën e mendimeve për alternativën e zhvillimit të individit e të shoqërisë dhe në njohjen e dobisë së bashkërendimit të veprimeve. Organet drejtuese qendrore tërheqin dhe parashtrajnë mendimin e organeve drejtuese vendore (Statuti i PSSH-së).

Ndërsa në nenin 2 gjejmë mbrojtjen e lirisë së mendimit dhe të shprehjes së anëtarit si dhe lirinë e zgjedhjes, që përcaktohet në pikën 1 dhe 2 : “Partia garanton dhe mbron për të gjithë anëtarët e saj lirinë e shprehjes së mendimeve, pikëpamjeve dhe platformave që synojnë zbatimin dhe përmirësimin e Programit dhe të Statutit. Liria e zgjedhjes dhe votimi i fshehtë janë individualë dhe të garantuar”. Gjithashtu në nenin 4 pika 1 thuhet: “Veprimtaria e organeve drejtuese të partisë është e hapur për anëtarët e saj. Dokumentet që pasqyrojnë këtë veprimtari dhe vendimet që merren u bëhen të njohura anëtarëve të partisë nëpërmjet strukturave organizative, ose shtypit dhe mjeteve të tjera të partisë për informimin publik”.

Në Partinë Socialiste sanksionohet sipas nenit 8 të statuti pika 1 që “Anëtarët e PSSH-së janë të barabartë në raport me partinë, pavarësisht nga funksionet që kanë brenda saj dhe gjendjes ekonomike e pozicionit shoqëror jashtë saj”. Ndërsa neni 41 qartëson: “Votimi për zgjedhjen midis kandidatëve për anëtarë forumesh drejtuese të partisë është i fshehtë dhe presupozon: të paktën më shumë se një kandidat mbi numrin e vendeve...”

Po ashtu në Statutin e Partisë Socialiste vëmë re përcaktimin dhe saktësimin e parimeve që lidhen me demokracinë e brendshme.

Partia Lëvizja Socialiste për Integrim

Një parti kjo e krijuar nga shkëputja e një bërthame prej përfaqësuesit të lartë të Partisë Socialiste pas një konflikti të hapur për mospërputhje qëndrimesh dhe interesash me ish- kryetarin e atëhershëm Fatos Nano. Kjo na rrit pritshmëritë për këtë parti dhe kemi bindjen se problemet e P.S-së nga

dolën këta përfaqësues dhe që e akuzuan këtë parti për mungesë të demokracisë së brendshme nuk do t'i transferonin si model ndërtimi në partisë e tyre të re. Megjithatë këtu mbetemi ende në gjykimin vetëm e bazës statutore të partisë. Në pikën 6 të Statutit të LSI-së të parimet kryesore përcaktohen: “një anëtar një votë dhe organizimi vertikal nga baza në qendër; b. liria e shprehjes e çdo anëtari për çdo problem që ka të bëjë me performancën e LSI-së, e të zgjedhurve të saj, dokumentet dhe zbatimin e tyre, si dhe çështje të tjera me interes; c. pacenueshmëria e personalitetit dhe dinjitetit të anëtarit nga çdo anëtar, funksionar i zgjedhur, ose i emëruar, forum apo vendim i cilido forumi të L.S.I-së; d. demokracia e brendshme dhe njohja e garantimi i përfaqësimit në forumet e L.S.I-së i fraksioneve; e. kolegjaliteti dhe transparenca në vendimmarrje dhe në drejtimin e çdo strukture të L.S.I-së; f. shtrirja e përfaqësimit dhe vlerësimi i gjithsecilit në bazë të kontributeve”(Statuti i LSI-së). Pika 7.7 (g), që ka të bëjë me detyrat e anëtarit, shpreh vullnetin për lirinë e shprehjes brenda partisë dhe marrjen e vendimeve me shumicë: “Anëtari i LSI-së ka për detyrë të pranojë vendimet e shumicës dhe të respektojë mendimin ndryshe”. Ndërsa pika 7.8 (d&e) ku flitet për të drejtat e anëtarit të LSI-së specifikohet që ai ka të drejtë : “Të propozojë dhe të propozohet si kandidat i LSI-së për zgjedhjet e pushtetit vendor, ato të përgjithshme si dhe në të gjithë organizmat ku kërkohet përfaqësim i L.S.I-së; të jetë i barabartë me të gjithë anëtarët e tjerë të L.S.I-së, pavarësisht nga funksionet që ai mbulon te L.S.I. apo gjetkë, gjendja ekonomike, përkatësia shoqërore”.

Një pjesë interesante që lidhet me atë çka ne kemi parashtruar si demokraci të brendshme është ajo ku në statutin e kësaj partie përcaktohet mënyrat e marrjes së vendimeve, pika 12: “Në forumet e L.S.I-së vendimet merren vetëm pas debatit dhe këmbimit të lirë të mendimeve; vendimet në forumet e L.S.I-së merren me konsensus dhe në mungesë të konsensusit me votim të hapur; vendimet që kanë të bëjnë me individët, me normat e Statutit dhe të Programit, apo kur kërkohet nga 1/3 e anëtarëve të forumit të L.S.I-së që merr vendimin, bëhen gjithnjë nëpërmjet një procesi të votimit të fshehtë; vendimi i miratuar nga shumica e pjesëmarrësve në votim është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjithë ata të cilëve ky vendim iu drejtohet; vendimet e forumeve publikohen në organet e shtypit të L.S.I-së apo në buletinet e saj periodike informative”. Ndërsa në pikën 13.4 jepet mundësia edhe për ankimimin e këtyre vendimeve: “Të drejtën e ankimimit të vendimeve të marra nga forumet e L.S.I-së e kanë të gjithë anëtarët apo forumet e saj. Në Këshillin Ankimor nuk mund të ankimohen vetëm vendimet e Konventës Kombëtare”.

E veçanta e statutit të kësaj partie është që paraqet një pikë të veçantë për mundësinë dhe lejimin e fraksioneve të brendshme të partisë dhe pika 14.1 shpreh se: “L.S.I-ja njeh dhe garanton përfaqësimin e fraksioneve në forumet e saj”.

Partia Bashkimi i të Drejtave të Njeriut

Kjo parti është marrë në shqyrtim për faktin se përbën një shembull të veçantë në spektrin politik shqiptar, për shkak të profilit të saj në mbrojtje të minoriteteve dhe të drejtave të njeriut edhe pse e lidhur me shumë me minoritetin grek. Në statutin e saj fillohet me të drejtat e anëtarit të PBDNJ-së, të drejtat të tilla që mund të cilësohen në linjë të njëjtë me nevojën dhe zbatimin e demokracisë së brendshme. Në nenin 12 përcaktohet që anëtari i partisë ka të drejtë: “Të marrë pjesë në përpunimin e politikës, të qëndrimeve e të vendimeve të partisë në të gjitha nivelet, përmes diskutimit të debatit demokratik si dhe të shprehë lirisht pikëpamjet e tij për tërë veprimtarinë partiake; të ketë pjesëmarrje aktive në jetën e komunitetit, të zgjedhë dhe të zgjidhet në të gjitha forumet drejtuese të partisë në të gjitha nivelet; të caktohet kandidaturë e partisë në të gjitha zgjedhjet elektorale të përgjithshme apo vendore; të miratojë apo të kritikojë lirisht funksionimin apo mosfunksionimin që konstaton në veprimtarinë e organeve në të gjitha nivelet drejtuese; të marrë pjesë në mbledhjet e partisë të çdo niveli ku shqyrtohen probleme që kanë të bëjnë me vetë atë”(Statuti i PBDNJ).

Ndërsa neni 13 përcakton barazinë mes anëtarëve të partisë: “Anëtarët e partisë janë të barabartë në raport me partinë, pavarësisht nga funksionet që mbajnë brenda saj, gjendjes ekonomike dhe pozicionit shoqëror jashtë saj”. Në nenin 83 përcaktohet mundësia për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në organet e partisë: “Zgjedhja e organeve drejtuese të partisë në çdo nivel bëhet me votim të fshehtë dhe me kandidatura konkurruese. Çdo anëtar i PBDNJ ka të drejtë të shprehë mendimin e tij për çdo kandidaturë të propozuar si dhe të propozojë kandidatin e tij. Çdo kandidat i propozuar nga anëtarët, ose nga organet e partisë ka të drejtë ta refuzojë këtë kandidaturë”. Duke konfirmuar në nenin 85 që: “Vendimet e partisë në të gjitha nivelet e organeve drejtuese merren përmes debatit të lirë demokratik dhe paraqitjes në të të alternativave të ndryshme. Vendimet merren me shumicë votash, ku vendimi i shumicës është i detyrueshëm për zbatim”. Dhe së fundmi në nenin 87 legalizohet mundësia për ekzistencën e mendimit ndryshe dhe mundësia e rrymave alternative brenda partisë, por edhe duke qartësuar që: “...kur nuk arrihet konsensusi në marrjen e vendimeve, rryma që ndodhet në minorancë i nënshtrohet mendimit të shumicës, duke ruajtur të drejtën e paraqitjes sërish për diskutim të alternativës së vet”.

Demokracia e brendshme në praktikë. Modeli i partive shqiptare

Sapo shqyrtoam statutet e katër partive që i zgjodhëm si përfaqësuese të partive shqiptare, duke kombinuar veçantinë e tyre për sistemin dhe peshën e tyre elektorale dhe politike për vendin. Askush nga ne nuk mund ta mohojë që janë statute me

norma demokratike, që e vlerësojnë dhe e parashikojnë demokracinë e brendshme si parim funksionues të partive. Megjithatë për të gjithë ata që e njohin sado pak realitetin partiak shqiptar, linden menjëherë në mendje paralelizma mes asaj që shkruhet atje dhe asaj që ka ndodhur dhe ndodh përditë në jetën e brendshme partiake.

Le ta nisim me jetën e brendshme në Partinë Demokratike: Në vitin 1992 pas humbjes së PD-së në zgjedhje, zëra themelues të PD-së, filluan kritikën ndaj Berishës për mënyrën si po e ndante ai pushtetin. Mes tyre shquante Arben Imami, Preç Zogaj, Gramoz Pashko, Perikli Teta dhe figura të tjera të partisë. Ata botuan një dokument, ku kërkonin një analizë të përgjegjësive brenda PD-së, por si përgjigje morën një Konferencë të jashtëzakonshme në muajin shtator, që i përjashtoi ata nga Partia Demokratike. Ky përjashtim i parë çoi në krijimin e Partisë Aleanca Demokratike, që u pozicionua si opozitare me PD-në.

Në vitet 1993-1994, brenda PD-së po formoheshin fraksione paksa më radikale nga e djathta që përfaqësoheshin nga Petrit Kalakula, që drejtonte degën e Tiranës dhe Abdi Baleta, një deputet me qëndrime nacionaliste të qarta. Këta paraqitën një frymë kritike ndaj Berishës për mbrojtjen që ky i bënte figurës së Fan Nolit. Kalakula dhe Baleta u përjashtuan nga PD-ja, dhe krijuan Partinë e Djathtë Demokratike dhe më pas Rimëkëmbja Kombëtare. Pas humbjes së referendumit të Kushtetutës, në nëntor të vitit 1994, Eduard Selami, kryetar i PD-së, nisi një tur kritikash në gjithë vendin duke kërkuar të bashkohej posti i kryeministrit, që mbante Aleksandër Meksi me atë të kryetarit të PD-së dhe të kërkonte forma të tjera të rimirimit të Kushtetutës. Pas kësaj ai u përjashtua nga PD-ja në një Kuvend të saj në pranverë të vitit 1995.

Në 1996-ën filloi të shfaqej pavarësia e një grupi deputetësh në 3 çaste të rëndësishme: lidhur me përbërjen e re të qeverisë Meksi; lidhur me refuzimin fillestar për të shkarkuar kryetarin e gjykatës së kasacionit si dhe çështjen e “drurit të arrës” ku ishin për ndjekje penale dy deputetë të PD-së, Genc Ruli dhe Rexhep Uka (Fuga, 2008, f. 269-270). Në janar të vitit 1997 u dhanë shenjat e para të krizës dhe u shfaqën po ashtu zërat e parë kritikë brenda PD-së. Kur kriza shpërtheu në gjithë elementët e saj në muajin shkurt dhe mars, 14 ministra dhe ish-ministra të tij, mes të cilëve Genc Ruli, Dashamir Shehi, Dylber Vrioni, Bashkim Kopliku etj. dhanë dorëheqjen duke u distancuar nga politika e PD-së.

Ndërsa në vitin 1999 do të ndodhte çarja tjetër e PD-së, me daljen kundër politikës së atëhershme dhe vetë liderit Berisha të Genc Pollos, Tritan Shehu, Ferdinand Xhaferajt, Nard Ndokës dhe Leonard Demit të cilët formuan Partinë Demokratike të Reformuar. Në vitin 2006 Ngjela shprehu hapur kundërshtitë e tij ndaj linjës së liderit Berisha, në një debat me të, të cilin edhe e regjistroi duke e nxjerrë në media. Pas këtij veprimi ai u pezullua nga partia si dhe nga posti si sekretar i marrëdhënieve publike dhe nga komisioni parlamentar si përfaqësues i

PD-së dhe nga grupi parlamentar. Në vitin 2009 Ngjela krijoi Partinë për Ligj dhe Drejtësi.

Shembujt e bashkëjetesës së mendimit ndryshe dhe kundërshtive në Partinë Socialiste nisin me vitin 1998 sepse më parë ndoshta mospasja e pushtetit i kishte ndaluar të kishin grupime dhe mendime ndryshe, por të kishin zëra tek e tek që nuk janë formalizuar ndonjëherë në lëvizje. Më 28 shtator të vitit 1998, kryetari Nano dha dorëheqjen nga postin i kryeministrit, dhe vendin e tij e zuri Pandeli Majko. Më 20 nëntor të 1999-ës dha dorëheqjen edhe si kryetar i Partisë Socialiste. Nano deklaroi thirrjen e kongresit të jashtëzakonshëm brenda muajit mars. PS-ja ishte e ndarë në dy pjesë, pro dhe kundër Nanos (Progni, 2009, f. 227). Më 17 maj presidenti Mejdani firmosi shkarkimin e Petro Koçit si Ministër i Rendit dhe emërimin e Spartak Poçit. Propozimi vinte nga kryeministri Majko. Petro Koçi ishte pozicionuar te grupi i mbështetësve të Nanos në PS (Progni, 2009, f. 229). Zgjedhjet brenda partisë në kongres i fitoi Fatos Nano, i cili fitoi për bashkëpunim edhe Ilir Metën që kishte qenë mbështetësi i Pandeli Majkos. Më 2 tetor Majko dha dorëheqjen dhe po në atë ditë KPD-ja zgjodhi Ilir Metën për kryeministër.

Situata në PS mes Metës kryeministër dhe Nanos kryetar partie ishte e mirë deri në shtator të 2001-it. Nano e akuzonte Metën se po përpiqeshin ta kthenin partinë në parti-shtet, dhe qeverinë në “qeveri pa parti” (Progni, 2009, f. 235). Beteja e akuzave ndërmjet grupeve në PS u ashpërsua shumë dhe kulmoi me KPD-në e famshme të dhjetor të 2001-it, duke u pagëzuar me emrin “Lëvizja për katarsis” (Progni, 2009, f. 235). Qeverisja e Metës u trondit fort dhe u arrit një pamundësi emrash të zgjedhur për ministrat e rinj, sepse mbështetësit e Nanos nuk shkonin në kuvend për të votuar. Në fund të janarit të 2002-it Meta dha dorëheqjen dhe KPD-ja e 6 shkurtit i dha votëbesimin Pandeli Majkos për të drejtuar qeverinë. Por në korrik u vendos nga KPD-ja bashkimi i postit të kryetarit të partisë me atë të kryeministrit. Kështu që Nano u bë kryeministër dhe Meta zv.kryeministër dhe u duk sikur kjo ishte zgjidhja e konfliktit të brendshëm. Por kjo nuk do të ishte paqe e gjatë mes grupimeve në PS, sepse në qershor të 2003-it Meta filloi kritikën për qeverinë Nano dhe bashkoi votat me Berishën që mos të arrihej të zgjidheshin tre ministrat e rinj. Në 12 dhjetor 2003 u mbledh kongresi VI i PS ku u rizgjedh Nano kryetar dhe u mënjanua totalisht Ilir Meta nga postet drejtuese. Më 6 shtator 2004 një grup anëtarësh dhe deputetë të PS-së me në krye vetë Metën u ndanë përfundimisht nga Partia Socialiste, duke u bërë të parët në PS që si pasojë e luftës së brendshme krijojnë një parti të re. Kjo parti e re ishte Lëvizja Socialiste për Integrim.

Në vitin 2005, me humbjen e zgjedhjeve, në krye të Partisë Socialiste, mbas dorëheqjes së Fatos Nanos, erdhi Rama me votim të fshehtë nga kongresi i partisë. Rama mënjanoi nga vendimmarrja dhe nga postet drejtuese ata që klasifikoheshin si nanoist, pjesën e deputetëve dhe anëtarëve të PS-së që kundërshtonin politikën e tij. Në vitin 2007, gjashtë deputetë pjesë e këtij grupi, që konsiderohej si nanoist,

votuan për zgjedhjen e presidentit të republikës. Ata u përjashtuan nga Partia Socialiste. Në vitin 2008 një pjesë e deputetëve, që ishin përjashtuar de facto nga vendimmarrja e partisë dhe tashmë mendimi i tyre nuk vlente më, u bashkuan dhe krijuan partinë e re: Partia Socialiste e Vërtetë 91’ nën drejtimin e Petro Koçit, ku bënin pjesë Makbule Çeço, Gjergj Koja etj.

Ndërsa brenda partisë, sidomos mbas humbjes së zgjedhjeve të vitit 2009, zërat ndryshe si Kastriot Islami, Ben Blushi, Arben Malaj, Andis Harasani kanë krijuar atë që quhej Lëvizja e Mendimit Ndryshe. Në media shumë herë janë dëgjuar zëra për përjashtimin e tyre nga partia, mënjanimi i tyre ka qenë i plotë për sa i përket mundësisë së dëgjimit të zërit në lidhje me vendimet dhe aksionet që ndërmer partia. Kjo gjë u bë realitet në dhjetor duke përdorur si justifikim mosprezencën në Parlament të Kastriot Islamit. Ai u përjashtua nga partia e tij historike dhe ku kishte pasur një peshë edhe një zë të rëndësishëm.

Nëse hedhim sytë te Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, edhe pse me një histori 7 vjeçare si parti mund të gjejmë raste të mendimit ndryshe në të. Në vitin 2009 kur partia pranoi të merrte pjesë në koalicionin qeverisës, zëra në kundërshtim të kësaj dolën brenda partisë. Këta ishin figura si Pëllumb Xhufi, Ndre Legisi, Sabit Brokaj, Fatos Klosi, Mustafa Muçi që kishin pozita të rëndësishme atëherë dhe u larguan nga partia e filluan të dilnin përkrah Ramës dhe linjës së PS-së.

Partia Bashkimi i të Drejtave të Njeriut në vitin 2004 u ndesh me kundërshtimet ndaj kryetarit Dule, që vinin nga Ligoraj Karamelo dhe nga një grup që e mbështeste atë. Mospranimi i këtij mendimi dhe i reformave që ai kërkonte çoi në largimin e tij nga partia dhe krijimin e një partie të re me emrin Lëvizja për të Drejtat e Njeriut. Më pas, në vitin 2009, para zgjedhjeve PBDNJ-ja shpalli ndarjen nga koalicioni qeverisës me PD-në për të dalë në koalicion me PS-në. Dolën zërat kundra: Kosta Barka dhe Thoma Miço, ky i fundit kërkoi edhe të kandidonte për kryetar partie. Por atij nuk iu lejua një gjë e tillë duke paraqitur argumentin se ata nuk përfaqësonin më PBDNJ-në, por Partinë Demokratike. Kjo solli shkëputjen e tyre nga partia.

Siç duket qartë demokracia e brendshme, të paktën për këto parti që ne i morëm në konsideratë, është thjesht fasada e statutit sepse praktika na tregon vetëm përjashtime, mënjanim dhe largime nga partia kur anëtarë të caktuar dalin kundër liderit. Kjo në disa raste ka çuar në lindjen e partive të vogla politike që kanë ardhur nga ndarja prej partisë së madhe. Në partitë politike shqiptare gjithmonë demokracia e brendshme është mundur nga koncepti i disiplinës partiake. Ky i fundit ka shërbyer gjithnjë si asi nën mëngë për të fuqizuar liderët e partisë dhe për t’i bërë ata të plotfuqishëm në vendimet që kanë vullnet të marrin dhe në mënjanimin e kundërshtarëve të tyre politikë. Disiplina partiake vepron si kundërpeshë e demokracisë së brendshme dhe në luftën mes të dyjave fiton përherë e para duke bërë të mundur që pushtetin faktin dhe kontrollin ta mbajnë vetëm një grup i vogël njerëzish që qëndrojnë më afër kryetarit të partisë.

Në vitin 1911, Robert Michels në studimin e tij mbi partinë socialdemokrate gjermane paralajmëroi në lidhje me një nga problemet qendrore me të cilën përballen partitë politike, është ai të cilin Michels-i e quajti “Ligji i hekurt i oligarkisë”. Në punimin e tij ai parashikonte që “një parti kurrë nuk do të jetë demokratike sepse brenda këtij organizimi është fara (geni) i oligarkisë” (Michel, University of Virginia Library Electronic Text Center). Ky përshkrim mbi partitë politike i realizuar një shekull më parë, mund të merrej sot në përdorim dhe në konsideratë për të gjitha partitë politike shqiptare si tregues që drejtimi i tyre është më shumë oligarkik sesa demokratik.

Konstatimi i mësipërm, që tregon fare mirë mungesën totale të vëmendjes, për zbatimin e demokracisë së brendshme nga partitë politike shqiptare mund të na hedh dyshimin se ndoshta demokracia e brendshme nuk shërben. Ndoshta nuk duhet për asgjë dhe prandaj edhe nuk gjen zbatim! Ndoshta, në të vërtetë, për një parti ka më shumë rëndësi pushteti dhe forca e liderit sesa demokratizimi! Por ja që teoria dhe logjika demokratike nuk na tregon një gjë të tillë.

Rekomandime dhe përfundime

Ashtu siç e përmendëm edhe më lart partitë politike ushtrojnë pushtet politik real që iu jep mundësinë edhe të cenojnë të drejtat themelore politiko-elektorale të qytetarëve- në mënyrë të veçantë të anëtarëve të tyre- me rrezikun që një dhunim i tillë mund të bëhet i pashmangshëm dhe i rrezikshëm nëse nuk luftohet në mënyrën e duhur. Për mendimin tim nuk ka asnjë justifikim për përjashtimin e veprimeve të brendshme partiake nga kontrolli juridik si kushtetues, ashtu edhe ligjor.

Nuk ka asgjë të keqe, ose jashtë logjike nëse gjykatat shqiptare (qoftë ajo kushtetuese ose ajo e shkallës së lartë) të mund të verifikojnë kur ka kërkesë nga anëtarët e partisë nëse funksionimi i organeve të partisë është konform statutit që ata vetë kanë vendosur. Nëse organizatat, në këtë rast partitë, vendosin disa rregulla, që më të rëndësishmet miratohen nga organet më të larta, detyrimi i parë që duhet të lindë është zbatueshmëria e tyre. Ashtu siç e pamë edhe lart problemi themelor me demokracinë e brendshme partiake nuk është mospasja e rregullave që përcaktojnë demokracinë e brendshme, por mos zbatimi i tyre nga organet apo personat që drejtojnë partinë. Pikërisht për këtë arsye mendoj se anëtari i interesuar, të cilit i duket se i janë cenuar disa të drejta që përcaktohen në statut, mund fillimisht t’i drejtohet organeve të brendshme të partisë për vënie në vend të së drejtës. Dhe nëse vendimi i tyre nuk i duket se është konform asaj që kanë rregullat e partisë atëherë ai të ketë mundësinë t’i drejtohet gjykatave dhe vendimi i tyre të bëhet i detyrueshëm për zbatim për partinë.

Dikush mund të mendojë se kjo është një ndërhyrje në jetën e partive dhe një cenim i tyre nga pushteti gjyqësor. Ndërsa për mua është më se normale që anëtari

i partisë të ketë një lloj mbrojtje nga cenimi që mund t’i bëjë partia e vet. Për aq kohë se çdo qytetar është i mbrojtur nga cenimi që mund t’i ndodh nga familja e vet, nga njerëzit e punës, nga shteti, nga qytetarët e tjerë duke iu drejtuar gjykatave, atëherë pse duhet që të mos jetë i mbrojtur nga cenimi i partisë së tij pikërisht nëpërmjet gjykatave.

Së fundmi pas përmirësimit të zbatimit të statuteve duke vendosur edhe mekanizma të jashtëm kontrollues siç janë gjykatat, zgjidhje tjetër për të përmirësuar situatën demokratike është shtimi i mënyrave të ushtrimit të demokracisë së brendshme brenda partive. Aplikimi i parimit “Një anëtar-një votë” është një mundësi shumë e mirë për rritjen e demokracisë së brendshme. Partia Socialiste e futi këtë parim në zgjedhjet e veta, por nuk arriti rezultatet e duhura sepse filloi sulmi brenda vetes për zgjedhje jo të drejta dhe të kontrolluara nga kryetari, megjithatë mund të konsiderohet si një hap përpara. “Elementi më reformues e demokratizues në jetën e një partie mbetet demokracia e tipit “Një anëtar-një votë” në kuptimin e vendimmarrjes që, jo vetëm zgjeron hapësirat e demokracisë, por dhe rrit përgjegjësinë e rolin e drejtpërdrejtë të anëtarit të partisë. Forma më e thjeshtë e zbatimit të këtij parimi është zgjedhja e kryetarit që rezulton vendimtare për procesin e reformimit partiak, sepse në Shqipëri nëpërmjet kryetarit perceptohet dhe fizionomia e partisë” (Mejdani, 2004, f. 46). Gjithashtu masivizimi i të drejtës për të votuar do të bëjë që shumica e anëtarëve të partisë të shohin më me shumë optimizëm të ardhmen e partisë së tyre, por edhe të kenë më besim në proceset zgjedhore në përgjithësi.

Së fundmi mund të themi se demokratizimi më i mirë, që mund të ndodh së paku te partitë politike shqiptare, është ndryshimi i profilit të liderve drejtues. Kjo do të thotë që normat në letër nuk janë të këqija dhe zbatimi i tyre do të çonte në një demokratizim të mjaftueshëm që nuk do të shtypej nga parimi i disiplinës partiake. Vullneti i liderve ndryshohet nëse elektorati ndëshkon dhe mbështet partinë në zgjedhje edhe në varësi të masës së demokracisë së brendshme që tregon partia.

Bibliografia

- Zampetti, Dallo Stato Liberale allo Stato dei Partiti, Milano, 1973.
Kelsen, H., Los fundamentos de la democracia Madrid, 1988.
Kelsen, H., Esencia y valor de la democracia Mexico, 1992.
Friederich, C. J., Gobierno constitucional y democracia Madrid, 1975, Botimi i dytë.
Heller, H., Teoria del Estado Mexico, 1955.
Kushtetuta e Shqipërisë.
Ligji 8580, datë 17.02.2000, Mbi partitë politike.
Denquin, J.M., Hyrje në shkencat politike Tiranë, UET Press.

Fuga, A., Media, politika, shoqëria (1990-2000) Dudaj, Tiranë, 2008.
Michel, R., Political Parties; a Sociological Study of the Oligarchical Tendencies of Modern Democracy University of Virginia Library Electronic Text Center.
Krasniqi, A., Partitë politike dhe sistemet politike Ilar, Tiranë, 2008.
Aragon, M., Constitucion y control del poder. Introducion a una teoria constitucional del control, Universidad Externado de Colombia, Bogota, 1999.
Progni, L., Trashëgimtarët, Partia Socialiste mes transformimeve dhe vazhdimësisë, Ideart, Tiranë, 2009.
Valades, D., El control del poder UNAM, Meksikë, 1998.
Mejdani, R., Reformimi demokratik i partive politike shqiptare-domosdoshmëri e kohës, Pegi, Tiranë 2004.
Statuti i Partisë Demokratike.
Statuti i Partisë Socialiste.
Statuti i Lëvizjes Socialiste për Integrim.
Statuti i Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut.

Intervista

*Florian Beiber:*¹

Roli i Partive në Ballkanin Perëndimor _____

_____ *Intervistoi: Dr. Klejd KËLLIÇI* _____

Cili është roli i partive politike në Ballkanin Perëndimor?

Partitë politike në Ballkanin Perëndimor përgjithësisht janë shumë të forta: forca e tyre nuk vjen nga idetë apo programet – pak njerëz kanë dijeni se çfarë duan realisht partitë – por nga aftësitë e tyre klienteliste. Konfliktet shpesh nxiten nga personalitete si dhe nga konkurrenca për pasuritë shtetërore, por jo nga idetë. Veçanërisht sot, arena konkurruese është ende më e ulët, pasi është e vështirë që ndonjë parti të dalë të sfidojë integrimin në BE për vendet e rajonit. Anëtarësia në parti synohet jo për shkak të bindjeve, por për të gjetur punë. Le të marrim Malin e Zi, në një raport të kohëve të fundit rezulton se Partia demokratike e Socialistëve ka 100 mijë anëtarë, pra mbi 15% e gjithë popullsisë është anëtarësuar në të. Tendenca të tilla mund të gjenden edhe gjetiu.

A ka ndikuar procesi i formimit të shtetit dhe kombit në konsolidimin apo mungesën e konsolidimit të sistemeve partiake në këtë rajon?

Nuk më duket se ka një lidhje të fortë mes tyre, pasi disa vende me një shtet të konsoliduar kanë patur një sistem partiak shumë të pakonsoliduar (Sllovenia, Bullgaria) e nga ana tjetër, Kosova apo Bosnja kanë pasur një sistem partiak mjaft

¹ Florian Bieber është Profesor i Studimeve të Evropës Juglindore dhe Drejtor i Qendrës për Studime të Evropës Juglindore në Universitetin e Graz-it, Austri. Ai ka studiuar në Trinity College (SHBA), Universitetin e Vjenës dhe në Universitetin e Evropës Qendrore (CEU), dhe fitoi PhD-në në Shkenca Politike nga Universiteti i Vjenës. Nga 2001 në 2006, ai ka punuar në Beograd dhe Sarajevë për Qendrën Evropiane të Studimeve mbi Minoritetet. Ai është Lektor i Ftuar i programit të Studimeve mbi Nacionalizmit, Universiteti i Evropës Qendrore (CEU) dhe ka dhënë mësim në Kent University, Cornell University, Universiteti i Bolonjës dhe Universiteti i Bolonjës. Është krye-redaktor i revistës Nationalities Papers.

të qëndrueshëm. Tipari thelbësor i shteteve të pakonsoliduara është se konkurrenca midis partive qendërzohet duke u shtrirë si çështje kombëtare, teksa çështjet sociale dhe ekonomike në fushata elektorale janë marginale, edhe pse shtetasit i cilësojnë këto të fundit si shqetësimet e tyre.

Ju pohoni se partitë etnike në Ballkan, pavarësisht ose kufizimit të tyre, kanë qenë gjithnjë të rëndësishme. Cili është roli i tyre sot dhe si do t'i konfiguroni ato në të ardhmen?

Minoritetet vazhdojnë të votojnë për partitë, që fokusohen vetëm tek minoritetet. Kjo prirje është rajonale dhe i ka fillesat që në zgjedhjet e para të viteve 90-të. Arsyeja është e thjeshtë. Partitë e mazhorancës shpesh i janë drejtuar shumicës etnike dhe u kanë dhënë shumë pak stimuj minoriteteve që të votojnë për to. Veçanërisht minoritetet masive si hungarezët e Serbisë, të Rumanisë dhe Sllovakisë nuk kanë asnjë arsye për të votuar për partitë kryesore. Sigurisht që kemi nacionalizëm pakicash, ashtu sikurse kemi edhe nacionalizëm të shumicës etnike, gjë që shpjegon edhe suksesin e këtyre partive. Tanimë kemi disa shembuj që në kohë zgjedhjesh parlamentare, minoritetet votojnë për partitë kryesore si në Mal të Zi dhe në njëfarë mase edhe në Serbi. Më tej, partitë kryesore në Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni kanë formuar koalicione para-zgjedhore me partitë e vogla të minoriteteve. Përgjithësisht, partitë e minoriteteve kanë qenë një burim stabiliteti, shpesh duke marrë pjesë në qeverisjen në rajon dhe jo rrallë herë e kanë ndihmuar vendin për integrimin në BE. Në periudhë afatgjate, ka gjasa që partitë e minoriteteve të mëdha dhe të mirë-organizuara do të mbeten aktorë me rëndësi, ndërsa partitë e minoriteteve më të vogla do të zhduken, ose do të kthehen në asgjë më tepër sesa zgjatime të partive kryesore. Çështja kryesore në një periudhë afatgjatë është nëse do të shohim mobilizim politik më të suksesshëm të minoritetit rom. Deri tani partitë e romëve kanë pasur një jetëgjatësi të shkurtër dhe me pak suksese. Në shumicën e vendeve në rajon, romët janë ndër komunitetet më masive dhe kanë potencialin për t'u kthyer në aktorë politikë me influencë. Kjo nuk duket se ka shumë gjasa për momentin, por mundësia ekziston.

Në shumë sisteme politike ballkanike (në Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi) partitë etnike po kalojnë një fazë ndryshimesh të rëndësishme për shkak të formimit të partive të reja. A do të ketë kjo ndikim për sa i përket rolit të tyre?

Kjo nuk varet vetëm nga partitë etnike, ne shohim disa vende me një sistem partiak shumë të qëndrueshëm (si Kroacia dhe Shqipëria) dhe disa të tjera që reflektojnë një paqëndrueshmëri të lartë (si Sllovenia, Bullgaria). Kjo paqëndrueshmëri rrjedh nga tre shkaqe: partitë i bashkohen qeverisë dhe e bëjnë të pamundur përmbushjen e premtimeve populiste duke u eklipsuar nga populistë të rinj: mund ta shohim këtë në Bullgari në vitin 2001 me partinë e ish-mbretit, që u shkatërrua dhe u

zëvendësua nga partia aktuale qeverisëse, GERB-i. Së dyti, partitë rrënohen për shkak të zbrazëtisë ideologjike, infrastrukturës së dobët, apo largimit të liderit partiak. Për shembull, këtë mund ta vërejmë në ngushtimin e LDK-së në Kosovë. Së treti, partitë etnike dhe ato të minoritetit i bashkohen qeverisë dhe rezultojnë të paafta për të zhvilluar substancialisht të drejtat e minoriteteve apo përfaqësimin dhe kështu dalin në skenë parti të reja, siç mund ta shohim në partitë e shqiptarëve në Mal të Zi dhe Maqedoni. Shpesh kjo çon në radikalizim dhe mund të zbutet vetëm nga qeveria ose vetë partia (siç ka ndodhur me BDI-në dhe më parë me PDSH-në në Maqedoni.)

Ka një rikthim të idesë të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Ka së paku dy forca politike, që e kërkojnë këtë (Vetëvendosja në Kosovë dhe Aleanca Kug e Zi në Shqipëri). A do të mund vala e re e nacionalizmit të riformësorë sistemin partiak në këtë zonë?

Evokimi i unifikimit me Shqipërinë përbën vetëm një pjesë të vogël të suksesit të *Vetëvendosjes*, por kritika e tij për sistemin politik në Kosovë, përfshirë korrupsionin dhe ndërhyrjen e aktorëve të jashtëm, është arsyeja kryesore e këtij suksesi. Për aq kohë sa nuk ka ndonjë parti tjetër që mbështetet në një platformë të tillë, *Vetëvendosja* do të vazhdojë të ketë sukses. Rëndësia e unifikimit do të varet nga konteksti, domethënë se deri në çfarë shkalle Kosova do të jetë në gjendje të zgjidhë çështjet me Serbinë dhe të përftojë njohje të mëtejshme. Nëse këto do të realizohen, atëherë ndjesia e fajit rreth Kosovës do të zhduket. Megjithatë, në qoftë se Kosova është në gjendje të vështirë ekonomike dhe e izoluar për sa i përket lirisë së lëvizjes, ideja e unifikimit do të jetë e fortë dhe mund të adoptohet edhe nga parti të tjera.

A mendoni se euro-skepticizmi mund të bëhet pjesë e repertorit të partive politike në të ardhmen e afërt të rajonit?

Partitë ekstremiste dhe ato euro-skeptike përgjithësisht në gjithë rajonin nuk janë në situatë të favorshme. Në fakt, brenda BE-së ka parti më të forta euro-skeptike dhe të ekstremit të djathtë, sesa në Ballkanin Perëndimor. Këto parti mund të ngrihen në dy rrethana: Nëse BE-ja nuk do ta integrojë rajonin në një kohë të shkurtër dhe vendos kushte shtesë, atëherë do të ketë gjasa për një çmagjepsje ndërmjet përkrahësve të BE-së dhe një rënie të mbështetjes për Integrimin European, që mund të shfaqet në parti të reja euro-skeptike (megjithatë, kjo nuk duket se do të realizohet, pasi edhe Kroacia u duk si euro-skeptike pavarësisht se asnjëra nga partitë kryesore nuk e refuzon integrimin). Së dyti, sa më shumë që vendet i afrohen BE-së, me negociatat e vështira të anëtarësimit etj., aq më tepër do të pakësohen euroentuziastët, gjë që do të sjellë ngritjen e partive euro-skeptike. Megjithatë nuk ka gjasa që të ketë forca politike të rëndësishme përpara anëtarësimit të plotë. Me pak fjalë, partitë euro-skeptike mund të fitojnë

mbështetje të madhe, por nuk ka gjasa që ato të dominojnë sistemin politik. Në të kundërt, pyetja thelbësore është nëse partitë kryesore, me gjithë retorikat e tyre në drejtim të integritetit, mund të bëhen agjentë të reformave dhe zgjerimit. Do ta konsideroja si prirje dominante kombinimin e deklarimeve euro-entuziaste me politikën skeptike, që kërkojnë një përshejtim të procedurave të anëtarësimit për arsye ideologjike, ashtu sikurse për benefitet që një sistem politik më pak i reformuar nuk mund t'i ofrojë.

Përktheu: Lulzim Hoxha

Financimi i partive politike nga donatorët privatë: Aleancë e heshtur? _____

_____ *Dr. Erjona CANAJ* _____

Abstrakt. *Financimi politik dhe, në mënyrë të veçantë, financimi nga donatorët privatë mbetet ende një nga temat më pak të trajtuara në debatin publik dhe në mendimin akademik që zhvillohet në vendin tonë. Partitë politike i kanë shumë të domosdoshme burimet financiare në veprimtarinë e tyre. Mbi të gjitha, ekuilibri mes financuesve dhe përfaqësuesve të popullit ose deputeteve të partisë është gjithnjë nën tension për shkak të varësisë që krijohet mes përfituesve (partive) dhe shpërblimeve që kërkohen në këmbim nga dhuruesi (bizneset/donatorët privatë). Donacionet e dhëna për të ndihmuar në realizimin e interesave të grupit që partia përfaqëson mund të kthehen në mjete për të ndikuar në të mirë të interesave të ngushta të minigrupit, brenda vetë këtij bashkimi vullnetar. Në këtë artikull do të trajtohet mënyra sesi financohen partitë politike në vendin tonë dhe problemet kryesore që e shoqërojnë këtë proces, legjislacioni shqiptar mbi partitë politike dhe në mënyrë të veçantë ligji i ri nr. 10374 (2011), i cili ka sjellë në këtë fushë disa risi domethënëse. Korniza ligjore konsiderohet një arritje e suksesshme, por pjesa mbi mjetet financiare dhe mbi mjetet materiale të partive politike mbetet ende një nga hallkat e tij të dobëta, sepse pavarësisht azhurnimeve të herëpashershme, ende nuk ka arritur të kufizojë abuzimet lidhur me financimet që partitë politike përfitojnë.*

Fjalët kyçe: *financim, parti politike, donatorë privatë, burime financiare.*

1. Hyrje

Financimi politik është një nga temat më pak të trajtuara në debatin publik që zhvillohet në Shqipëri. Në seancat plenare, në forumet e partive, në debatet televizive, në analizat e shtypit të shkruar dhe në konferencat e forumet shkencore mungon debati i mirëfilltë për financimin politik edhe pse ai i ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë zgjedhjet elektorale, qeverisjen, luftën kundër korrupsionit dhe vetë demokracinë. Ndërkohë, shumë agjenci dhe institucione ndërkombëtare

e shohin korrupsionin në politikë të pranishëm dhe në nivele të larta në shumë vende. *Transparency International* e vlerëson edhe vitin 2011 si vitin e krizës në qeverisje, duke theksuar se protestat në mbarë botën ishin tregues i mungesës së stabilitetit ekonomik dhe e transparencës së liderëve e të institucioneve të tyre publike¹. Këto organizma ndërkombëtarë e shohin në nivele të larta edhe në vendin tonë korrupsionin në politikë dhe te partitë politike. Partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet e përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit². Ato krijohen lirisht dhe organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike³.

Në çdo kohë të veprimtarisë së tyre partitë politike i kanë jetësore burimet financiare të cilat konsiderohen gjithnjë të domosdoshme. Duke qenë mjet i një nevojë të madhe, mënyra sesi paraiza financiare ndikon në politikëbërje, kërkon një përcaktim të qartë në mënyrë që kanalet financiare të jenë të kontrollueshme kohë pas kohe ose në vazhdimësi. Studiuesit gjerësisht bien dakort se partitë politike përbëjnë më shumë sesa thjesht një grup interesi në shoqëri dhe janë institucione që kërkojnë të influencojnë shtetin nëpërmjet marrjes së pushtetit qeverisës. Financimi i partive politike nga donatorët privatë jo vetëm që është tërësisht jashtë vëmendjes së mendimit akademik shqiptar, por për një kohë të gjatë përbente një nyje të pazgjidhur në legjisllacionin tonë. Sot situata lidhur me financimin e partive politike nga donatorët privatë, në sajë të ligjit të ri nr. 10374 datë 17.02.2011 “Për

¹ Shqipëria renditet në vendin e 95-të, mes 183 shteteve për shkallën e korrupsionit. Të dhënat jepen nga raporti i fundit mbi shkallën e korrupsionit në nivel global, publikuar sot nga Transparency International http://www.tia.al/eng/index.php?option=com_content&view=article&id=74:tia-prezanton-indeksin-e-perceptimit-te-korrupsionit-cpi-2011&catid=29:press-releases&Itemid=122; <http://www.panorama.com.al/lajmi-i-fundit/shkalla-e-korrupsionit-ti-shqiperia-ne-vendin-e-95/> aksesuar për herë të fundit më 1.12.2011 h:15:30.

² Neni 1 i ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”.

³ Shih nenin 9 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë., ku sanksionohet: “1. Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike. 2. Partitë politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e të cilave mbështeten në metodat totalitariste, që nxitin e përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si edhe ato me karakter të fshehtë janë të ndaluara sipas ligjit. 3. Burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike”; nenin 46 ku thuhet se: “1. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm. 2. Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqateve bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj. 3. Organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit” dhe nenit 131/d ku përcaktohet se: “Gjykata Kushtetuese vendos për: ...d) kushtetueshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, sipas nenit 9 të kësaj Kushtetute”.

disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, ka ndryshuar në mënyrë domethënëse. Në këtë ligj përcaktohet për herë të parë përmbajtja thelbësore e financimit jopublik: ato janë dhurime financiare, dhurime në natyrë, shërbime, sponsorizime, kredi ose garanci të ndryshme si dhe çdo transaksion tjetër financiar. Ligji i ri mbi partitë politike prezantohet pothuajse i plotë, i besueshëm dhe i kuptueshëm nga të gjithë të interesuarit. Ky ligj përcakton disiplinën juridike të fondeve jopublike, pra, rregullimin ligjor, transparencën, legjitimitetin, mbikëqyrjen dhe sanksionet përkatëse. Ligji në fjalë jo vetëm që ka specifikuar se cilat konsiderohen fondet jopublike por ka përmbushur edhe vakumin ligjor që ekziston që prej vitit 2001 në lidhje me kontrollin e (mos) ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke dizenuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si autoritetin kompetent për mbikëqyrjen financiare të fondeve publike dhe jopublike. Për herë të parë janë përfshirë në financimin jopublik dhe dhurimet në natyrë, megjithëse ato nuk janë identifikuar qartë dhe ligji nuk e përcakton nëse ato duhet të llogariten në vlerën e tyre dhe mbi to të ushtrohet auditimi. Në këtë drejtim, korniza ligjore prezantohet gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me angazhimet në nivel ndërkombëtar dhe europian. Megjithatë nuk mund të anashkalohen këtu disa problematika të rëndësishme të cilat mbeten ende të pazgjidhura siç mund të konsiderohet roli dhe besueshmëria e KQZ-së si organ kompetent mbikëqyrjeje, procedurat lidhur me verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve financiare të subjekteve zgjedhore, të cilat nuk janë të detajuara, si dhe specifika të tjera të financimeve nga donatorët privatë.

2. Baza ligjore e financimit politik

Legjisllacioni shqiptar njeh dy forma të financimit të partive politike: financimin publik dhe atë jopublik (privat). Nëse do t'i referohemi bazës ligjore për financimin e partive politike në Shqipëri, pa dyshim që do t'i referohemi në radhë të parë Ligjit themeltar të Republikës së Shqipërisë, Kushtetutës, në nenin 9 pika 3 ku sanksionohet: “*Burimet financiare të partive politike si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike.*” Ky nen e bën publikimin e financimeve dhe të shpenzimeve një detyrim kushtetues për të gjitha partitë politike.

Në plotësim të Kushtetutës, ligji nr. 8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike” Kreu III, bën përcaktimin ligjor të financimit të partive politike. Ky ligj është amenduar nga Ligji nr. 10 374 datë 10.02.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”. Neni 17 i ligjit, i ndryshuar, përcakton shprehimisht se burimet financiare dhe materiale të partive politike përbëhen nga kuotat e anëtarësisë, nga fondet publike, duke përfshirë edhe ndihmën financiare në masën e caktuar në Buxhetin e Shtetit të miratuar me ligj nga Kuvendi, fondet jopublike, të cilat janë dhurimet financiare, dhurimet

në natyrë, shërbimet, sponsorizimet, kredite apo garancitë e ndryshme, si dhe çdo transaksion tjetër financiar⁴.

Financimi publik përfitohet nga Buxheti i Shtetit sipas rregullave të përcaktuara në nenin 19 të ndryshuar. Çdo vit në Buxhetin e Shtetit përcaktohet një fond që shërben si ndihmë financiare publike për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike. Ndihma financiare e parashikuar në Buxhetin e Shtetit në vitet jozgjedhore, si rregull, nuk mund të jetë më e vogël se ndihma e parashikuar në vitin paraardhës⁵.

Fondi në fjalë ndahet sipas disa rregullave të përcaktuara po në nenin 19. Rregulli i parë përcakton: “70 përqind, të shumës së Buxhetit për financimin e partive, ndahet në bazë të numrit të deputetit të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare”. Rregulli i dytë kalkulon “20 përqind e fondit të Buxhetit Shtetëror ndahet në mënyrë të barabartë nëpërmjet partive parlamentare.⁶ Gjithashtu 10 përqind e ndihmës shtetërore ndahet në mënyrë të barabartë midis partive që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1 përqind të votave në shkallë vendi⁷. Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10-përqindëshi i shtohet fondit prej 70% dhe u ndahet partive parlamentare.

⁴ Neni 17 i ligjit më parë parashikonte që burimet financiare dhe materiale të partive politike përbëheshin nga: a) kuotat e anëtarësisë; b) çdo pasuri e fituar në mënyrë të ligjshme; c) ndihma financiare në masën e caktuar në Buxhetin e Shtetit, të miratuar me ligj nga Kuvendi.

⁵ Buxheti i Shtetit financon nëpërmjet një zëri të quajtur “Partitë Politike” tri kategori: Partitë Politike, Shoqatat dhe Organizatat e Veteranëve me Status. Fondet e përcaktuara për Partitë Politike zënë pjesën më të madhe, mesatarisht 95% të financimit për këto tri forma të organizimit shoqëror. Nga viti 2003 në vitin 2004 ka pasur një rritje rreth 4% të financimit për Partitë Politike, ndërsa për vitin 2005 ato kanë vazhduar të jenë në masën 194 milionë lekë. Në vitin 2006 ka pasur një rënie të lehtë me 2 milionë lekë dhe ky nivel ka vazhduar edhe për tri vite të tjera. Në vitin 2010 fondet për Partitë Politike u rritën me 3.6%, duke shkuar në 199 milionë lekë dhe në vitin 2011 ato u parashikuan në 200 milionë lekë. Burimi i Ministrisë së Financave është përpunuar nga ODA, në <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/202/Financimi-i-Partive-Politike-Shoqatave-dhe-Organizatave-te-Veteraneve-me-Status>, aksesuar për herë të fundit dt. 01.12.2011, h: 15:30.

⁶ Parti parlamentare janë ato parti politike që kanë fituar dhe zotërojnë të paktën një vend në Kuvend nga zgjedhjet pararendëse.

⁷ Neni 19 i ligjit “Për Partitë Politike” sanksiononte shprehimisht: “Në buxhetin shtetëror vjetor parashikohet ndihma financiare për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike. 70 përqind e ndihmës shtetërore ndahet në pjesë të barabarta sipas votave të fituara në zgjedhjet e fundit parlamentare, pa kufi të poshtëm, çka nënkupton që çdo parti merr një mbështetje financiare për votat që ka fituar. Kjo nuk kërkon domosdoshmërisht të ketë deputetë në Kuvend; 20 përqind e ndihmës shtetërore ndahet në mënyrë të barabartë midis partive që kanë grup parlamentar; 10 përqind e ndihmës shtetërore ndahet në mënyrë të barabartë midis partive që kanë marrë pjesë në dy zgjedhjet e fundit parlamentare me lista kombëtare”.

Financimi jopublik rregullohet nga neni 21 i ligjit “Për Partitë politike”, në kombinim me nenin 17, si dhe nga nenet 89-90 të Kodit Zgjedhor. Partive politike u lejohen dhuratat dhe ndihmat që vijnë nga parti ose bashkime ndërkombëtare partish, nga organizata e fondacione politike, vendase e të huaja, si dhe nga individë, persona fizikë e juridikë privatë vendas. Financimi nga donatorët privatë rregullohet gjithashtu dhe nga Kodi Zgjedhor: për herë të parë ai është sanksionuar në Kodin Zgjedhor të vitit 2004 në nenin 144. Kodi Zgjedhor aktual në nenet 89-92 përcakton mënyrën dhe elementet përbërëse të gjithë procesit të financimit të partive politike. Risi domethënëse në këtë fushë ka sjellë pa dyshim dhe ligji i ri nr. 10 374, i cili do të trajtohet gjerësisht në vijim. Vlen të përmendim këtu dhe udhëzimet e raportet e Komisionit të Venecias lidhur me financimet e partive politike. Raporti i fundit lidhur me financimin e partive politike (2010) e vë theksin mbi transparencën e financimit privat të partive dhe mbi kufizimet e mundshme: një nivel maksimal për çdo kontribut, ndalimin e kontributeve nga ndërmarrjet me natyrë industriale ose tregtare ose nga organizatat fetare, kontrollin paraprak nga organet publike, të specializuara për çështjet elektorale e të kontributeve nga anëtarë të partive që duan të qëndrojnë si kandidatë në zgjedhje⁸.

3. Financimi i partive politike nga donatorët privatë dhe mbikëqyrja e tyre

Financimi i partive politike sot nuk mund të konceptohet pa donacionet që vijnë nga privatët. Ndryshe nga fondet publike, që janë pak a shumë të përcaktuara, paratë e përfituara nga donatorët privatë janë më të dëshirueshme. Fondet private janë të dëshirueshme edhe për faktin se ato nxisin gjithashtu pjesëmarrjen qytetare në veprimtarinë e partive politike dhe ruajnë një lidhje midis partive dhe mbështetësve të tyre të bazës.

Në Shqipëri janë zhvilluar gjithsej pesëmbëdhjetë përballje elektorale (zgjedhje të përgjithshme elektorale dhe zgjedhje vendore). Që nga zgjedhjet e para pluraliste, të zhvilluara në 31 mars të 1991-it e deri te referendumi për Kushtetutën të zhvilluar në vitin 1998, “paraja politike” nuk ishte përcaktuese në rezultatet e këtyre përballjeve të para politike⁹. Partitë politike dhe fushatat e tyre politike në

⁸ Shih [http://www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-RA\(2010\)001-e.pdf](http://www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-RA(2010)001-e.pdf).

⁹ Përcaktuese ishin elemente të tjera si: keqpërdorimi i institucioneve shtetërore, dhuna fizike dhe verbale, që njohën si kulm të tyre zgjedhjet elektorale të zhvilluara në maj të 1996-ës. Shqipëria kishte vetëm një media elektronike shtetërore dhe reklamat politike në televizion ishin ende të panjohura. Shih *Zgjedhjet, Paraja dhe Demokracia. Si të rrisim transparencën financiare të partive politike shqiptare*, Botim i Këshillit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, Tiranë, 2011, edhe në <http://www.acfr-al.org/Zgjedhjet.pdf>.

fillim financoheshin kryesisht nga kuotat e anëtarësisë dhe nga fondet publike. Peshën kryesore në këtë financim e mbanin kontributet e anëtarësisë. Financimi privat ishte pothuaj i panjohur. Edhe pse lejohej financimi privat, bizneset e kishin shumë të vështirë të financonin opozitën¹⁰. Ndër vite “paraja politike” gjithnjë e më shumë po kthehej në një element ndikues në rezultatet e përballjeve dhe infrastruktura zgjedhore po bëhej tejet e kushtueshme¹¹. Partitë politike dhe fushatat e tyre politike (kryesisht pas viteve 2000-2001) janë financuar kryesisht nga tri burime: fondet private, fondet publike dhe kuotat e anëtarësisë. Peshën kryesore në vitet e fundit në këtë financim e mbajnë financimet private, ndërsa kontributet e anëtarësisë janë pothuajse të papërfillshme.

Me ligjin e ri partitë politike si subjekte zgjedhore lejohen të marrin ndihma dhe dhurata nga: a) partitë ose bashkime ndërkombëtare partish, b) organizata dhe fondacione politike vendase dhe të huaja dhe c) individë, persona fizikë e juridikë privat vendas¹². Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike përcaktohet shprehimisht në nenin 89 të Kodit Zgjedhor i cili sanksionon se subjektet zgjedhore mund të marrin, për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore, fonde vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas. Për këtë qëllim konsiderohet person fizik vendas edhe shtetasi shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t’i japë një subjekti zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlefata në sende ose shërbime. Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë duhet të bëhet vetëm nëpërmjet një llogarie të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor. Përgjegjësi i financës së subjektit zgjedhor, jo më vonë se tri ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore, deklaroi numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik duhet të publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Nga të dhënat e KQZ-së rezulton se nga të gjitha subjektet zgjedhore vetëm katër prej tyre rezultojnë të kenë përmbushur këtë detyrim¹³. Ky detyrim ligjor pa dyshim që duhet të përmbushet nga të gjitha subjektet zgjedhore. Kodi zgjedhor ka sanksionuar që asnjë subjekt, që ka lidhje me shërbimet shtetërore, nuk mund të japë dhurata për partitë politike. Donatorët ndalohen të japin financime në rast se kanë përfituar fonde publike, kontrata publike ose koncesione në dy vitet e fundit me

¹⁰ Po aty.

¹¹ Fushatat në këtë periudhë karakterizohen nga reklama të shumta politike në media dhe në mjedise publike, zyra elektorale të shumta dhe moderne, nga mitingje-spektakle, nga kompani të huaja e të specializuara për marketing elektorale, nga sondazhet periodike elektorale; këto ishin mënyra të reja të komunikimit me zgjedhësit, me ndikim në rezultatin elektorale dhe në porpocion të drejtë me sasinë e parave të shpenzuara.

¹² Neni 21 i ligjit “Për Partitë Politike”.

¹³ http://www.cec.org.al/index.php?option=com_content&view=article&id=16%3AAnumrat-e-llogarive-bankare-te-subjekteve&catid=6%3Afinancimi-i-subjekteve&Itemid=87&lang=sq, aksesimi për herë të fundit në dt. 30.11.2011 h. 14:20.

vlerë mbi 10 milionë lekë, ushtrojnë aktivitetet në fushën e medias, kanë qenë partner në fondet publike në projekte të ndryshme ose kanë detyrime monetare në buxhetin e shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.

Në lidhje me financimin privat rëndësi të veçantë merr dhe regjistrimi i këtyre fondeve, procedurë kjo e parashikuar në nenin 90 të Kodit Zgjedhor. Sipas tij çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çastin e dhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 89 të këtij Kodi dhe mban përgjegjësi personale për deklaram të rremë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohet nga KQZ-ja dhe është e detyrueshme për t’u nënshkruar në çdo rast dhurimi. Lista e personave që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse duhet të bëhen kurdoherë publike. Edhe pse ligji ka sjellë një zhvillim në lidhje me transparencën, vendosja e një limiti monetar përsëri lë hapësira për abuzim.

Në fakt, çështja që ka vazhduar të mbetet ende e debatueshme mbi financimin e partive politike është pikërisht transparenca dhe mbikëqyrja financiare. Miratimi i ndryshimeve në ligjin për partitë politike synoi sigurimin e kriterëve më të forta lidhur me themelimin e partive politike në Shqipëri dhe të transparencën së tyre. Njëkohësisht ky ligj përforcoi lejimin e përdorimit më transparent, racional e të përshtatshëm të burimeve financiare dhe materiale të shtetit në favor të zhvillimit të veprimtarive të partive politike. Ndryshime të reja të bëra në ligjin mbi partitë politike dhe nenet që kanë të bëjnë me financimin e partive politike duken në koherencë me rekomandimet e OSBE/ODIHR, të KE-së si dhe të KIE-së me qëllim krijimin e një kuadri ligjor të mirëpërcaktuar dhe me mekanizma më të fortë kontrolli. Në fakt, *mekanizma më të fortë* kontrolli nuk hasen në asnjë dispozitë të ligjit në fjalë dhe madje as procedurat për mbikëqyrjen e financimeve nuk duken të qarta. Këto procedura të detajuara nuk përcaktohen as në akte nënligjore.

Ndryshimi më i madh që është bërë në ligjin e ri të partive politike i përket pikërisht nenit 15/2 dhe nenit 23¹⁴. Në nenin 4 të ligjit të ri, i cili shton nenin 15/2, si pjesë përbërëse e kreut III “Mjetete financiare dhe materiale të partive politike” përcaktohet se “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive, sipas rregullave të këtij ligji”. Në bazë të këtij neni është identifikuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si autoriteti përgjegjës për monitorimin e financimit të partive politike, si dhe për kompetencat e këtij autoriteti në përmbushjen e këtij detyrimi. Në fakt, ky parashikim plotëson nenet 90 dhe 91 të

¹⁴ Neni 23 i ligjit të mëparshëm përcaktonte se Kontrolli i Lartë i Shtetit ishte organi kompetent i ngarkuar me funksionin e kontrollit financiar mbi partitë. Ky kontroll nuk do të kufizohej vetëm në pjesën e buxhetit të partive që sigurohen nga fondet publike, por do të mbulonte edhe dhuratat dhe ndihmat e përfituara në rrugë të tjera.

Kodit Zgjedhor, të cilave do t'i shoqërohet edhe neni 23/1 i ligjit të ndryshuar. Kështu, meqënëse Kodi Zgjedhor i vitit 2008 i jep më shumë kompetenca Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në ligjin e ri u parashikua ndryshimi i nenit 23, duke përcaktuar si autoritet kontrollues të raporteve financiare të partive politike pikërisht KQZ-në, si dhe shfuqizon nga ky proces Kontrollin e Lartë të Shtetit. Ky riformulim u bazua në dy faktorë: së pari, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u vlerësua se përbën një mekanizëm të pavarur dhe ekziston mundësia e dhënies së mandatit, autoritetit dhe burimeve të mjaftueshme për të mbikëqyrur në mënyrë efektive dhe paraprakisht financimin e partive politike; së dyti, nga praktika e zbatimit të ligjit “Për partitë politike”, të ndryshuar, tashmë rezultoi se nuk është ushtruar asnjë kontroll nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, çka tregoi mosfunksionimin real të formulës paraekzistuese të kontrollit. Për më tepër, heqja e kompetencës kontrolluese të Kontrollit të Lartë të Shtetit është një proces i filluar me vendimin nr. 33 të vitit 2001 të Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar pjesërisht kompetencat e këtij organi¹⁵. Debatet që lindën nga këto azhurnime ishin të shumëllojshme: që nga legjitimiteti i organit të mbikëqyrjes dhe monitorimit si dhe aftësia e tij për të ushtruar këtë funksion që shtrihen deri në faktin që ende ky organ nuk ka ndërmarrë një iniciativë kontrolluese të mirëfilltë ose denoncimin e rasteve kur ligji është shkelur.

Është diskutuar nëse KQZ-ja është një organ aq efektiv dhe i paanshëm për këtë detyrë. Në fakt, problemi nuk duhet reduktuar tek emri i institucionit që është ngarkuar në këtë funksion, por te puna që ky institucion bën dhe te përbërja e tij. KQZ-ja e ka politizimin e saj të përcaktuar që në përbërjen e saj me anëtarë të mazhorancës dhe kjo deklaratë përforcohet me raportet e OSBE/ODIHR në zgjedhje, duke deklaruar se KQZ-ja është e ndarë në linja partiake ku mbizotëron polarizimi dhe mosbesimi, ndaj për këtë arsye, te ky institucion, duke filluar që nga përbërja e këtij institucioni nuk mund t'i besohet kjo detyrë. Faktikisht KQZ-ja deri më sot ka luajtur thjesht rolin e një depozituese të garantuar të deklarimeve financiare. Tashmë asaj i besohet një detyrë tjetër madhore: mbikëqyrjen dhe monitorimin, duke e veshur kështu këtë institucion me kompetenca të vërteta kontrolli për të verifikuar vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjektet zgjedhore. Nga ana tjetër nuk duhet anashkaluar fakti që KQZ-ja nuk është një institucion financiar. Ndër të tjera në asnjë dispozitë nuk parashikohet përbërja e komisioneve hetimore me ekspertë financiarë. Në këto komisione hetimi dhe monitorimi duhet të ketë pa tjetër ekspertë financiarë: një komision hetimi duhet medoemos të

¹⁵ Në vendimin nr. 33 datë 09.05.2001, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 dhe 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, vendosi shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të shprehjes “por do të mbulojë edhe dhuratat dhe ndihmat e përfituara në rrugë të tjera”, në fjalinë e dytë të nenit 23 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”.

përbëhet në pjesën dërrmuese të tij nga ekonomistë ose nga ekspertë kontabël.

Për më tepër ligji i ri ka përcaktuar edhe sanksionet përkatëse për shkeljen e rregullave dhe të procedurave të auditimit dhe vërtetësinë e deklarimeve financiare kur konstatohet shkelje të dispozitave të këtij ligji: në këtë mënyrë KQZ-ja (ose çdo organ tjetër) kthehet dashur pa dashur në një institucion *quasi gjyqësor*, i cili i vendos sanksione subjekteve zgjedhore. Në këtë rast ky organ merr vendime administrative dhe kthehet në institucion rregullator dhe merr tri dimensione: administrativ, rregullator dhe *quasi gjyqësor*. Për më tepër organi përgjegjës për mbikëqyrjen e financimit politik *duhet të ketë të drejta dhe kompetenca* më të gjera të domosdoshme për vetë rëndësinë dhe kompleksitetin e financimit politik.

Në ligj nuk janë përcaktuar në detaje rregullat dhe nuk është përcaktuar një procedurë e mirëfilltë e monitorimit dhe kontrollit, ndaj për këtë arsye ligji në këtë pjesë ka mangësi të konsiderueshme. Duhet përmendur këtu se në ligj nuk përcaktohet qartë kur dhe si kryhen këto kontrole dhe nuk përcaktohet se cilat subjekte zgjedhore kontrollohen. Këto procedura mund të rregullohen edhe nëpërmjet akteve nënligjore, por deri më sot akte të tilla nuk janë miratuar.

Një zgjidhje alternative për organin kompetent për monitorimin dhe mbikëqyrjen financiare mund të ishte *Inspektorati i lartë i kontrollit dhe deklaratimit të pasurive* (ILKDP), ose përsëri *K Kontrolli i Lartë i Shtetit* (KLSH), pasi me përmbajtjen e ligjit të ri ky organ mund të vepronte me legjitimitet dhe me sukses. Në këtë pikë, problemi nuk vlen të thjeshtësohet vetëm duke paragjykuar organin e zgjedhur për mbikëqyrjen dhe për monitorimin e financimit të partive politike. Duhet të mendojmë se diskutueshmëria e KQZ-së (dhe cilido organ publik i vendosur në këtë përgjegjësi) lind edhe nga mungesa e sjelljes politike që vetë partitë politike kanë në këtë çështje, pasi puna e KQZ-së nis me deklaratimet/raportet që vetë partitë dorëzojnë mbi financat dhe shpenzimet e tyre. Gjatë periudhës 2000-2010-të nuk rezultoi asnjë rast i vetëm që partitë politike të kenë dorëzuar pranë KQZ-së raporte vjetore lidhur me burimet financiare me dhe shpenzimet¹⁶. Ato janë dorëzuar vetëm në fund të tetorit/fillimi i nëntorit të vitit 2009, në përmbushje të detyrimeve ligjore lidhur me zgjedhjet e 28 qershorit të 2008-ës. Por edhe këto dorëzime nuk duhet të bëhen 45 ditë pas shpalljes së rezultateve, por të paktën deri në 45 ditë pas ditës së zgjedhjeve të shpallura nga Dekreti i Presidentit të Republikës.

Në ligjin e ri të miratuar në shkurt të 2011-ës, në nenin 23 përcaktohet se partitë politike duhet të dorëzojnë raportet financiare një herë në vit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ato duhet të përmbajnë informacion të hollësishëm për burimet e financimit në bazë të formatit të standardizuar, të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; shpenzimet në bazë të formatit të standardizuar, të miratuar

¹⁶ Raporti SIGMA 2009 në *Zgjedhjet, Paraja dhe Demokracia. Si të rrisim transparencën financiare të partive politike shqiptare*, Botim i Këshillit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, Tiranë, 2011, edhe në <http://www.acfr-al.org/Zgjedhjet.pdf>.

nga KQZ-ja, subjektet e lidhura, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me partitë politike apo që kontrollohen prej tyre, të cilat deklarohen nga vetë partia politike. Po ashtu për sa i përket deklarimeve të detyrueshme në nenin 23/1 të ligjit të ri përcaktohet se çdo parti politike duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shumën e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çdo rast, dhuruesi, në kohën e dhurimit, nënshkruan detyrimisht një deklaratë dhurimi, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Lista e personave, që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse, duhet të bëhen kurdoherë publike; ndalohet përfitimi i fondeve jopublike, i kryer nga subjekte që nuk deklarojnë identitetin e tyre apo identiteti i të cilave është i papërcaktuar qartë nga partia politike përfituese e fondit jopublik; çdo shpenzim i kryer nga partia politike kryhet dhe dokumentohet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi¹⁷.

Ligji i ri parashikon figurën e ekspertëve kontabël për auditimin e financimeve dhe shpenzimeve. Ky detyrim ligjor është pasqyruar qartë dhe menjëherë në faqen zyrtare të KQZ-së. Për të siguruar kontrollin efektiv vendoset një kufi i tillë: nuk mund të bëhet auditimi i një subjekti zgjedhor nga i njëjti ekspert në vitin pasardhës. Gjithashtu në ndryshimet ligjore në nenin 23/2 pika “6” përcaktohet se “Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në këtë ligj nga partitë politike apo dhuruesit, në rast se nuk përbën vepër penale, është kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas parashikimeve të këtij ligji¹⁸. Ligji i ri i partive, i ndryshuar, parashikon që KQZ-ja ka autoritetin për të vendosur edhe gjopa për partitë politike që nuk deklarojnë financimet sipas rregullave të përcaktuara në ligj¹⁹. Problem

¹⁷ Ligji nr.8580 “Për partitë politike”, i ndryshuar me ligjin Nr.10 374, datë 10.2.2011.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Kështu në nenin 23/2 jepen sanksionet, ku përcaktohet se “Shkelja e dispozitave për financimin e partive politike nga ana e personit përgjegjës për financat në partinë politike apo e personit përgjegjës sipas statutit të saj dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë; shkelja e detyrimit për bashkëpunim me ekspertin kontabël të licencuar, të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nga ana e partisë politike, dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë; refuzimi për të bërë transparent burimet e financimit të partisë politike apo për të lejuar ushtrimin e kontrollit nga ana e ekspertit kontabël të licencuara të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dënohet me gjobë nga 2 000 000 deri në 5 000 000 lekë ose/dhe me pezullimin deri në 5 vjet të financimit publik për partinë politike; shkelja e afatit të dorëzimit të raportit financiar në kohën e duhur apo paraqitja e raporteve në shkelje të formatëve të standardizuara, të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë; fondet jopublike të përfituara nga partia politike, kur identiteti i dhuruesit nuk njihet apo nuk është i përcaktuar qartë, kalojnë për llogari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; pranimi i fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë dhe kur transaksioni nuk është kryer nëpërmjet llogarisë bankare dënohet me gjobë në masën 30 për qind të shumës së dhuruar”.

tjetër, i kapërcyer tashmë nga ligji i ri lidhej me faktin se financimi privat bëhej *cash* dhe nuk kalonte përmes rrugëve bankare: sot ligji përcakton qartë rregullat për marrjen e fondeve nga donatorët privatë. Në fakt, në raportet e prezantuara nga subjektet zgjedhore në vitin 2009 pothuajse të gjitha partitë politike e kanë përmbushur formalisht këtë detyrim²⁰.

4. Modele të financimit të partive politike në Europë dhe në rajon

Europa në lidhje me financimin e partive politike nga donatorët privatë paraqet një varietet thuajse të këndshëm. Tipari i përbashkët në të gjitha vendet dhe me sistemin tonë është publikimi i shpenzimeve të partive politike dhe i parave të përfituara nga donatorët privatë. Vende të ndryshme kanë zgjedhur forma të ndryshme të rregullimit ligjor të financimit. Pjesa më e madhe e shteteve anëtare i cilësojnë partitë politike si persona juridikë; gjithashtu kanë një legjislacion të detajuar lidhur me financimet si publike ashtu edhe ato jopublike. Në disa vende anëtare të BE-së partitë politike nuk gëzojnë personalitet juridik²¹. Partitë politike në këto vende konsiderohen si organizata të paregjistruara ose si organizma privatë të organizuar mbi baza vullnetare dhe ekzistenca e tyre nuk është e rregulluar me ligj. Republika Federale e Gjermanisë ishte vendi i parë evropian që ka implementuar një sistem të drejtpërdrejtë të financimit publik të partive politike²². Ndërsa për sa i përket financimeve nga fonde jopublike ato ndalohen nga fondacionet politike; nga shoqatat ose organizatat jofitimprurëse, me natyra bamirëse e fetare si dhe nga jashtë vendit. Në modelin gjerman parashikohet detyrimi i partive për të deklaruar publikisht, me anë të një deklarate bankare, origjinën dhe përdorimin e fondeve të marra brenda një viti buxhetor. Në Francë financimi i partive politike përfitohet nga fonde publike dhe fonde private. Kandidatëve të partive politike gjatë fushatave zgjedhore i është ndaluar që të mbledhin para *cash*: këtë gjë mund ta bëjnë vetëm nëpërmjet një organizate financiare ose nëpërmjet një përfaqësuesi me titullin financier. Shoqata hap një llogari bankare për transaksione financiare dhe shpërndahet me ligj tre muaj pas përfundimit të fushatës. Në Francë për të kontrolluar financimin e partive politike operon Bordi i Auditësve të fushatës kombëtare dhe financave politike dhe është përgjegjës për shqyrtimin e llogarive të fushatave. Komisioni

²⁰ Shih www.cec.org

²¹ Belgjika, Irlanda, Luksemburgu, Greqia.

²² Shih *Il finanziamento della politica in Francia, Germania, Regno Unito, Spagna e Stati Uniti d'America*, Documentazione e ricerche, Servizio Studi, Camera dei Deputati, Novembre, 2006.

mund të miratojë, të refuzojë apo të modifikojë llogaritë²³. Në Angli nuk ka një sistem të pastër të financimit publik të partive politike, por ekziston një ndihmë e limituar nga fondet publike të destinuara për partitë parlamentare të opozitës²⁴. Në Portugali ekziston ligji “Për financimin e partive politike dhe fushatën elektorale”, i cili rregullon sferën e financimit. Donacionet e kryera nga personat fizikë të identifikuar janë të limituara në vlerën e jo më tepër se 30% të minimumit të rrogës mujore për çdo donator dhe kryhen me transfertë bankare për çdo rast kur ato tejkalojnë rrogën minimale mujore. Si organ auditimi në këtë vend është Gjykata Kushtetuese e Llogarive, që heton ligjshmërinë e aktivitetit financiar të partive. Në rastin e Hungarisë, KLSH-ja dhe zyra kombëtare e revizionimit ka të drejtën të kontrollojë ligjshmërinë e çështjeve financiare të partive politike. Partitë duhet të deklarojnë të dhënat e tyre financiare të vitit paraardhës në gazetën hungareze, para datës 31 mars. Në Serbi, të dhënat financiare, kreditë dhe debitet e një partie politike, janë subjekt i një kontrolli vjetor në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe mund të jenë subjekt i çdo kontrolli nga organet kompetente. Pasqyra financiare vjetore dhe raportet e përcaktuara në ligjin “Për financimin e partive politike”, duhet të botohen në “Gazetën e Republikës së Serbisë”, me shpenzimet e partisë politike. Në rastin e Maqedonisë, ligji përcakton se burimi i të ardhurave i subjekteve zgjedhore është publik. Çdo evidencë që tregon të ardhurat dhe shpenzimet duhet të tregojë llojin, shumën dhe burimin e të ardhurave. Në modelin e Estonisë, shohim se çdo parti në mënyrë periodike, çdo datë 5 të çdo fillim katërmujorshi paraqet një raport të kompletuar mbi të gjitha fondet e marra, duke përcaktuar saktë datën e marrjes, tipin e financimit, por dhe tregon burimin e këtij fondi²⁵.

5. Konkluzione dhe rekomandime

Situata lidhur me financimin e partive politike nga donatorët privatë ka ndryshuar në mënyrë të veçantë me miratimin e ligjit nr. 10374. Në ligjin e ri përcaktohet për herë të parë disiplina juridike e fondeve jopublike, përmbajtja thelbësore e financimit jopublik, rregullimi, transparenca, legjitimiteti, mbikëqyrja dhe sanksionet përkatëse. Ligji në fjalë ka përmbushur edhe vakuumin ligjor që ekziston që prej vitit 2001 në lidhje me kontrollin dhe monitorimin e deklaratave

²³ Po aty.

²⁴ Shih M.Bimi, *Financimi i partive politike* në www.drejttesiashqiptare.com.

²⁵ A,Rommele, K.Lawson,G.Karasimenov (edited), *Cleavage parties and voters:Studies from Bulgaria, Czech Repp.,Hungary,Romania*, Greenwood, 1999; R. S.Katz, *Are cleavages frozen in the English speaking democracies?* në M,Cotta-D.D.Porta-L.Morlino *Scienza Politica*, Il Mulino, 2001; Paul G. Lewis *Political Parties in Post-Communist Eastern Europe*, Routledge 2000.

financiare të subjekteve zgjedhore nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Megjithatë korniza ligjore paraqet disa mangësi të konsiderueshme, për të cilat do të sugjerohen edhe disa rekomandime.

Legjislacioni i ri dizenjon një organ jo të përshtatshëm për kryerjen e monitorimit të vërtetësisë së deklarimeve financiare të subjekteve zgjedhore. Në këtë drejtim zgjidhjet mediate janë dy: ose KQZ-së t'i jepet besim në këtë detyrë të re, ose të amendohet përsëri ligji dhe të përcaktohet një organ tjetër më i përshtatshëm siç mund të jetë (përsëri) Kontrolli i Lartë i Shtetit. Në lidhje me mundësinë e parë duhet thënë se është ende herët për të përcaktuar nëse një organ i tillë do të jetë efektiv, ose joefektiv në mbrojtjen dhe monitorimin financiar të subjekteve zgjedhore. Puna e këtij organi lidhur me transparencën dhe legjitimitetin e burimeve financiare efektive do të nisë në vitin 2012 për raportet e auditit vjetor (për 2011-ën) dhe në 2013-ën për raportet e auditit që kanë të bëjnë me fushatat zgjedhore. Ndaj, për këtë arsye, duke vlerësuar se KQZ-ja deri më sot ka qenë thjesht depozituese dhe jo organ monitorues, i duhet dhënë këtij institucioni një besim tërësor dhe i pakushtëzuar për kapërcimin e pengesave të para dhe për afirmimin e saj në kohë si organ monitorues dhe kontrollues i subjekteve zgjedhore. Zgjidhja më e mirë në këtë drejtim është pa dyshim ngritja e komisioneve të përbëra me anëtarë ekspertë të ekonomisë. Zgjidhja e dytë, pra përcaktimi i një organi tjetër kompetent për mbikëjen financiare të partive politike, edhe pse shumë e nevojshme, sot do të dukej tepër e guximshme dhe joefektive.

Në ligj nuk përcaktohen qartë procedurat për mënyrën dhe për kohën e ushtrimit të këtij kontrolli. Nuk përcaktohen qartë se cilat janë subjektet zgjedhore që do t'i ushtrohen këtij kontrolli nga KQZ-ja, ose nëse ka subjekte zgjedhore të cilat mund të mos i nënshtrohen këtyre kontrolleve. Për këtë arsye ligji duhet të përcaktojë në detaje procedurat pasi janë ato që lënë vend për abuzime dhe për mungesë transparence, duke krijuar në këtë mënyrë edhe konflikte ose tensione ndërmjet vetë subjekteve zgjedhore. Duhet përcaktuar qartë edhe disa mekanizma të tjerë më eficientë me qëllim rritjen e transparencës së financimit jopublik të partive politike. Organi përgjegjës për mbikëqyrjen e financimit politik duhet të ketë të drejta dhe kompetenca më të gjera të domosdoshme për vetë rëndësinë dhe kompleksitetin e financimit politik.

Nevojitet mbi të gjitha forcimi i autoriteteve kombëtare për zbatimin e ligjeve, problem ky më akut i *rule of law*, që e shoqëron shpesh shoqërinë tonë. Në këtë kornizë perceptimesh dhe analizash institucionet zbatuese të ligjit duhet të angazhohen në mënyrë rigorozë në implementimin e tij, dhe angazhimet politike të përkthehen në reforma serioze në qeverisjen e vendit. Beteja antikorrupsion duhet të vazhdojë të jetë në qendër të agjendës së qeverisjes si kusht themelor për proceset integruese në Bashkimin Europian. Nevojitet nga ana tjetër vullneti politik i subjekteve zgjedhore për të kapërcyer problematikat aktuale lidhur me korrupsionin dhe me abuzimin. Duket se mungon vullneti i partive politike, i institucioneve politike dhe

i shoqërisë civile për të ndihmuar bashkarisht në zgjidhjen e këtyre problemeve dhe të burokracive formale. Subjektet zgjedhore duket se i gjejnë gjithmonë armët për të delegjitimuar aftësinë kontrolluese të institucioneve duke lënë hapësira mosbesimi në shkallë kombëtare. Vetë partitë politike duket se kanë treguar pak interes në fuqizimin e kapaciteteve dhe të institucioneve të garantuara për auditimin e llogarive dhe për zbatimin e legjislacionit. Kjo situatë, për fat të keq, e bën problemin të vërtitet në një rreth vicioz.

Në përfundim duhet nënvizuar rëndësia e posaçme e përfshirjes së të gjitha institucioneve të zbatimit të ligjit pasi lufta antikorrupsion nuk mund të konsiderohet e plotë pa vëmendjen e duhur ndaj çështjes problematike të financimit të partive politike. Në të gjitha aspektet problemi i transparencës financiare të partive politike mbetet ende për t'u përmirësuar, pasi konsiderohet ende një ndër pikat më evazive të këtij legjislacioni.

Bibliografia

Akte burimore

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligji nr. 8580 datë 17.02.200 “Për Partitë Politike”

Ligji nr. 10374 datë 17.02.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580 datë 17.02.200 “Për Partitë Politike”

Kodi Zgjedhor i miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008

Libra

Aziri E., *Sociologjia e partive politike*, Tetovë, 2004.

Katz R. S., *Are cleavages frozen in the English speaking democracies?* në M, Cotta-D.D. Porta-

Rommele A, Lawson K., Karasimenov G. (edited), *Cleavage parties and voters: Studies from Bulgaria, Czech Repp., Hungary, Romania*, Greenwood, 1999.

Krasniqi A. *Zgjedhjet në Shqipëri*, Tiranë 2009.

Krasniqi A., *Partitë politike në Shqipëri, 1920-2006*, Tiranë, 2007.

Lewis P. G. *Political Parties in Post-Communist Eastern Europe*, Routledge 2000.

Finacimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore, Udhëzues, Botim i Këshillit të Europës, 2003.

Lijphart A., *Le democrazie contemporanee*, Il Mulino 2001.

Morlino L. *Scienza Politica*, Il Mulino, 2002.

Porta D.D., *I partiti politici*, Il Mulino, 2001.

Seiler D.L., *Partite politike*, UET Press, Tiranë, 2009.

Artikuj shkencorë/Punime shkencore

Bushati D., *Financimi i partive politike*, Jus&Justicia, 2009, f. 90-97.

Bimi M., *Financimi i partive politike* në www.drejtjesiashqiptare.al

Il finanziamento della politica in Francia, Germania, Regno Unito, Spagna e Stati Uniti d'America, Documentazione e ricerche, Servizio Studi, Camera dei Deputati, Novembre, 2006.

Zgjedhjet, Paraja dhe Demokracia. Si të rrisim transparencën financiare të partive politike shqiptare, Botim i Këshillit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, Tiranë, 2011, edhe në <http://www.acfr-al.org/Zgjedhjet.pdf>

Zilja B., *Financimi i Partive Politike, Shoqatave dhe Organizatave të Veteranëve me Status*, në <http://open.data.al/>

Protesta si Fenomen Konservator _____

_____ **Dokt. Klementin MILE** _____

***Abstrakt.** Zakonisht e marrim të mirëqenë se protesta është një mjet për të sjellë ndryshime në shoqëri e, në këtë kuptim, gjithkush që proteston dhe i kërkon këto ndryshime, pozicionohet si progresist. Progresistët në shoqërinë bashkëkohore kanë emra të ndryshëm: marksistë, post-marksistë, ambientalistë, libertarianë, pacifistë etj. Këtu nuk bëhet fjalë për të vënë në dyshim sinjeritetin e protestës, e nga kjo të nxirret konkluzioni se ky nuk është një fenomen progresist. Nuk bëhet fjalë as për të vënë në dyshim nëse ka apo s'ka një të ardhshme më të mirë në imagjinatën e protestuesve. E megjithatë çështja e protestës si dukuri bashkohore duhet parë brenda kornizës së zhvillimeve shoqërore; kur vetë shoqëria nuk ka mundur të instalojë aparatin e vetëkritikës. Nëse shoqëria nuk ka zhvilluar pozicione nga të cilat mund të kritikojë vetveten, protesta nuk bën gjë tjetër veçse e riprodhon shoqërinë në të njëjtat parametra, duke mos ndryshuar asgjë nga pikëpamja strukturore. Protesta do të analizohet në tri dimensione kuptimore : në dimensionin kohor, faktik dhe social. Kjo analizë do të ekspozojë diferencën ndërmjet strukturës së shoqërisë dhe semantikës së protestës. Kjo diferencë shfaqet në dimensionin kohor si semantikë e prapambetur, në dimensionin faktik si semantikë sempliste dhe në dimensionin social si semantikë moniste.*

1. Hyrje

Në regjimet demokratike të kohës sonë protesta konsiderohet si formë e pjesëmarrjes politike, që tregon se demokracia është funksionale, se pushtetarët kontrollohen nga populli dhe se të drejtat kushtetuese bazë të njerëzve ushtrohen dhe kanë ndikim në përmirësimin e qeverisjes. Në këtë kuadër, protesta përfaqëson një vlerë që duhet kultivuar dhe një formë të mirëfilltë për të sjellë ndryshime pozitive në shoqëri. Duke e marrë këtë të mirëqenë, i gjithë diskutimi teorik për protestën fokusohet te strategjitë, taktikat, organizimi, synimet dhe motivet e protestës (Meyer at al, 2002; Della

Porta & Diani, 2006; Tilly, 2007). Nëse një protestë dështon, faji bie te njëri, ose te disa prej tyre. Në këtë mënyrë, të gjitha përpjekjet e ardhshme fokusohen te përmirësimi i strategjisë, ose i taktikave dhe organizimit, te specifikimi më i qartë i synimeve dhe tek transparenca e motiveve. Megjithatë, historia e protestave, pavarësisht mësimave të nxjerra nga dështimet e mëparshme, nuk rezulton të jetë histori suksesi. Presioni i popullit protestues mbi qeveritë nuk e ka përmirësuar aspak cilësinë e qeverisjes. Ndryshimet e synuara sociale nuk kanë ndodhur. Institucionet, që për protestuesit simbolizojnë të keqen dhe zanafillën e problemit, vazhdojnë të qëndrojnë në këmbë dhe të funksionojnë si më parë. Në këto kushte bëhet e domosdoshme një tjetër perspektivë studimi e protestës: një perspektivë që nuk i kërkon arsyet e dështimit të strategjia e ndjekur dhe tek elementet e tjera të lartpërmendura, *por te faktorë më themelorë që lidhen me vetë strukturën e shoqërisë bashkëkohore*. Kështu, nga kjo perspektivë shtrohet pyetja: Edhe nëse strategjia, taktikat, organizimi, synimet dhe motivet e protestës janë ato të duhurat, a mund të sjellë protesta ndryshimin social në emër të të cilit ndërmerret ajo? Dhe, në kushtet e shoqërisë bashkëkohore, si duhet të rindërtohet konceptimi ynë për protestën me qëllim që ajo të ketë sukses? Me anë të këtyre dy pyetjeve debati për protestën zhvendoset nga niveli filozofik në atë sociologjik, si dhe nga pozicionimi shterp pro, ose kundër protestës drejt një analize konstruktive, që synon të tregojë *kapacitetin* e kësaj forme të pjesëmarrjes politike dhe *rindërtimin* e saj në kushtet e shoqërisë bashkëkohore.

2. Metodologjia

Ky punim ndjek parimet e metodologjisë konstruktiviste radikale. Ekzistenca e realitetit nuk mohohet, si në rastin e solipsizmit, por as nuk mundet thjesht të marrim dije objektive për realitetin nga perceptimi shqisor, siç pretendon realizmi. Në fakt, të gjitha dijet që marrim për realitetin janë të ndërtuara; pra, nuk kemi akses të drejtpërdrejtë dhe të padyshimtë të realiteti (von Glasersfeld, 1995; von Foerster, 1984 & 2003; Maturana & Varela, 1980 & 1987; Bateson, 1972 & 1979). Implikimet e kësaj teze për studimin në fjalë lidhen *së pari me vëmendjen e veçantë që i duhet kushtuar mënyrës se si i japim kuptim realitetit* (në rastin konkret, protestës dhe shoqërisë ku ndodh ajo) dhe specifikimit të dimensioneve të kuptimit. Kështu, në përputhje me tezën neofunksionaliste të zhvilluar në teorinë e sistemeve, dallohen analitikisht tri dimensione kuptimore: faktik, kohor, dhe social (Luhmann, 1995a: 75). *Së dyti, merr rëndësi vendimtare përshkrimi i shoqërisë bashkëkohore*. Cilësia shkencore e shpjegimit dhe e parashikimit të ngjarjeve dhe proceseve sociale varet nga cilësia e përshkrimit të shoqërisë. *Së treti, në këtë studim realiteti vëzhgohet*

nëpërmjet skemës binare diferencim social/semantik. Diferencimi social i referohet diferencimit parësor të shoqërisë, i cili ka efekte strukturore në zhvillimin e proceseve sociale dhe në vetë riprodhimin e shoqërisë, ndërsa semantika i referohet kuptimit të kondensuar dhe të artikuluar nga shoqëria për të kuptuar vetveten (Luhmann, 1995a; Staeheli, 1998; Andersen, 2003). Dallimi ndërmjet diferencimit social dhe semantikës presupozon që jo gjithmonë shoqëria arrin ta kuptojë vetveten në mënyrë të përshtatshme, e aq më pak në mënyrë të tillë që të reflektojë realitetin e saj.

3. Si ta përshkruajmë shoqërinë bashkëkohore?

Përshkrimi i shoqërisë bashkëkohore implikon çështjen e diferencimit parësor të saj. Ndërmjet të gjitha teorive të zhvilluara për këtë qëllim, më të plota dhe më koherente janë teoria e materializmit historik e Karl Marksit dhe teoria e sistemeve sociale e Niklas Luhmann-it. Këto teori kanë një avantazh ndaj të tjerave për shkak se marrin në shqyrtim të gjithë historinë njerëzore, duke mundësuar kështu edhe analiza krahasuese. Natyrisht, përveç tyre ka edhe teori të tjera që fokusohen ekskluzivisht në shoqërinë bashkëkohore, të tilla si teoria e Ulrich Beck-ut që e përshkruan shoqërinë si “shoqëri risku” (Beck, 1992), teoria e Manuel Castells-it që e përshkruan shoqërinë si “shoqëri rrjetesh” (Castells, 2010), teoria e Lyotard-it që e përshkruan shoqërinë si “shoqëri postmoderne” (Lyotard, 1984), ose teoria e Debord-it që e përshkruan shoqërinë si “shoqëri spektakli” (Debord, 2006). Megjithatë, përveç pamundësimin të analizave krahasuese, këto teori kanë edhe një problem tjetër. Ato nuk duken se i referohen edhe aq shumë diferencimit social, sesa semantikës së shoqërisë. Në fakt, këto teori shprehin në mënyrë metaforike përpjekjet e shoqërisë për të kuptuar vetveten. Ato kontribuojnë për të krijuar variacion semantik, por me anë të tyre nuk mund të bëhen dot analiza që fokusohen te dallimi ndërmjet diferencimit dhe semantikës, pasi nuk e marrin parasysh këtë dallim.

Por le të ndalemi te Marksi dhe Luhmann-i. Sipas Marksit, shoqëria njerëzore ka kaluar nëpër disa faza: komunizmi primitiv, shoqëria skllavopronare, shoqëria feudale, dhe shoqëria kapitaliste. Përveç këtyre fazave, ai parashikon edhe evoluimin e mëtejshëm të shoqërisë, e cila, sipas tij, do të shndërrohet në shoqëri socialiste, e më pas në shoqëri komuniste (Marx & Engels, 2009). Ndryshe nga Marksi, Luhmann-i dallon tri lloje shoqërisë përgjatë historisë njerëzore: shoqëri primitive, shoqëri tradicionale dhe shoqëri moderne (Luhmann, 2006: 502-588). Ajo që e dallon njërin shoqëri nga tjetra, sipas Luhmann-it, është forma e diferencimit. Kështu, shoqëritë primitive karakterizohen nga diferencimi segmentar. Kjo do të thotë se shoqëria diferencohet në nënsisteme identike, në segmente, që e konstituojnë veten në të njëjtën mënyrë dhe me të

njëjtën perspektivë vëzhgimi. Të tilla nënsisteme janë fiset, fshatrat dhe familjet. Në dallim prej shoqërive primitive, shoqëritë tradicionale diferencohen duke formuar shtresa të pabarabarta në bazë të parimit të hierarkisë. Por, përveç dallimit lart-poshtë, ku disa konsiderohen shtresa të larta dhe të tjerat të ulëta, shoqëritë tradicionale përdorin edhe dallimin qendër-periferi, për shembull, dallimi ndërmjet qytetit, si qendër, dhe fshatit, si periferi, ose dallimi ndërmjet qendrës së perandorisë dhe territoreve të tjera perandorake. Ndryshe nga dy të parat, shoqëria moderne karakterizohet nga diferencimi funksional. Kjo do të thotë se brenda saj formohen sisteme, që dallojnë nga njëri-tjetri për sa i përket funksionit që kryejnë në shoqëri. Të tilla sisteme janë sistemi politik, ekonomik, ligjor, shkencor etj.

Duke përdorur logjikën e diferencimit social të Luhmann-it, i cili dallon tri parime diferencimi- segmentimin, stratifikimin, dhe funksionin -vëmë re se në teorinë e evolucionit social të Marksit gjenden vetëm dy prej tyre: segmentimi, në rastin e komunizmit primitiv dhe stratifikimi të shoqëritë skllavopronare, feudale dhe kapitaliste. Ndërkohë, shoqëria komuniste, në të cilën nuk do të ketë më klasa sociale, mund të hamendësojmë se do të jetë e njëjtë me komunizmin primitiv për sa i përket diferencimit, pra do të segmentohet, kurse shoqëria socialiste përbën një moment tranzicioni drejt komunizmit, ndaj dhe në të mund të gjejmë si mekanizmin diferencues të stratifikimit, ashtu edhe segmentimin. Tensioni ndërmjet të dyja teorive shihet qartë te përshkrimi i shoqërisë bashkëkohore, të cilën Marksi e emërton shoqëri kapitaliste, ndërsa Luhmann-i e emërton shoqëri moderne. Ndërsa Marksi dhe marksistët besojnë se shoqëria bashkëkohore karakterizohet nga diferencimi hierarkik dhe qendër-periferi, Luhmann-i është i mendimit se shoqëria bashkëkohore është e diferencuar funksionalisht. Në vijim, analiza e fenomenit të protestës do të zhvillohet nga premisa luhmanniane se jetojmë në një shoqëri që është diferencuar në sisteme funksionale të ndryshme ku, edhe pse ka hierarki dhe qendra, ato nuk janë parësore. Zgjedhja e teorisë sociale të Luhmann-it përkundër asaj të Marksit bëhet për dy arsye: *së pari*, kjo teori ka kompleksitet më të madh dhe nuk është përjashtuese; me anë të teorisë luhmanniane mund riformulohet dhe të interpretohet teoria marksiste, ndërkohë që aparati konceptual i teorisë marksiste është i pamjaftueshëm për të përfshirë teorinë sociale të Luhmann-it. Teoria luhmanniane, nisur nga pozitat konstruktiviste radikale, mund ta përshkruajë teorinë marksiste si *teori pozitiviste* (kujtojmë konceptin marksist të “ndërgjegjes false”, që presupozon ekzistencën e “ndërgjegjes së vërtetë” dhe mundësinë e identifikimit të saj, apo edhe konceptin e “alienimit”, që implikon mundësinë e një gjendje “të pa alienuar”), si *teori moniste* (pretendimi që marksizmi nuk është thjesht ideologji, por edhe shkencë, pra zotëron monopolin e së vërtetës), apo si *teori e përshtatshme për shoqërinë tradicionale, por jo për atë moderne* (përderisa privilegjon ekonominë mbi të gjitha sistemet e tjera dhe, në këtë mënyrë, nuk gjen konfirmim empirik

në kushtet e shoqërisë bashkëkohore). *Së dyti*, teoria luhmanniane, ndryshe nga ajo marksiste, është refleksive: ajo është njëkohësisht teoria që përshkruan dhe shpjegon fenomenet sociale (subjekti) dhe teoria që përshkruhet dhe shpjegohet prej vetvetes si njëri prej këtyre fenomeneve (objekti). Luhmann-i është i ndërgjegjshëm që teoria sociale, edhe pse sinon përshkrimin e shoqërisë, sidoqoftë është pjesë e kësaj shoqërie. Për këtë arsye, ai e ndërton teorinë sociale të tij në atë mënyrë që vetë teoria sociale, pasi përshkruan fenomenet sociale të botës, të përballet me vetveten si objekt dhe të vendoset para një testi shkencor që mund ta kalojë, ose jo. Kështu, Luhmann-i është në koherencë të plotë me premisën e tij teorike se nuk ka asnjë pozicion të privilegjuar për të prodhuar dije në shoqërinë bashkëkohore, e aq më pak dije përfundimtare.

4. *Protesta si objekt dhe koncept*

Pjesa më e madhe e studimeve e trajton protestën si objekt. Kjo është më e dukshme në studimet empirike dhe në ato historike. Në këtë mënyrë, studime të tilla krijojnë një konfuzion të dhënash dhe faktesh, por pa arritur dot t’i japin kuptim asaj që ka ndodhur. Logjika operative e Spencer Brown-it ndihmon për të kuptuar dallimin ndërmjet objektit dhe konceptit. Sipas tij, për t’i dhënë kuptim botës ku jetojmë duhet të bëjmë dallime. Kështu, duke vendosur një kufi dallues, krijohen dy anë: një anë e brendshme dhe një anë e jashtme. Vëzhguesi mund të shenjojë një anë, ose tjetrën, ose të dyja (edhe pse jo njëkohësisht) (Spencer Brown, 1972: 1-4). Kështu, kur vëzhguesi i jep një emërtim specifik një anë, ndërkohë që tjetra mbetet e paspecifikuar, krijohet një objekt. Kur vëzhguesi i specifikon të dyja anët e kufirit dallues, krijohet një koncept. Në këtë mënyrë, ashtu siç shprehet edhe Koselleck, koncepti implikon gjithmonë një kundërkoncept (2004). Raporti ndërmjet konceptit dhe kundërkonceptit karakterizohet nga diferenca dhe komplementariteti. Pra, edhe pse janë të ndryshëm prej njëri-tjetrit, specifikimet në të dyja anët e kufirit dallues implikojnë anën tjetër. Me fjalë të tjera, nëse duam ta trajtojmë protestën si koncept, kemi nevojë të specifikojmë anën tjetër të ndryshme prej saj dhe komplementare me të. Sipas Luhmann-it, protesta si koncept mund të shihet në dallimin ndërmjet protestës dhe asaj kundër së cilës protestohet: temës. Kjo është tema e shoqërisë që prodhon, mbulon, miraton atë kundër së cilës protestohet (Luhmann, 2003: 337). Vetëm kur protesta trajtohet si koncept mund të vëzhgohet fakti i ekzistencës paradoksale të saj. Duket se shoqëria moderne ka zhvilluar një formë autopoetike për të vëzhguar vetveten: në shoqëri, kundër shoqërisë (Luhmann, 2003: 339). Pra, protesta pozicionohet kundër shoqërisë, duke krijuar iluzionin se qëndron jashtë saj. Por në fakt, është shoqëria ajo që mundëson gjithçka sociale, përfshirë edhe protestën. Negativiteti i protestës është parazitari: ai

ekziston për shkak të pozitivitetit të shoqërisë. Kështu, shoqëria moderne ka krijuar kushtet strukturore që mundësojnë veprimin dhe reagimin, maskimin dhe demaskimin, konstruksionin dhe dekonstruksionin, konformitetin dhe devijancën.

Teoria e sistemeve sociale, e zhvilluar nga Luhmann-i, identifikon tri lloje sistemesh: sistemet e ndërveprimit, sistemet organizative dhe sistemin e shoqërisë. Shoqëria si sistem diferençohet më tej në nënsisteme funksionale, të tilla si politika, ekonomia, e drejta, shkenca, masmedia, etj. (Luhmann, 1977). Lidhur me protestën, Luhmann-i konstaton se tiparet e saj nuk lejojnë të klasifikohet në ndonjërin nga llojet e sistemeve të përmendura më sipër, por as nuk është zhvilluar në atë masë sa të mund të flitet për protestën si një lloj i ri sistemi social. E rëndësishme për analizën tonë është që protesta dallohet qartazi nga llojet e tjera të sistemeve sociale: elementi bazë që riprodhon protestën nuk është prezenca e aktorëve (ndërveprim), as vendimmarrja (organizatë), dhe as komunikimi (shoqëri). Në fakt interesi kryesor dhe fokusi i veprimit të protestuesve është te *demonstrimi* (Luhmann, 2003: 336). Ky tipar karakteristik i protestës duket se shpjegon prirjen e protestuesve për të pasur sa më shumë pasqyrim mediatik të lëvizjes së tyre. Kjo pasi demonstrimi, si element bazë i protestës, duhet të riprodhojë kushtet e vazhdimësisë së tij: duhet të pasohet nga demonstrime të tjera. “Ejani!” - është mesazhi kyç i protestës. Ky mesazh pritet të ketë më shumë rezonancë dhe të arrijë të influencojë më shumë njerëz nëse përcillet nëpërmjet masmedias. Ana e errët e këtij fenomeni është prodhimi i efekteve perverse. Vlejnë të përmenden dy prej tyre: *së pari, mbështetja e protestës te pasqyrimi mediatik e vendos lëvizjen në presion për të prodhuar vazhdimisht ngjarje, edhe kur nuk janë fare kushtet për këtë*. Kështu, protestuesit detyrohen të tematizojnë dhe të trajtojnë si çështje për të protestuar edhe fenomene krejt të rëndomta të përditshmërisë, duke i analizuar me një liri të gjerë interpretimi. Kjo bën që përgjithësisht të mos merren seriozisht, të mos gjejnë rezonancën e pritur nga publiku dhe të mos mobilizojnë dot shumë njerëz. *Së dyti, mbështetja te masmedia krijon personazhe protestuesish të famshëm*. Vëzhgimet empirike tregojnë që personazhe të tilla priren të përfitojnë nga fama e tyre për të përmirësuar pozicionin vetjak në shoqëri, duke e lënë pas dore fatin e lëvizjes (Hessdörfer et al, 2010: 12).

5. Temporaliteti i semantikës së protestës

Në dimensionin kohor bëhet dallimi ndërmjet *historisë* dhe *kronologjisë*. Historia fillon në momentin që çlirohet nga kronologjia. Sistemet kuptimore kanë histori vetëm nëse e kufizojnë veten me anë të aksesit opsional, qoftë kjo duke u fokusuar në ngjarje specifike të së shkuarës, ose nëpërmjet finalizimit të së

ardhmes (Luhmann, 1995a: 79-80). Kështu, duke iu referuar dallimit ndërmjet formës së diferencimit të shoqërisë dhe semantikës, mund t'i trajtojmë ato si sisteme me histori të ndryshme, të emërtuara përkatësisht “sistemi i shoqërisë” dhe “sistemi semantik”. Me fjalë të tjera, dhe për shkak të historive të ndryshme të tyre, nuk ka ndonjë garanci që semantika do të reflektojë ndryshimet në shoqëri. Kështu, *dallimi ndërmjet diferencimit të shoqërisë dhe semantikës sociale e ekspozon semantikën e protestës si të prapambetur*. Kjo semantikë nuk është e aftë të kuptojë kushtëzimet, mundësitë dhe formën e shoqërisë moderne.

Në nivelin strukturor, semantika e protestës i korrespondon diferencimit që karakterizon shoqëritë tradicionale: stratifikimit dhe dallimit qendër-periferi. Ajo shprehet me koncepte si dominimi, shfrytëzimi, manipulimi, e keqja, shteti i plotfuqishëm (pra shteti në qendër ose në krye), kapitalizmi (shoqëria reduktohet në ekonomi, ndërkohë që ekonomia është vetëm njëri prej sistemeve funksionale të shoqërisë), kolonizimi, dhunimi i lirisë, diskriminimi në bazë të statusit social, etj. Këto koncepte marrin kuptim nga kundërkoncepte të pozicionuara sipër, ose poshtë tyre (duke konfirmuar kështu hierarkinë e shoqërisë), ose përndryshe nga kundërkoncepte të pozicionuara në qendër, ose në periferi (duke konfirmuar formën tjetër të shoqërisë tradicionale, atë qendër-periferi). Por diferencimi funksional i shoqërisë moderne sjell fenomene negative të tjera, të ndryshme prej atyre që përbëjnë terminologjinë e lëvizjeve të protestave. Diferencimi funksional sjell përjashtim, neglizhencë, indiferencë, integrim negativ të lartë, probleme ekologjike dhe depersonalizim. Kjo ndodh sepse sistemet funksionale të shoqërisë në parim nuk diskriminojnë askënd për të marrë pjesë në to. Këto sisteme operojnë me anë të mediave simbolike si paraja, pushteti, ligji, e vërteta etj. Kështu, përderisa ke para, mund të kryesh transaksione ekonomike dhe nëse ke pushtet mund të operosh në politikë. Megjithatë, ajo çka funksionon si simbolike (bashkuese), funksionon gjithashtu edhe si diabolike (ndarëse). Për shembull, vërtet paraja si medium simbolik mundëson përfshirjen në ekonomi të gjithkujt, pavarësisht racës, etnisë, besimit fetar apo moshës, por, nga ana tjetër, përjashton nga ekonomia gjithkënd që nuk ka mundësi për të paguar. Kështu, duke u ndalur vetëm në një koncept për hir të ilustrimit, një semantikë e përditësuar e protestave do të ishte ajo që fokusohet te përjashtimi dhe jo te shfrytëzimi. Është e rëndësishme të kuptohet që shfrytëzimi bëhet i pamundur në kushtet e përjashtimit nga shoqëria. Duhet fillimisht të përfshihesh, që pastaj të shfrytëzohesh. Sa më shumë shoqëria bashkëkohore evoluon drejt fazës moderne të saj, aq më i mprehtë bëhet problemi i përjashtimit social dhe aq më shumë humbet për sa i përket rëndësisë problemi i shfrytëzimit. Duke mos i reflektuar këto ndryshime në semantikën e tyre, protestat e mbivlerësojnë kapacitetin e politikës për të zgjidhur problemet e shoqërisë, ose dorëzohen para saj.

6. Fakticiteti i semantikës së protestës

Dimensioni faktik i referohet temave dhe objekteve me kuptim dhe përdor dallimin ndërmjet “kësaj” dhe “diçkaje tjetër”. Në lidhje me këtë dimension kuptimor është e rëndësishme të theksohet se *fakticiteti* dhe *realiteti* nuk janë identikë. Realiteti iu referohet “gjërave”, të cilat janë reduktive të mundësive të kombinimit në dimensionin faktik. Kështu, koncepti i realitetit fsheh faktin që për konstituimin e kuptimit të çfarëdolloj objekti bashkëpunojnë gjithmonë dy horizonte kuptimore – një i jashtëm dhe një i brendshëm - dhe, rrjedhimisht, nevojiten përshkrime të dyfishta për të fiksuar kuptimin e objektit (Luhmann, 1995a: 76-77).

Në dimensionin faktik semantika e protestës shfaqet shumë simpliste. Ajo presupozon një realitet social të karakterizuar nga kapaciteti i pakufizuar për rezonancë. Përveç kësaj, presupozon kapacitet rezonues të njëjtë për të gjitha sistemet sociale, duke mos e marrë në konsideratë autonominë sistemike dhe dallimin ndërmjet sistemeve sociale në nivelin e funksioneve, kodeve dhe programeve specifike të tyre. Semantika e protestave shprehet me nocione si reformat, revolucioni, sistemi, barazia, drejtësia sociale, ose “drejtësi e vonuar, drejtësi e mohuar”. Në shoqërinë moderne këto nocione implikojnë domosdoshmërisht operacionet e më shumë se një sistemi social. Për shembull, reformat mund të ndërmerren nga politika, por efektet do t'i japin në ekonomi, arsim, ose shkencë, sipas rastit. Po ashtu, nocioni i drejtësisë sociale i referohet njëkohësisht operacioneve që ndodhin së paku në tri sisteme të ndryshme: politik, ekonomik dhe ligjor. Në kushtet kur secili prej këtyre sistemeve operon në bazë të logjikës së vet funksionale, janë të gjitha arsyet për të pritur një kapacitet rezonues asimetric: një ngjarje e rëndësishme në ekonomi mund të jetë krejt e papërfillshme politikisht (Luhmann, 1989: 43).

Mungesa e rezonancës sistemike për problemet sociale dhe ekologjike shihet nga protestuesit si shenjë papërgjegjshmërie, si mungesë integriteti, si antivlerë, paaftësi, korrupsion dhe deficiet demokratik. Rrjedhimisht protesta fokusohet tek “individë”, ose grupe të veçanta, duke lënë jashtë vëmendjes sistemet funksionale që kushtëzojnë veprimet dhe vendimet e tyre. Kështu protesta artikullohet në nivelin normativ (fjala kyç: duhet) dhe nuk reflekton aspak lidhur me çështjen e mundësisë së realizimit të aspiratave (fjala kyç: mundet). Natyrisht, ajo çka duhet bërë për përmirësimin e shoqërisë dhe ajo çka mund të bëhet janë sa të ndryshme aq dhe komplementare; veçse, *nëse synimi i protestave është realizimi i kërkesave të tyre dhe jo krijimi i iluzioneve, çështjet e mundësisë lipset të shtrohen për diskutim përpara çështjeve normative.* Në këtë mënyrë, arsenalin e dijeve të protestuesve duhet të përfshijë domosdo, përveç filozofisë dhe literaturës strategjiko-organizative, edhe teorinë sociale dhe teorinë e evolucionit social-kulturor.

Në terma abstrakte simplizmi i protestës vjen për shkak se semantika e saj nuk arrin të bëjë dot dallimin ndërmjet realitetit dhe fakticitetit, dhe prandaj i referohet ekskluzivisht realitetit. Pasojat e këtij fenomeni janë të dukshme: në realitet gjithçka duket e mundshme, pasi aty gjen vetëm një perspektivë – atë të “Sistemit”. Nëse diçka “e mundshme” nuk ndodh, atëherë problemi formulohet në termat e performancës morale dhe/ose profesionale, si dhe i atribuohet ndonjë pjese (personi, grupi, institucioni) të Sistemit. Megjithatë, mjafton të marrim në konsideratë dallimin ndërmjet realitetit dhe fakticitetit për të kuptuar se perspektiva e Sistemit kushtëzohet dhe, në këtë kuptim, mundësohet nga mjedisi (ku përfshihen edhe sistemet e tjera sociale dhe psikike). Kështu, qeverisja e keqe nuk është thjesht rrjedhojë e qeverisë së paaftë dhe të korrumpuar, por edhe e opozitës po aq të paaftë dhe të korrumpuar, në kushtet e një opinioni publik të karakterizuar nga ndjeshmëria e ulët si dhe nga fushat e tjera sociale që funksionojnë me logjikë autonome.

Për të rritur kompleksitetin e protestës në shoqërinë moderne nevojitet krijimi i pozicioneve kritike, pra i pozicioneve prej nga shoqëria mund të kritikojë vetveten. Këto pozicione mund të ofrohen vetëm nga sistemet funksionale të saj. Këtu duhen dalluar sistemet funksionale që operojnë me një logjikë konservatore dhe sistemet funksionale të karakterizuara nga një logjikë progresiste. Kështu, logjikën konservatore e gjejmë te politika (inovacioni politik është shumë i rrezikshëm elektoralisht), te ekonomia (për sa kohë ka tregje dhe likuiditet gjithçka shkon mirë), te masmedia (t'i japim publikut atë që kërkon), te sistemi ligjor (vendimmarrje në bazë të parimeve, koncepteve dhe rregullave të vendosura). Logjikën progresiste dhe presionin për emancipim e gjejmë në sisteme të tjera si arti (imagjinaria mund të vëzhgojmë realen, ta vendosim në perspektivë dhe ta kritikojmë), feja (imanenca e shoqërisë bëhet objekt vëzhgimi nga perspektiva transhendentale, edhe pse kjo e fundit është e kufizuar nga shkrimet e shenjta), shkencën (kriteret e së vërtetës nuk bazohen te konsensusi social apo tek i ashtuquajturin “*common sense*”) dhe intimiteti (përvoja e brendshme që aktualizohet në raportet intime bëhet pikë reference për të artikulluar nevojën e ndryshimit të kushteve sociale). *Por kur një shoqëri nuk i ka zhvilluar mjaftueshëm artin, fenë, shkencën etj., atëherë e ka thuar se të pamundur të kritikojë vetveten.* Zhvillimi i tyre nënkupton që në proceset sociale i referohemi shpesh këtyre sistemeve, i përdorim për të marrë vendime dhe për të bërë përshkrime të vetes dhe të tjerëve. Por faktikisht, në sa raste kemi parë të preferohet logjika artistike para asaj të masmedias, logjika shkencore para asaj ekonomike, apo logjika fetare para asaj politike?

7. Socialiteti i semantikës së protestës

Në dimensionin social të kuptimit artikullohet tensioni ndërmjet perspektivave të ndryshme për faktet, me fjalë të tjera tensioni ndërmjet *alterit* dhe *egos*. Konceptet alter dhe ego i referohen si sistemeve psikike individuale, ashtu dhe sistemeve sociale. Për analizën sociologjike të shoqërisë alter dhe ego konsiderohen partnerë komunikimi, që nuk e kanë në kontroll absolut njëri-tjetrin, pasi është e pamundur të parashikojnë me siguri veprimet përkatëse të njëri-tjetrit. Si të thuash, ata janë “kuti të zeza” që nuk bëhen kurrë plotësisht transparente. Për këto arsye, edhe pse bota në të cilën jetojmë është vetëm një, realitetet mund të jenë të ndryshme. Çdo sistem social dhe psikik zhvillon mënyrën e vet të veçantë të vëzhgimit dhe përshkrimit të botës dhe, në këtë kuptim, kemi një pluralizëm sistemik *par excellence*. Ndryshe nga shoqëritë primitive dhe ato tradicionale, shoqëria moderne nuk ka më një pozicion të privilegjuar nga i cili mund të vëzhgojë dhe të përshkruajë veten. Në shoqëritë paramoderne ky pozicion i takonte Zotit (fesë) dhe më vonë pushtetit sovran (politikës). Por diferencimi funksional i shoqërisë moderne nuk i jep prioritet asnjërit prej funksioneve të shoqërisë dhe, rrjedhimisht, asnjërit prej sistemeve funksionale të saj. Kështu, një problem themelor i shoqërisë moderne është ai i integritetit të perspektivave të ndryshme për faktet dhe ngjarjet në kushtet e mungesës së një qendre, ose të një kreu të privilegjuar për ta bërë këtë. Semantika postmoderniste e trajton këtë problem, por e konsideron të pazgjydhshëm dhe i dorëzohet relativizmit (Luhmann, 1995b).

Në këtë kontekst, semantika e protestave shfaqet moniste. Ajo presupozon unitet vlerash, interesash dhe këndvështrimesh, kur në fakt ka diversitet. Por ky diversitet synohet të kapërchet me skema vëzhgimore të tipit marksist, duke bërë dallimin ndërmjet ndërgjegjes “false” dhe ndërgjegjes “së vërtetë”. Me fjalë të tjera, sapo njerëzit t’i shpëtojnë kthetrave të ideologjisë sunduese (duke rënë në kthetrat e një tjetër ideologjie?), ata do të mund t’i hapin sytë për të parë “të vërtetën” e ekzistencës së tyre në shoqëri dhe kjo e vërtetë s’mund të jetë veçse një për të gjithë. Rrjedhimisht, pozicionet e ndryshme do të krijojnë një pozicion të përbashkët, realitetet e ndryshme do të transformohen në një realitet të përbashkët, dhe pas konsensusit do të vijë mobilizimi dhe veprimi kolektiv. Fushatat e ndërgjegjësimit janë një formulë e spikatur për arritjen e këtyre synimeve. Por fakti që fushatat e ndërgjegjësimit rrallëherë ndërgjegjësojnë duhet t’i bëjë protestuesit të reflektojnë. Në fakt, edhe ky reflektim është zhvilluar, por me një fokus të papërshtatshëm. Habermas-i na thotë që emancipimi shoqëror, e në këtë kuptim edhe ndërgjegjësimi, varet nga mënyra sesi komunikojmë. Sipas tij duhet të krijojmë situata komunikimi ideale, ku të gjithë të futemi si të barabartë, duke lënë jashtë sferës publike statuset tona specifike dhe interesat instrumentale, dhe le të fitojë argumenti më i mirë (Habermas, 1984: 24-28).

Kjo zgjidhje, e cila synon të na emancipojë dhe të na ndërgjegjësojë, ironikisht varet nga fakti nëse jemi apo jo të ndërgjegjësuar tashmë. Si të thuash, duhet të zhvillojmë një fushatë efektive ndërgjegjësimi që të ketë efekt fushata e ndërgjegjësimit.

Në dimensionin social protesta e legjitimon veten nëpërmjet ideve morale, etike, ose “intelektuale”. Por moraliteti nuk e ezauron socialitetin, ashtu si realiteti (sipas këndvështrimit të ndonjë intelektualit) nuk e ezauron fakticitetin e botës. Me anë të një analize specifike mund të kuptohet më qartë papërshtatshmëria e këtyre ideve për lëvizjen e protestës; mund të shihet se kjo semantikë nuk i merr parasysh kushtet strukturore të shoqërisë moderne. Moraliteti nuk gjen më vendin e dikurshëm në shoqëri, si parim organizues i saj (Luhmann, 1993). *Në shoqërinë moderne moraliteti mund të luajë vetëm një rol suplementar, por edhe këtë rol jo në mënyrë të unifikuar.* Kjo pasi shoqëria moderne jo vetëm ka zhvilluar kode sistemike në vend të parimeve morale (duke e kaluar kështu moralitetin në plan të dytë), por ka krijuar gjithashtu kushtet e funksionimit autonom të këtyre sistemeve funksionale (ndaj dhe normat morale të një sistemi nuk mund të përdoren në një sistem tjetër). Kështu, aktiviteti politik rregullohet para së gjithash nga konsideratat e pushtetit dhe të dallimit ndërmjet mazhorancës dhe opozitës (Luhmann, 1990: 168). Para se të gjykohet moralisht, veprimi politik gjykohet nga kriteret e suksesit elektoral. Moraliteti në politikë gjen shprehje vetëm në rastet korruptive, të cilat cenojnë vetekzistencën e shtetit, si dhe në rastet e shkeljes së parimit të konfidencialitetit (Luhmann, 1994). Në mënyrë të ngjashme, në shkencë moraliteti lidhet vetëm me çështjen e plagjiaturës, por nuk është kriter për të përcaktuar të vërtetën shkencore, sepse shkenca ka teoritë dhe metodat për këtë. Për të dhënë edhe një rast tjetër, në sport moraliteti shprehet me sloganin *fair play* (luftë e drejtë), por kjo nuk ndryshon asgjë në rezultatin e ndeshjes.

Përdorimi i ideve etike nga protestat ndeshet me probleme të tjera. Duke e kuptuar etikën si reflektim për moralin, ose si teori akademike që trajton justifikimin e gjykimeve morale, lindin menjëherë dy probleme. *Së pari, etika është një teori e zhvilluar në njërin prej sistemeve të shoqërisë, atë shkencor, dhe në kushtet e diferencimit funksional të shoqërisë moderne asnjë sistem nuk mund të përcaktojë zhvillimin e të tjerëve.* Kështu, idetë etike vetëm mund të “irritojnë” sistemet funksionale të shoqërisë, por edhe këtë në kushte specifike, kur ndjeshmëria sistemike (gjithnjë në bazë të logjikës specifike të sistemit në fjalë) është e lartë. Referuar sistemit politik në një demokraci, kjo do të thotë që kur opinioni publik fokusohet mbi të gjitha te figura morale e politikanit dhe e gjykon vendimmarrjen politike në bazë të vlerave morale, atëherë politika mund të irritohet nga perceptimi i rrezikut të humbjes së votave, e për pasojë të reagojë. Por edhe në këtë rast, në kushtet kur distanca ndërmjet politikanit dhe elektoratit është e konsiderueshme (duke qenë se përgjithësisht është vetëm masmedia që ngre

urat e komunikimit mes tyre), gjithnjë është i pranishëm rreziku i fshehjes së informacionit dhe i manipulimit të situatës. *Së dyti, idetë etike janë shumë abstrakte për t'u aplikuar drejtpërdrejt në situatat konkrete të vendimarrjes.* Në fakt, ajo çka quhet “etikë” sot është thjesht një utopi, në kuptimin origjinal që i ka dhënë utopisë Thomas More, pra si një paradoks të “toposit”, i cili nuk gjendet askund dhe nuk ekziston fare (Luhmann, 1993). Kështu, edhe pse në parim të gjithë mund të shprehen dakord me idetë etike, aplikimi sjell divergjenca, pamundësi teknike, grupe interesi pro dhe kundër, si dhe konflikte territoriale, kulturore dhe funksionale (Kjaer, 2009).

Idetë e intelektualëve vuajnë nga fakti që shoqëria moderne nuk ka vend për ta. Madje edhe në shoqërinë “postmoderne” të Lyotard-it duket se nuk ka vend për intelektualët (Lyotard, 1993: 3-7). Për të marrë pjesë në shoqëri duhet të kesh një rol (profesion), të cilin shoqëria e vlerëson. Cilësitë individuale janë një premisë e mirë, por nuk mjaftojnë. Ato duhen përkthyer dhe përshtatur për të performuar në një rol. Nëse dikush është inteligjent, atëherë mund ta përdorë këtë aftësi për t'u bërë jurist, ekonomist, politikan, ose pedagog. Por në listën e profesioneve të shoqërisë moderne nuk figuron intelektual. Nëse dikush megjithatë prezantohet si i tillë, atëherë kjo zgjon dyshime lidhur me identitetin social të personit. Hamendësime të llojit: “Si i siguron të ardhurat ky person?”, “Ku punon?”, “Kujt i shërben?” ngrihen natyrshëm për shkak të pamundësisë për të vepruar ndryshe në shoqëri përveçse nga pozitat e një roli. Rrjedhimisht, shoqëria moderne e delegjtitimon *a priori* intelektualin dhe idetë e ashtuquajtura intelektuale.

Protesta synon të eliminojë artificialisht diversitetin social, duke kërkuar unitet dhe konsensus për kauzën e saj. Kjo strategji prodhon dy rezultate: *alienim*, kur konsensusi arrihet, dhe *apatia*, kur nuk arrihet. Alienimi vjen ngaqë diversiteti i paketuar në një pako të shndritshme uniteti, nuk mund të rrijë gjatë aty pa e shpërthyer pakon. Protestuesit fillojnë të kuptojnë që synimet dhe interesat personale të tyre nuk përfaqësohen sa duhet nga kauza e përbashkët; fillojnë të kuptojnë që lëvizja është vënë në shërbim të interesave personale të disave dhe se të tjerët po përdoren prej tyre. Kështu, uniteti i dikurshëm dhe horizontal i lëvizjes së protestës merr formën e organizimit hierarkik, ku pushteti dhe të drejtat nuk janë më të barabarta. Në një kuptim, forma e re e lëvizjes i ngjan mjaft organizimit të institucioneve kundër të cilave protestohet. Nga ana tjetër, apatia që pason dështimin për të arritur konsensus dhe unitet, mund të interpretohet si shenjë dorëzimi para kompleksitetit dhe diversitetit social, dhe zakonisht kompensohet me anë të zhvillimit të semantikës së injorancës së publikut. Përpyekjet sizifiane të protestuesve kulmojnë me shprehjen e dëshpëruar të Krishtit në momentin e kryqëzimit: “Fali Zot, se nuk dinë çfarë bëjnë!”

Bibliografia

- Andersen, Niels Åkerstrøm (2003), *Discursive Analytical Strategies. Understanding Foucault, Koselleck, Laclau, Luhmann*, The Policy Press.
- Bateson, Gregory (1972), *Steps to an Ecology of Mind*, Jason Aronson Inc.
- Bateson, Gregory (1979), *Mind and Nature. A Necessary Unity*, E. P. Dutton.
- Beck, Ulrich (1992), *Risk Society. Towards a New Modernity*, Sage Publications.
- Castells, Manuel (2010), *The Rise of the Network Society*, Wiley-Blackwell.
- Debord, Guy (2006), *Society of the Spectacle*, Rebel Press.
- Della Porta & Diani (2006), *Social Movements. An Introduction*, Blackwell Publishing.
- Habermas, Jürgen (1984), *The Theory of Communicative Action, Vol. 1*, Beacon Press.
- Hessdörfer, Pabst & Ullrich (Eds.), (2010), *Prevent and Tame. Protest under (Self) Control*, Karl Dietz Verlag Berlin.
- Kjaer, Poul F. (2009), “Three-dimensional Conflict of Laws in Europe”, *ZERP-Diskussionpapier 2*.
- Luhmann, Niklas (1977), “Differentiation of Societe”, *The Canadian Journal of Sociology*, Vol. 2, No. 1, 29-53.
- Luhmann, Niklas (1989), *Ecological Communication*, Polity Press.
- Luhmann, Niklas (1990), *Political Theory in the Welfare State*, de Gruyter.
- Luhmann, Niklas (1993), “The Code of the Moral”, *Cardozo Law Review*, Vol. 14.
- Luhmann, Niklas (1994), ‘Politicians, Honesty and the Higher Amoralty of Politics’, *Theory, Culture & Society*, Vol. 11, 25-36.
- Luhmann, Niklas (1995a), *Social Systems*, Stanford University Press.
- Luhmann, Niklas (1995b), “Why Does Society Describe Itself as Postmodern?”, *Cultural Critique*, No. 30.
- Luhmann, Niklas (2003), *Teoria della società*, FrancoAngeli.
- Luhmann, Niklas (2006), *La sociedad de la sociedad*, Herder.
- Lyotard, François (1984), *The Postmodern Condition: A Report on Knowledge*, University of Minnesota Press.
- Lyotard, François (1993), *Political Writings*, UCL Press.
- Marx, Karl & Friedrich Engels (2009), *The Communist Manifesto*, Echo Library.
- Maturana, Humberto & Francisco Varela (1980), *Autopoiesis and Cognition. The Realization of the Living*, D. Reidel Publishing Company.
- Maturana, Humberto & Francisco Varela (1987), *The Tree of Knowledge. The Biological Roots of Human Understanding*, Shambhala Publications, Inc.
- Meyer, Whittier & Robnett (Eds.), (2002), *Social Movements. Identity, Culture, and the State*, Oxford University Press.
- Spencer Brown, George (1972), *Laws of Form*, The Julian Press Inc. Publishers.

- Stäheli, Urs (2003), "Financial Noises: Inclusion and the Promise of Meaning", *Soziale Systeme* 9, Heft 2, S. 244-256.
- Tilly, Charles (2007), *Social Movements, 1768-2004*, Paradigm Publishers.
- von Foerster, Heinz (1984), *Observing Systems*, Intersystems Publications.
- von Foerster, Heinz (2003), *Understanding Understanding*, Springer.
- von Glasersfeld, Ernst (1995), *Radical Constructivism: A Way of Knowing and Learning*, RoutledgeFalmer.

Sulltanizmi në Shqipëri _____

_____ **Dokt. Lulzim HOXHA** _____

Abstrakt. *Që prej afro dy dekadash pas përmbyesjes së regjimit totalitar, tranzicioni shqiptar duket më i pafundëm se kurrë. Koha tregoi se ardhja e të ashtuquajturit "sistem demokratik" nuk ishte gjë tjetër vecse një dështim. Në këto kushte, demokratizimi – në kuptimin e vërtet të fjalës – i vendit ende sot e kësaj dite shihet tepër i largët. Totalitarizmi shqiptar është ndër shembujt më të rrallë të sistemeve diktatoriale në botë, fakt ky që akoma vazhdon të ndikojë në tranzicionin e këtij vendi. Në këtë punim do të trajtohet tranzicioni i këtij vendi, nisur nga hipoteza se shkak kryesor i këtij tranzicioni të stërzgatur ka të bëjë me tiparet e regjimit të mëparshëm despotik të këtij vendi, tiparet kryesore të të cilit ende vazhdojnë të dominojnë procesin e demokratizimit të Shqipërisë.*

Hyrje

Në këtë punim do të fokusohemi në hulumtimin e despotizmit shqiptar, duke evidentuar se në të katërta dimensionet e tij - liderhipin, përmbytjen ideologjike, klientelizmin në administratë si dhe shpërbërjen e komunitetit - vërehen karakteristika të një prej formave më të rralla të regjimeve diktatoriale në botë, të quajtur sulltanizëm. Për vërtetimin e kësaj hipoteze, në këtë punim do të analizohen tre ceshtje kryesore: Së pari, sipas të gjitha të dhenave, tiparet e Republikës Popullore të Shqipërisë ishin një lloj nderthurjeje formash të ndryshme regjimesh autoritare. Nisur nga ky fakt, do të përpiqem të shpjegoj veçoritë e regjimit diktatorial në Shqipëri.

Së dyti, do të trajtohet gjerësisht rasti shqiptar, do të kryhet një krahasim me elementet kryesore të një prej regjimeve tipike sulltaniste, që është Rumania e Causheskut. Në përfundim të këtij kapitulli do të argumentohet klasifikimi i regjimit shqiptar në rradhët e regjimeve sulltaniste në botë.

Së treti, do të evidentohen elementet kryesore që kanë ndikuar në stërzgjatjen e tranzicionit demokratik në Shqipëri duke vendosur në dukje trashëgiminë politike dhe social-kulturore të regjimit sulltanist si dhe pasojat destruktive të së

shkuarës në formësimin e demokracisë difektoze shqiptare. Kjo do të mundësohet përmes një analize të tipareve të qeverisjes në këtë vend përgjatë tranzicionit duke i kushtuar një vëmendje të veçantë disa prej liderëve politik të periudhës që nga viti 1992 e deri në ditët e sotme. Në përfundim të këtij punimi do të kemi një ide më të qartë mbi karakterin e tranzicionit demokratik shqiptar dhe faktorëve determinues në zvarritjen e tij.

Koncepti i Sulltanizmit

Një grup i gjerë regjimesh politike (si p.sh Trujillo në Republikën Domenikane, Bokassa në republikën e Afrikës Qendrore, Marcos-i në Filipine, Shahu në Iran, Caushesku në Rumani apo Kim II Sung në Korenë e Veriut) kanë pasur tendenca të forta drejt një forme ekstreme të patrimonializmit, të cilin Weber e ka quajtur “Sulltanizëm” (Weber 1978, f.231). Kudo ku dominimi tradicional sjell një administratë, ku forcat ushtarake zoterohehen ekskluzivisht në duart e “udhëheqësit të madh”, i cili operon me një liri të theksuar veprimi e karakterizuar nga konturet e një pushteti personal suprem; atëherë në çdo rast të tillë kemi të bëjmë me tiparet e një regjimi sulltanist.

Weber nuk e ka perdorur termin “sulltanizëm” për të shpjeguar pretendimet fetare të bindjes. Ajo çka Weber kërkon të shpjegojë me këtë term lidhet me stilin e dominimit dhe udhëheqjes së një regjimi, i cili është një formë ekstreme e patrimonializmit. Ky nocion është tërësisht i zhveshur nga koncepti fetar në kuptimin religjioz të fjalës ndonëse mund të ndodhë që në disa raste figura e liderit mund të marrë dimensione gati hyjnore në sytë e popullit të tij. Në regjimin sulltanist sektori publik dhe ai privat janë të ndërthurur me njëri-tjetrin dhe ka një tendencë të theksuar drejt pushtetit familjar dhe dinastive të trashëguara, mungon racionalizimi i ideologjive (si psh në totalitarizëm), suksesi ekonomik varet nga lidhja personale me udhëheqësin, dhe mbi të gjitha udhëheqësi vepron veçanërisht në bazë të pushtetit të tij të pakontrolluar dhe të pakufizuar, për të arritur qëllime të personalizuar. Në këtë regjim dallimi i sferës publike nga ajo private bëhet thujtë i padukshëm, kjo për shkak se udhëheqësi shpeshherë është njëkohësisht edhe pronar i mjeteve të prodhimit (siç mund të jetë p.sh një feudal) por edhe pronar toke (si sundimtar i gjithë territorit të vendit). Politikën sulltaniste implementohen nga vullneti personal dominant i sulltanit (udhëheqësit suprem).

Ky regjim është i privuar nga një shtet i së drejtës dhe ekziston një shkallë shumë e ulët institucionalizmi; në sulltanizëm mund të ketë një pluralizëm socio-ekonomik, por thujtë një pluralizëm politik, sepse pushteti politik është i lidhur drejtpërdrejt me udhëheqësin. Karakteristika bazë e sulltanizmit është se të gjithë individët, grupet apo institucionet janë gjithnjë subjekt i ndërhyrjes despotike të sulltanit, kjo bën që pluralizmi të jetë thujtë inekzistent (Linz 2000,

f.259-63)). Ka një dallim themelor midis funksionit dhe pasojave të ideologjisë në regjimet totalitariste dhe ato sulltaniste. Në regjimet totalitare jo vetëm që ekziston një ideologji e përpunuar udhëheqëse, por kjo fuqi ka funksionin e legjitimitetit të regjimit, dhe udhëheqësit janë në njëfarë mënyre të detyruar nga ideologjia e sistemit. Ata e shohin këtë ideologji si një pikë reference dhe si një formë justifikimi për aktet e tyre. Në të kundërt, një udhëheqës sulltanist nuk karakterizohet nga një ideologji e përpunuar si justifikim ndaj akteve të tij. Mund të ekzistojnë ligjërime thellësisht personale me pretendimin se janë një ideologji, por kjo tip ideologjie përpunohet vetëm pasi lideri ka marrë pushtetin, është një subjekt manipulimi ekstrem dhe mbi të gjitha kjo ideologji fillon të gjenerohet vetëm në rastin kur udhëheqësi vendos ta praktikojë atë (f.261). Kështu mund të lindin dyshime nëse praktikën e Stalinit i përmbaheshin Marksizëm-Leninizmit, por nuk ka asnjë shkas për të diskutuar nëse ligjërimet e Trujillos i përmbaheshin Trujilloizmit. Mobilizimi i zgjeruar, i cili është një ndër tiparet e totalitarizmit, rrallë mund të gjendet i pranishëm në regjimet sulltaniste për shkak të shkallës së ulët të institucionalizimit dhe angazhimeve të dobëta për një ideologji të përgjithshme.

Siç u theksua më sipër, në sulltanizëm udhëheqja personale e sulltanit qëndron mbi ideologjinë. Mbështetja bazohet në interesin dhe vartësinë ndaj udhëheqësit: shpërblimet që ai ofron për luajalitetin si dhe frikën ndaj tij. Në një aspekt, lidhshipi në sulltanizëm dhe totalitarizëm janë të ngjashëm: në të dyja regjimet lideri suprem udhëheq me një pushtet të pakufizuar. Në këtë drejtim, Stalini dhe Somoza janë të ngjashëm. Megjithatë ka disa ndryshime të rëndësishme. Artikulimet ideologjike të një lideri totalitar merren seriozisht jo vetëm nga vartësit e tij, por nga e gjithë shoqëria duke përfshirë edhe klasën intelektuale (madje edhe intelektualët që jetojnë jashtë shtetit, ndaj të cilëve lideri ushtron kontroll). Kjo krijon një shkallë përgjegjësie organizative, sociale dhe ideologjike tek lidhshipi totalitar, gjë që nuk është e pranishme në lidhshpin sulltanist.

Në sulltanizëm, kjo udhëheqje e personalizuar, e bën dimensionin dinastik krejtësisht të pranueshëm dhe empirikisht të zakonshëm. Madje mund të thuhet se disidentët më të rrezikshëm të këtij regjimi janë pikërisht ata që e marrin seriozisht ideologjinë e liderit suprem. Regjimet sulltaniste mund të vëzhgohen empirikisht në rastet e shthurjes së regjimeve diktatoriale. Po kështu mund të evidentohen elemente të tjerë dallues të regjimeve sulltaniste: karakteristike e këtyre regjimeve janë krizat e sovranitetit dhe problemet e shkuara lidhur me pavarësinë kombëtare. Një tipar i përbashkët i tyre është se në të shumtën e rasteve pavarësia e tyre ka qenë e mundimshme dhe shpesh e parespektuar nga vendet fqinje. Tjetër faktor që bie menjëherë në sy është se të gjitha vendet sulltaniste gjenden në pozita gjeografike tepër të favorshme nga pikëpamja strategjike: Kuba, Nikaragua, Panama, Filipinet, Irani, Zaire, Antigua, Haiti të gjitha këto vende gjenden në pozita tepër të favorshme dhe për këtë arsye që prej afro dy shekujsh

kanë qenë nën ndikimin e vazhdueshëm të fuqive të mëdha (Linz & Cheihabi 1998, f.31).

Nuk mund të mohohet që në vendin tonë përgjatë gjithë këtyre dy shekujve të fundit influenca ndërkombetare po kështu ka qenë një faktor i pranishëm së stilit autoritar të liderit. Duhet thënë se lideri i regjimit të shkuar erdhi në pushtet duke pasur një mbështetje të njohur nga ana e komunistëve jugosllavë, kontrolli i të cilëve solli një ashpërsim të mënyrës së të qeverisurit të Enver Hoxhës në vitet e para të ardhjes së tij në pushtet mes shumë spastrimesh të përgjakshme. Po kështu, edhe në periudhën post-komuniste ndërkombëtarët kanë vazhduar të jenë një aktor i rëndësishëm politik në aktualitetin e vendit. Mjaftojnë të kujtojmë këtu mediatizimin e jashtëzakonshëm të ambasadorit amerikan gjatë zgjedhjeve të fundit lokale, apo përqëndrimi i skajshëm tek opinionet e trojkës së ambasadorëve për të kuptuar se konsensusi i ndërkombëtarëve, ashtu si në regjimin e shkuar, ende vazhdon të ketë një impakt thelbësor në regjimin politik, qoftë kjo në mënyrë direkte apo indirekte.

Komunizmi në Shqipëri: Një sprovë krahasuese me regjimin e Çausheku-t
Shqipëria, ashtu sikurse Rumania e periudhës pas ardhjes së Çaushekut karakterizohet nga ajo që Weber e quan “forma më ekstreme e patrimonializmit”, udhëheqësi vepron veçanërisht në bazë të pushtetit të tij të pakontrolluar dhe të pakufizuar, për të arritur qëllime të personalizuar. Po t’i kthehemi pjesës së parë ku flitet për tiparet kryesore të regjimeve sulltaniste, mund të shohim qartë se regjimi shqiptar ka shumë të përbashkëta me këto tipare. Në fakt ajo çka ndodhi me Shqipërinë qysh pas izolimit të saj nga vendet e tjera të bllokut lindor ishte vërtet mjaft interesante për t’u evidentuar. Enver Hoxha – të paktën në dukje – vazhdonte të pretendonte se ishte një mbështetës i stalinizmit, në një periudhë që vetë stalinizmi kishte pushuar së ekzistuari. Që nga ky moment argumentohet se lideri shqiptar pretendonte të shfaqej në sytë e popullit si një mbështetës i ideologjisë staliniste, ideologji e cila u përpunua nga ana e tij vetëm pas ardhjes në pushtet. Por në fakt totalitarizmi stalinist faktikisht kishte “vdekur” bashkë me predikuesin e tij. Ky është një fakt që mund të thuhet me njëfarë sigurie përderisa qysh pas vdekjes së Stalinit, të gjitha vendet anëtare të bllokut lindor filluan reformat, ndërkohë që Shqipëria dhe Rumania e Çausheku-t ishin të vetmet vende në Europë që pretendonin se stalinizmi ishte ideologjia e tyre sunduese, por në të vërtetë – ashtu siç do të shihet në vijim – kjo nuk ishte veçse një prej ligjërimeve thellësisht personale të udhëheqësve Hoxha dhe Çausheku.

Deri në vitin 1989 kur u ekzekutua, Çausheku (Ceausescu) mori nën kontroll të gjitha kapilarët e shtetit rumun, duke filluar që nga aspekti fetar, arsimor, tregtar, social dhe deri te jeta private. Në vitet e fundit të regjimit të tij ai u izolua edhe më tepër nga bota komuniste duke përforcuar kështu gjithnjë më tepër kultin e tij të individit. Analisti rumun, Bogdan Cristian Gavrilă, në një studim të tij në lidhje me etapën e evoluimit të komunizmit në Europën Lindore e ndan atë në dy profile

të përgjithshme: stalinizmin dhe destalinizmin. Sipas tij, të dyja këto profile e kanë origjinën në dy interpretime kryesore të fazave të zhvillimit të komunizmit në BRSS: Komunizmin e luftës dhe programin e ri ekonomik. I pari, pra komunizmi i luftës u shfaq për herë të parë më 28 Qershor 1918, kur në BRSS u lëshua dekreti i nacionalizimit dhe arriti kulmin e zhvillimit të tij përgjatë luftës civile. Programi i ri ekonomik ishte programi i reformave dhe zbutjes së regjimit komunist në BRSS dhe respektivisht në vendet e bllokut lindor ishte një burim historik legjitimimi për destalinizimin e ndërmarrë nga Hrushovi në vitin 1956 (Gavrilă 2004, f.17). Në këtë drejtim, Shqipëria ashtu si dhe Rumania u grupuan në anën e vendeve staliniste të Komunizmit të luftës. Në mënyrë të ngjashme me diktaturën e Enver Hoxhës në Shqipëri, edhe regjimi i Çaushekut erdhi duke u bërë gjithnjë më i ashpër.

Krahasimi mes këtyre dy regjimesh mund të realizohet mbi katër aspekte kryesore: 1) ideologjinë 2) nacionalizmin 3) liderhipin dhe 4) politikën e jashtme. Për sa i përket ideologjisë, bashkë me përqëndrimin gjithnjë e më të madh të pushtetit në duart e liderhipit, në të dyja këto vende u vu re një rikonfigurim të pikëpamjeve ideologjike, ku partia nuk shihej më si udhëheqësja e klasës punëtore por si një faktor themelor social dhe si një trupëzim i interesit kombëtar. Nëpërmjet një arsytimi të thjeshtë mund të vërejmë se si kjo ideologji e re (nëse mund ta cilësojmë si të tillë) ishte pikërisht ajo që synonte të përçonte nocionin e “shtetit nën rrethim”. Kjo ideologji është përdorur dhe nga Enver Hoxha, që kërkonte të përforconte në popull idenë se partia do t’i mbronte ata nga çdo rrezik i jashtëm. Ideologjia, përgjithësisht nuk ishte gjë tjetër veçse një mjet i përdorur nga udhëheqësi Hoxha për të artikulluar ideologjinë e tij, thellësisht personale, që kërkonte ta shfaqte partinë si një mbrojtëse të interesave kombëtare.

Enver Hoxha ishte vendimtar në prodhimin e një atmosfere kulturore totalisht të sunduar nga një propagandë doktrinare që ekzaltonte nacionalizmin. Gjuha, letërsia, historia, gjeografia, folklori dhe etnologjia u kultivuan jo vetëm për t’i dhënë popullit një ide për të kaluarën e vet, por gjithashtu për të injektuar dhe përhapur tek ai ksenofobinë, sllavofobinë, izolacionizmin, kompaktësinë etnike dhe unitetin gjuhësor (Pipa: 1990, f.121). E gjithë kjo propagandë me sa duket fshihte mungesën e përshtatshmërisë të shoqërisë shqiptare për të zbatuar idealin komunist, dhe që ky ideal mund të propagandohej si i tillë vetëm nga prania e një misionari suprem. Sikurse thoshte vetë udhëheqësi Enver Hoxha në Gazetën “Zëri i Popullit”: “Zhvillimi i kultit të individit ka rrënjë të thella e në kushtet e vendit tonë janë disa faktorë që e ushqejnë, si ekzistenca e shumë mbeturinave të feudalizmit e të patriarkalizmit, niveli i ulët ideologjik i kuadrove e i partisë dhe lehtë mund të shfaqet tendenca për të veshur me figura të jashtëzakonshme persona të veçantë” (Zëri i Popullit 1956).

Ndërkohë, në Rumani implementimi i një ideologjie të përgjithshme nga ana e regjimit kërkonte të formësohej së pari një sens familjariteti dhe së dyti idenë

e një vazhdimësie në progresivitetin e bazave të reja strukturore (Gavrila 2004). Mbi këto baza, ashtu si në regjimin e Hoxhës, edhe regjimi rumun u legjitimua mbi bazën e frikës nga agresorët e jashtëm, i cili në rastin rumun ishte BRSS i Hrushovit. Krijimi i sensit të familjaritetit ishte hapi i parë drejt akumulimit të pushtetit në duart e kryefamiljarit/ udhëheqësit të shtetit.

Në këtë drejtim, aspekti nacionalist nga të dy udhëheqësit shfaqet në trajtën e legjitimitit të pushtetit të tyre të centralizuar. Një fakt interesant është se duke filluar që nga viti 1980 PKR adoptoi një ideologji të ashpër nacionaliste me anë të së cilës shënjestronte vazhdimisht komunitetin hungarez, duke e akuzuar se përkrahte politikën e Hungarisë, të cilat ishin diametralisht të kundërta me metodat e liderit rumun. Ashtu si në regjimin e Hoxhës, edhe Çausheku e përdori nacionalizmin për ta izoluar më tej vendin duke i forcuar më tej pozitën e tij si udhëheqës suprem. Në të dyja këto vende nacionalizmi erdhi si një nevojë për: legjitimim, mbështetje dhe justifikim. Por që me perfeksionimin e “kultit të udhëheqësit”, si në regjimin e Hoxhës ashtu edhe në atë të Çaushekut duket se ai u shndërrua nga një qëllim në një mjet.

Në aspektin e liderit – ku vihen re dhe ngjashmeritë më të mëdha – një tipar dallues i regjimeve sulltaniste është ai që udhëheqësi sundon në një qeveri të përbërë nga një klan ku përfshihen të afërm të tij, të cilët janë caktuar në poste të larta në drejtimin e vendit. Pushteti përqëndrohet vetëm brenda këtij klani, dhe në rast të vdekjes së udhëheqësit suprem, si pasues “zgjidhet” një nga të afërmit e tij. Kështu p.sh Elena Çausheku (e shoqja e udhëheqësit) ishte një prej 15 anëtareve të Komitetit Qëndror, ku bënte pjesë dhe vetë Nikola Çausheku (Nicolae Ceausescu). E njëjta gjë ndodhte edhe në Shqipërinë e Enver Hoxhës ku menjëherë pas vdekjes së udhëheqësit, e shoqja e tij Nexhmije Hoxha caktohet në postin e kryetares së Frontit Demokratik, një prej strukturave më të rëndësishme të PPSH. Por ajo çka është kryesorja dhe një tipar karakteristik të regjimeve sulltaniste: pas vdekjes së Enver Hoxhës, si pasues caktohet krushku i tij Ramiz Alia (mbesa e liderit të ri të PPSH ishte martuar me djalin e udhëheqësit suprem). Në këtë mënyrë edhe pas vdekjes së Hoxhës, pushteti në Shqipëri vazhdoi të qëndronte në duart e klanit të “Sulltanit të kuq” (Fischer 2008) shqiptar.

Por ajo që është më domethënëse në këto dy regjime është formësimi i “kultit të udhëheqësit” nga ana e dy liderëve. Krijimi i “kultit të udhëheqësit” ka një impakt shumë të rëndësishëm mbi shoqërinë e një vendi, sepse akumulimi i pushtetit gjithnjë e më tepër në duart e udhëheqësit dhe klanit të tij ka pasoja destruktive mbi ndjenjën e përkatësisë ndaj komunitetit dhe përgjegjësisë vetjake në të. Kështu pra duke shpërbërë ndjesinë e komunitetit tek individët, udhëheqësi e ka më të lehtë për t’u imponuar turmave autoritetin e tij duke e zëvendësuar komunitetin me partinë-shtet. Madje Enver Hoxha arriti deri në pikën ku shkatërroi një prej instrumenteve kryesore të krijimit të komunitetit siç janë institucionet fetare, duke e kthyer kështu Shqipërinë në të vetmin shtet

ateist në botë. Nga ana e tij, regjimi i Çausheku-t asgjësimin e komuniteteve e realizoi me anë të aplikimit të një pushteti disiplinues brenda partisë me anë të programit të tij famëkeq të “sistematizimit”, i cili synonte të zhdurte më shumë se 700 fshatra dhe për t’i vendosur banorët e tyre në 550 qendra agro-industriale gjoja për të rritur hapësirën e tokave të punëshme, për të modernizuar infrastrukturën rurale dhe për të reduktuar diferencën mes fshatrave dhe qyteteve por që i parë nga një këndvështrim tjetër miliona rumunë, hungarezë dhe fshatarë romë do të dëboheshin nga mini-komunitetet e tyre për t’u vendosur në blloqet e apartamenteve, brenda të cilëve opinionet dhe aktivitetet e tyre mund të monitoroheshin më lehtësisht (Bideleux & Jeffries 2007, f.494).

Një tjetër tipar i rëndësishëm i regjimeve sulltaniste është ai i hyjnizimit ekstrem të udhëheqësit. Në regjimin e Çausheku-t kjo dukuri evidentohet në titujt e shumtë të dhënë udhëheqësit rumun dhe veçanërisht kur gjatë vitit 1974 Çausheku mori postin e Presidentit të Republikës Socialiste, ngjarje që u shoqërua me një ceremoni gjatë së cilës ai mbante në dorë një skeptër mbretëror, ndonëse realisht ai nuk ishte mbret. E njëjta dukuri vihet re edhe në rastin e Enver Hoxhës, pas vdekjes së të cilit Presidenti Ramiz Alia zotohej që, porsia hyjnive, Enver Hoxhës do t’i kujtohej vetëm ditëlindja dhe jo datëvdekja. Muzeu i Enver Hoxhës në qendër të Tiranës pranë ministrive dhe komitetit qëndror të partisë, kishte formën e një piramide, gjë që përsëri të kujtonte mjetin me anë të cilit faraonët shkonin në qiell. Ndërsa monumenti i tij lartësohej në sheshin Skënderbej dhe e nxirrte në hije monumentin e heroit tonë kombëtar; miti i Enverit ishte tashmë kryemiti i Shqipërisë socialiste (Sulstarova 2003, f.96). Vërehet pra një ngjashmëri edhe në strategjitë e udhëheqësve për ta akumuluar pushtetin rreth vetes dhe klanit të tyre.

Në politikën e jashtme ngjashmeritë mes këtyre dy regjimeve bëhen edhe më evidente. Të dyja këto vende patën tensione të mëdha me vendet e tjera të bllokut lindor dhe veçanërisht me BRSS gjatë fundit të viteve 70’, kur politikën destalinizuese të Hrushovit kishin arritur kulmin e tyre. Në rrafshin ndërkombëtar, Shqipëria dhe Rumania ishin të vetmet vende të bllokut lindor mbështetëse të stalinizmit. Të dyja regjimet ndoqën një politikë të ashpër kundrejt agresorëve qofshin këta real apo të supozuar, me anë të së cilës fituan dhe një legjitimim të udhëheqjes së tyre. Ashtu siç kumton Daniel Chirot në lidhje me regjimin rumun: “Në mungesë të periudhës së terrorit stalinist të shkaktuar nga okupatori sovjetik si dhe frikës se diçka e tillë mund të ripërsëritej, regjimi komunist në Rumani do të ishte rrëzuar shumë kohë më parë” (Chirot 1978, f.456).

Nga të gjitha tiparet e mësipërme të regjimit të Çausheku-t vihen re shumë ngjashmëri me regjimin e Enver Hoxhës, ku do të veçonim: I) përqendrimi i pushtetit në duart e udhëheqësit II) mosekzistenca e një ideologjie dominuese, përveç rasteve kur udhëheqësi vendos të përdorë një lloj ideologjie thellësisht të personalizuar siç shfaqet në rastin konkret nacionalizmi dhe shfaqja e partisë si

mbrojtësja kryesore e sovranitetit të vendit III) funksionarët e lartë të shtetit janë pjesë e klanit apo të afërm të udhëheqësit suprem.

Tranzicioni shqiptar është karakterizuar nga kriza të shpeshta, mungesë stabiliteti, korrupsioni galopant, krim i organizuar dhe inefiçencë në menaxhimin e këtyre problemeve. Nga ana tjetër Rumania është në një gjendje krejt tjetër për sa i përket aspektit ndërkombëtar. Sot Rumania është anëtare me të drejta të plota e Bashkimit Europian dhe me gjithë problemet me emigracionin dhe me krimin e organizuar, është e dukshme që ky vend ka bërë shumë hapa përpara. Perfundimisht, me gjithë te perbashketat e tyre ne format e regjimit, duhet thënë se Shqipëria dhe Rumania që pas ardhjes së demokracisë janë duke ndjekur një tranzicion demokratik krejt të ndryshëm për sa i përket zhvillimit të tyre: ndërkohë që e para gjendet nën një krizë të vazhdueshme politike dhe me nota negative në progres-raportet e BE-së, Rumania i ka kaluar këto probleme vite më parë. Për rrjedhojë, në rast se fenomeni i tranzicionit na jep idenë e një objekti nën një proces kalimi nga një pikë në një pikë tjetër, mund të thuhet se tranzicioni shqiptar, ndryshe nga ai rumun, ende nuk ka mbërritur në pikën e dëshiruar, që do të thotë "të bëhemi si gjithë Europa".

Përfundime

Nga sa u tha më sipër, konkludojmë se:

Së pari, zgjatja e tranzicionit shqiptar i atribuohet kryesisht pasojave që la pas regjimi sulltanist i Hoxhës, ndër më të rëndësishmet instrumentalizimi i politikës me qëllim plotësimin e interesave dhe objektivave personale të elitës politike. E gjithë kjo mendësi është një pasojë direkte e ideologjisë së personalizuar të udhëheqësit Hoxha gjatë të kaluarës sulltaniste. Ky faktor vazhdon të jetë vendimtar në formësimin e një ideologjie të personalizuar edhe në periudhën e tranzicionit. Në këto kushte, ngjarje të tilla paradoksale si transferimi i deputetëve në parlament nga njëra parti në tjetrën, adoptimi i politikave të majta nga ana e një partie të djathtë, apo së fundmi formimi i një koalicioni qeveritar mes një partie të djathtë dhe një partie të majtë, serviren si normale për opinionin publik.

Së dyti, sulltanizmi është faktor i prodhimit të një shkalle demoralizimi masiv tek individit. Gjatë regjimit të kaluar kjo u evidentua edhe më tepër. Sistemi sulltanist i shkëputi të gjitha kapilarët e lidhjeve fisnore dhe komunitare, gjë që përforcoi kultin e individit të udhëheqësit Hoxha në pozitë të një "babai të madh" dhe të gjithëpushtetshëm. Doktrinat patrimonialiste të udhëheqësit suprem shtriheshin në të gjitha fushat e jetës së individit.

Së fundmi, ardhja e tranzicionit dhe rikonceptimi i rolit të individit në shoqëri bën të mundur rishfaqjen e individit si qenie e lirë nga ndikimi i "babait të madh". Megjithatë bashkë me zhvishjen nga doktrinat e udhëheqësit, kjo prodhon dhe

një gjendje zbrastërie në jetën e individit. Ajo që mungon është pikërisht ajo formë patrimonializmi që kishte "kontaminuar" mendjen e shoqërisë shqiptare për më shumë se dyzet vjet me rradhë. Në këtë kuptim, pushteti patrimonialist i regjimit të kaluar shfaqet në formën e varësisë së individit drejt fenomeneve të tilla si korrupsioni, klientelizmi, militantizmi apo përdorimi i mekanizmave informale të shoqërisë, të cilat pësuajnë një rritje të dukshme qysh me shembjen e regjimit të shkuar. Shpesh, politika shqiptare karakterizohet nga ekzistenca e një lidhësi me tendencë të qarta autoritare, pasi vetëm ky lloj lidhësi duket se është në gjendje t'i japë kuptim mekanizmave informal të shoqërisë. Pengesa e vetme për këta liderë është pikërisht sistemi që duhej të implementonin.

Bibliografia

- Bideleux R & Jeffries I, *A History of Eastern Europe: Crisis and change*, Routledge, USA 2007,
- Chirot D, *Social Change in Communist Romania*, University Of North California Press, USA 1978,
- Fischer B, *Diktoret e Ballkanit*, AIIS, Tirane 2008
- Linz J & Cheihabi H, *Sultanistic Regimes*, John Hopkins University Press, Baltimore and London 1998
- Linz J, *Totalitarian and Authoritarian regimes*, Lynne Rienner publishers Inc., USA 2000
- Pipa A, *Albanian Stalinism: ideo-political aspects* (New York: Columbia University Press/ East European monographs, 1990
- Sulstarova E, *Ligjerimi nacionalist ne Shqiperi*, Aferdita, Tirane 2003
- Weber M, *Economy and Society: an outline of interpretive sociology*, Berkeley University of California Press, 1978
- Zëri i Popullit, Tiranë, 14.04.1956

Recencë

Dr. Klejd KËLLIÇI

**Peter Mair, (1997) Party System Change:
Approaches and Interpretations,
Bot. Oxford: Clarendon Press, 1997, pp. xiv, 244**

*Ndonëse libri në fjalë është botuar në vitin 1997, ai është tashmë një prej burimeve më influente dhe të cituara në studimet mbi partitë politike, ndaj dhe u mendua që të paraqitej në revistën **Polis**. Kjo për arsye shkencore, por edhe njerëzore. “Ndryshimet në Sistemet Partiake: Qasje dhe Interpretime” (në origjinal “Party System Change: Approaches and Interpretations”) mbetet një prej parashtrimeve teorikë më të plotë të viteve të fundit në lidhje me këtë temë. Kjo recensë është gjithashtu një shenjë nderimi për Peter Mair, i cili u nda nga jeta në gusht të vitit të kaluar. Autori është një prej studiuesve më me ndikim të viteve dhe më të respektuar në fushën e shkencave politike, politikës së krahasuar dhe organizimit politik.*

Studimi i partive politike mbetet gjithmonë një prej fushave më të studiuara dhe të debatuar në lëmin e shkencave politike, gjithsesi punimet me karakter sistematik dhe teorik, që kanë ushtruar ndikim mbi studiuesit, mbeten të pakta. Që me daljen në botim në vitet shtatëdhjetë (i ribotuar në vitin 2005) të punimit të Giovanni Sartorit, fusha e studimit të partive është dominuar pikërisht nga paradigma sistematike sartoriane në analizën e fenomeneve, që lidhen me partitë politike. Libri i Peter Mair, i botuar në vitin 1997, sfidon pikërisht pikëpamjet mbisunduese mbi sistemin e partive politike, aq më tepër me futjen në skenën e studimeve të ndryshimeve demokratike të vendeve të Evropës Lindore. Ky libër ka në qendër të tij ndryshimin dhe stabilitetin e sistemit modern të partive politike. Që në fillim të librit, Mair përqendrohet kryesisht në studimin e sistemit politik të partive të Evropës Perëndimore duke anashkaluar, ose më saktë, duke propozuar një qasje analitike të ndryshme në studimin e sistemeve partiake të Evropës Lindore. Autori merr në analizë kryesisht hipotezën e ‘ngrirjes’ së sistemit të partive politike në një atmosferë ndryshimi dhe rikonceptimi të formave të

përfaqësimit politik. Libri nuk ka si qëllim të analizojë partitë si organizata apo të japë qasje origjinale lidhur me to, por merret me konceptin e sistemit të partive, ndryshimet që pësojnë këto dhe rezistencën që kjo formë përfaqësi politik ka në arenën demokratike. Literatura mbi partitë ka reflektuar që prej viteve shtatëdhjetë e në mënyrë sistematike krizat që, struktura e partisë dhe sistemet partiake kanë pësuar si pasojë e daljes në skenë të lëvizjeve shoqërore, e mbarimit të Luftës së Ftohtë dhe e transformimeve ideologjike tek e majta/e djathta apo e pamundësisë për t'u bërë ballë krizave ekonomike. Shpesh është vënë theksi se partitë dhe sistemi i partive janë në një krizë pa kthim prapa e megjithatë partitë politike duket se po i rezistojnë me sukses transformimeve shoqërore.

Libri është i ndarë në katër pjesë. Në pjesën e parë, autori merret me hipotezën e 'ngrirjes' sistemit të partive. Me ngrirje ai ka parasysh hipotezën dominante, deri në mesin e shekullit të kaluar, në lidhje me frakturat sociale dhe për pasojë formimin e stabilizimit të partive në Evropën Perëndimore nga Seymour Lipset dhe Stein Rokkan. Autori argumenton se koncepti i ngrirjes së sistemit ka të bëjë jo më me ndarjet e mëdha ideologjike, por me vetë përforcimin e diskurrit ideologjik nga vetë partitë. Konflikti, pra, vetushqehet nga partitë duke marginalizuar çdo lloj alternative potenciale. Mair thekson këtu faktin se sistemi i partive është më shumë produkt i vetë partive politike, se sa i konteksteve sociale në të cilat ato veprojnë.

Pjesa e dytë e librit merret me konceptin e vazhdimësisë në kohë dhe atë të ndryshimit të partive. Përfaqësimi politik shënon tashmë një traditë të konsoliduar, ku kërkesat që vijnë nga shoqëria kalojnë në një pjesë të madhe përmes kanaleve të partive politike. Në këtë kuptim, Mair nuk pranon analizën mbi tranzicionin e partive nga formacione ideologjike në parti gjithpërfshirëse apo parti, që ndryshojnë trajektoren politike në funksion të ndjesive momentale të elektoratit. Diskuri elektorale nuk gjen shumë mbështetje nga Mair, i cili argumenton se jo të gjitha partitë i nënshtrohen nevojës për të kapur sa më shumë elektorat. Ai shtron në këtë pjesë një seri pyetjesh studimore që, sipas tij, mund të shpjegojnë më mirë sistemin e partive si për shembull ato që lidhen me analizën e hipotezës së centralizimit të partive, me marrëdhënien mes ndryshimeve organizative dhe luhatshmërisë elektorale si dhe me analizën e faktorëve institucionalë që ndikojnë në ndryshimin e partive.

Pjesa e tretë e librit hulumton çështje si organizimi i partive dhe 'pushtimin' nga ana e tyre të shtetit duke gjetur burime të tjera, përtej atyre shoqërore, për të mbijetuar. Në këtë kuptim, Mair përforcon faktin se tashmë partitë politike janë në një pozicion force, sidomos kur ato marrin pushtetin, duke bërë të mundur shfrytëzimin maksimal të burimeve administrative për të mbajtur në këmbë strukturën partiake. Kështu, Mair bën një dallim thelbësor mes konceptit të ndryshimit të sistemit të partive me ndryshimet që pësojnë vetë partitë. Me ndryshim të sistemit partiak, autori nënkupton dinamikën e përmes të cilave

organizohen aktorët partiakë. Me ndryshim, pra, autori ka parasysh zëvendësimin e plotë të një sistemi me një tjetër brenda kuadrit sistemik. Në këtë kuptim, autori pranon se ndryshimet sistematike ndodhin në kushte transformimesh rrënjësore politiko-sociale, ndërkohë që ndryshimi i partive është një fenomen më fluid dhe më pak i matshëm.

Në libër ka dhe një kapitull me titull provokativ 'Miti i ndryshimit elektorale'. Autori sfidon këtu paradigmen mbisunduese në shkencat politike mbi partitë ku zakonisht ndryshimet shoqërore detyrimish shoqërohen me ndryshime të rëndësishme elektorale, pra të një lidhje të drejtpërdrejtë të luhatjeve elektorale me (ndryshimin e) partitë. Ajo që Mair kërkon të vërtetojë është fakti se, pavarësisht se struktura sociale e vendeve perëndimore ka ndryshuar thellësisht, kjo nuk është reflektuar në ndryshime të identifikimeve politike. Në këtë kuptim, ndryshimi i 'frakturave', apo rënia e 'frakturave' shoqërore nuk është shoqëruar me rënien e partive tradicionale politike.

Pjesa e fundit e librit merret kryesisht me strukturën e kompeticionit politik në sistemet partiake perëndimore. Autori e ndan këtë pjesë në tre kapituj, duke bërë një dallim të qartë mes sistemeve partiake në Evropën Perëndimore dhe në atë Lindore. Lidhur me këto të fundit, autori e mbështet tezën e tij në argumentin se konteksti i ekzistencës së sistemeve partiake në Lindje është i ndryshëm nga ai në Perëndim— sidomos kur krahasohet stabiliteti perëndimor në aspektin e ofertës politike me mungesën e stabilitetit në Lindje—në raport me stabilitetin perëndimor në ofertën politike me instabilitetin dhe lëvizshmërinë në Lindje. Autori ia atribuon këtë jo vetëm kontekstit politik, por edhe momentit në të cilin lind forma e partisë në Evropën Lindore.

Megjithëse kanë kaluar pesë vite nga botimi i tij, libri mbetet ndoshta kontributi më domethënës në fushën e teorive të partive politike në vitet e fundit. Perspektiva teorike që ai shtron vazhdon të mbetet e vlefshme. Ndoshta pika më e ndjeshme e librit mbetet analiza që Mair u bën partive politike në Evropën Lindore, pasi botimi i tij është bërë pak kohë pas zgjedhjeve të para në këtë rajon. Pavarësisht elementit të paqartësisë, në disa vende të Evropës Lindore janë kristalizuar alternativa politike, që i kanë mbijetuar kohës dhe janë stabilizuar. Sistemet politike në vendet e Evropës Lindore mund të analizohen pikërisht përmes modelit që Mair parashtron në analizën e tij mbi sistemin e partive në Evropën Perëndimore.

Weberi dhe tradita weberiane në sociologjinë amerikane

Fatos Tarifa, PhD

Abstrakt. Si një ndër themeluesit dhe përfaqësuesit më të shquar të mendimit sociologjik klasik, Max Weber ka patur dhe vazhdon të ketë një ndikim jashtëzakonisht të madh në mendimin sociologjik botëror. Ky artikull trajton ndikimin që ka patur Weberi në zhvillimin e sociologjisë amerikane dhe—vice versa—ndikimin që ka patur Amerika në formimin e mendimit sociologjik weberian. Për shkak se Weberi ka qenë dhe mbetet një figurë polarizuese në debatin akademik, përmbajtja e mendimit weberian dhe influenca e tij studiohen në tri periudha kryesore: (1) periudha pas prezantimit të veprës së Weberit publikut amerikan në vitet 1930, (2) periudha pas Luftës së Dytë Botërore dhe (3) gjysma e dytë e viteve 1960 e në vazhdim, periudhë kjo që mund të quhet periudha e “deamerikanizimit” të Weberit dhe e “kthimit” të tij në Gjermani. Si përmbajtja, ashtu edhe influenca e tij vlerësohen në kontekstet historike dhe politike të kohës.

Hyrje

Si një ndër themeluesit dhe përfaqësuesit më të shquar të mendimit sociologjik klasik, Max Weber, ashtu si edhe Karl Marx, ka patur një ndikim jashtëzakonisht të madh, edhe pse të vonuar, në mendimin sociologjik amerikan dhe atë botëror. Ky artikull trajton ndikimin që ka patur Max Weberi në zhvillimin e sociologjisë amerikane dhe—vice versa—ndikimin që ka patur Amerika në formimin e mendimit sociologjik weberian. Vepra kryesore e Weberit, *Etika protestante dhe shpirti i kapitalizmit* (*The Protestant Ethic and the Spirit of Capitalism*, [1904-05] 1958), ka provokuar një ndër debatet teorike më të mëdha në shekullin e 20-të. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak se, përmes “kritikës pozitive të materializmit historik”, Weberi sfidoi interpretimin marksist të historisë (Bendix [1960] 1977: 50), edhe pse, siç argumentojnë

Hans Gerth dhe C. Wright Mills [1946] 1958: 46), “një pjesë e mirë e veprës së Weberit dëshmon se ai vetë e aplikoi mjeshhtërisht metodën historike të Marksit”. Sidoqoftë, për Weberin, teoria e Marksit ishte një teori njëshkaksore, reduksioniste, dhe, për këtë arsye, jo e saktë në shpjegimin e historisë dhe të shoqërisë njerëzore. Sipas tij, Marks, si ekonomist, kishte bërë po atë gabim që po bënte antropologjia në kohën e tij, duke i dhënë një rëndësi dominante një perspektive teorike të kufizuar dhe duke e reduktuar shumësinë e faktorëve shkaksorë në një teoremë të mbështetur në një faktor të vetëm (Ibid, ff. 46-47). Nëse vëmë re sesa shumë ngjasojnë pikëpamjet e Weberit mbi strukturat politike të shoqërisë me pikëpamjet e Marksit mbi strukturat ekonomike të saj, mund të thuhet se Weberi nuk e hodhi poshtë tërësisht materializmin historik të Marksit; ai u përpoq ta plotësojë materializmin ekonomik të Marksit me një materializëm politik dhe militar (Ibid. f. 47).

Një ndër arsyet pse vepra e Weberit ka patur dhe vazhdon të ketë një influencë kaq të madhe dhe zgjon edhe sot një interes të veçantë është, parasëgjithash, “superioriteti akademik inherent i saj, si një qasje komparativiste në investigimin makrosociologjik, krahasuar me marksizmin reduksionist dhe funksionalizmin stukturalist ahistorik (Roth 1977: xiii). Siç ka shkruar Jürgen Habermas (1971: 66), Weberi theu “trilemën e historicizmit, të utilitarizmit dhe të marksizmit”.

Weberi në Amerikë dhe Amerika tek Weberi

Për një kohë të gjatë, madje edhe pas vdekjes së tij në vitin 1920, Weberi mbeti pothuasje i panjohur në Amerikë, edhe pse Amerika nuk kishte qenë e panjohur për të. Në veprën e tij *Etika protestante*, e cila është ndër më të shiturat e të gjitha kohëve, Weberi flet gjerësisht për Amerikën dhe jep një përshkrim tepër interesant të tipareve të peisazhit social të këtij vendi, duke iu kundërvënë stereotipeve gjerësisht të përhapura në Gjermaninë e kohës së tij mbi këtë vend, si edhe imazhit të gjermanëve dhe të europianëve të tjerë mbi *shoqërinë moderne* në përgjithësi (Kalberg 2009).

Weberi e vizitoi Amerikën vetëm një herë, në vitin 1904 (nga shtatori deri në prag të Krishtlindjeve), në një kohë kur ai sapo kishte përfunduar së shkruari pjesën e parë të *Etikës protestante*. Kjo vepër u plotësua pas kthimit të tij nga Amerika në Heilderberg dhe u botua, në gjermanisht, një vit më vonë, më 1905. Edhe pse para tij, një tjetër sociolog dhe ekonomist i madh gjerman, Karl Marks, kishte shkruar gjerësisht për Amerikën, si një korrespondent i rregullt i gazetës së njohur amerikane *New York Tribune*, ai, pra Marks, asnjëherë nuk e vizitoi atë vend (Holmes 1947).

Arsyeja e vizitës së Weberit në Amerikë ishte një ftesë për të marrë pjesë në Kongresin e Arteve dhe të Shkencave në St. Louis, Missouri. Në librin e tij Max

Weber in America, Lawrence Scaff (2011) na thotë se *udhëtimi i Weberit në Shtetet e Bashkuara*, mund të konsiderohet një pikë kthese në jetën e tij dhe një moment shumë i rëndësishëm në formimin e ideve të tij sociologjike. Weberi, i cili *ishte shumë i influencuar nga tradita intelektuale gjermane e idealizmit, e romanticizmit dhe e dëshpërimit kulturor konservativ (Stern 1961)*, nuk mund të kuptohet pa marrë në konsideratë eksperiencën e tij në Amerikë. Po kështu, rruga e veçantë që ka ndjekur Amerika drejt modernitetit do të ishte e vështirë të kuptohej pa një njohje të thellë të atij korpusi të gjerë veprash që shkroi Max Weberi. Hans Gerth dhe C. Wright Mills [1946] 1958: 17), shkruajnë se, “Ndoshta Shtetet e Bashkuara ishin për Weberin ajo çfarë Anglia ka qenë për brezat e mëparshëm të liberalëve gjermanë: modeli i një shoqëri të re”.

Deri disa dekada më parë, të vetmet burime informacioni mbi vizitën e Weberit në Amerikë kanë qenë biografia e shkruar për të, pas vdekjes së tij, nga bashkëshortja dhe bashkudhëtarja e tij në atë udhëtim, Marianne Weber ([1924] 1988), një artikull i titulluar “Maks Weberi dhe Shtetet e Bashkuara”, botuar në SHBA gjatë Luftës së Dytë Botërore nga H. W. Brann (1944), si edhe Parathënia që Gerth dhe Mills ([1946] 1958) kanë shkruar për vëllimin e redaktuar prej tyre me titull *Nga Maks Weberi: Ese në sociologji (From Max Weber: Essays in Sociology)*.

Scaff (2011), me librin e tij *Maks Weberi në Amerikë*, hedh dritë mbi këtë episod të rëndësishëm në karrierën e Weberit dhe tregon se si kritika me të cilën u prit vepra e tij në Amerikë, pas përkthimit në anglisht dhe botimit të saj në atë vend, ka qenë një histori po aq amerikane sa edhe vetë sojourni i Weberit në Amerikë. Scaff dëshmon se si vizita në Shtetet e Bashkuara dhe eksperiencia që fitoi gjatë atij udhëtimi ndikuan thellësisht në pikëpamjet e Weberit mbi *emigracionin*, mbi *kapitalizmin*, mbi *shkencën dhe kulturën*, mbi *racat dhe diversitetin kulturor*, mbi *protestantizmin* dhe *modernitetin*, tema këto gjerësisht të trajtuara në veprat e tij. Në fakt, krijimtaria intelektuale më e rëndësishme e Weberit nisi pas kthimit të tij nga Amerika.

Nga ana tjetër, Scaff dëshmon, gjithashtu, ndikimin që ka patur Max Weberi, pas vdekjes së tij (në moshën 56 vjeç), në zhvillimin e shkencave sociale në Shtetet e Bashkuara, duke treguar se si veprat e tij u përkthyen dhe u interpretuan nga sociologë të tillë amerikanë si, Talcott Parsons, Hans Gerth dhe C. Wright Mills, apo nga një ekonomist i shquar si Frank Knight, njëri prej themeluesve të Shkollës së Çikagos. Parsons, mbi të gjithë, mund të thuhet se ka meritën e padiskutueshme për popullarizimin e ideve dhe të veprës së Weberit në Amerikë dhe në të gjithë botën anglishtfolëse (Honigsheim 1968). Në fakt, ajo që ka ndodhur me veprën e Weberit është se, pasi u përkthye dhe u botua në Amerikë dhe pasi u kanonizua, u kodifikua dhe, mund të themi, u “amerikanizua” atje nga Parsons dhe të tjerë, ajo iu paraqit publikut gjerman dhe atij europian, pas Luftës së Dytë Botërore, në një dritë të re.

Duket se asnjë aspekt i jetës amerikane, siç pati rast ta njohë atë prej eksperiencës së tij të drejtpërdrejtë, nuk ka ndikuar në mendimin sociologjik të Weberit aq sa qëndrimi i amerikanëve ndaj fesë. Gjatë vizitës tek disa prej kushërinjve të tij në Mt. Airy, në Karolinën e Veriut dhe në Virxhinia, Weberi pati mundësi të vëzhgojë nga afër disa nga praktikat evangjeliste në formën e tyre të kulluar. Është me rëndësi të vihet në dukje se botimi i parë, në të cilin Weberi trajton dallimet midis një sekti fetar dhe kishës së institucionalizuar, është mbështetur pikërisht në përvojën e tij nga vizita e sipërpërmendur në malet Apalaçia, në Karolinën e Veriut. Shtetet e Bashkuara i dhanë Weberit mundësinë që të shohë realisht se si ishte krijuar jeta shoqërore para se ajo të kalçifikohej në ato forma që përkthyesi i veprës së tij në Amerikë, Talcott Parsons, do t'i quante "pattern variables" (Ibid). Ishte kryesisht në shtetet e Jugut dhe në ato të Perëndimit në Shtetet e Bashkuara që Weberi mundi të kuptojë se si feja ishte në gjendje të konfirmonte pozitën e nderuar të një individi në shoqëri, duke u shërbyer kështu objektivave sekulariste.

Ndikimi që ka patur Amerika në mendimin sociologjik dhe politik të Weberit, si edhe ndikimi që vepra e këtij të fundit ka patur në zhvillimin e sociologjisë amerikane, janë trajtuar më parë në dy biografi të shkëlqyera intelektuale që janë shkruar për të—njëra nga Reinhard Bendix ([1960] 1977) dhe tjetra nga Julian Freund (1968). Po kaq interesant sa ato është edhe libri i sociologut të njohur gjerman, Claus Offe, *Refleksione mbi Amerikën: Tokëvill, Weber dhe Adorno në Shtetet e Bashkuara (Reflections on America: Tocqueville, Weber and Adorno in the United States)*, botuar në vitin 2005. Weberi është mendimtari evropian tipik, apo klasik: abstrakt, i ditur, depresiv dhe i vështirë. Reinhard Bendix, një ndër njohësit dhe interpretuesit më të mirë të Weberit, pohon se "është fakt se vepra e Weberit është e vështirë të kuptohet" dhe se "çfarëdo që mund të thuhet për të justifikuar fjalitë e gjata dhe kredencialet akademike nuk mjafton për të shpjeguar 'stilin' karakteristik të shkrimeve sociologjike të Weberit" (Bendix [1960] 1977: xlcii). Lawrence Scaff (2011), nga ana e tij, dëshmon se sa e vështirë ka qenë fillimisht që veprat e Weberit, edhe pse të përkthyer në anglisht nga mendimtarë të tillë të shquar si Parsons, Knight etj., të botoheshin në Amerikë, pasi botuesit dyshonin nëse idetë e një mendimtari të villë të vështirë, si Weberi, do të mund të tërhiqnin vëmendjen e publikut amerikan.

Në imagjinatën time, si sociolog, gjithmonë jam përpjekur të kuptoj se si Maks Weberi, ky mendimtar kuintencialisht gjerman—më gjerman ndoshta edhe se internacionalisti Karl Marksi—është pritur dhe çfarë ka parë ai, në vitin 1904, në rrugët e Çikagos, në malet e Karolinës së Veriut, në Nju Orlins, në fushat e Alabamës dhe të Oklahomës, në Niagara, në Boston dhe Kejmbrixh (Masaçusets), në rrugët e Manhatanit, apo në qytete të tilla, si Filadelfia, Uashingtoni dhe Baltimore, të cilat ai i vizitoi gjatë qëndrimit të tij në Shtetet e Bashkuara) dhe si konkretisht Amerika, me atë që ajo është dhe që ajo përfaqëson, ka ndikuar

në zhvillimin e mendimit të tij sociologjik. Hans Gerth dhe C. Wright Mills, në biografinë e shkruar që kanë shkruar për të, na ndihmojnë të kuptojmë se çfarë pa dhe çfarë kuptoi Weberi në Amerikë. Ata shkruajnë:

[Weberi] mahnitej me *rush hour* në Manhatanin e poshtëm, çka atij i pëlqente ta shihte nga mesi i Urës së Bruklinit si një panoramë transporti masiv dhe lëvizjeje të zhurmëshme. Grataçielat, të cilat ai i shihte si "fortesa të kapitalit", i kujtonin atij "pikturat e vjetra të kullave në Bolonjë dhe në Firence (Gerth & Mills [1946] 1958: 15).

Çikago, nga ana tjetër, me shkallën e lartë të krimit dhe të dhunës, me kontrastet e saj të mprehta midis bregut të artë dhe lagjeve të varfra, "tymit, pislëkut, gjakut dhe anëve të errëta" të grataçelave, i la Weberit përshtypjen e një qyteti "të jashtëzakonshëm" (Ibid). Këtë përshtypje të tij e thelloi edhe më shumë përzierja "e lodhshme" e njerëzve që e popullonin atë qytet, dhe për të cilët Weberi shkruante:

...grekët pastrojnë këpucët e amerikanëve për pesë cent, gjermanët shërbejnë si kamarierë, irlandezi merret me politikë dhe italiani gërmon kanalet e pista. Me përjashtim të disa zonave rezidenciale ekskluzive, i tëri ai qytet gjigant, më i madh se Londra, është si një njeri, të cilit i është çveshur lëkura dhe mund të shohësh se ç'ndodh brenda trupit të tij (cituar në Gerth & Mills [1946] 1958: 15).

Pa dyshim që një rol të rëndësishëm në formimin e mendimit weberian në atë kohë duhet të kenë luajtur takimet dhe njohja e tij me disa ndër sociologët dhe filozofët amerikanë më të shquar. Kongresi i Arteve dhe i Shkencave në St. Louis, i zhvilluar në kuadrin e një ngjarjeje kulturore shumë të rëndësishme për kohën, siç ishte Panairi Botëror (*World's Fair*), mblodhi së bashku një listë *all-star* intelektualësh amerikanë dhe evropianë për të debatuar nëse ekziston një unitet metodologjik që i bashkon shkencat natyrore dhe ato sociale.

Ndër intelektualët e shquar gjermanë, përveç Weberit, në atë kongres morën pjesë edhe ekonomisti dhe sociologu i njohur Werner Sombart dhe teologu e filozofi Ernst Troeltsch. Në St. Louis, Weberi mbajti një leksion shumë të suksesshëm mbi strukturën sociale të Gjermanisë, duke iu referuar kryesisht problemeve rurale dhe politike (Ibid, f. 16). Po në St. Louis, Weberi u takua me sociologun e shquar afro-amerikan W. E. Burghardt Du Bois. Ky i fundit, i cili e njihje gjermanishten shumë mirë, e kishte dëgjuar Weberin të mbante leksione në Berlin, në kohën që ai vetë kishte qenë student në Universitetin e Humboldt. Për shkak se Weberi ishte shumë i interesuar për marrëdhëniet ndër-racore në Shtetet e Bashkuara, takimi i tij me Du Bois mund të ketë influencuar së tepërmi

disa nga pikëpamjet e tij të mëvonëshme, mbështetur në parashtrimin e ideve të Du Boisë mbi marrëdhëniet raciore në Amerikën e *fin-de-siècle* në dy librat e tij tashmë klasikë, *Zezaku i Filadelfias (The Philadelphia Negro)* dhe *Shpirtrat e folkut zezak (The Souls of Black Folk)*, të botuar respektivisht në vitet 1899 dhe 1903, pra vetëm pak kohë para se Weberi të vizitonte Amerikën. Në të dyja këto studime, Du Bois i kushtonte vëmendje të veçantë strukturës sociale dhe, duke përdorur metoda sociologjike, si vëzhgimet dhe statistikën, eksploroj ndikimin e fesë mbi kulturën, një temë kjo qendrore edhe në veprën e Weberit. Idetë e Du Boisë për të promovuar shanset që zezakët mund të kishin në jetë i përshtateshin shumë mirë vëmendjes që Weberi u kushtoi, siç shprehet Scaff (2011: 111), “një ethosi që nxirrte në pah dinjitetin e punës dhe disiplinimin e vetvetes në shërbim të një ideali sekular”. Weber, ashtu si edhe Du Bois, refuzoi çdo pikëpamje eugjenetike mbi racat, duke i parë dallimet racore, po të përdorim gjuhën e sotme, si *socially constructed*, pra, si shoqërisht të krijuara. Lidhur me gjendjen dhe shanset e zezakëve në Amerikë, Weberi shkruante:

Unë kam biseduar me rreth njëqind banorë të bardhë në shtetet e jugut, nga të gjitha klasat shoqërore dhe nga të gjitha partitë, dhe problemi se çdo të bëhet me këta njerëz [zezakët] duket absolutisht i pashpresë (cituar në Gerth & Mills [1946] 1958: 16-17).

Lexuesit e veprës më të shquar të Weberit, *Etika protestante dhe shpirti i kapitalizmit*, nuk e kanë të vështirë të konstatojnë influencën që ka patur në mendimin sociologjik weberian një figurë e tillë ikonë në historinë dhe kulturën amerikane, si Benjamin Franklin. Për Weberin, Franklin ishte personifikimi i *tipit ideal* të “shpirtit të kapitalizmit”, si edhe një provë e qartë e fuqisë së “shpirtit” si një faktor i rëndësishëm në histori (Kessel 2007: 160-161). Si një ndër themeluesit e “Ëndrrës Amerikane”, Benjamin Franklin i shërbeu Weberit si një ilustrim mjaft i mirë i “frymës së kapitalizmit” që ky i fundit përpoq të shtjellojë në veprën e tij *Etika protestante* (Ibid, f. 161). Ajo që rrallë është vënë në dukje—dhe që meriton një vëmendje të veçantë—është indikimi që ka patur në mendimin weberian një tjetër personalitet i shquar amerikan: psikologu dhe filozofi pragmatist William James, i cili kishte studiuar në Berlin dhe në Halle të Gjermanisë (Scaff 2011: 30), dhe me të cilin Weber krijoi një lidhje të veçantë intelektuale. Edhe pse as William James dhe as John Dewey, dy ndër personalitetet amerikane më të shquara të shkencës sociale në atë kohë, nuk morën pjesë në Kongresin e Arteve dhe të Shkencave në St. Louis, Weber mundi të takohet me Jamesin më vonë, kur, pas udhëtimeve të tij në shtetet e Jugut, ai vizitoi Harvardin (Ibid, f. 146).

Scaff, si edhe autorë të tjerë, kanë evidentuar disa ngjashmëri të rëndësishme midis veprës së Jamesit *Llojet e eksperiencës fetare: Një studim në natyrën njerëzore (The Varieties of Religious Experience: A Study in Human Nature)*, botuar më

1902, pra dy vjet para udhëtimit të Weberit në Amerikë, dhe veprës së këtij të fundit *Etika protestante*. Nëse mbajmë parasysh se pjesa e parë e kësaj vepre të Weberit, siç thamë më sipër, ishte shkruar dhe dërguar për botim para udhëtimit të tij në Amerikë, ndërsa pjesa e dytë e saj u shkrua pas kthimit të tij nga Amerika, nuk është vështirë të kuptojmë ndikimin e pikëpamjeve të Jamesit në mendimin weberian. Për shembull, duke hequr dorë nga kategoritë aprioristike të Kantit mbi fenë, Weberi formuloi një pikëpamje të ngjashme me atë të Jamesit mbi kategori të tilla si, asketizmi dhe misticizmi, si edhe i kushtoi një rëndësi të veçantë sjelljes praktike dhe dobisë pragmatike të besimit fetar, duke shpjeguar qartë tipet e jetës spirituale të “personalitetit”, të formuara nga eksperiencia fetare (Ibid, ff. 150, 152).

Amerika, Tocqueville dhe Weber

Përpara Weberit, një tjetër mendimtar i shquar europian, francezi Alexis de Tocqueville, kishte vizituar Amerikën për 9 muaj, në fillim të viteve 1830. Por, ndërsa vepra e tij madhore, *Demokracia në Amerikë (Democracy in America)*, përmendet nga Marksi, në veprat e Weberit çuditërisht nuk gjejmë asnjë përmendje të saj, edhe pse Weberi duhet ta ketë lexuar atë në frëngjisht, siç rezultoj nga shënimet e bëra me dorën e tij në një kopje të këtij libri të gjetur në koleksionin e tij në Heidelberg. Sidoqoftë, kushdo që ka lexuar si Tocquevillin, ashtu edhe Weberin, nuk mund të mos vërejë, nga njëra anë, ngjashmëritë midis interpretimit që Weberi i bën “eksepcionalizmit amerikan” (kryesisht një nivel më i lartë i angazhimit civik sesa në Gjermani) dhe linjave kryesore të vëzhgimeve të Tocquevillit në veprën e tij të sipërpërmendur dhe, nga ana tjetër, besimin që të dy këta mendimtarë të shquar kishin në *lirinë* dhe në *pavarësinë* e individit dhe, po kështu, në *racionalitetin*. Si Tocqueville, ashtu edhe Weber, ishin liberalë jo vetëm sepse ata kërkonin mbrojtjen e lirive të individit nga çdo formë dominimi jolegjitim, por edhe sepse besonin në përpjekjet për të krijuar një të ardhme më të mirë (Langenbacher 2005: 31).

*Interesimi në rritje për të studiuar bazat sociale të shoqërive demokratike ka bërë që, si Tocqueville, ashtu edhe Weberi, të rikthehen në ditët tona në qendër të vëmendjes të sociologëve politikë dhe atyre komparativistë. Studimet e këtyre të fundit fokusohen kryesisht në veprat e Tocquevillit *Demokracia në Amerikë* (1835-40) dhe *Regjimi i vjetër dhe revolucionit (L’Ancien Régime et la Révolution, 1856)*, si edhe në studimet e Weberit mbi fenë dhe në shkrimet politike të tij. Edhe pse Tocqueville vinte në qendër të teorisë së tij politike *interesat*, ndërsa Weberi theksonte rolin e *vlerave*, si një faktor esencial për motivimin e veprimit politik dhe për legjitimitimin e shtetit, si njëri, ashtu edhe tjetri, i kushtuan rëndësi të veçantë rolit të *strukturës sociale*, të bindur se ajo mund ta pengojë, ose ta *ndihmojë zhvillimin e demokracisë* (Faught 2007).*

Përsa i përket përvojës dhe vëzhgimeve të tyre të drejtpërdrejta në Amerikë, Tocqueville jo vetëm vuri re me admirim mënyrën se si funksiononte demokracia amerikane, por edhe shprehu shqetësimin e tij për fatin e lirisë në “epokën demokratike”. Weberi, nga ana tjetër, duke u fokusuar në rolin e burokracisë në një demokraci, shkroi me entuziazëm për energjinë rinore që ai vuri re në Shtetet e Bashkuara edhe pse, në fillim të shekullit të 20-të, ky vend, gjithashtu, po u nënshtrohej tendencave dominuese të burokratizimit evropian (shih Offe 2005). Weberi jo vetëm e përdori konceptin e një burokracie racionale kundër konceptit marksist të luftës së klasave (Gerth & Mills [1946] 1958: 49), por ai, gjithashtu, i pa burokracinë dhe demokracinë në mënyrë *dialektike*. Sipas tij, demokracia duhet ta kundërshtojë burokracinë si një tendencë që mund të çojë në krijimin e një kaste mandarinësh, të shkëputur nga njerëzit e zakonshëm, përmes trajnimit të tyre si ekspertë dhe përmes posteve të pandryshuara që ata zenë në administratë, por, nga ana tjetër, demokracia duhet të promovojë atë çfarë kërkon arësyeja dhe që nuk e do sentimentin demokratik (Ibid, f. 18).

Sido që të jetë, si Tocqueville, ashtu edhe Weber, vlerësonin jetën e asociuar të amerikanëve si një specifikë e admirueshme e shoqërisë së tyre. Tocqueville shkruante se “Americans...constantly unite” ([1835-40] 2004: 489), ndërsa Weberi vinte në dukje se Amerika është “the association-land par excellence” (Weber [1910] 1972: 20; cf. Weber [1920] 1946). Në përgjithësi, Weberi trajtoi dy prej temave qendrore që vëmë re në analizat e Tocquevillit mbi kulturën politike të amerikanëve: mundësinë e një “tiranie të shumicës” (*tyranny of the majority*) në Shtetet e Bashkuara, si edhe rolin e rëndësishëm të shoqatave të qytetarëve (*civil association*).

Duke vënë në pah të përbashkëtat dhe dallimet midis Tocquevillit dhe Weberit, Bendix shkruan se:

Nëse Tocqueville mund të thoshte se, si një aristokrat i lindur dhe adhurues i lirisë, ai mundi të shohë qetësisht rënien e klasës së tij dhe të shohë [gjithashtu] qartë rrezikun që i kërcënohej lirisë me ngritjen e demokracisë, Weber mund të thoshte se, si një “ujk i vetmuar”, i lindur në një familje liberale të klasës së mesme në Gjermaninë e gjysmës së dytë të shekullit të 19-të, ai pa si rënien e liberalizmit në kushtet e lindjes së një shteti të fuqishëm, ashtu edhe rrezikun ndaj individit me burokratizimin e shoqërisë moderne (Bendix [1960] 1977: 7).

Nga një perspektivë teorike, mund të thuhet se Tocqueville plotëson vizionin e përgjithëm weberian mbi shpirtin e kapitalizmit. Njëlloj si Weberi, ai thekson qëndrimin pozitiv të amerikanëve ndaj punës (për ta çdo lloj pune konsiderohet “e nderuar”), si edhe shpirtin entrepreneur të tyre (“guximi” dhe “besimi” në biznes). Por, ndërsa Tocqueville vuri në dukje padurimin (*restiveness*) e aktorëve

ekonomikë dhe dëshirën e tyre për gjithnjë e më shumë të mira materiale (*taste for material well-being*), Weberi theksoi dimensionet metodike dhe asketike të shpirtit të kapitalizmit. Ai e konsideronte “asketizmin protestant si bazën e qytetërimit profesional modern—një lloj “kostruktimi shpirtëror” të ekonomisë moderne” (cituar në Gerth & Mills [1946] 1958: 19). Sidoqoftë, siç argumenton Richard Svedberg (2007), teza e Weberit se ekziston një korrelacion pozitiv midis protestantizmit (veçanërisht variantit *kalvinist* të tij) dhe kapitalizmit modern gjen mbështetje edhe në veprën e Tocquevillit. Ky i fundit, gjithashtu, shihte një lidhje të drejtpërdrejtë midis jetës ekonomike (apo shpirtit të kapitalizmit) dhe fesë, veçse, në dallim nga Weberi, ai theksonte lidhjen akoma më të ngushtë midis shpirtit të kapitalizmit dhe dimensionit politik (kushteve politike dhe sjelljes politike të qytetarëve). Duhet thënë se edhe termi “shpirt” (*Geist*) që përdor Weberi, gjendet shpesh në veprën e Tocquevillit, kur ai flet për shpirtin entrepreneur të amerikanëve (*l'esprit de l'entreprise*).

“Amerikanizimi” i Weberit

Është me interes të vëmë në dukje se si Weberi u “konstruktua” si një themelues i sociologjisë, siç vlerësohet ai në të gjitha tekstet dhe kurset e teorisë sociologjike. Kjo, në thelb, është një çështje me të cilën merret sociologjia e njohjes (*sociology of knowledge*) dhe mund të formulohet kështu: Si kanë mundur t’i influencojnë krijimin dhe zhvillimin e sociologjisë procese të caktuara historike dhe institucionale? Unë mendoj se një pjesë e asaj se si e shohim ne Weberin sot rezulton jo nga vetë Weberi, por nga mënyra se si Weberi u “përshtat” dhe u “ri-konsiderua” nga sociologët amerikanë në vitet 1930 deri 1950, sidomos nga Talcott Parsons, i cili e përktheu atë në anglisht dhe i cili dominoi mendimin sociologjik amerikan dhe atë botëror në prag, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore (Tarifa 2008: 51).

Ndonëse Émile Durkheim konsiderohej një mjeshtër i mendimit shoqëror në Francë dhe Max Weber ishte, gjithashtu, një autoritet i padiskutueshëm shkencor në Gjermani, idetë e tyre mbetën fare pak të njohura jashtë kufijve të kontinentit evropian, të paktën në dekadat e para të shekullit të 20-të. Deri në atë kohë, Auguste Comte, Herbert Spencer dhe Karl Marx ishin, ndoshta, të vetmit mendimtarë socialë evropianë të shekullit të 19-të, veprat e të cilëve ishin botuar në Shtetet e Bashkuara. Durkheim dhe Weber ishin ende të panjohur përtej oqeanit. Pothuajse asnjë nga veprat e tyre nuk ishte përkthyer dhe botuar në Amerikë. Disa nga sociologët e parë të rëndësishëm amerikanë si, William Graham Sumner dhe Lester Frank Ward, në analizat e tyre mbi ndryshimet shoqërore që po ndodhnin në Amerikë si rezultat i industrializmit, urbanizmit, proceseve të brendshme migruese dhe emigracionit nga jashtë, u mbështetën kryesisht tek Comte dhe Spencer (Ibid, f. 50).

Por, si ndodhi atëherë që Marx, Durkheim dhe Weber filluan të vlerësohen si “klasikë”, ose si figurat themeluese të teorisë sociale? Këta mendimtarë europianë mund të mos ishin bërë figurat qendrore të traditës klasike në sociologji, nëqoftëse universitetet franceze dhe ato gjermane nuk do të kishin patur atë reputacion që ato kishin në fillim të shekullit të 20-të. Në atë periudhë, universitetet, sidomos ato që e kishin orientuar veprimtarinë e tyre në kërkimin shkencor, ishin akoma një dukuri relativisht e re në Shtetet e Bashkuara, ndërkohë që në Europën Perëndimore ato kishin një traditë të gjatë dhe të pasur. Shumë prej sociologëve më të njohur amerikanë në atë periudhë studiuin në universite europiane. Ata u njohën kështu me debatet e rëndësishme teorike që zhvilloheshin në Francë dhe në Gjermani mbi origjinën e kapitalizmit, mbi natyrën e sekularizmit, mbi perpektivat për ndryshime revolucionare dhe për zhvillimin e demokracisë. Marx, Durkheim dhe Weber ishin ndër autorët kryesorë me të cilët ata u njohën nga afër.

Debatet mbi çështjet e mësipërme morën një rëndësi të veçantë në Shtetet e Bashkuara në vitet 1930, periudhë në të cilën Depresioni i Madh, lindja e fashizmit dhe e Nazizmit në Europë dhe lëvizjet sociale të lidhura me feminizmin dhe me të drejtat civile të zezakëve shkaktuan tronditje sociale dhe sollën ndryshime esenciale në shoqërinë amerikane. Me fjalë të tjera, ngaqë në këtë periudhë Amerika filloi të përjetojë shumë prej problemeve që shqetësonin edhe Europën, të tilla si kriza ekonomike, konflikte klasore, sfida ndaj shoqërisë liberale dhe kritikën ndaj saj—si nga e majta, ashtu edhe nga e djathta—teoritë evolucioniste, si ato që kishin zhvilluar Comte dhe Spencer një shekull më parë, e humbën kredibilitetin dhe rëndësinë e tyre. Sociologët amerikanë filluan të interesoheshin për ide, të cilat ishin të dobishme për të kuptuar realitetin social në zhvillim e sipër në vendin e tyre, veçanërisht për ide që kishin të bënin me rreziqe dhe konflikte sociale serioze. Shumë prej tyre e kthyen vështrimin nga mjeshtrit e mendimit shoqëror europian.

Figura qendrore në sociologjinë amerikane që e zhvendosi vëmendjen nga Comte dhe Spencer tek Marx, Durkheim dhe Weber ishte Talcott Parsons. Parsons studioi në Gjermani dhe, kur u kthye në Harvard, solli me vete fokusin europian në problemet e kapitalizmit, idetë marksiste dhe ato weberiane. Vepra e tij kryesore, *Struktura e veprimtarisë sociale* (*The Structure of Social Action*), e botuar në vitin 1937, luajti një rol esencial për t'i vënë emra të tillë si Marx, Durkheim dhe Weber në qëndër të traditës klasike në sociologji (Seidman 2008: 62), edhe pse, në këtë vepër, Parsons duket se ka dhënë një “interpretim kreativ të gabuar” të Weberit (Roth 1977: xvi).

Në sociologjinë amerikane të pas Luftës së Dytë Botërore mbizotëruan dy qëndrime kryesore: teorizimet e përgjithshme mbi shoqërinë (shembulli më tipik i të cilëve është teoria “grandioze” parsoniane) dhe empiricizmi (Calhoun 2007; Calhoun et al. 2007; Lantz 1984). Nuk ka dyshim, sidoqoftë, se ai që dominoi

sociologjinë dhe fushën e teorisë sociale në Amerikë, nga vitet 1940 dhe deri në mes të viteve 1960, ishte Talcott Parsons.

Weberi në tri periudha

Reinhard Bendix ([1960] 1977: xlv) dhe Guenther Roth (1977: xvi) shpjegojnë se, në Shtetet e Bashkuara, vepra e Weberit u bë e njohur në tri periudha, ose në tri stadi. Periudha e parë është ajo kur, përmes përkthimit nga Talcott Parsons, në vitin 1930, të veprës *Etika protestante dhe shpirti i kapitalizmit*, Weberi iu prezantua publikut amerikan për të parën herë. Kjo vepër zuri vend menjëherë në programet e pothuajse të gjitha universiteteve amerikane, edhe pse studimet krahasuese të Weberit mbi fetë e mëdha botërore ishin ende të panjohura për sociologët dhe për publikun amerikan. Fillimisht, Parsons, i cili, siç shprehej vetë ai, ishte “një amerikan i influencuar së tepërmi nga Weberi” (Parsons 1971a: 27), e trajtoi Weberin si një prej pararendësve të teorisë së tij mbi veprimin social voluntarist, ndërsa më vonë, në analizat e tij mbi sistemet sociale, Parsons mendonte se ishte shkëputur nga influenca e Weberit (Roth 1977: xvi).

Periudha e dytë nis pas Luftës së Dytë Botërore, me rritjen e interesimit për studimin e organizatave të mëdha dhe të stratifikimit social në Shtetet e Bashkuara, kur konceptet weberiane, sidomos ai mbi *Idealtypus* (tipin ideal), mbi “burokracinë”, mbi klasat dhe statusin u bënë mjaft të përhapura dhe të diskutuara në sociologjinë dhe në shkencën politike amerikane. Në këtë fazë, përveç Parsonsit, i cili, në vitin 1947, botoi (të përkthyer prej tij), pjesën e parë të veprës së Weberit *Wirtschaft und Gesellschaft* (*Ekonomia dhe shoqëria*, përkthyer në anglisht *Economy and Society*), përkthyes dhe studiues të veprës së Weberit u bënë, gjithashtu, Hans H. Gerth dhe C. Wright Mills ([1946] 1958). Krahas tyre—dhe me rënien e influencës së funksionalizmit strukturalist të Talcott Parsonsit—vepra e Weberit tërhoqi edhe më shumë vëmendjen e sociologëve amerikanë. Një ndër më të njohurit prej tyre, Reinhard Bendix, me studimin e tij *Nëpunësit e lartë civilë në shoqërinë amerikane* (*The Higher Civil Servants in American Society*, 1949), me vëllimin e redaktuar bashkërisht me Seymour Martin Lipset *Statusi, Klasa dhe Pushteti* (*Status, Class, and Power*) (Bendix & Lipset [1953] 1966), si edhe me një artikull të rëndësishëm të tij, të titulluar “Sociologjia e Maks Weberit sot” (1965), solli një interpretim të ri të Weberit në sociologjinë amerikane. Bendix u përpoq t'i verë përballë interpretimit parsonian të Weberit substancën historike të sociologjisë weberiane të politikës, të së drejtës dhe të fesë (Roth 1977: xvi).

Periudha e tretë nis me përkujtimin e 100 vjetorit të lindjes së Weberit, në Kongresin e 15-të të Shoqatës Sociologjike Gjermane, mbajtur në Heidelberg, më 1964, në të cilin referuesit kryesorë ishin Talcott Parsons, Raymond Aron dhe Herbert Marcuse, ndërsa emrat e diskutantëve përfshinin sociologë të

tillë të njohur si: Max Horkheimer, Jürgen Habermas, Carl Friedrich, Eduard Baumgarten, Reinhard Bendix etj. (shih Stammer 1971). Edhe pse, siç ka vënë në dukje Hans Gerth ([1963] 1982), kritikën politike ndaj Weberit, si nga e majta, ashtu edhe nga e djathta, kishin filluar qysh në vitet 1930, me debatin kundërthënës mbi veprën e tij *Etika protestante*, si edhe mbi atë që Weberi e quan *Wertfreiheit* (interpretim objektiv, i çliruar nga vlerat e studiuesit), ishte pikërisht kjo ngjarje, pra Kongresi i sociologëve gjermanë, ajo që shënoi fillimin e një fushate sulmesh ndaj Weberit si “përfaqësuesi kryesor i shkencës sociale liberale ose borgjeze”. Në Heildeberg, ishte pikërisht Reinhard Bendix, ai që ngriti fort zërin kundër akuzave të Herbert Marcuse-së ndaj Weberit. Ishte po Bendix, i cili, gjashtë vjet më vonë, më 1970, në kulmin e rebelimit që kishte shpërthyer si brenda, ashtu edhe jashtë komunitetit akademik në Shtetet e Bashkuara, në mbledhjen vjetore të Shoqatës Sociologjike Amerikane, që atë vit e zgjodhi atë president të saj, paraqiti kuintesencën e pikëpamjeve të tij mbi Weberin (shih Bendix 1970a).

Po atë vit, Bendix botoi librin e tij *Sulm mbi arsyen: Ese mbi njohjen sociale* (*Embattled Reason: Essays on Social Knowledge*, 1970b), me të cilin ai u angazhua edhe më shumë në debatin kundërthënës mbi Weberin që kishte pushtuar qarqet akademike në Shtetet e Bashkuara dhe në Gjermani. Si reagim ndaj sulmeve të ashpra kundër Weberit nga autorë të tillë si, Mommsen, Markuse dhe Lukacs, më 1971 dhe 1972, Anthony Giddens, gjithashtu, solli një interpretim të ri të Weberit në librat e tij *Kapitalizmi dhe teoria sociale moderne* (*Capitalism and Modern Social Theory*) dhe *Politika dhe sociologjia në mendimin e Maks Weberit* (*Politics and Sociology in the Thought of Max Weber*). Giddens thekson me të drejtë se:

Një ndër detyrat më të ngutshme që qendrojnë përpara teorisë sociale moderne është riezaminimi i mjedisve sociale dhe politike që gjeneruan parametrat kryesorë të mendimit shoqëror të sotëm. Në rastin e Weberit, kjo do të thotë një farë rikthimi në atë lloj diskutimi që stimuloi vepra e tij në Gjermani në kohën kur ai jetoi (Giddens 1972: 8).

Roth vë në dukje se të trija këto faza të njohjes dhe të interpretimit të Weberit nuk kanë qenë sekuenca ekskluzive. Sipas tij:

Etika protestante vazhdon të interpretohet e izoluar nga krijimtaria tjetër e Weberit; ato pjesë të veprës së Weberit, të zgjedhura dhe të popullarizuara nga Hans H. Gerth dhe C. Wright Mills, vazhdojnë të jenë pjesë e kurrikulave të sociologjisë në të gjitha universitetet amerikane; vlerësimet që gjejmë në pjesën e parë të veprës së Weberit *Ekonomia dhe shoqëria*, të përkthyer nga Parsons, vazhdojnë të citohen edhe sot jashtë kontekstit teorik dhe historik (Roth 1977: xviii).

Sidoqoftë, qasja komparativiste që Weberi sugjeroi dhe aplikoi në veprat e tij është bërë tashmë gjerësisht e vlerësuar dhe e përdorur në sociologjinë politike, në sociologjinë historike të krahasuar, në shkencën politike, në studimet mbi fenë etj.

“Deamerikanizimi” i Weberit dhe “kthimi” i tij në Gjermani

Lawrence Scaff (2011), argumenton se, për ironi të fatit, Weberi që u bë një figurë e rëndësishme në sociologjinë gjermane në vitet 1960 ishte jo Weberi i fundit të shekullit të 19-të dhe i fillimit të shekullit të 20-të, por Weberi në versionin amerikan të viteve 1940 dhe 1950, siç u interpretua ai kryesisht nga Parsons. Sipas sociologut gjerman Friedrich Tenbruck (1975), mënyra se si u prit dhe u interpretua vepra e Weberit në Gjermaninë e viteve 1960 ishte po aq e fragmentuar sa edhe parashtrimi që i kishin bërë asaj Talcott Parsons dhe të tjerë në Shtetet e Bashkuara.

Është fakt që Weberi i shkroi veprat e tij më të famshme pasi u kthye nga Amerika. Ai, natyrisht, i shkroi ato në gjermanisht, çka do të thotë se, në periudhën nga botimi i tyre në Gjermani deri në “rikthimin” e tij në qendër të vëmendjes, si në traditën sociologjike amerikane, ashtu edhe në atë europiane, mendimi weberian është *ndërmjetësuar* nga përkthyesit e tij. Si Reinhard Bendix ([1960] 1977), ashtu edhe Jürgen Habermas (1971) e kanë kritikuar Talcott Parsonsin për një interpretim të ngushtë (shih gjithashtu Parsons 1971b: 81), si edhe për “interpretimin liberal” që ai i ka bërë veprës së Weberit. Në vitin 1964, Habermas shprehej se:

Në Gjermani, ne që akoma jemi në kërkim të alibive, do të kishim dashur shumë t’u shkonim pas atyre [amerikanëve–F.T.]. Por sociologjia politike e Weberit ka patur këtu një histori tjetër (Habermas 1971: 66).

Mbi të gjitha, vepra e Weberit i përket “traditës intelektuale të liberalizmit europian”, tipar ky, të cilin Talcott Parsons nuk e mbajti sa duhet parasysht në analizat e tij mbi Weberin dhe sociologjinë e tij” (Bendix ([1960] 1977: 1).

Pavarësisht “amerikanizimit” që iu bë mendimit të Weberit përmes përkthimit të veprave të tij, Weberi mbeti, parasëgjithash, një “Germanic thinker”. Një ndër konceptet më të njohura që formuloi ai, është *Lebensstil*, i cili në anglisht është përkthyer si *lifestyle*—në shqip “mënyrë jetese”). Por Weber formuloi, gjithashtu, edhe koncepte të tjera si këto—*Lebensführung* (në anglisht: *life conduct*, ndërsa në shqip “sjellje shoqërore”; *Lebensideal* (në anglisht: *life ideal*, ndërsa në shqip “ideal jetësor”), *Lebensanschauung* (në anglisht: *life outlook* ndërsa në shqip “pikëpamje mbi jetën”), *Lebensauffassung* (në anglisht: *life conception*, ndërsa në shqip “koncepti mbi jetën”), *Lebensluft* (në anglisht: *life atmosphere*, ndërsa në shqip “atmosphere

jetësore”), dhe *Lebensstimmung* (në anglisht: *life mood*, ndërsa në shqip mund të përkthehej “kuptimi mbi jetën”).

Gjatë periudhës naziste, Weberi u harrua thuajse tërësisht në qarqet intelektuale dhe akademike gjermane dhe ajo që ndodhi me të pas Luftës së Dytë Botërore, në Gjermani dhe në Europë, ishte jo rileximi sistematik apo rivlerësimi i korpusit të veprave të Weberit, por huazimi i një versioni të standadizuar të sociologjisë weberiane, i cili, ndoshta, e ka reduktuar disi mendimin e tij sociologjik tejet të pasur përmes një vargu tezash standarde. Loewenstein (1966) thekson se mbetet të sqarohet më tej nga studiuesit e veprës së tij nëse Weberi, i kanonizuar nga amerikanët, mund të interpretohet sot në një mënyrë të ndryshme dhe në nuanca të tjera. Kjo është, në fakt, një detyrë e vazhdueshme e historisë së mendimit intelektual.

Weberi në kontekst historik

Lawrence Scaff shtron pyetjen nëse Weberi duhet parë dhe vlerësuar si një mendimtar social i ngjashëm me bashkëkohësit e tij gjermanë dhe amerikanë, apo ai, përkundrazi, i përket një grupi mendimtarësh të tillë si, Tuqididi, Platoni, Aristoteli, Makiaveli, Kanti, Hegeli, Niçja dhe figura të ngjashme me ta? (Scaff 2011: 249). Ka autorë, të cilët mendojnë se, për shkak të gjerësisë dhe thellësisë së mendimit të tij intelektual, Weberi u ngjan më shumë këtyre të fundit. Reinhard Bendix, nga ana e tij, shkruan:

Në kohën tonë të specializimit shkencor [Weberi] ngjan me një dijetar të Rilindjes, që e sheh tërë njerëzimin si providencën e tij. Mendoni një çast për spektrin e gjerë të interesave dhe të aftësive të tij. Ai studioi për drejtësi dhe ekonomi; u bë ekspert në interpretimin e doktrinave religjioze dhe ishte një studiues i shquar i Biblës; ai i njihte shumë mirë mënyrat e vëzhgimit të tokave në Romën e Lashtë, kompanitë tregëtare mesjetare dhe tregun modern të shkëmbimit; ai u bë ekspert i historisë krahasuese të institucionave urbane; ai studioi në detaje problemet e marrëdhënieve të punës në bujqësinë e Gjermanisë Lindore; ai zhvilloi një perspektivë sistematike për interpretimin e qytetërimit të lashtë mesdhetar; ai kreu një studim të veçantë mbi origjinën mesjetare të muzikës Perëndimore dhe analizoi në detaje kushtet sociale dhe psikologjike të rendimentit të punës në industrinë tekstile të Gjermanisë Perëndimore. Në të gjitha këto, ai kishte avantazhin e një arsimimi klasik gjerman; ai njihte shumë mirë shtatë ose tetë gjuhë, të cilave u shtoi edhe rusishten në kohën e Revolucionit Rus të vitit 1905 (Bendix: [1960] 1977: 469).

Pavarësisht interesave të gjera dhe aftësive të tij të jashtëzakonshme, sociologjia weberiane ishte produkt intelektual i kohës së tij, njëlloj si edhe mendimi marksist, ai i Simmelit, i Frojdit, i Parsonsit etj. Weberi jetoi si periudhën e optimizmit Viktorian të shekullit të 19-të (e cila, për Gjermaninë, nga viti 1870 deri më 1914, u karakterizua nga disa dekada të tëra prosperiteti të përgjithshëm), ashtu edhe fundin dramatik të saj me barbarizmin e *paprecedent të Luftës së Parë Botërore, e cila, sipas Weberit, ishte rezultat i rivaliteteve ekonomike dhe politike mes fuqive të mëdha të kohës* (shih Gerth & Mills [1946] 1958: 39-40). Madje, siç thotë Parsons, “kulmi i pjekurisë intelektuale të Weberit koïncidoi me shpërthimin e krizës më të madhe të rendit social dhe politik të botës Perëndimore” në shekullin e 20-të, krizë që preku jo vetëm Perëndimin, por edhe “marrëdhëniet e tij me pjesën tjetër të botës” dhe që nisi me Luftën e Parë Botërore, më 1914 (Parsons 1971a: 28). *Këto eksperiencë bënë që Weberi t'i trajtonte me shumë ambivalencë dhe skepticizëm proceset globale të kohës së tij—ndërveprimin midis barazisë, modernitetit dhe demokracisë—duke krijuar një “vizion pesimist mbi botën”* (Aron 1971: 92), si edhe duke theksuar, me një sens fatalizmi dhe frike apokaliptike, atë çka ai e quajti *stahlhartes Gehäuse* (“iron cage”) të burokracisë dhe *pakuptimësinë inherente të modernitetit* (Langenbacher 2005: 31). *Ndonëse në fillimet e krijimtarisë së tij Weberi u nis nga pozitat e Kantit dhe të neokantianëve për të dalluar atë çka është nga ajo çka duhet të jetë, pra faktet nga vlerat, botëkuptimi i tij, në të cilin gjejmë të integruar edhe konceptin e tij mbi Macht politik (politikë e pushtetit), ishte, më në fund, një botëkuptim “darwinian-niçean”* (Aron 1971: 94, 99; Warren 1988). *Siç shkruante Karl Jaspers për të:*

Weberi ishte një ekzistencialist tipik, i cili, i deziluzionuar me zhvillimet e kohës së tij, u detyrua që të pajtohej me fragmentarizimin dhe pakuptimshmërinë ekstreme të botës moderne (cituar në Jones 1989: 89).

Edhe pse Weberi ka qenë dhe mbetet një figurë polarizuese në debatin akademik përse i përket qëllimit dhe pasojave që ka studimi empirik dhe dija mbi shoqërinë, si për politikën, ashtu edhe për vetë shoqërinë, ai mori dhe ruajti deri në fund një pozicion të tijin të dallueshëm, çka shpjegon përse Jaspers e zgjodhi atë si figurën heroike të filozofisë së tij ekzistencialiste. Roth vë në dukje se “ky qëndrim ekzistencialist stoik duket se u qëndron rezultateve të tij në fushën akademike, njëlloj ashtu sikurse shpirti Prometeian dhe mesianik i Marksit u ka qëndruar arritjeve të tij shkencore” (1977: xiv).

Bibliografia

- Aron, Raymond. 1971. "Max Weber and Power-Politics", ff. 83-100 në Otto Stammer (ed.), *Max Weber and Sociology Today*. New York: Harper & Row Publishers.
- Bendix, Reinhard. 1949. *Higher Civil Servants in American Society*. Boulder, CO: University of Colorado Press.
- Bendix, Reinhard & Seymour Martin Lipset (eds.). [1953] 1966. *Status, Class, and Power: Social Stratification in Comparative Perspective*. Second Edition. New York: The Free Press.
- Bendix, Reinhard. [1960] 1977. *Max Weber: An Intellectual Portrait*. With an Introduction to the New Edition by Guenther Roth. Berkeley, CA: University of California Press.
- Bendix, Reinhard. 1965. "Max Weber's Sociology Today", *International Social Science Journal* XVII, 1: 9-22.
- Bendix, Reinhard. 1970a. "Sociology and the Distrust of Reason", *American Sociological Review* 35, 5: 831-843.
- Bendix, Reinhard. 1970b. *Embattled Reason: Essays on Social Knowledge*. New York: Oxford University Press.
- Brann, H. W. 1944. "Max Weber and the United States", *Southwestern Social Science Quarterly* (June): 18-30.
- Calhoun, Craig. 2007. "Sociology in America: An Introduction", ff. 1-38 në Craig Calhoun (ed.), *Sociology in America: A History*. Chicago, IL: The University of Chicago Press.
- Calhoun, Craig, Joseph Gerteis, James Moody, Steven Pfaff & Indermohan Virk (eds.). 2007. *Contemporary Sociological Theory*. Oxford: Blackwell Publishing.
- Du Bois, W. E. Burghardt. 1898. *The Philadelphia Negro*. Philadelphia, PA: University of Pennsylvania Press.
- Du Bois, W. E. Burghardt. 1903. *The Souls of Black Folk*. New York: Bantam Classic.
- Faught, Jim. 2007. "Interest, Values, and Democracy: Tocqueville and Weber", *Journal of Classical Sociology* 7, 1: 55-81.
- Freund, Julian. 1968. *The Sociology of Max Weber*. New York: Pantheon.
- Gerth H. H. [1963] 1982. "The Reception of Max Weber's Work in American Sociology", ff. 208-217 në Joseph Bensman, Arthur J. Vidich & Nobuko Gerth (eds.), *Politics, Character and Culture: Perspectives from Hans Gerth*. Westport, CT: Greenwood Press.
- Gerth, H. H. & C. Wright Mills. [1946] 1958. "Introduction: The Man and His Work", ff. 3-74 në Gerth, H. H. & C. Wright Mills (eds.), *From Marx Weber: Essays in Sociology*. New York: Oxford University Press.
- Giddens, Anthony. 1971. *Capitalism and Modern Social Theory*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Giddens, Anthony. 1972. *Politics and Sociology in the Thought of Max Weber*. London: Macmillan.
- Habermas, Jürgen. 1971. [Koment on Talcott Parsons], ff. 59-71 në Otto Stammer (ed.), *Max Weber and Sociology Today*. New York: Harper & Row Publishers.
- Holmes, John Haynes. 1947. "Henry George and Karl Marx: A Plutarchian Experiment", *The American Journal of Economics and Sociology* 6, 2: 159-167.
- Honigsheim, Paul. 1968. *On Max Weber*. New York: Free Press.
- James, William. 1902. *The Varieties of Religious Experience: A Study in Human Nature*. London & Bombay: Longmans, Green, and Co.
- Jones, Larry Eugene. 1989. "In the Twilight of the Liberal Era: Max Weber and the Crisis of German Liberalism, 1914-20", *Central European History* 22, 1: 89-102.
- Kalberg, Stephen. 1997. "Tocqueville and Weber on the Sociological Origins of Citizenship: The Political Culture of American Democracy", *Citizenship Studies* 1: 199-222.
- Kalberg, Stephen. 2009. "Max Weber's Analysis of the Unique American Civic Sphere: Its Origins, Expansion, and Oscillations", *Journal of Classical Sociology* 9, 1: 117-141.
- Kessel, J. H. J. van. 2007. "Benjamin Franklin: The Personification of Max Weber's 'Spirit of Capitalism'", ff. 159-169 në *Philosophical Age*, vol. 31. St. Petersburg: St. Petersburg Center for History of Ideas.
- Langenbacher, Erik. 2005. "Disenchanted Liberals: Alexis de Tocqueville and Max Weber", ff. 25-45 në Patrick Hayden & Tom Lansford (eds.), *Politics and Ethics in Review*. New York: Nova Science Publishers.
- Lantz, Herman R. 1984. "Continuities and Discontinuities in American Sociology", *Sociological Quarterly* 25, 4: 581-596.
- Loewenstein, Karl. 1966. *Max Weber's Political Ideas in the Perspective of Our Time*. Boston, MA: University of Massachusetts Press.
- Offe, Claus. 2005. *Reflections on America: Tocqueville, Weber and Adorno in the United States*. Cambridge: Polity Press.
- Parsons, Talcott. 1971a. "Value-Freedom and Objectivity", ff. 27-50 në Otto Stammer (ed.), *Max Weber and Sociology Today*. New York: Harper & Row Publishers.
- Parsons, Talcott. 1971b. [Koment], ff. 78-82 në Otto Stammer (ed.), *Max Weber and Sociology Today*. New York: Harper & Row Publishers.
- Roth, Guenther. 1977. "Introduction to the New Edition", ff. xiii-xxxvii në Reinhard Bendix, *Max Weber: An Intellectual Portrait*. Berkeley, CA: University of California Press.
- Roth, Guenther & Reinhard Bendix. 1959. "Max Webers Einfluss auf die amerikanische Soziologie", *Kölner Zeitschrift für Soziologie* XI: 38-53.

- Roth, Guenther & Claus Wittich (eds.). 1968. *Max Weber, Economy and Society*, 3 vols. New York: Bedminster.
- Scaff, Lawrence A. 2011. *Max Weber in America*. Princeton, NJ: Princeton University Press.
- Seidman, Steven. 2008. *Contested Knowledge: Social Theory Today*. 4th ed. Oxford: Blackwell Publishing.
- Stammer, Otto (ed.). 1971. *Max Weber and Sociology Today*. New York: Harper & Row Publishers.
- Stern, Fritz. 1961. *The Politics of Cultural Despair: A Study in the Rise of the Germanic Ideology*. Berkeley, CA: University of California Press.
- Svedberg, Richard. 2007. "Tocqueville and the Spirit of American Capitalism", ff. 42-70 në Victor Nee & Richard Svedberg (eds.), *On Capitalism*. Stanford, CA: Stanford University Press.
- Tarifa, Fatos. 2008. *Ftesë në sociologji: Imagjinata sociologjike dhe jeta e përditshme*. Tiranë: Ombra GVG.
- Tenbruck, Friedrich. 1975. "Dan Werk Max Weber", *Kölner Zeitschrift für Soziologie* XXVII: 663-702.
- Tocqueville, Alexis de. [1835-40] 2004. *Democracy in America*. Trans. Arthur Goldhammar. New York: Library of America.
- Tocqueville, Alexis de. [1856] 1955. *The Old Regime and the French Revolution*. New York: Anchor Books.
- Warren, Mark. 1988. "Max Weber's Liberalism for a Nietzschean World", *American Political Science Review* 82, 1.
- Weber, Marianne. [1924] 1988. *Max Weber: A Biography*. With a new introduction by Guenther Roth. Translated and edited by Harry Zohn. Transaction Publishers.
- Weber, Max. [1904-05] 1958. *The Protestant Ethic and the Spirit of Capitalism*. Trans. Talcott Parsons. New York: Scribner's.
- Weber, Max. [1910] 1972. "Max Weber's Proposal for the Sociological Study of Voluntary Organizations", *Journal of Voluntary Action Research* 1: 20-23.
- Weber, Max. [1920] 1946. "The Protestant Sects and the Spirit of Capitalism", ff. 302-322 në Hans H. Gerth and C. Wright Mills (eds.), *From Max Weber*. New York: Oxford University Press.

Ekologjia humane dhe ndihmesa e Shkollës së Çikagos në zhvillimin e Antropologjisë Sociale

Prof. Asoc. Dr. Aleksandër DHIMA¹

Abstrakt: Në këtë trajtesë, autori është ndalur në disa aspekte social-antropologjike të ekologjisë humane: komunikimin mjedisor, efektet e masmedies mbi grupet e ndryshme kulturore dhe në disa modele/teori të kësaj shkolle me impakt të drejtpërdrejtë mbi jetën sociale të komunitetit. Sipas autorit, shkolla e Çikagos ndërtoi një korpus dijesh që mund të konsiderohet si një reagim i ri metodologjik rreth dukurive të karakterit kulturor, etno-psikologjik dhe social të kohës. Me përfaqshjen e saj ndaj nënkulturave, ajo dha një mesazh të qartë shoqëror: mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët, në mënyrë që ata të marrin pjesë aktive në vendosjen e kushteve të përbashkëta jetësore.

Hyrje

Ekolgjia humane interesohet për ndërveprimin midis individëve në një bashkësi urbane, ose të urbanizuar. Ajo studion evolucionin e sistemeve ekologjike nëpërmjet bashkëlidhjes së organizimit social, kulturës së popullsisë që lëvizin dhe mjedisit ku ato jetojnë *ex novo*, pra proceset e njëkohshme të natyrave të ndryshme (mjedisore, biotike, komunikuese) në kohë dhe në hapësirë (Orlove 1980: 235; Alberti 2008). *Ekologjia humane* synon të formulojë, të sintetizojë dhe të zbatojë "mbushjen e boshllëkut shumëdimensional" midis njeriut dhe natyrës, ajo pranon kompleksitetin në

¹ Titullar i lëndës "Antropologji e Komunikimit" dhe lektor në lëndët e Antropologjisë social-kulturore në UET. Është bursist i Fondacionit "Alexander von Humboldt", autor i disa monografive dhe teksteve mësimore (pas)universitare.

vend të reduksionizmit dhe i shtrin konceptet ekologjike përtej formacioneve shtetërore të stabilizuara (Borden & Jacobs 1989; Gläser 1989; Wright et al. 1993). Është kjo arsyeja madhore pse antropologët socialë janë përfshirë prej kohësh në një bashkëpunim efikas me kolegët e tyre sociologë, ekologjistë si dhe me studiuesit e urbanizimit, për ndërtimin e një teorie të “mirëkuptimit njerëzor në rrafsh komunitar, rajonal dhe global, në harmoni me mjedisin natyror dhe social” (Young 1974: 103).

Rezultatet më të spikatura të këtij drejtimi kërkimor-shkencor pasqyrohen në revistën *Human Ecological Review*, organ zyrtar i Shoqatës me të njëjtin emër, themeluar më 1979-ën në Washigton (Borden 2008: 95). Zbatimin e parë formal në studime të karakterit shoqëror, kjo teori e gjeti në veprën e Robert Parkut dhe Bërdenit *Hyrje në Shkencën e Shoqërisë* (Park & Burden 1921: 161). Prej asaj kohe, *ekologjia humane* u përfshi gjerësisht në interesat shkencore të *shkollës së Çikagos*. Qysh më 1893-in, Adamsi ngriti (për herë të parë) pyetjen: “A e di populli amerikan se ku po shkon? Çikago ishte shprehja e parë e mendimit amerikan përbashkues, sepse çdokush duhet të fillojë të mendojë për vlerat komunitare” (Adams, 1931: 343).

Konceptet e shkollës së Çikagos mbi realitetin shoqëror

Shkolla e Çikagos përbën një qendër të integruar ku është përpunuar një informacion i jashtëzakonshëm nga fushat e sociologjisë, psikologjisë, antropologjisë, filozofisë urbanistikës etj. Në përfytyrimin e sociologëve, qyteti i Çikagos është njohur tradicionalisht si një lloj “laboratori njerëzor”, për shkak se ka qenë qendra e ndryshimeve industriale rrënjësore, e një imigrimi me shpejtësi të pakrahasueshme dhe e një urbanizimi intensiv në rrafsh federal (Depew & Peters 2001: 3). Ai ka pasur, ndoshta, fluksin më të madh të njerëzve që vinin nga shtete të ndryshme për të ndërtuar një jetë më të mirë; pra ishte një qytet, i cili për nga ndryshimet demografike në fillim të shekullit të 20-të, nuk ka pasur të ngjashëm. Ndaj thuhet se lindja e një qendre studimore të këtyre përmasave nuk është e rastësishme. Grupet e ndryshme “racore” dhe kulturore, që popullonin këtë qytet tipik amerikan për kohën, u ndodhën përballë një procesi të shpejtë transformues të burimeve natyrore, teknologjisë, marrëdhënieve shoqërore si dhe të masmedies që u bë aq e larmishme dhe e fuqishme si askund në Botën e Re.

Mendimtarët e hershëm të kësaj shkollë e vendosnin shoqërinë amerikane në majë të ndryshimit social pozitiv, për shkak të “demokracisë së pastër” që ishte arritur asokohe në SHBA. Midi, për shembull, argumentonte se:

Për të ekzistuar një shoqëri ideale duhet të zhvillohet një formë komunikimi e tillë që t’i lejojë individit të vlerësojë veprimet, qëndrimet, pikëpamjet dhe pozicionet shoqërore të të tjerëve, të cilat mund të jenë të ndryshme nga të

vetat, gjithashtu ta bëjë individin të pranueshëm dhe të kuptueshëm nga të tjerët, sepse vetëm kështu ai do të përparonte drejt një “ideali” të shoqërisë njerëzore (Mead 1934: 317).

Por, ndërsa Midi e sheh këtë lloj shoqërie si “ideale”, Djui e quante atë pak më parë “komunitet të madh” dhe më tej mbronte supozimin se njerëzit janë mjaftueshmërisht inteligjentë për vetëqeverisje dhe se njohuritë e tyre në këtë drejtim shkojnë “në funksion të asociimit dhe komunikimit” (Dewey 1927: 143).

Një ndihmesë interesante në formësimin fillestar të koncepteve të *shkollës së Çikagos* kanë sjellë konsideratat mbi *rolin social* të komunikimit dhe vijëzimin e një historie “natyrore” të shtypit, ku trajtohen tema që kanë të bëjnë me tërheqjen mbas terrenit më tepër sesa mbas konceptualizimit. “Biologjizmi” i Parkut lidhet me idenë se “qyteti duhet parë si një problem organizimi territorial, që prek popullata të ndryshme, shpesh emigrante, në rrethana konkurrence, përshtatjeje dhe asimilimi” (Maigret 2010: 55-56). Autori ndalet, gjithashtu, në formimin efektiv të publikut për të kuptuar se çfarë bëjnë njerëzit me informacionin: emigrantët i lexojnë botimet në anglisht, edhe pse nuk i kuptojnë shumë mirë, sepse duan të “hapen” ndaj shoqërisë “pritëse”. Komunikimi, sipas tij, është një hapësirë publike ku ushtrohet konflikti: emigrantët do të preferonin ta lexonin shtypin në gjuhën e tyre amtare (gjë që, sidoqoftë, nuk do të përbente rastësi në kushtet e një komuniteti heterogjen, si ai i Çikagos), por nuk e bëjnë këtë, sepse shpresojnë që bashkëjetesa dhe ndërveprimi komunikues midis njerëzve me prejardhje të ndryshme mund të prodhojë, me kalimin e kohës, një përvojë të përbashkët.

Duke përditësuar dhe shtrirë modelet e mëparshme teorike, *shkolla e Çikagos* ndihmoi në konceptimin e përshtatshëm të “medies së re” dhe mënyrave se si duhet të zhvillohen më tej teknologjitë mediatike nëpërmjet funksionalitetit të “medies së vjetër”, p.sh. si duhet të transformohet një objekt, ose një teknologji për t’i shpëtuar daljes nga përdorimi. Kjo *shkollë* u interesua veçanërisht për mediet, sepse ato mund të shkaktojnë një alterim (ndryshim) të shpejtë dhe potencial mbi trupin njerëzor dhe rolin e tij në disa drejtime: si subjekt për mediatizim; si entitet që kërkon vazhdimisht “të shtrijë njohuritë e tij për jetën dhe realitetin shoqëror”, siç do të shprehej Mekluhani (McLuhan, 1962), ose si një entitet që rikodohet, si në teoritë e kibernetikës dhe të teknologjisë të tipit “pse digjitalet janë kompjuter”. Pse trupi njerëzor mund të veprojë si një formë ndërmjetësimi me medien? Kjo pyetje ka të bëjë, në radhë të parë, me medien teknologjike dhe lidhet me disa forma të pakapshme ndërhyrjesh, si në rastin e piraterisë në kodet e përcjelljes. Përqasjet teorike të kësaj *shkollë* mund t’i japin nxitje zhvillimit të mëtejshëm të medieve dhe të përligjin *diversitetin mediatik*, madje mund ta përforcojnë atë, sepse media- sipas përfaqësuesve të saj- përbën një formë të fuqishme të vjeljes së informacionit.

Teoria konstruktiviste

Kjo teori mbështetet në idenë e Miçellit për të eksploruar konceptin e medias në terma shumë të gjera, duke hulumtuar jo vetëm median “teknike” moderne dhe masmedian, por edhe një sërë praktikash institucionale dhe sidomos *habitat*-in, në kuadër të të cilit “marrin jetë” dhe përhapen imazhet mediatike (Mitchell, 1988; 1994; 2004). Për të realizuar këtë qëllim duhet të përdoren sa më shumë indikatorë nga media e vjetër dhe moderne, duke përfshirë shkrimin, skulpturën dhe vizatimin, ashtu sikurse televizionin dhe realitetin virtual, për të vendosur kështu lidhje midis këtyre fushave që lejojnë një avitje krahasuese në studimin e medias dhe historisë së saj.

Në qendër të hulumtimit të kësaj teorie vendoset *gjuha* si mjet për ndryshimin/transformimin e ideve për përdorim materialist dhe për komunikim social. Konceptet dhe termat e përdorura shërbejnë kështu si urë lidhëse midis dy anëve të medias: teknikës materiale dhe praktikës sociale. Përmes gjuhës, komunitetet përputhen, ose jo në mendime apo opinione mbi tema të ndryshme të trajtuara nga media. Sipas kësaj teorie ekziston një realitet paralel në medie, i cili është më shumë një “realitet i konstruktuar”. *Shkolla e Çikagos* ndriçon kështu një anë tjetër të funksionit të medias, *funksinin konstruktues* (ndërtues): media krijon, ndërton, po kaq sa edhe pasqyron realitete.

Në botën shkencore gjermanishtfolëse, kjo teori trajtohet më tepër në rrafshin filozofik-mediatik, sepse “realiteti i konstruktuar i medias” mund të realizohet nëpërmjet një procesi njohës të *konstruktit* nga kahja ontologjike në atë empirike. Kjo prirje përbën kështu një ndihmesë për versionin e ri të diskursit aktual në filozofinë perëndimore. Agjentët që gjenerojnë “realitete” e gjejnë përligjen e veprimit të tyre në rrymat e ndryshme të *konstruktivizmit*: sistemi konjitiv i “vëzhguesit” të realitetit vihet në bashkëlidhje me *bioepistemologjinë konstruktiviste* (Maturana & Varela 1972); komunikimi i sistemit social qëndron në bazë të teorisë së *sistemit vetëprodhues* (Luhmann 1988; 1989; 1995; Fuchs 2007); sistemet e masmedias janë objekt i *konstruktivizmit medio-kulturor* (Merten 1995; Rusch 1999; 7); veprimtaria e trurit lidhet me *konstruktivizmin cerebral* (Roth 1996); kultura i drejtohet kësaj teorie përmes *kulturalizmit konstruktivist* (Janich 1999) dhe, së fundi- si shumë kumulative e të gjitha formave të mësipërme- vjen në konsideratë *konstruktivizmi social-kulturor* (Schmidt 2000). Roth shprehet se “... *truri është nëna e çdo ndërtimi të realitetit, madje edhe imagjinata dhe reflektimi mbi [vetë]ndërgjegjen janë prodhim i trurit si etiketues neutral* (Roth 1996: 44).

Siç duket, studiuesit e sipërpërmendur përqendrohen në *komunikimin parësor*, duke e vështruar kulturën dhe median si agjentë që gjenerojnë realitete konkrete, ndërkohë që vetëm rryma e *konstruktivizmit të përparuar*, në variantin e propozuar prej Shmidit, synon t'i trajtojë të gjithë agjentët njëloj, si në një “qark të mbyllur”. Shumica e këtyre varianteve moderne të *konstruktivizmit* mund të vështrohen si të kundërta (antipode) me *realizmin*, i cili po mbizotëron tash së fundi në punimet shkencore mediatike.

Pyetjet që ngrihen mbi raportin e *realizmit* me *konstruktivizmin* janë: a është realiteti “zbulim”, apo “shpikje”? A pasqyron media (saktësisht apo në mënyrë të tjetërsuar) realitetin? A është bota një *projektim*, apo *dizajn*? A përfaqësojmë ne njerëzit një *faktor*, apo jemi vetë konstruktë? Ne e përshkruajmë, apo e ndërtojmë vetë realitetin? Shumica e konstruktivistëve propozon që natyra konstruktive e realitetit tonë dhe bota që na rrethon është një *conditio sine qua non* për njohjen; me fjalë të tjera, njeriu s'mund ta ndërtojë vetë realitetin, sepse ai është dhënë “një herë e përgjithmonë”, ne s'mund të vendosim *për*, apo *kundër* një konstrukti të ri si parakusht dhe mënyrë për njohje të mëtejshme.

Studiuesit e gazetarisë kanë, përkundrazi, një vizion tjetër, atë *realist*. Gërke, i cili është i orientuar në “teorinë e sistemeve”, në artikullin “Mbi realitetin e masmedias” shkruan:

Çështja rreth sistemit funksional të masmedias mbështetet në faktin që si masmedia ashtu edhe gazetarja...ndërtojnë një realitet sui generis; në rrafshin teorik të sistemit, këtu shtrihet pyetja se si bëhet e mundur të realizohet kjo formë specifike e krijimit të rendit social dhe kjo do të thotë që sistemi i masmedias dallohet në vetvete nga sistemet e tjera më të afërta (Görke 2001: 55).

Një shembull tjetër mbi rolin e aktorëve pjesëmarrës në ndërtimin e këtij realiteti na vjen nga Shmidi:

Aktorët janë subjekte në ndërtimin e realitetit, por ata s'janë subjektivë, në kuptimin arbitrar, të qëllimshëm apo relativist të fjalës; kjo ndodh sepse individët janë gjithmonë më të vonshmit. Çdo gjë që bëhet e ndërgjegjshme lidhet së pari me aktivitetin ndërgjegjësues të pakapshëm të neuroneve...E gjitha kjo presupozon diskurse të rregulluara shoqërisht dhe të programuara kulturalisht brenda sistemit social. Në këtë kuptim, janë pikërisht këto procese ato që organizojnë dhe drejtojnë ndërtimin e realitetit (Schmidt 2000: 47).

Kohët e fundit, diskutimet rreth “ndërtimit të realitetit” po përfshijnë- përveç arteve dhe shkencave sociale e kulturore- edhe disiplina të tilla si matematikën, biologjinë, fizikën dhe arkitekturën.

Teoria e mediumit

Teoria e mediumit veçohet nga teoritë e tjera të medias për nga hulumtimi që ajo u bën ndikimeve të teknologjive të komunikimit në varësi të përmbajtjes specifike të mesazheve që ato përcjellin. Ky emërtim lidhet me një sërë drejtimesh

metodologjike, të cilat shërbejnë për të kuptuar se si ndikojnë mjetet e shprehjes mbi domethënien e komunikimit njerëzor.

Mekluhani sfidoi përcaktimet konvencionale të deriatëhershme kur deklaronte se “mediumi është mesazhi” dhe me këtë ai kuptonte se sa shumë dallohen kanalet e informimit, jo vetëm nga përmbajtja, por edhe nga mënyrat se si ato i përcjellin mendimet dhe kuptimet. Ai e dallon median në bazë të proceseve konjitive të rastit dhe popullarizoi idenë, sipas së cilës kanalet mediatike janë një forcë zotëruese që ndikon dukshëm në shoqëri dhe në kulturën përkatëse. Në këtë kuptim, procese të tilla meritojnë të quhen *ekologji të medias*. Autori besonte se ne mund të hulumtojmë jo vetëm median në vetvete, por edhe “mënyrat, me anë të të cilave një medium i ri shpërthen traditën dhe ridimensionon jetën sociale”. Mekluhani mendonte gjithashtu se “impakti social i medias do të shkaktonte një shtrirje të ndjeshmërive tona dhe do të ndryshonte botën tonë sociale” (McLuhan [1964] 2008: 59). Pak më parë, në librin *Galaktika e Gutenbergut*, ai argumentonte se kur hynë teknologjitë e reja të medias në jetën shoqërore, balanca e ndjesive tona u “riformatua”, duke nxjerrë në pah disa në kurriz të të tjerave. Kështu p.sh., printeri përforcoi vizualitetin (dukjen), duke e ndarë atë më tej nga shqisat e tjera, në veçanti nga tingulli dhe nga zhurma e shtypit të shkruar. Ai shkon edhe më tej kur argumenton se:

“Media e shkruar ndihmoi në krijimin e një mjedisi ndjenjash, tipik për shoqëritë kapitaliste perëndimore- një mjedis ky që ishte burokratik dhe i organizuar drejt një prodhimi masiv, mbi bazën e ideologjisë individualiste dhe një angazhimi drejt kombit-shtet, si njësi sociale fundamentale” (McLuhan 1962: 15).

Kjo teori përqendrohet më tepër në tiparet e *mediumit* sesa në përcjelljen, ose marrjen e informacionit. Sipas saj, një *medium* nuk është thjesht një gazetë, sit interneti, kamera digjitale etj; ai është më tepër një *mjedis simbolik i çdo akti komunikues*. Media, pavarësisht se çfarë përmbajtje transmeton, ndikon tek individët dhe në shoqërinë përkatëse. Teza e Mekluhanit mbështetet në faktin që njerëzit i përshtaten mjedisit të tyre përmes një farë balance, ose përpjesëtimi ndjeshmërie dhe që mediumi i moshës përkatëse tregon një klasë të veçantë perceptimi afektues. Teoricienë të tjerë të këtij drejtimi argumentojnë se mediet nuk janë thjesht kanale për transmetimin e informacionit midis dy apo më shumë mjedisesh, por janë në vetvete rrjete të dallueshme social-psikologjike që inkurajojnë tipa të caktuar ndërveprimi, ndërkohë që nuk nxisin disa të tjerë. Me një fjalë, kjo teori synon të përcaktojë se si krahasohen dhe kontrastojnë mjetet e ndryshme të komunikimit (TV nga radio, libri nga revistat dhe gazetatat etj) *vis-à-vis* ndërveprimet përmes një mediumi të veçantë.

Teoria e mediumit përbën një teori analitike me modele empirike. Disa nga metodat e saj mbështeten në analizën e tipareve të medias dhe në analizën historike të perceptimit njerëzor. Ajo hulumton variablet fizike, psikologjike dhe sociale në këndvështrimin se si janë të prirura ato variable për të kapur mediumin, nëse komunikimi zhvillohet në një, ose në dy kahe, sa shpejt mund të përhapen mesazhet, nëse të mësuarit e kodimit, ose të çkodimit të tyre në medium është i vështirë apo i thjeshtë, sa njerëz mund ta “kapin” të njëjtin mesazh në të njëjtin moment etj. Variable të tilla ndikojnë në përdorimin e mediumit dhe në impaktin e tij social, politik dhe psikologjik.

Në të kundërt me teoritë e tjera të medias, kjo teori nënvizon faktin që çdo formë mediatike shprehet në një medium të dhënë, por nuk pretendon që ky medium duhet të jetë patjetër i natyrës letrare apo gjuhësore. Ajo ka koherencë dhe forcë shpjeguese dhe mbështetet sidomos në parime strukturaliste. Prandaj thuhet që teoria e mediumit ka përparësinë e rivlerësimit të teorive të ashtuquajtura “të mëdha”, ashtu siç ndodh me *passtrukturalizmin*, duke hequr dorë nga shpjegime tërësore dhe duke u përqendruar në tiparet sinkronike të *të folurit* (jo të shkrimit) dhe të *gjuhës* (jo të fjalëve të veçanta). Pra, ne mund ta vështrojmë atë si një “kombinim të përjashtimit dhe negativitetit”. Në një farë mënyre, sipas fjalëve të Miçellit, ajo paraqet “paleontologjinë e së tashmes” në fushën e studimit të medias (Mitchell 2004: 227).

Në kohët e reja, teoria e mediumit zë një pozicion disi anësor, sidomos në studimet e komunikimit dhe medias të kontinentit amerikan (Croteau & Hoynes 2002), sepse këto studime i kushtojnë më tepër rëndësi mediumit të komunikimit dhe jo përmbajtjes së tij. Shembullin tipik na e jep Mejrovici, i cili e përdorte prej kohësh termin “teori e mediumit” për t’iu referuar pjesës së informacionit që përqendrohet në aspektet teknologjike të medias, përtej përmbajtjes së tyre (Meyrowitz 1994: 76-77).

Përfundime

Teoritë dhe modelet e mësipërme, përpunimi i të cilave përbën një nga arritjet më të mëdha të *shkollës së Çikagos*, përfshijnë një grup termash me sfond ndërdisiplinor që ndërldhin tre koncepte bazë: *median*, *mediumin* dhe *mediacionin*, me konotacione të ndryshme, valenca të mundshme dhe kuptime të shumëfishta. Si shembuj domethënës të mendimit ekologjik human në antropologji, ato janë të mjaftueshme për të kuptuar se sa e rëndësishme është problematika sociale që ka të bëjë me mjetet e komunikimit masiv, ose me komunikimin në përgjithësi. Me gjithë specifikat e shkollave të ndryshme amerikane të karakterit sociologjik, te *shkolla e Çikagos* artikullohet më mirë se kudo gjetiu parimi se “shoqëria është në thelb komunikim”.

Antropologjisë së komunikimit i interesojnë më shumë paradigmat, ose shtyllat mbi të cilat mbështetet kjo *shkollë*. Për mendimtarët e fushave përkatëse, ajo që ne quajmë “botë”, ose “realitet i jashtëm”, “hapësira ku jetojmë”, nuk është bota e objekteve, e cila shihet si diçka e ndryshme dhe “e huaj” në vetvete; në fakt, bota që njohim ne është një hapësirë e manipuluar, e “përthyer” nga subjektiviteti njerëzor. Njeriu është në marrëdhënie të qëllimshme me botën dhe i krijon këto marrëdhënie në bazë të projekteve që ka dhe vizioneve që kërkon të realizojë për të përmirësuar jetesën e tij. Nga ana tjetër, sipas konceptit të kësaj *shkolle*, bota është *plurale*, e ndarë pafundësisht në pjesë; në botë ka vetëm qenie të veçanta, përgjithësimi është iluzion njerëzor, është “fiksion” i mendjes. Pra, në thelb të shoqërisë nuk është grupi, familja, ose ndonjë formë tjetër organizimi, në thelb të saj është individi i cilësuar si njësi e pavarur.

Nga këto ide, ne marrim shkas për të nxjerrë një përfundim shumë të rëndësishëm: çdo njeri, në bazë të kulturës dhe kushteve të jetesës, krijon një vizion subjektiv për realitetin. Çdo njeri mbart një përfytyrim mbi botën, çka do të thotë se çdo qytet, grup apo familje është një gjendje mendore “më vete”, sepse ne njerëzit jetojmë në të njëjtën hapësirë fizike, por jemi qenie me realitete shpirtërore të ndryshme. Kjo është thelbësorja që “shqetësonte” autorët e *shkollës së Çikagos* kur ndërtoan atë korpus dijesh. Në këtë këndvështrim, kjo *shkollë* mund të shihet edhe si reagim ndaj dukurive të karakterit kulturor, etno-psikologjik dhe social të kohës. Me përqaqjen e saj jomoraliste ndaj nënkulturave, “sociologjia e Çikagos” dha një mesazh të qartë shoqëror e politik: *Mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët, në mënyrë që ata të marrin pjesë aktive në vendosjen e kushteve të përbashkëta jetësore.*

Një shembull kuptimplotë i zbatimit të principeve klasike të mendimit social të *shkollës së Çikagos* gjendet në veprën e L. Wirth *Urbanizmi si mënyrë jetese* (1938). Në të formësohet për herë të parë koncepti teorik i *modernes*, i cili ka të bëjë me mundësitë dhe format e integritimit shoqëror si dhe me pjesëmarrjen sociale në kushtet e një mënyre jetese të qëndrueshme urbane dhe heterogjene në shoqëritë e asaj kohe (Vortkamp 1998: 275). Në kontributet e tij të veçanta shkencore mbi Çikagon, ku ai jetoi dhe punoi për dhjetëra vjet, fokusi nuk i kushtohej qytetit në vetvete, por qytetit si “laborator kërkimor i së ardhmes”. Një kërkim empirik mbi baza teorike duhet patjetër- sipas fjalëve të tij- të drejtohet në vende që mund të shndërrohen vërtet në qendra sociale moderne, për një mënyrë jetese moderne. Në këtë kuadër, *heterogjeniteti social-kulturor* dhe *pluraliteti* i mjeteve të informimit do të ishin vendimtare, sepse nëpërmjet tyre do të sigurohej legjitimiteti i veprimeve social-kulturale dhe bashkëpunimi kolektiv i individëve që përbëjnë komunitetin, i cili do të çonte më tej në procese komunikuese të formës diskursive konsensuale.

Por, diversiteti mbetet, sidoqoftë, një nga shqetësimet kryesore për Uirthin, përderisa ai i drejton pyetjen vetes se si do të bashkëjetonin në të njëjtën hapësirë njerëz me realitete shpirtërore të ndryshme. Paralel me këtë problem, ai evidenton edhe një tjetër “pikë kritike” në fund të viteve 1940, kur u bë i pranishëm realiteti

i bombës bërthamore: duke qenë se midis njerëzve kishte hendeqe të mëdha kulturore, cila do të ishte garancia se rendi botëror nuk do të prishej në mungesë të një shtrati vlerash të përbashkëta që do të garantonin neutralizimin e rrezikut bërthamor? Uirth e përshkallëzon problemin e *diversitetit*, sepse e kalon atë në një dimension ndërshtetëror, pra nuk e kufizon thjesht brenda shtetit (Wirth 1946; 1947; 1948). Pra pyetja thelbësore që shtrun ai është: “Cili vektor do të lidhë dhe do të bashkojë këto vullnete të shpërndara nëpër botë, që do të integrojnë njerëzit në një botëkuptim të ngjashëm apo të përafërt lidhur me disa gjëra thelbësore që shqetësojnë gjininë njerëzore?” Dhe përgjigjja e tij është: “Nëpërmjet mjeteve të komunikimit masiv”. Sepse vetëm ato nuk njohin kufi; për nga vetë natyra, ato kanë mundësi të përshkojnë hapësira shumë të mëdha, të krijojnë kontakte midis një numri të pafund njerëzish.

Në përfundim, *shkolla e Çikagos* ngjan të jetë një aset i pazëvendësueshëm për kuptimet shoqërore, kulturore dhe politike të medias. Megjithëse kjo *shkollë* mund të ketë mbivlerësuar rëndësinë e komunikimit në formësimin e jetës sociale, ajo do të mbetet për shumë kohë një stacion i rëndësishëm për ata që kërkojnë të ndriçojnë më tej rrugën tonë si “kafshë simbolpërdoruese”, meqenëse ne njerëzit ia kemi dalë të komunikojmë si nga afër (në komunitet), ashtu edhe nga larg, duke përdorur një realitet virtual.

Bibliografi

- Adams, Henry (1931). *The Education of Henry Adams*. New York: Modern Library (originali: 1918).
- Alberti, Marina (2008). *Advances in Urban Ecology, Integrating Humans and Ecological processes in Urban Ecosystems*. Springer Verlag.
- Borden, Richard J. (2008). *Reflections on the Founding and First Twenty Five Years of the Society for Human Ecology*. In: “Human Ecology Review” vol. 15, No. 1: 95-108.
- Borden, Richard J. & J. Jacobs (1989). *International Directory of Human Ecologists*. Bar Harbor-ME: Society for Human Ecology.
- Chapin, F.S. et al. (2000). *Consequences of changing biodiversity*. In: “Nature” 405 (6783): 234-242.
- Croteau, David R. & William D. Hoynes 2002 (3rd ed). *Medial Society, Industries, Images and Audiences*. Newbury Park-CA: Pine Forge Press/ Sage Publ.
- Davis, Mike (2006). *Planet of Slums*. London: Verso.
- Depew, D.J. & J.D. Peters (2001). *Community and Communication, The Conceptual Background*. In: G.J. Shepherd & E.W. Rothenbuhler (eds.) “Communication and Community” Mahwah-NJ: Erlbaum Assoc.: 3-21.
- Dewey, John (1927). *Search for the Great Community, The Public and Its Problems*. New York: Henry Holt and Co: 143-184.

- Fuchs, Peter (2007). *Das Maß aller Dinge; Eine Abhandlung zur Metaphysik des Menschen*. Weilerswist: Velbrück Wissenschaft, 2007.
- Gläser, B. (1989). *Humanökologie*. Opladen: Westdeutscher Verlag.
- Görke, Alexander (2001). *Unterhaltung als Leistungssystem öffentlicher Kommunikation; ein systemtheoretischer Entwurf*. In: Siegfried J. Schmidt; Joachim Westerbarkey; Guido Zurstiege (eds) „A/effektive Kommunikation; Unterhaltung und Werbung“ Münster: Lit: 53-74.
- Janich, Peter (1999). *Wechselwirkungen; Zum Verhältnis von Kulturalismus, Phänomenologie und Methode*. Würzburg: Königshausen und Neumann.
- Jelinski, D.E. (2005). *Culture, ecology and conservation*. In: "Human Ecology" vol. 33, No. 2: 271-288.
- Luhmann, Niklas (1988). *Erkenntnis als Konstruktion*. Bern: Benteli; id. (1989). *Ecological Communication*. Cambridge-MA: Polity Press; id. (1995). *Gesellschaftsstruktur und Semantik; Studien zur Wissenssoziologie der modernen Gesellschaft*. Frankfurt am Main: Suhrkamp.
- Maigret, Éric (2010). *Sociologjia e komunikimit dhe e mediave*. Tiranë: Papirus: 73-122 (originali: *La sociologie de la communication et des médias*. Paris: Armand Colin, 2010).
- Maturana, Humberto R. & F.G. Varela (1972). *Autopoiesis; The organization of the living*. In: H.R. Maturana & F.G. Varela "Autopoiesis and Cognition" Dordrecht: Reidel.
- McDonnel, M.J. (1997). *A paradigm shift*. In: "Urban Ecology" vol. 1, No. 2: 85-86.
- McLuhan, Marshall (1962). *The Gutenberg Galaxy; The Making of Typographic Man*. Toronto: University of Toronto Press; London: Routledge and Kegan Paul; id. (1964). *Understanding Media; The Extensions of Men*. New York: McGraw-Hill; Cambridge-MA: MIT Press [1994]; Corte Madera-CA: Gingko Press [2003]; London: Routledge Classics [2004]; botimi shqip (2008): *Instrumentat e komunikimit; Media si një zgjatim i njeriut*. Tiranë: Instituti i Dialogut & Komunikimit.
- Mead, George Herbert (1934). *Obstacles and Promises in the Development of an Ideal Society*. In: "Mind, Self and Society" Chicago: University of Chicago Press: 317-328.
- Merten, K. (1995). *Konstruktivismus als Theorie für die Kommunikations-wissenschaft*. In: "Medien Journal" vol. 4: 3-20.
- Meyrowitz, Joshua (1994). *Medium Theory*. In: David Crowley & David Mitchell (eds) "Communication Theory Today" Stanford-CA: Stanford University Press: 50-77.
- Miller, J.R. et al. (2003). *Encyclopedia of Human Ecology*. Santa Barbara-CA: ABC-CLIO.
- Mitchell, William J. Thomas (1988). *The Language of Images*. Chicago: University of Chicago Press; id. (1994). *Picture Theory; Essays on Verbal and Visual Representation* Chicago: Chicago University Press; id. (2004). *Romanticism and the Life of Things; Fossils, Totems, and Images*. In: Bill Brown (ed) "Things" Chicago: University of Chicago Press: 227-244.
- Orlove, B.S. (1980). *Ecological Anthropology*. In: "Annual Review of Anthropology" vol. 9: 235-273.
- Ostrom, E. et al. (2002). *The Drama of the Commons*. Washington DC.: National Academy Press.
- Park, Robert E. & E.W.S. Burden (1921). *Introduction to the Science of Sociology*. Chicago: University of Chicago Press: 161-216.
- Pearce, T. (2010). *A great complication of circumstances*. In: "Journal of the History of Biology" vol. 43: 493-528.
- Roth, Gerhard (1996). *Schnittstelle Gehirn; Zwischen Geist und Welt*. Bern: Benteli.
- Rusch, Gebhard (1999). *Kommunikation der Wirklichkeit der Medien und der Kommunikation*. In: G. Rusch u. Siegfried J. Schmidt (eds) "Konstruktivismus in der Medien-und Kommunikationswissenschaft" Frankfurt am Main: Suhrkamp: 7-12.
- Schmidt, Siegfried J. (2000). *Kalte Fascination; Medien, Kultur, Wissenschaft in der Mediengesellschaft*. Weilerswist: Velbrück Wissenschaft.
- Turner, N.J.; M.B. Ignace; R. Ignace (2000). *Traditional ecological knowledge and wisdom of aboriginal peoples in British Columbia*. In: "Ecological Applications" vol. 10: 1275-1287.
- Vortkamp, Wolfgang (1998). *Partizipation und Gemeinschaft; Louis Wirths Soziologie der Moderne in der Tradition der Chicagoer Schule*. In: „Soziale Welt“ vol. 49, No. 3: 275-294.
- Wirth, Louis (1938). *Urbanism as a Way of Life*. In: "American Journal of Sociology" vol. 44: 1-24; id. (1946). *A Sociologist Looks at the Community*. In: Louis Wirth et al. (eds) "Community Planning for Peacetime Living" Stanford-CA: California University Press: 3-89; id. (1947). *Ideas and Ideals as Sources of Power in Modern Culture*. New York: Harper and Brothers: 499-508; id. (1948). *World Community, World Society and World Government*. In: Quincy Wright (ed) "The World Community" Chicago: Chicago University Press: 9-20.
- Wright, Scott D.; G.L. Young; M. Grace (eds) (1993). *Human Ecology; Crossing Boundaries*. Fort Collins-CO: Society for Human Ecology.
- Young, G.L. (1974). *Human ecology as an interdisciplinary concept; A critical inquiry*. In: "Advances in Ecological Research" vol. 8: 100-105.

ABSTRACTS _____

New but not that new parties: LSI and PDIU in government _____

Klejdi KËLLIÇI _____

Abstract

This article aims to analyse the political party system in Albania, focusing mainly in the role of 'new parties' in the performance of it. The paper will analyse the theoretical concept on 'new parties' and the environment in which they operate. Their presence shall be seen in the light of theoretical concepts like the ability to 'blackmail' the system or the coalition potential. The article will later on focus on two case studies like Socialist Movement for Integration (LSI) and Justice, Integration and Unity Party (PDIU) which entered in the government in 2009.

Structure and Organization of parties in post-communist Albania: A study of the Democratic Party of Albania _____

Anjeza XHAFERI _____

Abstract

This study is an attempt to analyze the factors that have contributed towards the success of the Democratic Party of Albania. It seeks to introduce new dimensions in measuring the success of a political party. The study rejects the elements of 'office-holding' and 'policy – or performance-based' measures of success, because they are determined by a complex array of economic, political,

social and institutional factors. The concept of "party success" is defined in terms of: 'breadth' and 'durability'. At the same time the study aims at 'emancipating' the political parties from the past and macro-institutional factors, to which very often are ascribed the reasons for the perceived failure of politics in Albania. The approach used in this study has regarded the political parties as the real political actors that as such should assume the responsibility for the perceived failures. Neither the lack of political culture, nor the communist system, are the main factors to shape the activity and development of political parties in Albania. Both macro-institutional and historical structural approach has limited explanatory power for the success of the Democratic Party. Its success is a direct consequence of the decisions that the political parties themselves, including Democratic Party as one of the key actors, have taken. The research showed that the Democratic Party of Albania has been successful because and when its elite have been able to craft inclusive ideological programs and because of its extensive penetration in the country, which it owes to its structure as a mass party. The party has established patronage linkages with its sympathizers, the rank and file and militants and consequently has ensured their loyalty and maintained an extensive electoral penetration in country.

The rapport between "political parties – public" under the influence of television _____

Roland LAMI _____

Abstract

Many researchers argue that in terms of information society, democracy undergoes a profound functional transformation. According to Habermas, Meyer and Hinchman, Lew and Merkel, democracy is not only transformed at the level of presentation and portrayal of politics, but the political process itself varies in every aspect. Its core is reformatted as a result of the interaction between the media code and the political one. Scholars suggest that political actors are subject to this process as a result of the expansion and commercialization of media systems. In this configuration of the public scene, media stand between politicians and their followers. Politicians speak in the media, whereas the media address to the voters. Such transformation provides for media a significant role, while politics and politicians are forced to increasingly

pay attention to the image and form rather than the content and reality. The whole transformation is called mediatization of politics. Albanian politics is nowadays part of this new era, where television is considered as a necessary medium in influencing the public. Precisely, the analysis of interaction “television - politics – public” is the main focus of this paper. Specifically, it aims to identify some possible implications that television causes to the politics and, more importantly, to the public. The entire process is analyzed from a theoretical perspective of some well-known authors in the field of sociology of communication.

Edi Rama, the case of a media-driven politician in Albania: The implications for political parties

Belina BUDINI

Abstract

Since the first years of the democratic transition and in the later period of consolidation, media and politics in Albania have faced dramatic challenges and transformations. The relation between the two raises many concerns for the course of post-communist transition. However, no special attention has been given to the role of the media in this area and few researchers have attempted to map out the degree of intrusion of media into the political domain under such conditions. By examining the case of Edi Rama, former Mayor of Tirana and actual Chairman of the Socialist Party as the first fully ‘media-crat’ who performs his style-politics through media in post-communist Albania, this paper endeavors to map out the role of the media regarding both the personalization and the ‘mediatization’ of politics in the special context of a young and developing democracy. Edi Rama represents one of the most significant examples in this regard. By and large, it indicates the growing intrusion of media into the political domain. Accordingly, this paper will argue that the media could significantly shape the course of Rama political rise and the consolidation of his stature in the Albanian political arena, with significant implications for political parties in the context of a new democracy. A former painter and artist, Rama used to be in fact the challenger

of power-holders and the ardent critic of political parties in Albania. He belonged to the group of intellectuals who, after the fall of communist dictatorship, came to define themselves against political parties and politicians. Such an anti-political project which was to some extent discursively construed in the media arena, was picked-up and developed more closely by Edi Rama, while would finally penetrate the political process as a pure political act. This paper provides a short literature review of media politics approaches, underlining the role of the media in shaping the course of political processes, especially in post-communist countries. Its focus is on the mediatization process of the profile of Edi Rama as a celebrity politician in the period between 1998 and 2008.

When considering such recent developments in new democracies, we endorse a critical position, suggesting that ‘unregulated media and political communication in newly democratizing contexts may actually be more disruptive than productive in the formation of stable institutions and patterns of citizen participation’ (Bennett, 1998). Critical scholars assert that democracy requires social networks and political filtering organizations (whether parties, unions, or other social institutions) to anchor and deliberate about the political communication received from suddenly distant and noisy channels.

Annual EU Progress Report in the Albanian press – A qualitative analysis

Odeta BARBULLUSHI

Abstract

EU annual Progress Reports are the casue of much media debate and political discussion. They can also serve as the battlefield or war weapon in the hands of Albanian politicians. The war is usually for the appropriation of the process of integration as well as for securing the monopoly over its meaning. This article builds on qualitative research, which focuses on the construction of social and political identities through the representation of the EU annual Progress Reports of October 2011 in Albanian daily press. Building on Critical Discourse Analysis, this article explores the way that press contributes to the formation and consolidation of party identities, as well as national identity vis-a-vis other markers such as ‘European’ or ‘Balkanic’.

Sultanism in Albania _____

Lulzim HOXHA _____

Abstract

For almost 2 decades after the collapse of the totalitarian regime, Albanian transition seems more infinite than ever. Time has shown that the coming of the so called “democratic system” was nothing but a failure. On these conditions the democratization – in the real sense of the term – of the country still today looks too far. Albanian totalitarianism is one of the most rare examples of world’s despotic systems, a fact that still influences the transition of this country. This work will analyze the past despotic rule, which will be treated as the major cause of the infinitude of country’s transition and the key features of which still dominates Albania’s process of democratization.

Financing of political parties by private donors: silent alliance? _____

Erjona CANAJ _____

Abstract

Political funding and, in particular, funding from private donors is still one of the topics less analyzed in the public debate and academic opinion in our country. Political parties needs many financial resources necessary to their operation. Above all, the balance between funders and people’s representatives or deputies of the party is increasingly under pressure due to the addiction that is created between beneficiaries (parties), and rewards required back by the donor (business/private donors). Donations given to help in the realization of the interests of the group that represents the party can create influence and impact in favor of narrow interests of the persons of the voluntary union.

In this paper will be analyzed the way political parties are funded in our country and the main problems that accompany this process, the Albanian legislation

on political parties and in particular the new law no. 10374 (2011) where has brought several innovations in this area. The legal framework is considered a successful approach but the section on financial and material funds of political parties remains one of its weak links because, despite frequent updates, it has not yet managed or established a deterrent to abuse resources of political parties benefit.

Protest as a Conservative Phenomenon _____

Klementin MILE _____

Abstract

One usually takes it for granted that protest is a means to bring changes in the society and, in this sense, all those who protest and demand these changes are positioned as progresists. In contemporary society progresists take on different names – Marxian, post-Marxian, environmentalists, libertarians, pacifists etc. Here the issue is not to put in doubt the existence of a better future in protesters’ imagination. However, when society has not yet developed certain positions from which it may criticise itself, protest contributes to nothing else but reproducing the society in the same parameters, since it does not change anything structurally. Protest will be analysed into three meaning dimensions: temporality, facticity, and sociality. This analysis will expose the difference between the societal structure and semantics of protest. This difference is manifested in the temporal dimension as outdated semantics, in the fact dimension as simplified semantics, and in the social dimension as monist semantics.

The interaction between political parties and civil society organizations in Albania _____

Gentian ELEZI _____

Abstract

The aim of this paper is to analyze and explain the interaction of Albanian political parties with another important elements of democracy such as civil society organizations. The study argues that civil society organizations have been used by political parties for increasing their legitimacy of their actions and performance, in the eyes of the electorate and the wider public. Civil society organizations, in specific moments, have provided political parties with candidates and have helped them in regenerating and 'cleaning' the political staff. In the medium term, this trend has brought a slow loss of image of civil society organizations and their study products and activities in the community. The study applies some main theoretical works to the Albanian case and it is also based on the events of last political elections of 2009.

Weber and the Weberian Tradition in American Sociology _____

Fatos TARIFA _____

Abstract

As one of the founders and most prominent representatives of classical sociological thought, Max Weber has been and continuous to be extraordinarily influential in contemporary social thought. This article elaborates on Weber's influence on the development of American sociology and—vice versa—America's impact in shaping Weberian sociological thought. Since

Weber has always been a polarizing figure in academic debate, both the content of his thought and his influence are examined here in three main periods: (1) the period after his work was introduced to the American public in the 1930s, (2) the post World War Two period, and (3) the one starting with the second half of the 1960s, which may be considered as the period when Weber was "de-americanized" and "returned" to Germany. Both content and influence of his thought are considered within historical and political contexts.

Human Ecology and the Contribution of the Chicago School to Social Anthropology _____

Aleksandër DHIMA _____

Abstract

In this study the author tries to analyse some social-antropological aspects of *human ecology* such as: environmental communication, impact of mass media on different cultural groups, and some models/theories that could affect the social community. According to the author, the *Chicago School* founders developed a body of knowledge that could be considered as a reaction to phenomena of cultural, ethnopsychological and social nature of the time. With its standing towards subcultures, the sociological approach of *Chicago School* provides a clear message that equal opportunities for all citizens are relevant for an active participation in the decision making process.

TITUJT E BOTUAR DHE NË PROCES TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE SOCIALE



TË BOTUAR

1. Arti i të folurit publik / Stephen Lucas
2. Bazat e komunikimit pamor / Bo Bergström
3. Dinamika e komunikimit masiv / Joseph Dominick
4. Hyrje në komunikimin ndërkulturor / Judith Martin, Thomas Nakayama
5. Hyrje në komunikimin politik / Brian Mcnair
6. Hyrje në shkencat politike / Jean-Marie Denquin
7. Komunikimi organizativ. Qasje dhe prirje / Michael Papa, Tom Daniels, Barry Spiker
8. Marrëdhënie ndërkombëtare të Lindjes së Mesme / Louice Fawcett
9. Marrëdhëniet publike / Joe Marconi
10. Mediat dhe shoqëritë / Francis Balle
11. Nocione të logjikës / Philippe Thiry
12. Partitë politike / Daniel-Louis Seiler
13. Semiotika e tekstit / Maria Pia Pozzato
14. Sociologjia e komunikimit dhe e mediave / Éric Maigret
15. Studime bashkëkohore të sigurisë / Alan Collins
16. Teori të marrëdhënieve ndërkombëtare / Tim Dunne, Milja Kurki, Steve Smith

NË PROCES

1. Elementët e sociologjisë / Henry Giddings
2. Gjeopolitika – Gjeografia e marrëdhënieve ndërkombëtare / Saul Bernard Cohen
3. Hyrje në analizën e ligjëritit – Teori dhe metodë / James Paul Gee
4. Hyrje në filozofinë politike / Jonathan Wolf
5. Komunikimi politik modern / James Stanyer
6. Kuptimi i komunikimit njerëzor / Ronald Adler, George Roadman
7. Manual i punonjësit të marrëdhënieve me publikun / Merry Aronson, Don Spetner, Carol Ames
8. Manual i ri i shkencave politike / Robert Goodin, Hans-Dieter Klingemann
9. Manuali i Kembrixhit për shkencat e edukimit / Keith Sawyer
10. Manuali i Oksfordit i filozofisë së edukimit / Harvey Siegel
11. Marrëdhënie publike, Strategji dhe taktika / Dennis Wilcox, Glent Cameron
12. Mediat dhe shoqëritë / Francis Balle
13. Një përvijim i filozofisë (Elementët bazë të filozofisë) / Bertrand Rasell
14. Një vështrim në teoritë e komunikimit / Em Griffin
15. Partitë politike – Një studim sociologjik i prirjeve oligarkike të demokracisë moderne / Robert Michels
16. Pasojat e modernitetit / Anthony Giddens
17. Politika e jashtme – Teori, aktorë, raste / Steve Smith, Amelia Hadfield, Tim Dunne
18. Politika e jashtme e SHBA / Jerel Rosati
19. Politikatat e Bashkimit Europian / Michelle Cini
20. Shtatë dijet e nevojshme për edukimin e së ardhmes / Edgar Morin
21. Sociologjia e sjelljes devijante / Marshall Clinard, Robert Meier
22. Sociologjia sot – Elementë themelorë / Michael Kimmel, Amy Aronson
23. Strategjia në botën e sotme / John Baylis, James Writz, Colins Gray, Eliot Cohen
24. Teori të demokracisë / Frank Cunningham

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS / TIRANË
Bulevardi “Gjergj Fishta” / www.uet.edu.al / info@uet.edu.al